



DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 427 • QERSHOR 2026



“40 VJET DRITË E DIJES, ZË I BESIMIT DHE I KOMBIT”

REVISTA QË RUAJTI SHPRESËN DHE IDENTITETIN E NJË POPULLI

KATËR DEKADA NË SHËRBBIM TË DRITËS DHE DIJES

REVISTA “DITURIA ISLAME” DHE RRUGËTIMI PËRNDRITËS NË MËRGATË

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Kurban Bajramit

Të dashur besimtarë,

Nesër është dita e Kurban Bajramit, andaj kam kënaqësinë që sot, në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal t'ju drejtohem me përgëzimet dhe urimet më të mira për këtë festë madhështore të Kurban Bajramit, me bindje dhe shpresë që nesër Bajramin ta presim e ta përfetojmë në formën më të mirë të mundshme.

Kjo natë e bekuar na rikujton madhësinë e besimit, fuqinë e sakrificës dhe vlerat që e mbajnë të fortë familjen, shoqërinë dhe kombin tonë.

Kurban Bajrami lidhet ngushtë me adhurimin më madhështor të haxhit, me qëndrimin në Arafat. Sot është dita kur miliona besimtarë nga mbarë bota bashkohen në lutje, përlësi dhe kërkim faljeje para Krijuesit në rrafshnaltën e Arafatit, qëndrim i cili na e mëson barazinë ndërmjet njerëzve, pastërtinë e zemrës dhe nevojën për t'u kthyer gjithmonë te paqja dhe drejtësia, mëshira dhe solidariteti.

Zoti xh.sh., thotë: "Dhe për hir të Allahut, vizita e Shtëpisë (Qabesë) është obligim për ata që kanë mundësi ta përballojnë rrugën." (Ali Imran, 97).

Kjo festë bart në vete edhe simbolikën e kurbanit, një akt i lartë bindjeje, sakrifice dhe afërsie me Zotin e Madhërishëm. Kurbanin na kujton se njeriu fiton vlerë kur di të ndajë nga vetja për të tjerët, kur ndihmon nevojtarin, kur afron zemrat dhe forcon solidaritetin mes njerëzve.

Zoti i Madhërishëm, thotë: "Me të vërtetë, Ne të kemi dhënë ty begati të shumta. Andaj, falu vetëm për Zotin tënd dhe prej kurban!" (El Kevther, 1-2).

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Sot, më shumë se kurrë, kemi nevojë t'i ruajmë traditat tona më të mira, ta forcojmë familjen si themel të shoqërisë dhe ta kultivojmë respektin, dashurinë dhe kujdesin për njëri-tjetrin. Bajrami është festë që bashkon gjenerata, hap dyert e zemrës dhe rikthen vlerat e mirësisë, faljes dhe mirëkuptimit.

Njeriu, si krijesa më e bukur dhe më e nderuar, e pajisur me mendje, ndërgjegje dhe vlera që e dallojnë nga çdo krijesë tjetër, është thirrur në vazhdimësi përmes zbulesës hyjnore të ndërtojë paqe, mirëkuptim, bashkëpunim dhe solidaritet mes njerëzve. Njeriu është krijuar me qëllim që të përhapë dashuri, drejtësi dhe mëshirë, e jo urrejtje, përçarje dhe shkatërrime.

Në realitetin politik dhe ekonomik që po kalon vendi ynë, kjo festë na fton të reflektojmë për më shumë përgjegjësi, unitet dhe shpresë. Le të jetë Bajrami një moment afrimi mes njerëzve, tejkalim i ndasive dhe forcimi i besimit.

Më 7 të muajit të ardhshëm, vendi ynë përballë me një moment vendimtar për demokracinë, dinjitetin qytetar dhe të ardhmen e shtetit, ditën kur zëri i popullit përcakton rrugën që do të ndjekim. Është dita kur vota bëhet forcë, përgjegjësi dhe shpresë, për të mbrojtur të ardhmen tonë me guxim, unitet dhe vizion.

Andaj ju bëj thirrje të gjitha forcave politike në vend që fushatën ta zhvillojnë me dinjitet, maturi dhe respekt, larg gjuhës së urrejtjes dhe përçarjes. Le të garohet me ide, vizion dhe përgjegjësi ndaj atdheut, sepse sovrani është qytetari, dhe vullneti i tij duhet të respektohet mbi çdo interes politik. Pavarësisht rezultatit, Kosova ka nevojë për unitet, bashkëpunim dhe institucione të forta që i shërbejnë popullit dhe mbrojnë të ardhmen e vendit tonë.

I Dërguari i fundit për njerëzimin mbarë, Muhamedi a.s., ka thënë: "Më i dashuri te Zoti është ai që është më i dobishëm për njerëzit."

Ruajtja e vlerave morale, kultivimi i ndërgjegjes, edukimi shpirtëror, përgjegjësia individuale dhe shoqërore, paqja e brendshme, solidariteti njerëzor, respekti reciprok dhe përkushtimi ndaj së drejtës përbëjnë virtyte themelore që duhet ta karakterizojnë besimtarin e devotshëm dhe të drejtë.

Megjithatë, me dhimbje të thellë themi se po jetojmë në një botë ku luftërat, konfliktet dhe padrejtësitë vazhdojnë të marrin jetë të pafajshme çdo ditë. Gjaku i fëmijëve, grave, pleqve dhe civilëve të pambrojtur po derdhet për interesa politike, ekonomike dhe gjeostrategjike, duke e tronditur rëndë ndërgjegjen njerëzore. Në vend të paqes dhe humanizmit, shpesh po mbizotërojnë urrejtja, dhuna dhe interesat që shkelin mbi dinjitetin dhe jetën e njerëzve të pafajshëm.

Andaj në këtë natë feste e reflektimi, mesazhi i Bajramit bëhet edhe më i fuqishëm: Kur ne zgjedhim paqen para urrejtjes, dialogun para konfliktit dhe humanizmin para interesave që sjellin shkatërrim. Sakrifica dhe solidariteti që simbolizojnë këtë festë na ftojnë të mos heshtim përballë padrejtësisë, por të lutemi dhe të angazhohemi për një botë më të drejtë, më njerëzore dhe më të sigurt për të gjithë.

Në këtë Natë të Bajramit, uroj që në familjet tuaja të mbretërojë paqja, harmonia dhe begatia. Zoti i pranofte lutjet, sakrificat dhe veprat tona të mira, ndërsa zemrat tona i mbushtë me mëshirë, dashuri dhe shpresë.

Me fat festa e Kurban Bajramit!

Myftiu Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 26.05.2026

- 2 Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Kurban Bajramit

JUBILEU

- 4 "Dituria Islame"- katër dekada konsekuencë ndaj dijes e të vërtetës
- 5 Revista "Dituria Islame" – kronikë e qëndresës shpirtërore, kombëtare dhe historike të shqiptarëve në katër dekadat e fundit
Myftiu Naim ef. Tërnavë
- 10 Revista që ruajti shpresën dhe identitetin e një populli - Intervistë me prof. Sabri Bajgorën
- 15 Revista "Dituria Islame" dhe funksioni i saj në formësimin e mendimit islam dhe identitetit kombëtar shqiptar
Ramadan Shkodra
- 22 "Dituria Islame" dhe kontributi i saj në fuqizimin e identitetit kombëtar shqiptar në Kosovë (1990–1999)
Dr. Sadik Mehmeti
- 27 Dimensioni letrar dhe kulturor i "Diturisë Islame"
Dr. Hysen Matoshi
- 31 Katër dekada në shërbim të dritës dhe dijes
Elez Osmani
- 33 "Dituria Islame" – frymëzim për imamët dhe dritë për xhematin
Isa Tërshani
- 37 "Dituria Islame" te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut
Prof. dr. Ziber Lata
- 39 Roli i revistës "Dituria Islame" në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar në Luginën e Preshevës
Sulejman Fejzullahu
- 42 Revista "Dituria Islame" dhe rrugëtimi përndritës në mërgatë
Bashkim Aliu
- 45 Kontributi i revistës "Dituria Islame" në avancimin e rolit të gruas myslimane shqiptare
Dr. Violeta Smajlaj

FETARE

- 48 Kurban Bajrami – Festa e sakrificës, mëshirës dhe solidaritetit – thirrje për unitet dhe përgjegjësi
- 50 Pamje nga hixhreti i shokëve të Pejgamberit a.s. drejt Medinës së ndritur
Idris Ahmed
- 54 Objektivat hyjnore (2)
Dr. Zenel Hajdini
- 57 Ateizmi i ri dhe Islami
Muhammad Legenhausen
- 59 Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (8)
Hazir D. Selmani

EDUKIM DHE FAMILJE

- 63 Identiteti islam i Bashkimit Evropian
Enis Reçica
- 66 Brezi i ekraneve – fëmijët në epokën digjitale
Dr. Flora Hajdarmataj
- 71 Statusi ekonomik i gruas sipas Islamit
Anisa Hoti
- 73 Mishi dhe shëndeti: nevojë apo teprim?
Agron M. Rexhepi, PhD, MSci, MD

KULTURË

- 76 Filozofia islame në periudhën e kalifatit abasid
MA. Liron Krasniqi
- 80 Mulla Ramë Gërvalla – mësues dhe hoxhë i kohës
Mr. Fatos Gërvalla
- 82 Muhaxhirët – ruajtësit e identitetit kombëtar përmes fesë islame
Refik Gërbeshi

HISTORI DHE CIVILIZIM

- 87 Beogradi – qytet i xhamive dhe minareve
Dr. Azmir Jusufi
- 90 Vështrim i shkurtër mbi inkuizicionin spanjoll
Sumeja Tahiri

REPORTAZH

- 93 Në Kosovë u prit dhe u festua festa e Kurban Bajramit
- 96 Nga Kosova drejt Mekës - një udhëtim i përjetuar me shumë përkushtim



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 427 • viti 39 • QERSHOR 2026
• Dhul Hixhxe 1447
• Çmimi 2 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



“Dituria Islame”- katër dekada konsekuencë ndaj dijes e të vërtetës

“Allahu do t'i lartësojë në shkallë ata që besojnë dhe ata që janë pajisur me dije.”

(El Muxhadele, 11)

Fundshekulli i kaluar kishte ruajtur për shqiptarët ndryshime të mahnitshme, nga ato që edhe ëndërrimtarët më idealistë e kishin vështirë t'i përfytyronin se do t'iu ndodhnin mbi truallin e vet. Aspirata e kahershme për ta jetësuar mëvetësinë e tokës së trashëguar nisi të artikulohej, jo më thjesht si një ëndërr e largët, por si një projekt dhe detyrim historik i patejkalueshëm që përgjeronte me ngulm ndërgjegjen kolektive të kombit tonë. Një vërtetim i kujdesshëm i ndryshimeve në kapërcyell të shekullit që lamë pas, do të na rrëfente se sa më shumë që i shtrëngohej laku në fyt këtij populli të shumëvuahtur, aq më shumë edhe do të vezullonte në horizontin e tij drita e shpresës, se mizorisë mbase po i vinte fundi. Në këtë vorbull të frikshëm, të furtunave ciklonike, që sihariqonin shkëlqimin e rendit të errët monist gjithandej nëpër botë, prijësit fetarë myslimanë të Kosovës, po nxirrnin në skenë edhe një zë kumbues, i cili përvijonte shtigjet e besimit të drejtë, lirisë së merituar e mëvetësismit pa kushte.

Në qershorin e vitin 1986, si një ag i shumëpritur pas një nate të gjatë, doli në dritë revista që mori si amanet ta mbante të gjallë shpresën për liri dhe ta shpërndante besnikërisht dritën e diturisë. Ishte pra “Dituria Islame” që po lindte me një detyrë fisnike, po aq sa ishin fisnikë edhe ideatorët sypatrembur të saj, dhe me një mision krejt të dëlirë: që të mbante të ndezur fanarin e dijes, e ta çelikeste aspiratën për liri, në një popull që fortunat historike e aspiratat gllabëruese të armiqve të pa mëshirë, kishin goditur gjer në molisje bijtë dhe bijat e tij.

Me bindjen se fjala e shkruar ka fuqinë mahnitëse që t'i flasë njeriut për çdo kohë e në çdo kohë, pareshtur e gjer në amshim, lapsat e guximshëm të shkollarëve myslimanë të këtyre trojeve gravinin urtësisht porosinë e Zotit në fletat e një reviste që i rezistonte valëve goditëse të popullit tonë anëmbanë.

“Dituria Islame” fliste sikur populli, ëndërronte guximshëm sikur patriotët e tij dhe rezistonte me pietet po sikur heronjtë e tij. Ajo tregoi më së miri së populli ynë, intelektualët e mirëfilltë të saj nuk durojnë mospërfilljen dhe i rezistojnë guximshëm tentativave mjerane të gjithë atyre që përpiqen padrejtësisht ta shuajnë zërin e tij.

Rrallëherë emërtimi i një reviste, siç thuhet, përkonte plotësisht me qëllimin e saj, por revista, e denjoi emrin e vet, dhe për katër deca me radhë besnikërisht e përhap diturinë, sublimoi rolin e bartësve të saj, dhe për më tepër rrënjosi në mendësinë e shqiptarëve faktin se çdo dituri e mirëfilltë në të vërtetë ishte dhe mbetet e mishëruar për Islamin. Ata penëdashës s'bënin asgjë më shumë, vetëm se synonin që të fiksonin idenë se ngritja e një individi, e sigurisht edhe e një populli duhet t'i ketë dy shtylla: besimin e drejtë dhe dijen e mirëfilltë. Niseshin nga premisa e fjalës së Allahut të Lartëmadhëruar ku tha në Kuran: “Allahu do t'i lartësojë në shkallë ata që besojnë dhe ata që janë pajisur me dije.” (El Muxhadele, 11).

Megjithatë, nëse misioni i saj në të kaluarën ishte të mbillte farën e dijes, të ruante identitetin fetar e kulturor të kombit tonë dhe të formësonte vetëdijen e brezave në kohë sfiduese, atëherë misioni që e pret në të ardhmen është po aq fisnik edhe hiç më pak i rëndësishëm. Në një kohë kur zhurma e mendimeve rrezikon të mbyset zërin e së vërtetës, dhe kur trendi i relativizmit moral dhe rrymat zhvlerësuese të virtyteve të trashëguara tentojnë të bëhen sipërore në shoqërinë tonë, “Dituria Islame” do të vazhdojë të jetë tribunë e mendimit të kthjellët, e dijes autentike islame dhe pararendës i orientimit të shëndoshë intelektual, moral e shpirtëror të bijtë e brezave në vijim.

Prandaj, 40-të vjetori i “Diturisë Islame” nuk është vetëm një kremtim i një historie të lavdishme, thjesht sa për të thurur elozhe për të kaluarën e ndritshme, por bartë te ne një testament të brezave të shkuar, që duhet ruajtur e ripërtërirë si një besëlidhje me fisnikërinë e etikën dhe si një mishërim me të vërtetën. Pa u zmbrapsur nga vizioni i saj fare, ky zë i kumbueshëm zotohet se do të mbrojë dinjitetin e njeriut përmes besimit, do ta ruajë shenjtërinë e moralit e të familjes. Ajo do të afirmojë kuptimësinë e shëndoshë përballë zbrazëtisë shpirtërore dhe do t'ua rikujtojë gjithsecilit se vlerat nuk janë sajese e konstruksione kalimtare të një epoke, por dritë e përhershme që nuk vjetërsohen kurrë ngase kanë në themel të vetin udhëzimin hyjnor dhe të vërtetën absolute.

Mr. Driton Arifi

Revista “Dituria Islame” – kronikë e qëndresës shpirtërore, kombëtare dhe historike të shqiptarëve në katër dekadat e fundit

Myftiu Naim ef. Tërnavë

Shkrimi dhe dija zënë një vend qendror në Sqytetërimin islam, duke u konsideruar jo vetëm mjete komunikimi, por edhe amanete hyjnore, intelektuale dhe civilizuese. Që nga shpallja e parë kuranore, me urdhrin “Lexo!” dhe përmendjen e “penës”, Islami e ka ngritur dijen dhe dokumentimin e saj në një rang të vlerave themelore të zhvillimit njerëzor

Në fillim të sures El Kalem, Allahu i Madhëruar shpall: ن. وَالْقَلَمِ وَمَا يَسْطُرُونَ “Nun. Betohe me për penën dhe për atë që shkruajnë.” (El Kalem, 1).

Ky betim hyjnor përbën një nga afirmimet më madhështore të vlerës së dijes në Islam. Fakti që Krijuesi i gjithësisë betohet në penën dhe në atë që shkruhet me të, dëshmon pozitën e jashtëzakonshme që feja islame i kushton diturisë, mendimit, kulturës dhe fjalës së shkruar. Në traditën kuranore, betimi hyjnor lidhet vetëm me realitete dhe shenja që bartin urtësi të thella dhe ndikim vendimtar në jetën njerëzore. Prandaj pena shfaqet si simbol i qytetërimit, i vetëdijes dhe i përparimit njerëzor.

Në konceptimin islam, pena nuk është thjesht një mjet fizik shkrimi, por një simbol i ruajtjes së dijes, i transmetimit të së vërtetës dhe i ndërtimit të civilizimeve. Përmes saj janë ruajtur shpalljet hyjnore, janë transmetuar mësimet pejgamberike, janë dokumentuar historitë e popujve dhe është trashëguar përvoja intelektuale e njerëzimit.

Pjesa e ajetit: “dhe për atë që shkruajnë”, e zgjeron domethënien e betimit përtej instrumentit të shkrimit, duke e përqendruar vëmendjen edhe te përmbytja dhe përgjegjësia morale e fjalës së shkruar.

Shkrimi ka bërë të mundur që mendimi njerëzor të kapërcejë kufijtë e kohës dhe të mbetet i gjallë ndër breza.

Pjesa e ajetit: “dhe për atë që shkruajnë”, e zgjeron domethënien e betimit përtej instrumentit të shkrimit, duke e përqendruar vëmendjen edhe te përmbytja dhe përgjegjësia morale e fjalës së shkruar. Islami nuk e vlerëson vetëm mjetin, por edhe mesazhin që përcillet përmes tij. Pena mund të jetë mjet udhëzimi ose devijimi, ndërtimi ose shkatërrimi, drejtësi ose mashtrimi. Për këtë arsye, fjala e shkruar bart një përgjegjësi të jashtëzakonshme etike dhe shoqërore.

Ky ajet përfaqëson gjithashtu një nderim të lartë për dijetarët, mendimtarët, shkrimtarët





dhe të gjithë ata që kontribuojnë në përhapjen e dijes dhe të vërtetës. Njerëzit e penës formësojnë vetë-dijen kolektive, edukojnë brezat dhe ndikojnë në orientimin moral e kulturor të shoqërive. Historia dëshmon se një ide e shkruar ka fuqinë të ndryshojë rrjedhën e epokave, të ngrejë kombe dhe të ruajë identitetin e tyre.

Nuk është rastësi që Kurani, mrekullia e fundit hyjnore, u ruajt përmes memorizimit dhe shkrimit. Pikërisht përmes penës u zhvilluan shkencat islame, teologjia, jurisprudenca, filozofia, mjekësia, astronomia dhe fusha të tjera që kontribuan në ndriçimin e njerëzimit për shekuj me radhë.

Në kohën bashkëkohore, kur fjala e shkruar përhapet me shpejtësi të paprecedentë përmes teknologjisë dhe mediave, ky betim kuranor fiton një aktualitet edhe më të madh. Ai na kujton se pena dhe fjala posedojnë fuqi të jashtëzakonshme për të ndërtuar ose shkatërruar, për të edukuar ose manipuluar, për të përhapur të vërtetën ose gënjeshtërën. Prandaj, Islami e konsideron penën një amanet të shenjtë moral, i cili duhet të vihet gjithmonë në shërbim të së vërtetës, drejtësisë, dijes dhe dinjitetit njerëzor.

“DITURIA ISLAME” – INSTITUCION I MENDIMIT ISLAM, FORMIMIT KULTUROR DHE RUAJTJES SË IDENTITETIT KOMBËTAR SHQIPTAR

Mund të pohohet me bindje se revista tremujore “Edukata Islame” dhe “Takvimi-Kalendari vjetor” përbënin bazën e parë institucionale dhe intelektuale mbi të cilën u ndërtua projekti i mëvonshëm botues i revistës “Dituria Islame”. Përvoja e fituar nëpërmjet këtyre botimeve, si në aspektin organizativ ashtu edhe në atë përmbajtësor, krijoi parakushtet e nevojshme për themelimin dhe konsolidimin e një reviste më të avancuar e më gjithëpërfshirëse, duke e shndërruar kështu “Diturinë Islame” në vazhdimësi natyrore të një tradite tashmë të krijuar publicistike dhe kulturore.

Pas botimit të përkthimit të parë të Kuranit në gjuhën shqipe më 1985, një ngjarje që shënoi kthesë të madhe në jetën shpirtërore të shqiptarëve, ishte themelimi i revistës “Dituria Islame”, e cila përfaqësoi hapin e dytë madhor në procesin e afirmimit të dijes islame në gjuhën amtare. Themelimi i revistës “Dituria Islame” në vitin 1986 nga ana e Bashkësisë Islame përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë moderne të mendimit fetar, kulturor dhe intelektual të shqiptarëve myslimanë në Kosovë dhe më gjerë. Ajo lindi në një periudhë të ndërlikuar historike, kur shqiptarët ishin privuar nga çdo e drejtë elementare e tyre

nga okupimi klasik i Serbisë; kur përballëshim me mungesë të literaturës islame në gjuhën shqipe, me kufizime ideologjike ndaj fesë dhe me sfida serioze në ruajtjen e identitetit tonë fetar e kombëtar.

Në rrethanat e një sistemi që synonte marginalizimin e religjionit nga jeta publike, nevoja për një platformë të organizuar të edukimit dhe komunikimit islam ishte bërë domosdoshmëri historike për shqiptarët.

Në një kohë kur ideologjitë materialiste dhe ateiste ushtronin ndikim të konsiderueshëm në jetën shoqërore, “Dituria Islame” ofroi një alternativë intelektuale dhe shpirtërore të bazuar në argumentim, dije dhe moral. Ajo promovoi dialogun, mendimin kritik, harmoninë ndërmjet fesë dhe shkencës, si dhe vlerat universale të drejtësisë, solidaritetit dhe dinjitetit njerëzor.

Në këtë frymë, revista “Dituria Islame”, përgjatë katër dekadave të veprimtarisë së saj, është shndërruar në një institucion të rëndësishëm të mendimit, kulturës dhe edukimit islam në hapësirën shqiptare. Përmes trajtimit të temave teologjike, juridike, historike, filozofike, etike, kulturore dhe shkencore, revista ka kontribuar në formimin intelektual të lexuesit, promovimin e mendimit kritik dhe ruajtjen e identitetit fetar, kulturor e kombëtar. Ajo ka shërbyer si platformë akademike për studiues, imamë dhe intelektualë, duke ndërtuar një traditë të qëndrueshme të dijes, debatit dhe vetëdijes shkencore.

Rëndësia e saj lidhet ngushtë me traditën islame të ruajtjes dhe transmetimit të dijes, e cila buron nga vetë praktika pejgamberike e dokumentimit të shpalljes hyjnore. I Dërguari i fundit prej Zotit xh.sh., Muhamedi a.s., urdhëroi shkrimin e menjëhershëm të ajeteve kuranore, duke siguruar autenticitetin dhe transmetimin e saktë të Fjalës së Zotit brez pas brezi. Në këtë kuptim, kontributi shumëvjeçar i revistës “Dituria Islame”, përfaqëson jo vetëm një vlerë kulturore dhe akademike, por edhe një mision edukativ dhe shpirtëror, i cili vazhdon të shërbejë si formë e sadakasë rrjedhëse përmes dijes së dobishme që u transmetohet brezave.

Revista u shndërrua në tribunën kryesore të mendimit islam shqiptar, duke ofruar edukim fetar sistematik, njohuri kulturore, historike dhe morale, si dhe duke krijuar një urë të qëndrueshme komunikimi ndërmjet institucioneve fetare, dijetarëve dhe besimtarëve. Njëkohësisht, revista “Dituria Islame”, luajti rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen dhe dokumentimin e trashëgimisë islame shqiptare, në afirmimin e kontributit të dijetarëve shqiptarë ndër shekuj dhe në lidhjen e myslimanëve shqiptarë me zhvillimet intelektuale e kulturore të botës islame. Përmes përkthimeve, studimeve dhe analizave bashkëkohore, ajo e integroi lexuesin shqiptar në rrjedhat më të gjera të mendimit islam ndërkombëtar.

E lindur në një periudhë të ndjeshme historike, të karakterizuar nga mungesa e literaturës islame në gjuhën shqipe, kufizimet ideologjike dhe sfidat e ruajtjes së identitetit, ajo mori përsipër një mision të shumëfishtë: përhapjen e dijes islame, edukimin moral e shpirtëror të besimtarëve dhe forcimin e vetëdijes kombëtare shqiptare.

Përmes trajtimit të temave nga teologjia, etika, historia, qytetërimi islam, arsimit, kultura dhe çështjet shoqërore, revista kontribuoi në ngritjen intelektuale dhe fetare të lexuesve shqiptarë. Në një kohë kur botimet islame në gjuhën shqipe ishin të rralla, ajo u bë një burim i besueshëm orientimi, edukimi dhe formimi kulturor, duke ndikuar drejtpërdrejt në ruajtjen e identitetit fetar, gjuhësor dhe kombëtar të shqiptarëve.

Me kalimin e viteve, “Dituria Islame” u afirmua si një zë autoriteti që ndriçoi mendjet dhe preku zemrat e mijëra lexuesve në Kosovë, në të gjitha trojet shqiptare dhe në mërgatë. Ajo krijoi një lidhje të qëndrueshme ndërmjet dijes fetare dhe nevojave konkrete të shoqërisë, duke promovuar një kuptim autentik, racional dhe të balancuar të Islamit. Përmes qasjes së saj argumentuese dhe edukative, revista luajti rol të rëndësishëm në formimin e vetëdijes kritike, në mbrojtjen e rinisë nga ndikimet ideologjike dhe në afirmimin e vlerave universale të moralit, dijes dhe përgjegjësisë shoqërore.

Një dimension i veçantë i veprimtarisë së saj ishte trajtimi i historisë kombëtare dhe i rolit të institucioneve fetare në ruajtjen e identitetit shqiptar. Përmes studimeve dhe analizave historike, revista argumentoi se imamët, xhamitë, mejtetet dhe medresetë, nuk ishin vetëm qendra të edukimit fetar, por edhe institucione që kontribuan në ruajtjen e gjuhës shqipe, të traditës kombëtare dhe të vetëdijes kulturore gjatë periudhave të ndryshme historike. Në këtë kontekst, ajo vlerësoi kontributin e figurave fetare shqiptare në proceset e emancipimit kulturor dhe të rilindjes kombëtare.

Rëndësia e revistës u bë edhe më e dukshme gjatë periudhës së represionit serb në Kosovë (1989–1999). Në një kohë kur institucionet shqiptare përballëshin me mbyllje, censurë dhe diskriminim sistematik, “Dituria Islame” mori përsipër një rol të gjerë shoqëror e kombëtar. Ajo dokumentoi shkeljet e të drejtave të njeriut, represionin institucional, mbylljen e shkollave dhe universiteteve shqiptare, si dhe vuajtjet e popullsisë shqiptare nën regjimin serb. Në këtë mënyrë, revista u shndërrua në një dëshmi të rëndësishme historike dhe në një mbrojtëse të së vërtetës kolektive të kohës.


Njëkohësisht, ajo promovoi vlerat e rezistencës paqësore, solidaritetit shoqëror dhe unitetit kombëtar. Vëmendje të veçantë i kushtoi lëvizjes së pajtimit të gjaqeve, duke e konsideruar atë si një nga proceset më të rëndësishme morale e kombëtare në historinë moderne të shqiptarëve. Përmes artikujve, analizave dhe kronikave të saj, revista kontribuoi në forcimin e kohezionit shoqëror dhe në ruajtjen e stabilitetit moral të popullit shqiptar në periudha të vështira historike.


Ajo luajti rol të pazëvendësueshëm në edukimin fetar islam, ngritjen intelektuale, ruajtjen e identitetit islam të shqiptarët, dokumentimin e proceseve historike dhe mbrojtjen e vlerave shpirtërore e kombëtare. Për këtë arsye, “Dituria Islame” mbetet një nga monumentet më të rëndësishme të mendimit, kulturës dhe trashëgimisë intelektuale të shqiptarëve.

REVISTA “DITURIA ISLAME” GJATË LUFTËS SË KOSOVËS – DOKUMENTIM, DËSHMI DHE QËNDRESË

Gjatë periudhës së luftës në Kosovë (1998–1999), revista “Dituria Islame”, tejkaloj rolin e një botimi të zakonshëm fetar dhe u shndërrua në një tribunë të rëndësishme të dokumentimit historik, të mbrojtjes së të vërtetës dhe të afirmimit të dinjitetit kombëtar të shqiptarëve. Në një kohë kur popullsia shqiptare përballej me represion sistematik, spastrime etnike, dëbime masive, vrasje, masakra dhe shkatërtime të organizuara nga regjimi serb, revista mori përsipër misionin e dëshmimit të realitetit dhe të sensibilizimit të opinionit vendor e ndërkombëtar për tragjedinë që po përjetonte Kosova.

Përmes kronikave, analizave, reportazheve dhe dëshmive autentike, revista “Dituria Islame” dokumentoi me përgjegjësi intelektuale dhe morale format më të rënda të dhunës





shtetërore serbe, duke evidentuar shkeljet sistematike të të drejtave themelore të njeriut, terrorin policor e ushtarak, burgosjet arbitrare, masakrat ndaj civilëve dhe politikën e dëbimit masiv të shqiptarëve nga trojet e tyre. Në këtë aspekt, revista u shndërrua në një arkiv të rëndësishme të kujtesës kolektive dhe në një dëshmi të çmuar historike të vuajtjeve dhe rezistencës së popullit shqiptar.

Njëkohësisht, revista promovoi vlerat e solidaritetit, humanizmit dhe qëndresës morale, duke theksuar se feja islame nuk përfaqëson vetëm dimensionin shpirtëror të jetës, por edhe një burim force etike, përgjegjësie shoqërore dhe mbrojtjeje të dinjitetit njerëzor. Përmes faqeve të saj u afirmua rëndësia e ndihmës reciproke, unitetit kombëtar dhe ruajtjes së identitetit kulturor e fetar në kushtet e luftës dhe të krizës humanitare.

Një dimension i veçantë i veprimtarisë së saj ishte ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës. Duke publikuar informacione, analiza dhe dëshmi mbi krimet e kryera ndaj shqiptarëve, revista synonte të zgjonte ndërgjegjen e botës demokratike dhe të vendeve islame përballë katastrofës që ndodhte në Kosovë. Në këtë mënyrë, revista “Dituria Islame” u bë një urë komunikimi ndërmjet Kosovës dhe opinionit ndërkombëtar, duke mbrojtur të drejtën e popullit shqiptar për liri, dinjitet dhe vetëvendosje. Revista dëshmon se Bashkësia Islame nuk mbeti e kufizuar vetëm në misionin e saj fetar, por u shndërrua në një institucion me rol të gjerë humanitar, kombëtar dhe shoqëror. Kjo ngase xhamitë, Këshillat e Bashkësisë Islame dhe strukturat e saj lokale u kthyen në qendra të organizimit humanitar, të solidaritetit

qytetar dhe të mbështetjes së popullatës civile dhe të UÇK-së, duke ofruar strehim për të zhvendosurit, shpërndarë ndihma humanitare, mbështetur familjet e viktimave dhe kontribuar në ruajtjen e kohezionit shoqëror në kohët më të vështira të historisë moderne të Kosovës.

Në këtë kuptim, revista “Dituria Islame” bashkoi dijen, fenë, humanizmin dhe patriotizmin në shërbim të së vërtetës historike, duke ruajtur kujtesën e një periudhe tragjike dhe duke dëshmuar për qëndresën, vuajtjet dhe aspiratat e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi. Prandaj, kontributi i saj gjatë luftës mbetet një kapitull i veçantë në historinë e gazetarisë, kulturës dhe mendimit kombëtar shqiptar, si një shembull i përgjegjësisë intelektuale dhe morale në mbrojtje të së vërtetës, drejtësisë dhe dinjitetit njerëzor.

REVISTA “DITURIA ISLAME” – QENDËR E VETËDIJES KOMBËTARE DHE ZË I KOSOVËS NË BOTË

Gjatë viteve të okupimit serb dhe luftës në Kosovë, revista “Dituria Islame” dokumentoi me përkushtim rolin e Bashkësisë Islame dhe Medresesë, në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe në mbrojtjen e interesave të popullit shqiptar. Medreseja paraqitej si një qendër e rëndësishme e mendimit intelektual, e edukimit dhe e vetëdijes kombëtare, ku zhvilloheshin takime dhe diskutime për sfidat politike, shoqërore dhe kombëtare të kohës.

Revista pasqyroj gjithashtu kontributin e diasporës shqiptare dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës në organizimin e ndihmës humanitare, forcimin e solidaritetit kombëtar dhe mbështetjen e çështjes së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Përmes raportimeve mbi takimet, konferencat dhe aktivitetet ndërkombëtare të përfaqësuesve të Bashkësisë Islame, ajo kontribuoi në sensibilizimin e opinionit botëror, veçanërisht të vendeve islame, për represionin, spastrimin etnik dhe vuajtjet e popullit shqiptar.

Në këtë mënyrë, “Dituria Islame” tejkaloi rolin e një reviste fetare dhe u shndërrua në një platformë të rëndësishme të vetëdijes kombëtare, të dokumentimit historik dhe të ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, duke mbrojtur me argumente, dinjitet dhe përgjegjësi të vërtetën, drejtësinë dhe të drejtën e popullit shqiptar për liri e pavarësi.

Gjatë luftës së Kosovës, revista “Dituria Islame” dokumentoi me përgjegjësi historike sakrificën e popullit shqiptar dhe heroizmin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke e paraqitur atë si shprehjen më të lartë të përpjekjes për liri, dinjitet dhe mbrojtje të atdheut. Në faqet e saj pasqyroheshin trimëria dhe flijimi i luftëtarëve të UÇK-së, si dhe mbështetja morale e shpirtërore që institucionet fetare i jepnin qëndresës kombëtare.

Revista evidentoi gjithashtu krimet e kryera gjatë luftës, duke dokumentuar masakrat ndaj civilëve, dëbimet masive,

shkatërrimin e vendbanimeve shqiptare dhe vuajtjet e popullsisë, me synimin që këto ngjarje të ruheshin në kujtesën historike si dëshmi e një periudhe tragjike për Kosovën. Revista dokumentoi gjithashtu dramën e eksodit të shqiptarëve gjatë luftës, duke evidentuar vuajtjet e popullsisë së dëbuar me dhunë, por njëkohësisht edhe solidaritetin e jashtëzakonshëm të shqiptarëve në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, për pritjen dhe strehimin e vëllezërve të tyre të dëbuar, por edhe pritjen dhe strehimin e tyre nëpër shumë shtete të Evropës, Amerikës, Kanadasë, e vendeve të tjera të botës.

Një vend të rëndësishëm zinte edhe pasqyrimi i mbështetjes ndërkombëtare për Kosovën, veçanërisht ndërhyrja e NATO-s, e cila paraqitej si moment vendimtar për ndalimin e dhunës dhe çlirimin e vendit. Revista shprehte mirënjohjen e popullit shqiptar ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të Bashkimit Evropian dhe Aleancës së NATO-s, për rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe për hapjen e rrugës drejt lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

REVISTA “DITURIA ISLAME” NË KOSOVËN E PASLUFTËS DHE TË PAVARËSISË – ARKIV I KUJTESËS KOMBËTARE DHE PASQYRË E MISIONIT FETAR, KULTUROR E KOMBËTAR

Edhe pas përfundimit të luftës së viteve 1998-1999, revista “Dituria Islame” vazhdoi të luajë një rol të rëndësishëm në jetën fetare, kulturore dhe intelektuale të Kosovës, duke u shndërruar në një kronikë të besueshme të proceseve historike, shoqërore dhe shtet formuese të periudhës së pasluftës. Në faqet e saj u pasqyruan me seriozitet akademik zhvillimet kryesore që lidhen me rindërtimin e vendit, konsolidimin e institucioneve demokratike dhe forcimin e identitetit shtetëror e kombëtar të Kosovës.

Një vend të veçantë zuri trajtimi i Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe heroizmit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila paraqitej si simbol i sakrificës, lirisë dhe dinjitetit kombëtar. Revista i kushtoi vëmendje të veçantë dëshmorëve të kombit, duke ruajtur kujtimin dhe veprën e tyre si themele morale e historike të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Po ashtu, “Dituria Islame” dokumentoi me mirënjohje mbështetjen vendimtare të aleatëve ndërkombëtarë, veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve perëndimore dhe NATO-s, duke e konsideruar ndërhyrjen e tyre faktor kyç në ndalimin e spastrimit etnik dhe në çlirimin e Kosovës. Në këtë kuadër, revista e paraqiste lirinë dhe pavarësinë e Kosovës si rezultat të ndërthurjes së sakrificës së popullit shqiptar, luftës së UÇK-së dhe mbështetjes së fuqishme ndërkombëtare.

Një nga momentet më të rëndësishme të pasqyruara në faqet e saj ishte shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt

2008, e trajtuar si realizim i aspiratave shekullore të popullit shqiptar dhe si kurorëzim i një rruge të gjatë sakrifice, rezistence dhe përkushtimi kombëtar. Në vazhdimësi, revista pasqyroj edhe përpjekjet e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe në Luginën e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit për realizimin e të drejtave të tyre kombëtare, duke dokumentuar sakrificat, qëndresën dhe aspiratat e tyre për liri, barazi dhe dinjitet.

Revista “Dituria Islame” mbetet një burim me vlerë të veçantë për studimin e periudhës së luftës, të shtet ndërtimit të Kosovës dhe të rolit që feja, kultura dhe identiteti kombëtar kanë luajtur në historinë bashkëkohore shqiptare. Gjatë pothuajse katër dekadave të veprimtarisë së saj, revista “Dituria Islame” ka tejkaluar kufijtë e një organi të zakonshëm fetar, duke u shndërruar në një institucion të rëndësishëm të kujtesës historike, të mendimit intelektual dhe të vetëdijes kombëtare shqiptare. Përmes faqeve të saj, ajo ka dokumentuar me përkushtim zhvillimet më të rëndësishme fetare, kulturore, shoqërore, kombëtare dhe politike që kanë shënuar historinë moderne të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi.

Në periudhat më të vështira të ekzistencës sonë kombëtare, kur Kosova përballej me represion, dhunë sistematike, luftë dhe përpjekje për shuarjen e identitetit të saj, “Dituria Islame” mbeti një zë i palëkundur i së vërtetës, i dinjitetit njerëzor dhe i ndërgjegjes kombëtare. Ajo regjistroi me përgjegjësi historike vuajtjet, sakrificat, qëndresën dhe idealet e popullit shqiptar, duke ruajtur për brezat e ardhshëm një pasuri të jashtëzakonshme dokumentare mbi një nga periudhat më vendimtare të historisë sonë.

Vlera e saj nuk qëndron vetëm në pasqyrimin e ngjarjeve, por edhe në dokumentimin e rolit të fesë, të institucioneve islame, të solidaritetit shoqëror dhe të forcës morale që ndihmuan popullin shqiptar të përballonte sfidat më të mëdha të kohës. Në këtë aspekt, revista paraqet një burim të pazëvendësueshëm për studimin e historisë fetare, kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve.

Me plot të drejtë mund të thuhet se “Dituria Islame” përfaqëson një mini-enciklopedi të historisë bashkëkohore shqiptare dhe një arkiv të gjallë të memories kolektive të Kosovës. Në faqet e saj u ndërthuren harmonishëm besimi, kultura, patriotizmi, sakrifica dhe aspirata për liri, duke e bërë atë një thesar të çmuar intelektual e kombëtar. Si e tillë, ajo mbetet një trashëgimi me vlerë të jashtëzakonshme shkencore, historike dhe kulturore, e destinuar të shërbejë si referencë e rëndësishme për studiuesit, historianët dhe brezat që do të vijnë.

Intervistë me Sabri ef. Bajgorën, në numrin ekskluziv të jubilarit të katërt (1986-2026) të “Diturisë Islame”

Revista që ruajti shpresën dhe identitetin e një populli

“Për 40 vjet, ‘Dituria Islame’ ka qenë urë ndërmjet traditës dhe kohës sonë, tribunë e dijes dhe zë i shpresës, identitetit dhe vetëdijes islame ndër shqiptarë.”

Kjo intervistë sjell jo vetëm kujtimet e një kryeredaktori, por një rrëfim të gjallë mbi rolin e “Diturisë Islame” në ngritjen e vetëdijes në kohë krize e lufte shfarosëse, pasqyrimin e zërit të qëndresës e të rezistencës gjithëpopullore shqiptare asokohe dhe mbi mësimet që ajo periudhë i lë brezave që vijnë.

Pas 40 vjetësh, si do ta përkufizonit vlerën dhe rolin që ka pasur “Dituria Islame” në shoqërinë tonë?

Kur flasim për katër dekada të revistës “Dituria Islame”, nuk flasim thjesht për historinë e një botimi periodik, por për historinë e një institucioni të mendimit, kulturës dhe vetëdijes islame ndër shqiptarë. Që nga numri i saj i parë në qershor të vitit 1986 e deri më sot, revista ka qenë një tribunë e dijes, e edukimit dhe e formimit intelektual e shpirtëror

të brezave të tërë, jo vetëm në Kosovë, por gjithandej në trojet shqiptare në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Luginë të Preshevës, më pas edhe në Shqipëri dhe pa dyshim, në diasporë.

Vlera e saj qëndron para së gjithash në faktin se ajo arriti të krijojë një urë të qëndrueshme ndërmjet traditës sonë islame e kombëtare dhe sfidave bashkëkohore. Nëpërmjet faqeve të saj janë trajtuar tema fetare, kulturore, historike, arsimore dhe kombëtare, duke ndihmuar në formimin e një vetëdijeje të shëndoshë fetare dhe kombëtare. Për shumë lexues, veçanërisht në vitet kur qasja në literaturën islame ishte e kufizuar, për shkak të mungesës së saj, “Dituria Islame” ishte dritarja kryesore për t’u njohur me vlerat e Islamit, me historinë tonë dhe me zhvillimet intelektuale në botën myslimane.



Roli i saj bëhet edhe më i rëndësishëm kur kujtojmë periudhat e vështira që kaloi populli ynë. Në vitet e represionit, të përjashtimit institucional dhe më pas gjatë luftës së viteve 1998-1999, revista nuk u kufizua vetëm në trajtimin e temave fetare, por u bë një zë i fuqishëm i dinjitetit njerëzor, i mbrojtjes së identitetit kombëtar dhe i shpresës kolektive.

Pas 40 vjetësh mund të them me bindje të plotë se *“Dituria Islame”* ka qenë më shumë se një revistë. Ajo ka qenë një kujtesë kolektive, një tribunë e dijes dhe një dëshmi e gjallë se fjala e mençur, kur i shërben të vërtetës dhe vlerave, mund t’u mbijetojë kohëve më të vështira dhe të mbetet udhërrëfyese edhe për brezat e ardhshëm.

Çfarë e ka bërë “Diturinë Islame” të mbijetojë dhe ta ruajë relevancën e saj për katër dekada?

Mbijetesa e një reviste për katër dekada të plota, sidomos në rrethana të tilla historike siç i ka përjetuar Kosova, nuk mund të shpjegohet vetëm me përkushtimin profesional të redaksisë apo me mbështetjen institucionale. Unë mendoj se në rastin e *“Diturisë Islame”*, kemi të bëjmë me një ndërthurje të disa faktorëve që e kanë bërë atë jo vetëm të mbijetojë, por edhe ta ruajë autoritetin dhe relevancën e saj përgjatë gjithë këtyre viteve.

Së pari, forca e saj ka qenë misioni. Që nga themelimi në vitin 1986, *“Dituria Islame”* nuk është konceptuar si një revistë e zakonshme informative, por si një mjet edukimi, ndriçimi dhe vetëdijesimi për mendjet dhe zemrat. Ajo ka pasur një vizion të qartë: t’i shërbejë fesë, dijes, kulturës dhe shoqërisë. Institucionet dhe botimet që mbështeten mbi misione afatgjata zakonisht arrijnë t’u rezistojnë më mirë ndryshimeve politike, ideologjike dhe shoqërore.

Së dyti, revista ka ditur të qëndrojë çdo herë besnike pranë lexuesve të saj. Në çdo periudhë historike ajo ka trajtuar temat që kanë preokupuar shoqërinë tonë.

Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm ka qenë po ashtu besueshmëria. Në një kohë kur informacioni shpesh është i shpejtë, sipërfaqësor dhe i pakontrolluar, besueshmëria mbetet një nga pasuritë më të mëdha të çdo mediumi.

Mendoj se mbijetesa e saj lidhet edhe me faktin se ajo ka ruajtur identitetin e vet. Ka qenë e hapur ndaj ideve dhe zhvillimeve të reja, por pa u shkëputur nga parimet themelore mbi të cilat është ndërtuar. Ka ditur të ecë me kohën pa humbur rrënjët e saj.

Si e përjetuat marrjen e detyrës së kryeredaktorit në një kohë (1996) kur vendi po hynte në një periudhë trazirash të thella dhe paqartësie për të ardhmen e tij?

Marrja e detyrës së kryeredaktorit të *“Diturisë Islame”* në vitin 1996 ishte për mua një nder i madh, por njëkohësisht edhe një barrë e rëndë përgjegjësie. Ishte një kohë kur qielli

“Ajo periudhë më mësoi se përgjegjësitë e mëdha nuk zgjidhen duke pyetur nëse je i gatshëm për to, por duke u përpjekur t’u përgjigjesh me ndershmëri dhe përkushtim.”

mbi Kosovë po “errësohej” çdo ditë e më shumë. Tashmë kishte filluar të shpërthente fuqishëm ndjenja për lirinë e vendit nga robëria dhe okupimi serb, gati 100-vjeçar.

Kur pranova këtë detyrë, e ndjeva thjesht si amanet. *“Dituria Islame”* e cila tashmë i kishte mbushur 10-vjet që nga themelimi, kishte fituar emër, autoritet dhe besim te lexuesit e saj. Prandaj pyetja që më shoqëronte vazhdimisht ishte: si ta ruajmë këtë mision në kohën kur shumë gjëra rrezikonin të shembeshin përreth nesh?

Kujtoj se në takimet me bashkëpunëtorët dhe autorët e shkrimeve, shpesh bisedonim jo vetëm për temat që do të trajtonim, por edhe për fatin e popullit tonë. Në secilin prej nesh ekzistonte ndjenja se po jetonim në prag të ngjarjeve të mëdha historike. Demonstratat, represioni, arrestimet, dhuna sistematike dhe më pas lufta e hapur, e cila solli vrasje, masakra e gjenocid ndaj popullatës shqiptare, e cila u shoqërua me djegie të shtëpive, shkollave e të xhamive, po edhe vrasje të imamëve tanë, e vunë në provë çdo institucion shqiptar, përfshirë edhe institucionin e Bashkësisë Islame.

Personalisht, ajo periudhë më mësoi se përgjegjësitë e mëdha nuk zgjidhen duke pyetur nëse je i gatshëm për to, por duke u përpjekur t’u përgjigjesh me ndershmëri dhe përkushtim. Kishte net pa gjumë, kishte ankth për fatin e familjes, të kolegëve dhe të popullit tonë, por kishte edhe një besim të palëkundur se Allahu nuk e lë pa ndihmë një popull që qëndron i lidhur me të vërtetën, me lirinë dhe me drejtësinë.

Do të ishte e pandershme nga ana ime, që në këtë rast të mos i falënderoja të gjithë bashkëpunëtorët e atëhershëm si dhe stafin teknik, të cilët nuk u ndalën e as nuk u thyen shpirtërisht për asnjë çast. Më kujtohet se në ato vite të luftës, në mungesë të kompjuterëve dhe të stafit profesional, thyerjen teknike të revistës e bëmë në shtëpia e mulla Sejdi Simnicës, përkatësisht te djemtë e tij, Nysreti, Nuhiu dhe Fetiu. Na ka ndodhur disa herë të qëndrojmë në shtëpinë e tyre për 2-3 ditë pandërprerë, sepse natën nuk guxonim të lëviznim, sidomos jo nga mëhalla e Muhaxherëve, ku këta e kishin shtëpinë, sepse shumë afër tyre ndodhej edhe stacioni famëkeq i policisë serbe.

Në çfarë mënyre arriti “Dituria Islame” të mbijetojë dhe të botohet në rrethanat e luftës?

Kur flasim për vazhdimësinë e botimit të *“Diturisë Islame”* gjatë viteve të luftës, ndoshta dikujt, sot mund t’i duket si një çështje teknike ose organizative. Mirëpo, për ata që i kanë jetuar ato vite, e dinë se çdo numër i botuar në atë periudhë përfaqësonte një fitore të vogël kundër frikës, pasigurisë dhe represalieve të pushtetit serb, kundër popullit tonë.

Vitet 1998–1999 ishin vite të vështira e të rënda në çdo kuptim. Kosova po përjetonte një rrëzë nga periudhat më tragjike të historisë së saj moderne. Unë atëbotë, me detyrë zyrtare isha edhe kryeimam i Kosovës, ligjërues në FSI dhe po ashtu i angazhuar në një detyrë tepër delikate dhe të ndjeshme për atë kohë, si sekretar i Këshillit të Emergjencës së BIK-ut, ku kryetar i këtij Këshilli ishte myftiu aktual Naim ef. Tërnavë, atëbotë drejtor i Medresesë “Alaudin”. Kur një pjesë e kolegëve tanë, anëtarë të Këshillit emergjent, nga pasiguria dhe frika për familjet e tyre, kishin hequr dorë nga këto përgjegjësi, vetëm Myftiu dhe Unë, kishim qëndruar të palëkundur, duke qenë të vetëdijshëm se në çdo moment na priste arrestimi e mbase edhe torturimi deri në vdekje. Nëpër duart tona kanë kaluar mjete të shumta materiale, të cilat i përcillnim deri te Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe Zonat e UÇK-së gjithandej Kosovës. Krahës kësaj, unë vazhdoja me zell të madh dhe me përkushtim edhe botimin e përmuajshëm të revistës “Dituria Islame”, sepse e dinim se heshtja nuk ishte alternativë. Pikërisht në kohë lufte, fjala e përgjegjshme bëhet edhe më domethënëse. Pothuajse çdo numër i “Diturisë Islame”, nëpërmjet lidhjeve dhe rrugëve tona, depërtonte edhe në mesin e luftëtarëve të lirisë.

Nuk ishte e lehtë. Kishte periudha kur komunikimi me bashkëpunëtorët bëhej jashtëzakonisht i vështirë, sepse atëherë nuk kishte internet e as celularë. Shumë autorë shkrimesh dhe imamë ndodheshin në zona të rrezikuara, disa ishin të zhvendosur, ndërsa të tjerë përballëshin drejtpërdrejt me represionin. Çdo informacion që vinte nga terreni bartte me vete lajme të dhimbshme për familje të shpërngulura, për shtëpi, shkolla e xhami të djegura apo për kolegë që nuk mund të kontaktoheshin më.

Pas përfundimit të luftës, kur filluam të shihnim përmasat e plota të shkatërrimit, e kuptuam edhe më qartë rëndësinë e dokumentimit. Shumë prej atyre që kishin humbur jetën nuk mund të flisnin më. Shumë xhami ishin shndërruar në rrënoja. Shumë familje po kërkonin ende më të dashurit e

“Kur më pyesin se si arriti ‘Dituria Islame’ të mbijetojë gjatë luftës, përgjigjja ime është e thjeshtë: ajo mbijetoi sepse mbijetoi shpresa.”

tyre. Në ato momente, “Dituria Islame” mori edhe një mision shtesë: të ruante kujtesën historike të asaj që kishte ndodhur, në mënyrë që sakrificat e popullit tonë dhe e njerëzve të fesë të mos harrohej kurrë.

Prandaj, kur më pyesin se si arriti revista të mbijetojë gjatë luftës, përgjigjja ime është e thjeshtë: ajo mbijetoi sepse mbijetoi shpresa. Ajo mbijetoi sepse kishte njerëz që besonin se edhe në ditët më të errëta fjala e së vërtetës nuk duhet të shuhet. Dhe mbi të gjitha, mbijetoi me ndihmën e Allahut, i Cili u dha forcë zemrave tona të vazhdonin misionin edhe atëherë kur rrethanat dukeshin ta pafavorshme për Ne.

A ishte revista, në atë kohë, thjesht një revistë e rëndomtë, apo një formë rezistence e palëkundur kombëtare, shpirtërore dhe kulturore?”

Nëse do t’i referoheshim vetëm formës së saj, “Dituria Islame” ishte një revistë e përmuajshme fetare, shkencore dhe informative, me rubrikat, artikujt dhe përmbajtjen e saj të rregullt. Mirëpo, kushdo që i ka jetuar vitet e fundit të shekullit XX në Kosovë, e di se ajo

përfaqëson shumë më tepër se kaq. Në rrethanat e okupimit, të shtypjes sistematike dhe të luftës, ajo u shndërrua në një formë të veçantë të rezistencës shpirtërore, kulturore dhe kombëtare.

“Dituria Islame” nuk ishte revistë politike dhe as nuk kishte për qëllim të zëvendësonte rolin e institucioneve politike. Misioni i saj ishte tjetër: ta ruante moralin, ta forconte besimin, të edukonte dhe ta kultivonte vetëdijen historike e kulturore. Por pikërisht ky mision e bëri atë një faktor të rëndësishëm të rezistencës. Sepse pushtuesi, sado që mund të kontrollojë një territor, megjithatë nuk mund të sundojë lehtë mbi mendjen dhe shpirtin e një populli që e njeh identitetin e vet dhe nuk heq dorë prej tij.

Në faqet e revistës përpiqeshim të përcillnim mesazhin se besimi nuk është arratisje nga realiteti, por forcë për ta përballuar atë. Shkruanim për durimin, shpresën, drejtësinë, dinjitetin njerëzor dhe përgjegjësinë ndaj atdheut e shoqërisë.



Kujtonim figurat e mëdha të historisë sonë fetare dhe kombëtare, të cilët me gjakun dhe jetën e tyre i dolën zot atdheut, sepse popujt që humbin kujtesën e tyre historike, rrezikojnë të humbin edhe të ardhmen.

Prandaj, po të më kërkohej ta përkufizoja me një fjalë rolin e saj në ato vite, do të thosha se “Dituria Islame” nuk ishte thjesht një revistë që botohej gjatë kohës së luftës; ajo ishte një zë i ndërgjegjes kolektive që refuzonte të heshte përballë padrejtësisë dhe që përpigjej të mbante gjallë shpresën, besimin dhe dinjitetin e një populli të tërë.

“Si e balanconit mesazhin fetar me atë kombëtar, por edhe me realitetin e dhimbshëm që po përjetonte populli shqiptar në trojet e okupuara në fund të shekullit XX?”

Kjo ishte ndoshta njëra nga sfidat më të ndjeshme dhe më të rëndësishme me të cilat jemi përballur gjatë asaj periudhe. Në rrethana të zakonshme, një revistë fetare merret kryesisht me edukimin shpirtëror, moral dhe intelektual të lexuesit. Mirëpo, në fundin e shekullit XX, ne nuk jetonim në rrethana të zakonshme. Populli ynë po përjetonte dhunë sistematike, mohimin e të drejtave themelore, dëbime, burgosje dhe më pas luftën me të gjitha pasojat e saj tragjike. Në një realitet të tillë, ishte e pamundur të flisje vetëm për fenë duke e injoruar vuajtjen e njerëzve dhe gjenocidin që po ndodhte para syve të krejt botës.

Në traditën tonë fetare dhe kombëtare, dashuria për atdheun, mbrojtja e identitetit dhe e dinjitetit, kundërshtimi i padrejtësisë dhe solidariteti me të shtypurit, nuk janë nocione të huaja. Përkundrazi, ato janë pjesë e etikës islame. Prandaj nuk e kemi parë kurrë identitetin fetar dhe atë kombëtar si dy rrugë që përplasen me njëra-tjetrën. Në historinë shqiptare ato shpesh kanë ecur krah për krah. Imamët tanë kanë qenë jo vetëm mësues të fesë, por edhe edukatorë, mbrojtës të gjuhës, të kulturës dhe të ndërgjegjes kombëtare.

Nganjëherë sfida më e madhe nuk ishte çfarë të shkruanim, por si ta shkruanim. Si të flisje për masakrat që po ndodhnin anekënd Kosovës? Si të shkruaje për padrejtësitë pa e ushqyer urrejtjen? Si të mbroje të drejtën e popullit tënd pa rënë në grackën e fanatizmit dhe ekstremizmit? Këto ishin pyetje që na shoqëronin vazhdimisht.

Sot, kur e shikoj atë periudhë nga distanca e kohës, mendoj se balanca më e mirë që arritëm të ruanim ishte kjo: nuk e sakrifikuam mesazhin fetar për hir të rrethanave politike, por as nuk e mbyllëm fenë brenda mureve të një diskursi të shkëputur nga jeta reale e njerëzve. Përpigeshim ta bënim fenë burim force, urtësie, qëndrese dhe shprese për një popull që po kalonte nëpër një sprovë historike.

“Nuk e sakrifikuam mesazhin fetar për hir të rrethanave politike, por as nuk e mbyllëm fenë brenda mureve të një diskursi të shkëputur nga jeta reale e njerëzve.”

Në fund të fundit, misioni ynë ishte t’ua kujtonim njerëzve se edhe kur humbet shumëçka në këtë botë, nuk duhet të humbësh kurrë besimin te Zoti, dinjitetin njerëzor dhe shpresën për drejtësi. Pikërisht këto tri vlera na ndihmuan të mbijetonim si popull dhe si institucion në vitet më të vështira të historisë sonë të afërt.


Cili ishte vendimi më i vështirë që ju është dashur të merrni si kryeredaktor gjatë asaj periudhe?

Kur e kujtoj sot atë periudhë, e kam të vështirë të veçoj vetëm një vendim, sepse pothuajse çdo numër i revistës bartte me vete dilema, përgjegjësi dhe rreziqe të veçanta. Megjithatë, nëse do të duhej ta përmbledh në një vendim themelor, do të thosha se vendimi më i vështirë ishte të vazhdonim të flisnim dhe të shkruanim në një kohë kur shumëkush mendonte se heshtja ishte më e sigurt.

Në vitet e luftës dhe të represionit, çdo fjalë e shkruar peshohej ndryshe. Nuk ishte fjala vetëm për cilësinë e një artikulli apo për korrektësinë e një qëndrimi editorial. Çështja ishte shumë më e thellë: si të thuhej e vërteta

pa i ekspozuar njerëzit ndaj rrezikut? Si të dokumentoheshin padrejtësitë pa rrezikuar mbylljen e mundshme të hapësirave që ende na kishin mbetur?

Vendimi më i vështirë ishte pikërisht ruajtja e kësaj balance. Të mos heshtnim, por as të mos lejonim që dhimbja e ligjshme të shndërrohej në gjuhë urrejtjeje. Të mos lejonim



që revolta ndaj padrejtësisë të na largonte nga parimet që na mësonte feja jonë.

Me kalimin e viteve kam arritur në përfundimin se vendimet më të vështira nuk janë gjithmonë ato që shihen nga jashtë. Nganjëherë vendimi më i rëndë është të mbetesh besnik ndaj parimeve tua kur rrethanat të shtyjnë t'i braktisë ato. Në atë periudhë, sfida jonë më e madhe ishte ta ruanim të vërtetën pa e humbur urtësinë, ta ruanim guximin pa e humbur maturinë dhe ta ruanim shpresën pa e mohuar realitetin.

Çfarë roli luajti fjala e shkruar në ruajtjen e shpresës dhe identitetit në atë kohë?

Kur një popull kalon nëpër trauma të mëdha, ekziston rreziku që përditshmëria e dhimbshme ta largojë nga kujtesa e vet historike. Fjala e shkruar e pengon këtë harresë. Ajo krijon lidhje dhe vazhdimësi ndërmjet së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes.

Sot, pas shumë vitesh, jam i bindur se një pjesë e rezistencës sonë kolektive është zhvilluar edhe nëpër faqet e librave, gazetave dhe revistave. Aty u ruajtën idetë, vlerat, kujtimet dhe shpresat e njerëzve. Aty u dokumentuan vuajtjet, por edhe qëndresa. Aty u dëshmuar se një popull mund të plagoset rëndë, por nuk mund të mposhtet për sa kohë që ruan besimin, kujtesën dhe fjalën e lirë.

Për këtë arsye, besoj se fjala e shkruar nuk ishte thjesht një mjet komunikimi në atë kohë. Ajo ishte një strehë shpirtërore, një dëshmi historike dhe një urë shprese ndërmjet një të tashmeje të dhimbshme dhe një të ardhmeje që ende nuk shihej, por në të cilën ne vazhdonim të besonim.

Me distancën e sotme, cili është mësimi më i madh që ajo periudhë ju ka lënë juve personalisht dhe institucionit?

Koha ka një veçori të veçantë: ajo nuk i ndryshon ngjarjet që kemi përjetuar, por e ndryshon mënyrën se si i kuptojmë ato. Kur jeton brenda një stuhie, përpiqesh kryesisht të mbijetosh. Kur kalojnë vitet dhe e shikon atë periudhë nga distanca, fillon të kuptosh më qartë mësimet që ajo të ka lënë.

Personalisht, mësimi më i madh që kam nxjerrë është se forca e vërtetë e njeriut nuk matet në kohët e rehatisë, por në kohët e provës. Vitet e represionit dhe të luftës më mësuuan se njeriu është shumë më i fortë sesa mendon, kur mbështetet te Zoti, te parimet dhe te përgjegjësia që ndien ndaj të tjerëve.

Një mësim tjetër i madh ka qenë vlera e institucioneve. Në kohë normale, ndonjëherë nuk e kuptojmë sa të rëndësishme janë ato. Mirëpo, kur vijnë kohët e krizës, kuptohet se institucionet serioze janë shtyllat që e mbajnë shoqërinë të qëndrueshme. Përvoja e "Diturisë Islame" më ka bindur se institucionet nuk ndërtohen vetëm me ndërtesa, me rregullore apo me buxhete. Ato ndërtohen me njerëz që besojnë në misionin e tyre dhe që janë të gatshëm të sakrifikojnë për to.

Për vetë institucionin, mendoj se mësimi më i madh ishte se misioni i tij është shumë më i rëndësishëm se rrethanat në

të cilat vepron. Vlerat mbi të cilat ishte ndërtuar revista – dija, besimi, edukimi dhe shërbimi ndaj shoqërisë – mbetën të njëjtat.

Një nga mësimet më të çmuara që kemi nxjerrë si institucion është se fjala e përgjegjshme ka jetë më të gjatë sesa zhurma e momentit.

Çfarë duhet të mësojë brezi i ri nga përvoja e "Diturisë Islame" gjatë viteve të luftës?

Brezi i ri ka sot një realitet krejt tjetër nga ai që kemi përjetuar në vitet e represionit dhe luftës. Jeton në një kohë lirie, zhvillimi teknologjik dhe qasje të pakufizuar në informacion. Pikërisht për këtë arsye, mendoj se mësimi nga ajo periudhë nuk duhet parë si nostalgji historike, por si një busull vlerash për të ardhmen.

Së pari, brezi i ri duhet ta kuptojë se liria nuk është një dhuratë që merret një herë e përgjithmonë dhe mbetet e garantuar pa përpjekje. Përvoja e "Diturisë Islame" në vitet e vështira tregon se liria e fjalës, e besimit dhe e identitetit është diçka që kërkon përgjegjësi, kujdes dhe mbrojtje të vazhdueshme. Ajo nuk ruhet vetëm me institucione formale, por edhe me vetëdijen e individëve që e çmojnë dhe e përdorin atë në mënyrë të drejtë.

Së dyti, është shumë e rëndësishme që brezi i ri ta kuptojë vlerën e fjalës së shkruar dhe të dijë së mirëfilltë. Në kohën tonë, informacioni qarkullon me shpejtësi të madhe, por jo gjithmonë me cilësi dhe përgjegjësi. Përvoja e "Diturisë Islame" na mëson se fjala ka peshë, ka ndikim dhe mund të ndërtojë ose të shkatërrojë. Prandaj, çdo brez duhet të mësojë të dallojë mes informacionit të shpejtë dhe dijë së thellë, mes opinionit të çastit dhe të vërtetës së verifikuar.

Së treti, një mësim i madh është rëndësia e identitetit dhe e kujtesës historike. Një shoqëri që harron rrënjët e saj rrezikon të humbasë orientimin në të ardhmen.

Brezi i ri duhet ta kuptojë se moderniteti dhe identiteti nuk janë në konflikt me njëri-tjetrin, por mund të ecin së bashku nëse ndërtohen mbi dije dhe vetëdije të shëndoshë.

Prandaj, përvoja e "Diturisë Islame" gjatë viteve të luftës nuk është vetëm histori për t'u kujtuar, por një amanet për t'u ruajtur. Amanet që fjala të mbetet e përgjegjshme, dija të mbetet e ndershme dhe identiteti të mbetet i gjallë në çdo kohë dhe në çdo brez.

Në një fjali: çfarë përfaqëson sot "Dituria Islame" pas 40 vjetësh ekzistence dhe dinamike të shpejtë në trojet shqiptare?

Sot, pas 40 vjetësh ekzistence, "Dituria Islame" përfaqëson një institucion të gjallë të dijës dhe kujtesës islame ndër shqiptarë, një tribunë të qëndrueshme të mendimit fetar, kulturor dhe shoqëror, që ka ruajtur vazhdimësinë e vlerave në kohë sfidash dhe ndryshimesh të mëdha historike, duke mbetur një referencë e besueshme për edukimin shpirtëror dhe intelektual të brezave.

Intervistoi: Driton Arifi

Revista “Dituria Islame” dhe funksioni i saj në formësimin e mendimit islam dhe identitetit kombëtar shqiptar

Ramadan Shkodra

Revista “Dituria Islame”, si organ i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, përfaqëson një nga projektet më të rëndësishme të periodikut islam, kulturor dhe kombëtar ndër shqiptarët në fundin e shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI. E themeluar këtu e katër dekada më parë, saktësisht në qershor të vitit 1986 në Prishtinë, ajo lindi në një kohë jashtëzakonisht të vështirë politike, shoqërore dhe kulturore për shqiptarët e Kosovës, por pikërisht në ato rrethana arriti të bëhej një dritare e rëndësishme e mendimit fetar, kulturor, kombëtar dhe intelektual shqiptar.

Dalja e revistës “Dituria Islame” përkonte me një periudhë të kthesave të mëdha si në

planin ndërkombëtar, ashtu edhe në atë kombëtar. Në rrafshin ndërkombëtar po shënoheshin fillet e rënies së ideologjisë komuniste në botë, si dhe fryrja e erërave të demokracisë. Ndërkohë, në planin kombëtar zhvilloheshin procese të rëndësishme historike, ishte periudha pas Lëvizjes Studentore në Kosovë në vitin 1981, rezistenca shqiptare ndaj pushtetit serbo-jugosllav, si dhe fillimet e shthurjes së sistemit monist dhe antifetar.

Në një realitet të tillë, themelimi i një reviste me mision fetar dhe kundër ideologjisë komuniste-ateiste dhe sistemit serbo-jugosllav, u paraqit si një detyrë imediate për institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Prandaj, themelimi dhe botimi i revistës “Dituria Islame”, e cila në zanafillë ishte konceptuar si organ fetar dhe informativ në gjuhën shqipe (shih: “Dituria Islame”, nr. 1, qershor 1986), përbënte jo vetëm një arritje institucionale, por edhe një akt të guximshëm intelektual dhe kulturor.

Ajo në fakt, u bë krah i fuqishëm dhe vazhduese e misionit të revistave dhe botimeve të tjera islame në gjuhën shqipe, si “Takvimi” (1970) dhe “Edukata Islame” (1971) etj., të cilat tashmë kishin krijuar një traditë të vyer të periodikut islam ndër shqiptarë dhe kishin përgatitur edhe kuadrot që më vonë do të merrnin përgjegjësinë për drejtimin dhe zhvillimin e periodikut, më konkretisht revistës “Dituria Islame” dhe që do të kontribuonin në zhvillimin e literaturës islame në gjuhën shqipe.

E themeluar këtu e katër dekada më parë, saktësisht në qershor të vitit 1986 në Prishtinë, ajo lindi në një kohë jashtëzakonisht të vështirë politike, shoqërore dhe kulturore për shqiptarët e Kosovës



NDËRMJET MISIONIT FETAR, PËRGJEGJËSISË KOMBËTARE DHE DEKOMUNIZIMIT TË SHOQËRISË

Megjithëse u themelua në rrethana jo të favorshme politike dhe shoqërore, revista “Dituria Islame” u prit jashtëzakonisht mirë nga lexuesit dhe, brenda një kohe relativisht të shkurtër, arriti të depërtojë jo vetëm në Kosovë, por edhe në viset e tjera shqiptare ku jetonin shqiptarët. Ajo fitoi besimin dhe respektin e lexuesve, duke u shndërruar në një prej organeve më të rëndësishme të mendimit islam, kulturor dhe informativ në gjuhën shqipe.

Përveç se i dha një shtytje të fuqishme periodikut dhe literaturës islame në gjuhën shqipe, fillimisht në Kosovë dhe në hapësirën shqiptare të ish-Jugosllavisë, e më vonë edhe në Shqipëri, “Dituria Islame” gradualisht mori përmasa të një reviste me ndikim mbarë-shqiptar. Ajo krijoi profilin dhe identitetin e saj të veçantë, duke mbledhur rreth vetes kuadrot më të përgatitura të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe studiues, intelektualë, shkrimtarë e personalitete të njohura të jetës akademike shqiptare. Në këtë mënyrë, revista u shndërrua në një tribunë të mirëfilltë të dijes islame, të debatit kulturor dhe të reflektimit intelektual.

Gjatë katër dekadave të veprimtarisë së saj, “Dituria Islame” ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e mendimit islam në gjuhën shqipe, në formimin e brezave të rinj të studiuesve dhe autorëve, si dhe në pasurimin e kulturës fetare, historike dhe kombëtare shqiptare. Ajo u bë një shkollë e hapur e mendimit dhe e shkrimit, duke afirmuar autorë të rinj dhe duke u ofruar hapësirë penave më të njohura të kohës për të trajtuar tema që lidhen me fenë, kulturën, historinë, trashëgiminë dhe sfidat nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar.

Fati i revistës “Dituria Islame” ka qenë i lidhur ngushtë me fatin e popullit dhe të vendit tonë. Për këtë arsye, ajo nuk mbeti vetëm një tribunë fetare, por u bë pjesë aktive e proceseve shoqërore, kulturore dhe kombëtare, që përshkuan Kosovën dhe hapësirën shqiptare në fund të shekullit XX. Përmes faqeve të saj u promovuan vlerat e dijes dhe të besimit, u kultivua vetëdija kombëtare dhe u mbështetën përpjekjet për liri, arsim, kulturë dhe emancipim shoqëror.

Pas më shumë se katër dekadash botimi të pandërprerë, mund të konstatohet se kontributi i revistës është i prekshëm, i dokumentueshëm dhe historikisht i rëndësishëm. “Dituria Islame” përfaqëson një trashëgimi të çmuar për historinë e mendimit islam, kulturën shqiptare, jetën fetare dhe kujtesën

Gjatë viteve
'90, në kohën
e represionit
serb dhe të
mbylljes së
mediave
shqiptare,
'Dituria
Islame' e
tejkaloj rolin e
një reviste
fetare dhe u
shndërrua në
tribunë të
çështjes
kombëtare, të
rezistencës
intelektuale
dhe të
mbrojtjes së
identitetit
shqiptar.

kolektive të shqiptarëve. Ajo është një arkiv i rrallë i zhvillimeve fetare, kulturore, arsimore dhe kombëtare të kohës sonë.

Megjithatë, periudha që e vulosi më fuqishëm identitetin dhe misionin e revistës ishte ajo e viteve '90 të shekullit XX. Ndërsa popujt e Evropës Juglindore po përjetonin proceset e demokratizimit pas rënies së sistemit komunist, Kosova u përball me riokupimin klasik nga Serbia e regjimit të Slllobodan Millosheviqit. Në këto rrethana të jashtëzakonshme, kur institucionet shqiptare u goditën, mediat u mbyllën, liritë themelore u mohuan dhe populli shqiptar iu nënshtrua një represioni sistematik, “Dituria Islame” mori një rol shumë më të gjerë se ai i një reviste fetare.

Ajo u shndërrua në një tribunë të rëndësishme të çështjes kombëtare, të rezistencës intelektuale dhe të mbrojtjes së identitetit shqiptar. Një ndër kontributet e saj më të rëndësishme ishte thyerja e territ informativ që regjimi serb përpiqej t'i impononte shoqërisë shqiptare në Kosovë. Pas mbylljes së gazetës “Rilindja” dhe Radio Televizionit të Prishtinës në korrik të vitit 1990, pushteti serb synonte izolimin e opinionit shqiptar nga informacioni i lirë dhe kontrollin e plotë të hapësirës publike. Në këto rrethana, “Dituria Islame” vuri në shërbim faqet e saj për botimin e materialeve, analizave dhe shkrimeve që nuk mund të botoheshin më në mediat e ndaluara shqiptare, duke u shndërruar në një nga tribunat e rralla të komunikimit publik në

gjuhën shqipe (shih: “Dituria Islame”, nr. 15–16, f. 34–42; nr. 17, f. 33–42). Në këtë mënyrë, revista dha një kontribut të çmuar në ruajtjen e informimit të opinionit shqiptar dhe në kundërshtimin e bllokadës informative të imponuar nga regjimi serb.

Pikërisht në faqet e saj gjetën vend denoncimi i dhunës dhe i politikave represive serbe, rikthimi i kujtesës historike të mohuar, rehabilitimi i figurave të anatemuara nga ideologjia komuniste, dekomunizimi i mendimit dhe i historiografisë shqiptare, si dhe afirmimi i vlerave fetare, kulturore dhe kombëtare. Krah misionit të saj themelor për ngritjen e vetëdijes fetare, revista u bë kronikë e kohës, dëshmitare e vuajtjeve të popullit shqiptar dhe mbështetëse e përpjekjeve të tij për liri, pavarësi dhe dinjitet kombëtar.

Për këtë arsye, trajtimi i veprimtarisë së revistës “Dituria Islame” gjatë viteve '90 nuk paraqet vetëm historinë e një periodiku fetar, por edhe një kapitull të rëndësishëm të historisë kulturore, intelektuale dhe kombëtare të shqiptarëve në një nga periudhat më të vështira dhe njëkohësisht më vendimtare të historisë së tyre bashkëkohore.

AFIRMUESE DHE KULTIVUESE E MENDIMIT ISLAM

Që në zanafillën e saj, revista *"Dituria Islame"*, krahas pasqyrimin të rregullt të aktiviteteve të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, arriti të shndërrohet në një tribunë të mendimit islam ndër shqiptarë. Faqet e saj filluan të mbusheshin me shkrime studimore, fetare, kulturore dhe edukative të autorëve më të njohur të kohës, duke bashkuar breza të ndryshëm intelektualësh dhe studiuesish. Në mesin e kontribuuesve të parë janë: haxhi Sherif Ahmeti, haxhi Jetish Bajrami, hafëz Ali Aliu, Feti Mehdiu dhe Resul Rexhepi, të cilët me dijen, përvojën dhe autoritetin e tyre i dhanë revistës peshë fetare, intelektuale dhe kulturore. Krahas tyre, në faqet e *"Diturisë Islame"* u afirmua edhe një brez i ri studiuesish dhe përkthyesish, i përfaqësuar nga Nexhat Ibrahim, Miftar Ajdini dhe autorë të tjerë, të cilët sollën në gjuhën shqipe ide, tema dhe trajtesa nga mendimi islam bashkëkohor dhe trashëgimia intelektuale islame botërore.

Misioni themelor dhe parësor i revistës *"Dituria Islame"* gjatë katër dekadave të botimit të saj ka qenë avancimi i jetës fetare islame ndër shqiptarë përmes fjalës së shkruar në gjuhën shqipe. *"Dituria Islame"* u shndërrua në revistën më të rëndësishme dhe më me ndikim të periodikut islam shqiptar, duke krijuar një traditë të qëndrueshme studimore e publicistike dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin fetar, kulturor dhe intelektual të brezave të tërë të lexuesve. Përmes mijëra artikujve, studimeve, përkthimeve, analizave dhe trajtesave të botuara ndër vite, revista kontribuoi në pasurimin e literaturës islame në gjuhën shqipe dhe në afirmimin e disiplinave të ndryshme islame, si tefsiri, hadithi, akaidi, fikhu, historia islame, mendimi islam, edukimi fetar dhe kultura islame.

Megjithatë, për shkak të vëllimit të madh të materialit të botuar gjatë katër dekadave, në këtë rast do të ndalemi vetëm te disa shembuj përfaqësues nga periudha e parë e revistës dhe veçanërisht nga vitet '90 të shekullit të kaluar, periudhë në të cilën u formësua identiteti i saj intelektual dhe shkencor. Në faqet e saj kontribuan dhjetëra autorë, teologë, imamë dhe studiues të njohur, ndër të cilët spikasin haxhi Sherif Ahmeti, haxhi Jetish Bajrami, Feti Mehdiu, Avni Aliu, Imam Vehbi Ismaili, Naim Tërnavë, Qazim Qazimi, Resul Rexhepi, Muhidin Ahmeti, Sabri Bajgora, Sulejman Osmani, Ali F. Iljazi, dhe shumë të tjerë. Përmes trajtesave të tyre u shtjelluan tema të shumta që lidhen me bazat e besimit islam, adhurimet, etikën, edukimin, jetën familjare dhe dimensionin shpirtëror të njeriut.

Në mesin e temave të trajtuara gjatë kësaj periudhe mund të veçohen shkrime si: "Rreth besimit në Zotin", "Kur'ani për shkurorëzimin", "Rruga e qëlluar dhe rruga e gabuar", "Shpirti (Nefsi Vahide)", "Obligimet ndaj mësimit fetar islam", "Muhamedi nuk ishte ëndërrues, por udhëhiqej nga drita hyjnore", "Ramazani – muaji i adhurimit", "Haxhi – obligim fetar", "Jeta pas

vdekjes dhe ndëshkimi në varr", "Tefsiret e fraksioneve islame", "Vlerat shpërblehen sipas qëllimit", "Vështrim mbi agjërimin" dhe "Porositë e arta të muajit të bekuar Ramazan". Këto trajtesa dëshmojnë jo vetëm larminë tematike të revistës, por edhe përpjekjen e saj të vazhdueshme për t'ia ofruar lexuesit shqiptar dijen islame në gjuhën amtare, në mënyrë të kuptueshme, bashkëkohore dhe të mbështetur në burimet autentike të Islamit.

TRIBUNË E KUJTESËS HISTORIKE, KULTURËS DHE IDENTITETIT KOMBËTAR

Me ndryshimet e mëdha politike dhe shoqërore që përfshinë Kosovën gjatë viteve '90, edhe revista *"Dituria Islame"* mori një mision të ri historik. Në kohën kur regjimi serb mbylli institucionet kryesore të informimit në gjuhën shqipe, si Radio Televizioni i Prishtinës dhe gazetën "Rilindja", revista u bë një nga zërat e rrallë të shtypit të lirë shqiptar në Kosovë. Në faqet e saj u botuan informata, lajme, analiza dhe materiale të rëndësishme që në rrethana normale do të ishin publikuar në mediat tashmë të ndaluara shqiptare. Në këtë mënyrë, *"Dituria Islame"* dha një kontribut të rëndësishëm në informimin e opinionit publik dhe në thyerjen e terrinës informative që përpiqej të impononte pushteti serb.

Në faqet e saj gjetën pasqyrim largimet masive nga puna, mbyllja e institucioneve arsimore, dhuna policore, bastisjet, arrestimet, keqtrajtimet dhe shkeljet sistematike të të drejtave themelore të njeriut. Ajo botoi pa hezitim qëndrimet e institucioneve politike e shoqërore shqiptare, duke u shndërruar në një tribunë të fuqishme të mbrojtjes së të drejtave kombëtare, qytetare dhe njerëzore të shqiptarëve në Kosovë.

Megjithatë, rëndësia e revistës gjatë kësaj periudhe nuk kufizohej vetëm në dimensionin informativ dhe kronikën e rezistencës shqiptare. Sidomos pas ardhjes në krye të saj të prof. Qemajl Morinës, *"Dituria Islame"* fitoi një profil më të gjerë kulturor, shkencor dhe kombëtar, duke u shndërruar në një tribunë të mendimit shqiptar dhe në një hapësirë të rëndësishme të dekomunizimit të dijes, kulturës dhe historiografisë shqiptare. Në një kohë kur shumë figura,



ngjarje dhe procese historike vazhdonin të mbeteshin të shtrembëruara nga historiografia serbo-jugosllave dhe nga trashëgimia ideologjike e sistemit komunist, faqet e revistës u hapën për studiues, historianë, gjuhëtarë, publicistë dhe krijues që synonin rikthimin e kujtesës historike dhe rivlerësimin e trashëgimisë kombëtare shqiptare.

Një vend të rëndësishëm në faqet e revistës zuri edhe rivlerësimi i figurave të shquara të historisë, kulturës dhe arsimit kombëtar, të cilat për dekada kishin mbetur në hije ose ishin interpretuar përmes filtrave ideologjikë. Kështu, revista botoi studime kushtuar hoxha Hasan Tahsinut, Said Najdeni – Hoxhë Vokës, Ismail Ndroçit, imam Vehbi Ismailit, hafëz Ali Ulqinakut, mulla Idriz Gjilanit, mulla Hasan Masuricës, Rexhep Vokës, Qamil Balës, Haki Tahës, hafëz Ibrahim Dallit, hafëz Xhemal Mulla, hafëz Ali Krajës etj.. Përmes këtyre trajtesave, *“Dituria Islame”* kontribuoi në rikthimin në kujtesën kombëtare të personaliteteve që kishin lënë gjurmë të rëndësishme në historinë fetare, arsimore, kulturore dhe kombëtare shqiptare.

Një kontribut me rëndësi të veçantë i revistës *“Dituria Islame”* në procesin e rikthimit të kujtesës historike dhe të afirmimit të personaliteteve të kulturës shqiptare ishte edhe botimi i biografive dhe studimeve kushtuar figurave të shquara kombëtare. Në këtë drejtim, një rol të veçantë luajti prof. Mehdi Polisi, i cili përmes punës së tij të palodhur solli për lexuesin shqiptar biografi dhe trajtesa të përkthyer për personalitete të rëndësishme të historisë dhe kulturës shqiptare, të përfshira në enciklopedinë e njohur arabe *“Kamus el A’lam”*. Ndër to veçohet studimi kushtuar rilindësit të madh shqiptar Sami Frashëri, i botuar në disa vazhdimësi në faqet e revistës (shih: *“Dituria Islame”*, nr. 22–43). Këto botime jo vetëm që pasuruan fondin e njohurive historike dhe kulturore të lexuesit shqiptar, por kontribuan edhe në ndriçimin e vlerësimeve që personalitete të shquara shqiptare kishin gëzuar në botën islame dhe orientale.

Në të njëjtën frymë, rëndësi të veçantë paraqet edhe studimi i prof. Qemajl Morinës *“Idetë islame të Hoxhë Kadriut në revistën ‘Udha e së Vërtetës’”*, i botuar në shtatë vazhdimësi në numrat 87–95 të revistës. Përmes këtij studimi, revista kontribuoi në rikthimin në vëmendjen shkencore të një personaliteti të rëndësishëm të mendimit fetar dhe kombëtar shqiptar, duke ndriçuar dimensione të panjohura të veprimtarisë së tij intelektuale dhe të rolit që ai pati në zhvillimin e mendimit islam ndër shqiptarë. Këto trajtesa dëshmojnë për përkushtimin e *“Diturisë Islame”* ndaj hulumtimit, rivlerësimit dhe promovimit të trashëgimisë

intelektuale shqiptare, si pjesë e misionit të saj për ruajtjen e kujtesës historike dhe kulturore kombëtare.

Po aq domethënës ishte kontributi i revistës në fushën e historisë kombëtare dhe dokumentimit të padrejtësive historike ndaj shqiptarëve. Në këtë drejtim spikasin studimet e dr. Hakif Bajramit mbi projektet serbe për asgjësimin e shqiptarëve, planet sekrete për shpërnguljen dhe likuidimin e shqiptarëve të Kosovës, si dhe analizat e tij mbi proceset historike që çuan në shpalljen e pavarësisë së shtetit shqiptar. Krahës tyre, revista botoi studime të prof. dr. Zekeria Canës për kthimin me dhunë të shqiptarëve në fenë ortodokse gjatë viteve 1912–1913, punime të dr. Sabit Ukës mbi muhaxhirët shqiptarë të Sanxhakut të Nishit dhe historinë e arsimit shqiptar në ato treva, si dhe trajtesa të tjera kushtuar fatit historik të shqiptarëve në hapësirat etnike.

Një dimension tjetër me rëndësi të veçantë ishte trajtimi i letërsisë, kulturës dhe trashëgimisë shpirtërore shqiptare. Në këtë kuadër, revista botoi studime mbi veprën e Naim Frashërit, letërsinë shqiptare me alfabet arab, elementin islam në letërsinë shqipe, krijimtarinë e Muhamed Kyçyikut, si dhe materiale të shumta që trajtonin traditat, zakonet dhe vlerat e kulturës popullore shqiptare. Përmes këtyre botimeve, *“Dituria Islame”* dëshmoi se identiteti kulturor shqiptar nuk mund të kuptohej i shkëputur nga dimensionet e tij fetar, historik dhe qytetëruar.

Në të njëjtën kohë, revista i kushtoi vëmendje të veçantë historisë së arsimit dhe institucioneve shqiptare me studimet mbi

shkollat – gjatë periudhës osmane në Kosovë, kontributin e mësuesve të fesë në përhapjen e shkrim-leximit shqip, institucionin e Shejh-ul-Islamit dhe figurat shqiptare që e përfaqësuan atë, si dhe trajtesat për vakëfet, medresetë dhe institucionet tradicionale islame, të cilat ndihmuan në rivlerësimin e një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë sonë arsimore e kulturore, e cila për dekada kishte qenë e anashkaluar ose e paraqitur në mënyrë të shtrembëruar.

TRIBUNË E DIALOGUT INTELEKTUAL, FETAR DHE KOMBËTAR

Një kontribut me rëndësi të veçantë i revistës *“Dituria Islame”* gjatë viteve ’90 ishte krijimi i një hapësire të lirë dialogu dhe reflektimi përmes intervistave me personalitete të shquara të jetës fetare, intelektuale, kulturore dhe kombëtare shqiptare. Në një periudhë kur shoqëria shqiptare në Kosovë po përjetonte procesin e çlirimit nga trashëgimia ideologjike e komunizmit dhe nga censura politike e sistemit serbo-jugosllav, revista u shndërrua në një tribunë ku

artikuloreshin mendime, përvoja dhe vizione që kontribuan në dekomunizimin e vetëdijes shoqërore, në rivlerësimin e identitetit fetar e kombëtar dhe në vendosjen e një drejtësie të vonuar ndaj figurave dhe ideve që për dekada kishin mbetur në marginat e jetës publike.

Një vend të veçantë zinin intervistat me personalitetet kryesore të jetës fetare shqiptare. Në faqet e revistës u botuan intervista me prof. Hasan ef. Nahi (nr. 18), dr. Feti Mehdiun (nr. 19) dr. Rexhep Bojën, Myfti i Kosovës (nr. 21), me Naim ef. Tërnavën (nr. 21), me myderrizin e njohur haxhi Sherif Ahmetin (nr. 36). Përmes këtyre bisedave trajtoheshin çështje që lidhnin organizimin e jetës fetare, edukimin islam, rolin e institucioneve fetare dhe sfidat me të cilat përballej komuniteti mysliman shqiptar në rrethanat e kohës.

Në këtë kuadër, rëndësi të veçantë morën intervistat me personalitete të njohura të jetës fetare shqiptare në Shqipëri pas rënies së komunizmit. Veçanërisht domethënëse ishin intervistat me haxhi hafëz Sabri Koçin (nr. 50 dhe nr. 67–68), simbol i qëndresës së fesë dhe i mbijetesës së institucioneve fetare shqiptare gjatë regjimit komunist, si dhe me myftiun e Kavajës, Muhamed ef. Hoxhën (nr. 69), i cili fliste për rikthimin e rinisë drejt fesë dhe vlerave shpirtërore. Këto intervista pasqyronin procesin e ringjalljes fetare në Shqipëri dhe përpjekjet për rindërtimin e institucioneve fetare pas dekadash persekutimi.

Po aq të rëndësishme ishin edhe intervistat me figura të njohura të klerit katolik shqiptar, të cilat dëshmonin për frymën e dialogut ndërfaqet dhe të respektit reciprok që revista promovonte vazhdimisht. Në këtë kuadër dallojnë intervista me Patër Zef Pllumin (nr. 67–68), një ndër dëshmitarët më të rëndësishëm të persekutimit komunist dhe figurë emblematike e kujtesës historike shqiptare, si dhe me imzot Nikë Prelën (nr. 75), ipeshkëv i Ipeshkvisë së Kosovës dhe personalitet i njohur i jetës fetare e kombëtare shqiptare.

Po aq domethënëse janë edhe intervistat me figura që mishëronin kujtesën historike dhe aspiratat kombëtare shqiptare. Në këtë kuadër veçohet intervista ekskluzive me Lekën I, Mbret i Shqiptarëve (nr. 96), e cila riktheu në debatin publik një figurë dhe një traditë shtetformuese që kishte qenë pothuajse e ndaluar gjatë periudhës komuniste. Gjithashtu, intervista me Driton Lajçin, nënkryetar i Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës (nr. 96), pasqyron angazhimin e rinisë studentore në proceset e rezistencës dhe emancipimit demokratik të Kosovës.

Në tërësi, korpusi i intervistave të botuara në revistën “Dituria Islame” përbën një arkiv të rrallë me vlera të veçanta fetare, kulturore, intelektuale dhe kombëtare të fund shekullit XX.

DRITARE E RIKTHIMIT TË JETËS FETARE NË SHQIPËRI

Një vëmendje të veçantë revista “Dituria Islame” i kushtoi zhvillimeve në Shqipëri pas shembjes së regjimit komunist dhe rikthimit të lirisë së besimit, duke e konsideruar këtë proces jo vetëm si një ngjarje me rëndësi fetare, por edhe si një kthesë historike në jetën kombëtare të shqiptarëve. Në një kohë kur Shqipëria po dilte nga një periudhë gati gjysmë-shekullore të ndalimit institucional të fesë dhe të ateizmit shtetëror, revista ndoqi me interes të veçantë procesin e ringjalljes së jetës fetare, duke pasqyruar hap pas hapi rihapjen e xhamive, rikthimin e praktikës fetare, themelimin e institucioneve arsimore islame dhe rindërtimin e strukturave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Përmes reportazheve, kronikave, intervistave dhe analizave, lexuesit në Kosovë dhe në hapësirën mbarëshqiptare informoheshin për një proces historik që simbolizonte rikthimin e një pjese të rëndësishme të identitetit shpirtëror dhe kulturor të shqiptarëve.

Që në vitet e para të pluralizmit, revista solli një varg shkrimesh dhe reportazhesh që dokumentonin hapat e parë të kësaj rilindjeje fetare. Në këtë kuadër u botuan shkrimet “Xhamia filloi jetën” (nr. 25) dhe “Vizita e parë” (nr. 25), të cilat pasqyronin emocionet dhe atmosferën e rikthimit të jetës fetare në Shqipëri. Në të njëjtën linjë, reportazhi i Qemajl Morinës “Pas gjysmë shekulli Shqipëria i kthehet fesë” paraqet një dëshmi të gjallë të transformimeve që po ndodhnin në shoqërinë shqiptare, ndërsa shkrimi “Ligjet ndërrojnë, ndjenjat shpërthejnë” evidenton dimensionin emocional dhe shpirtëror të këtij procesi, duke dëshmuar se besimi i ruajtur për dekada në vetëdijen e njerëzve po rikthehej tashmë në hapësirën publike.

Një vend të veçantë zuri pasqyrimi i rikthimit të praktikës fetare dhe i rolit të fesë në jetën e qytetarëve. Në këtë drejtim, artikulli “Islami jeton në zemrat e popullit shqiptar” (nr. 26), kushtuar festimit të Bajramit në Tiranë, dëshmonte se besimi kishte mbijetuar në vetëdijen kolektive pavarësisht dekadave të represionit shtetëror.

Vëmendje e konsiderueshme iu kushtua edhe rindërtimit institucional të jetës fetare dhe arsimit islam në Shqipëri. Revista informoi lexuesit për njohjen zyrtare të shkollave fetare nga shteti shqiptar përmes shkrimit “Shqipëria zyrtarisht njeh shkollat fetare” (nr. 32), ndërsa përmes analizës së Qemajl Morinës “Ringjallja e fesë në Shqipëri” u trajtuan dimensionet historike, kulturore dhe shoqërore të këtij transformimi. Në të njëjtën frymë, artikulli “Vazhdon traditën e saj Medreseja ‘Sheh Shamia’ në Shkodër” (nr. 70), dëshmonte vazhdimësinë e traditës së arsimit islam ndër shqiptarë, ndërsa shkrimi “Shkodra – shembull i mirëkuptimit dhe tolerancës fetare” (nr. 74), vinte në pah harmoninë ndërfaqet si një nga vlerat më të rëndësishme të shoqërisë shqiptare.

Në tërësi, përmes dhjetëra reportazheve, analizave, kronikave dhe intervistave, “Dituria Islame” u shndërrua në një kronikë e rëndësishme e ringjalljes fetare në Shqipëri. Ajo



dokumentoi një nga proceset më domethënëse të historisë moderne shqiptare – rikthimin e lirisë së besimit pas dekadave të ateizmit shtetëror – duke dëshmuar se rilindja fetare ishte njëkohësisht edhe një proces i rikthimit të kujtesës historike, identitetit kulturor dhe vetëdijes shpirtërore të shqiptarëve.

DENONCUESE E HAPTË E KRIMEVE SERBE NDAJ POPULLATËS BOSHNJAKE

Ndonëse vepronte në kushte jashtëzakonisht të vështira, në një Kosovë të pushtuar dhe të ekspozuar ndaj represionit sistematik serb, revista “Dituria Islame” i kushtoi një vëmendje të veçantë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, duke u bërë një nga zërat më të fuqishëm të solidaritetit me popullin boshnjak dhe njëkohësisht një tribunë paralajmëruese për rrezikun që i kanosej edhe shqiptarëve të Kosovës. Në një kohë kur një pjesë e opinionit ndërkombëtar ende hezitonte ta emëronte agresionin serb me emrin e tij të vërtetë, revista publikoi artikuj, reportazhe, analiza dhe dëshmi që denonconin krimet e luftës, spastrimin etnik dhe gjenocidin e ushtruar ndaj popullsisë boshnjake.

Revista i kushtoi një hapësirë të veçantë dokumentimit të krimeve të kryera gjatë luftës. Në këtë drejtim u botuan shkrimet “Gjenocidi serb mbi muslimanët e Bosnjës – dhunimi i vajzave dhe grave muslimane” (nr. 43/1992), si dhe artikulli i Muharrem Omerdiqit “Krimet çetnike ndaj muslimanëve në Bosnjë e Hercegovinë gjatë agresionit të vitit 1992” (nr. 44/1992). Këto materiale sollën para lexuesit shqiptar dëshmi tronditëse mbi dhunën sistematike, masakrat dhe krimet kundër popullsisë civile, duke e bërë revistën një nga burimet e rëndësishme të informimit mbi tragjedinë boshnjake në gjuhën shqipe.

Një vend të veçantë zunë edhe analizat dhe editorialet që trajtonin dimensionet politike dhe morale të konfliktit. Në numrin 44, Qemajl Morina botoi analizën “Turpi i Evropës”, ku kritikonte heshtjen dhe pafuqinë e bashkësisë ndërkombëtare përballë katastrofës humanitare në Bosnjë.

Me vazhdimin e luftës, revista e thelloi trajtimin e kësaj teme përmes analizave historike, politike dhe civilizuese. Në shkrimin “Bosnja – viktimë e indolencës së Perëndimit” (nr. 51), Qemajl Morina argumentonte se tragjedia boshnjake nuk ishte vetëm rezultat i agresionit serb, por edhe pasojë e mosveprimit të faktorëve ndërkombëtarë. Në të njëjtën frymë, editoriali “Bosna – Endelusi i ri” (nr. 57), ngrinte alarmin se shkatërrimi i Bosnjës përbente një kërcënim për vetë vlerat mbi të cilat ndërtohej Evropa moderne.

Ndërkaq, artikulli “Gjenocidi, indolencia dhe vetëflajimi” (nr. 78), përmbledhte në mënyrë sintetike tragjedinë, qëndresën dhe sakrificën e popullit boshnjak përballë agresionit.

Në këtë kuptim, shkrimet e “Diturisë Islame” për Bosnjën nuk përbënin vetëm raportim dhe analizë të një lufte, por një akt ndërgjegjësimi kombëtar, një thirrje për vigjilencë dhe një dëshmi të solidaritetit të sinqertë të shqiptarëve me popullin boshnjak në një nga periudhat më tragjike të historisë së tij moderne.

MBËSHTETËSE E DENJË E PËRPJEKJEVE TË POPULLIT SHQIPTAR PËR LIRI E PAVARËSI

Një dimension me rëndësi të veçantë në veprimtarinë e revistës “Dituria Islame” ishte angazhimi i saj në pasqyrimin e gjendjes së rëndë politike, shoqërore dhe humanitare nëpër të cilën kaloi Kosova gjatë viteve të okupimit serb, si dhe në mbështetjen morale, intelektuale dhe kombëtare të përpjekjeve të popullit shqiptar për liri, dinjitet dhe pavarësi. Në një kohë kur institucionet shqiptare të informimit ishin mbyllur ose vepronin nën tryzni të vazhdueshme, revista u bë një nga zërat më të rëndësishëm që dokumentonte sistematikisht represionin, diskriminimin dhe dhunën e ushtruar nga regjimi serb ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Në faqet e saj u botuan artikuj, kronika dhe reportazhe që pasqyronin forma të ndryshme të terrorit shtetëror, si “Dajak për shqiptarët”, “Dhuna e ‘shtetit juridik’ edhe në Medrese”, “Tmerri i asaj nate në Medrese”, “Represion dhe dhunë edhe mbi imamë”, si dhe shumë shkrime të tjera që dëshmonin për shkeljet e vazhdueshme të të drejtave njerëzore, fetare dhe kombëtare të shqiptarëve. Përmes këtyre materialeve, revista jo vetëm informonte opinionin publik, por edhe ruante një dëshmi të shkruar të realitetit të kohës, duke dokumentuar për brezat e ardhshëm politikën represive të regjimit serb në Kosovë.

Megjithatë, “Dituria Islame” nuk mbeti vetëm kronikane e vuajtjeve dhe e padrejtësive. Ajo u bë edhe bartëse e një

fryme shprese, qëndrese dhe mobilizimi moral në mbështetje të aspiratave të popullit shqiptar për liri. Në faqet e saj gjetën vend analiza, intervista, reportazhe dhe trajtesa që pasqyrojnë rezistencën qytetare, protestat studentore, sakrificën e popullit shqiptar dhe përpjekjet për çlirim. Në këtë kuadër veçohen shkrimet “Dhembje e krenari në ditën e protestës studentore”, “Studentët paqësorë shqiptarë përballë terrorizmit shtetëror serb në Kosovë”, si dhe intervista me Driton Lajçin, nënkryetar i Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, e cila pasqyron rolin e rinisë studentore në proceset e rezistencës dhe emancipimit kombëtar.

Me daljen në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe përshkallëzimin e konfliktit, revista i kushtoi vëmendje të veçantë zhvillimeve që lidhnin luftën për liri me të drejtën legjitime të popullit shqiptar për vetëvendosje. Në këtë kontekst u botuan shkrime si “Drenica – kurban i lirisë së Kosovës”, “Kosova (shqiptarët) në prag të luftës”, “Masakra e Drenicës – vazhdimësi e terrorit gjenocidal serb”, “Kosova pas Drenicës”, “Dëshmorët nuk vdesin”, “UÇK-ja faktor vendimtar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës” dhe “Kosova ndërmjet terrorit serb dhe indiferencës së Perëndimit”. Përmes këtyre trajtesave, revista afirmonte të drejtën e popullit shqiptar për liri dhe evidentonte shkaqet historike, politike dhe shoqërore që kishin çuar në shpërthimin e konfliktit.

Një vend të rëndësishëm në faqet e revistës zuri edhe dokumentimi i krimeve të luftës dhe i shkatërrimit të trashëgimisë fetare e kulturore shqiptare. Artikuj si “Agresionit serb nuk i shpëtuan as xhamitë”, “Masakra që tmerroi botën”, “Një natë para natës së Bajramit Reçaku u la me gjak” dhe “Vdekja që u përjetësua në malet e lirisë”, dëshmojnë për përkushtimin e revistës që të ruajë kujtesën e vuajtjeve të popullit shqiptar dhe të dokumentojë pasojat e agresionit serb mbi njerëzit, institucionet dhe trashëgiminë kulturore të Kosovës.

Përmes këtij angazhimi të vazhdueshëm, “Dituria Islame” u shndërrua në një tribunë të rëndësishme të ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Ajo kontribui në ruajtjen e së vërtetës historike, në forcimin e frymës së qëndresës dhe në mbështetjen morale të popullit shqiptar në një nga periudhat më të vështira të historisë së tij moderne. Në këtë kuptim, revista nuk ishte vetëm një vëzhgues e zhvillimeve të kohës, por një pjesëmarrëse aktive në përpjekjen kolektive për liri, dinjitet dhe pavarësi, duke dëshmuar se fjala e shkruar mund të shndërrohet në një formë të fuqishme rezistence dhe shërbimi kombëtar.

PËRFUNDIMI

Shqyrtimi i veprimtarisë së revistës “Dituria Islame” gjatë viteve ’90 dëshmon qartë se ajo e tejkaloi funksionin e një periodiku fetar, duke u shndërruar në një institucion të rëndësishëm të jetës fetare, kulturore, intelektuale dhe

kombëtare shqiptare. Në një periudhë të karakterizuar nga ndryshime të thella historike – rënia e sistemit komunist, rikupimi i Kosovës nga regjimi serb, represioni institucional, rezistenca qytetare dhe lufta për liri – revista luajti një rol të rëndësishëm në artikullimin e mendimit të lirë dhe në konsolidimin e vetëdijes kolektive shqiptare.

Përmes një korpusi të gjerë artikujsh, studimesh, intervistash dhe analizash, “Dituria Islame” kontribui në forcimin e vetëdijes fetare dhe në afirmimin e vlerave islame në gjuhën shqipe, duke u shndërruar njëkohësisht në një hapësirë të rëndësishme të debatit intelektual. Ajo ofroi platformë për një gamë të gjerë autorësh, teologë, studiues, historianë dhe publicistë, të cilët trajtuan çështje thelbësore të identitetit, historisë dhe kulturës shqiptare në kontekstin e sfidave të kohës.

Një nga kontributet më domethënëse të revistës qëndron në rolin e saj në procesin e dekomunizimit të vetëdijes shqiptare dhe në rikthimin kritik të kujtesës historike. Përmes trajtimit të figurave të anashkaluara, ngjarjeve të shtrembëruara dhe trashëgimisë së mohuar, revista kontribui në rivendosjen e kontinuitetit historik dhe kulturor të shqiptarëve. Në të njëjtën kohë, ajo dokumentoi në mënyrë të qëndrueshme realitetin e represionit në Kosovë, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe format e rezistencës qytetare e kombëtare, duke u shndërruar në një burim të rëndësishëm kronistik të periudhës.

Po ashtu, “Dituria Islame” pasqyroj me ndjeshmëri të veçantë proceset e ringjalljes fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit, duke krijuar ura komunikimi ndërmjet hapësirave shqiptare dhe duke kontribuar në ripërtëritjen e identitetit shpirtëror e kulturor. Përmes intervistave me personalitete të shquara, ajo krijoi një arkiv të çmuar të mendimit shqiptar të fund shekullit XX, duke afirmuar kulturën e dialogut dhe pluralizmit intelektual.

Në këtë kuptim, revista “Dituria Islame” gjatë viteve ’90 përfaqëson një platformë të shumëfishtë: shkollë e edukimit fetar, tribunë e mendimit intelektual, forum i kulturës shqiptare dhe arkiv i kujtesës historike. Ajo arriti të ruajë ekuilibrin ndërmjet misionit fetar dhe përgjegjësisë kombëtare, duke i shërbyer njëkohësisht dijes, besimit, kulturës dhe lirisë.

Ky mision u bë i mundur falë angazhimit institucional të Bashkësisë Islame të Kosovës, vizionit të redaksisë, kontributit të autorëve dhe besimit të lexuesve. Prandaj, kontributi i saj përbën një kapitull të rëndësishëm të publicistikës shqiptare dhe të mendimit islam në hapësirën shqiptare.

Në përmbyllje, “Dituria Islame” nuk ishte vetëm dëshmitare e zhvillimeve historike të kohës, por edhe pjesëmarrëse aktive në formësimin e tyre. Ajo mbetet një trashëgimi e vyer e kulturës fetare, intelektuale dhe kombëtare shqiptare, me një rol të qëndrueshëm në ruajtjen e identitetit dhe kultivimin e vlerave që kanë ushqyer ndër breza vetëdijen fetare dhe kombëtare të shqiptarëve.

“Dituria Islame” dhe kontributi i saj në fuqizimin e identitetit kombëtar shqiptar në Kosovë (1990–1999)

Dr. Sadik Mehmeti

Periudha e dytë (1990–1999) pra, paraqet një fazë të veçantë në zhvillimin e revistës “Dituria Islame”, e karakterizuar nga një angazhim më i theksuar fetar, kombëtar dhe shoqëror në rrethana të thella krizash politike dhe humanitare në Kosovë.

IDENTITETI SHQIPTAR – VAZHDIMËSI HISTORIKE

Përgjatë historisë së tyre, trojet shqiptare kanë qenë hapësirë ndërthurjeje e shumë rrymave fetare, kulturore dhe politike. Megjithatë, shoqëria shqiptare nuk e ka humbur identitetin e saj, por përmes një ndërveprimi të kujdesshëm me ndikimet e jashtme ka ndërtuar një veçanti historike - një identitet unik dhe të dallueshëm, të cilin e ka ruajtur dhe kultivuar ndër shekuj, dhe me të cilin vazhdon të identifikohet.

Në këtë proces, bashkësitë fetare shqiptare, e kanë luajtur një rol të rëndësishëm, duke kontribuar përmes njerëzve të tyre, institucioneve dhe literaturës së botuar në përhapjen e dijes, në ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore e kulturore, si dhe në ndërtimin e vetëdijes identitare, e cila ka ndihmuar në vazhdimësinë historike dhe në forcimin e përkatësisë shoqërore.

Një rol vendimtar në këtë zhvillim padyshim ka luajtur Bashkësia Islame e Kosovës, e cila, si institucioni përfaqësues i komunitetit shumicë të popullatës, përmes literaturës së bollshme dhe organeve të saj mediatike e botuese, ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në edukimin fetar, kulturor dhe intelektual të shqiptarëve, si dhe në ruajtjen, afirmimin dhe fuqizimin e vlerave shpirtërore e kombëtare.

“DITURIA ISLAME” – PLATFORMË E MENDIMIT FETAR, KULTUROR DHE IDENTITAR

Ndër periodikët më të rëndësishëm të Bashkësisë Islame të Kosovës, një vend të veçantë në historinë bashkëkohore të mendimit fetar dhe kulturor shqiptar, zë revista “Dituria Islame”, e cila filloi të botohej në qershor të vitit 1986, me daljen e numrit të saj të parë, dhe vijon pandërprerë rrugëtimin



e saj botues deri më sot. Ashtu si vetë botuesi i saj, pra Bashkësia Islame të Kosovës, e cila në themel ka angazhimin fetar, kulturor dhe arsimor, edhe redaksia e revistës “Dituria Islame” ka ndjekur me përkushtim zhvillimet fetare islame, kulturore, arsimore e shkencore, duke u shndërruar në një platformë të rëndësishme të artikullimit të mendimit fetar dhe intelektual.

Njëkohësisht, ajo ka shërbyer si hapësirë për inteligjencën e shquar shqiptare për trajtimin e temave me rëndësi që lidhen me fenë, historinë, kulturën dhe trashëgiminë kombëtare, duke ndihmuar në ruajtjen dhe forcimin e kujtesës historike e identitare të shqiptarëve.

Elita intelektuale shqiptare, e pranishme në revistën “Dituria Islame”, karakterizohet nga një larmi e theksuar profilesh, duke përfshirë dijetarë të teologjisë islame, studiues të fushave të ndryshme shkencore, gjuhëtarë, poetë, pedagogë, si dhe personalitete me angazhime të gjera shoqërore e kulturore. Këta autorë trajtuan një gamë të gjerë temash, që shtriheshin nga mendimi fetar islam, studimet teologjike, doktrina dhe jurisprudenca islame, deri te reflektimi filozofik dhe mendimi kritik; nga kultura dhe trashëgimia shpirtërore, arsimi dhe pedagogjia, deri te letërsia, gjuha shqipe dhe analiza letrare; si dhe nga historia kombëtare, deri te kronikat informative dhe trajtimi i zhvillimeve më të rëndësishme në hapësirën shqiptare dhe më gjerë.

Megjithatë, në një trajtim jubilar me rastin e katër dekadave të botimit të revistës “Dituria Islame”, e cila përgjatë këtij rrugëtimi ka arritur të botojë mbi 426 numra, është e pamundur të përfshihen në mënyrë të plotë të gjithë autorët dhe kontributet e tyre. Kjo jo vetëm për shkak të numrit të madh të bashkëpunëtorëve dhe larushisë tematike që e karakterizon revistën, por edhe për faktin se një trajtim i tillë do të kërkonte një hapësirë studimore shumë më të gjerë. Për këtë arsye, në këtë analizë, vëmendje e veçantë do t’u kushtohet teksteve që trajtojnë historinë dhe kulturën shqiptare, si fusha me rëndësi të posaçme në procesin e afirmimit dhe fuqizimit të vetëdijes historike, kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve. Megjithatë, edhe ky korpus tematik është tepër i gjerë për t’u trajtuar në tërësi, prandaj, analiza përqendrohet kryesisht në numrat e botuar gjatë viteve 1990–1999, një periudhë që përfaqëson një fazë të rëndësishme të konsolidimit të profilit fetar, kulturor dhe intelektual të revistës. Kjo qasje kushtëzohet edhe sepse zhvillimi i revistës “Dituria Islame”, si në aspektin tematik, ashtu edhe në atë institucional e intelektual, sipas mendimit tonë, ndahet në tri periudha kryesore, të cilat pasqyrojnë faza të ndryshme të evolucionit

dhe ndikimit të saj në jetën fetare, kulturore dhe shkencore shqiptare:

- Periudha e parë (1986–1990) – faza e intensifikimit të jetës fetare dhe kulturore në kushtet e sistemit antifetar dhe ideologjik në rënie;

- Periudha e dytë (1990–1999) – faza e rezistencës kulturore dhe afirmimit kombëtar në kushtet e okupimit;

- Periudha e tretë (pas vitit 1999 e sot) – faza e transformimit shoqëror në kushtet e lirisë dhe globalizimit në fillim të shek. XXI.

Dhe përderisa periudha e parë (1986–1990) mund të cilësohet, sipas mendimit tonë, si faza e intensifikimit të jetës fetare dhe kulturore në kushtet e sistemit antifetar dhe ideologjik në rënie, kjo përkon edhe me fazën e themelimit dhe konsolidimit fillestar të revistës “Dituria Islame”, një etapë që mund të konsiderohet si një nga momentet kyçe dhe si një pikë kthese në historinë e shtypit islam në gjuhën shqipe. Në këtë kohë, jeta politike, shoqërore dhe shpirtërore e shqiptarëve në Kosovë po kalonte nëpër procese intensive transformimi: sistemit ateisto-komunist po i afrohej fundit, ndërsa shoqëria shqiptare, veçanërisht ajo myslimane, po përballlej me nevojën e ripërcaktimit të rolit të saj fetar dhe kulturor në rrethana të reja historike e ideologjike. Pikërisht

në këto rrethana, revista “Dituria Islame” u shfaq si një mundësi e rëndësishme për artikullimin e mendimit fetar, si dhe për ruajtjen e vetëdijes shpirtërore dhe afirmimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

Dhe ndërsa periudha e tretë, e cila fillon pas luftës dhe çlirimit të Kosovës (1999) dhe shtrihet deri në ditët e sotme, mund të cilësohet si faza e transformimit shoqëror në kushtet e reja politike, kulturore, të lirisë dhe globalizimit, si dhe të përgatitjes së qytetarit/besimtarit për sfidat e shek. XXI, revista “Dituria Islame” ka ridimensionuar ndjeshëm rolin dhe misionin e saj. Ajo është angazhuar gjithnjë e më shumë në trajtimin dhe analizimin kritik të dukurive negative shoqërore, sfidave morale e kulturore, si dhe të ndikimeve ideologjike dhe rrymave të ndryshme që shoqërojnë proceset e globalizimit dhe transformimin e shoqërisë së pasluftës përballë sfidave të shekullit XXI.

Në anën tjetër, periudha më e rëndësishme dhe me ndikimin më të madh të revistës “Dituria Islame” në fuqizimin e identitetit të shqiptarëve, gjithnjë sipas mendimit tonë, mbetet periudha e dytë (1990–1999), pasi ajo përfaqëson një fazë të veçantë të rezistencës intelektuale, kulturore dhe kombëtare në rrethana shumë të rënda politike dhe shoqërore. Kjo periudhë karakterizohet nga rritja

Periudha e dytë (1990–1999) pra, paraqet një fazë të veçantë në zhvillimin e revistës “Dituria Islame”, e karakterizuar nga një angazhim më i theksuar fetar, kombëtar dhe shoqëror në rrethana të thella krizash politike dhe humanitare në Kosovë.

e rolit të revistës si zë i artikulimit të realitetit të dhunshëm dhe represiv, si dhe si platformë e rëndësishme e ruajtjes dhe fuqizimit të vetëdijes kombëtare e fetare të shqiptarëve në Kosovë.

ZË I FUQISHËM I KAUZËS PËR LIRI DHE PAVARËSI

Periodha e dytë (1990–1999) pra, paraqet një fazë të veçantë në zhvillimin e revistës “Dituria Islame”, e karakterizuar nga një angazhim më i theksuar fetar, kombëtar dhe shoqëror në rrethana të thella krizash politike dhe humanitare në Kosovë. Kjo periudhë përkon me intensifikimin e represionit të regjimit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, i cili u manifestua përmes mohimit sistematik të të drejtave politike, arsimore dhe kulturore, dhunës institucionale, torturave, mbylljes dhe kufizimit të institucioneve arsimore në gjuhën shqipe, si dhe ngjarjeve të rënda që tronditën shoqërinë shqiptare, përfshirë masakrat e shumta dhe së fundmi edhe luftën e viteve 1998–1999.

Në këto rrethana, në një periudhë të pushtimit serb në Kosovë, revista “Dituria Islame” dhe botuesi i saj, Bashkësia Islame e Kosovës, mbajtën një qëndrim të fuqishëm moral, fetar dhe kombëtar, duke u shndërruar në një zë të rëndësishëm për artikullimin e shqetësimeve shoqërore, fuqizimin e ndjenjës fetare dhe kombëtare, si dhe afirmimin e dinjitetit dhe rezistencës shpirtërore të popullit shqiptar në Kosovë.

Në periudhën e dytë të revistës, udhëheqjen e saj e mori studiuesi dhe intelektual i guximshëm e vizionar mr. Qemajl Morina, nën drejtimin e të cilit ajo njohu një zgjerim të dukshëm tematik dhe të rrethit të bashkëpunëtorëve. Krahas çështjeve fetare, që mbetën boshti kryesor i saj, revista filloi të përfshijë gjithnjë e më shumë shkrime me karakter historik, letrar, kulturor dhe publicistik. Ky zgjerim lidhej ngushtë me rrethanat e ndjera që po kalonte Kosova, si dhe me nevojën për një trajtim më të gjerë të çështjeve shoqërore e kombëtare.

Kështu, “Dituria Islame”, nga një tribunë e dijes fetare, u shndërrua në përkrahëse dhe zë i fuqishëm i kauzës së shqiptarëve për liri dhe pavarësi, duke luajtur një rol të rëndësishëm në një nga periudhat më sfiduese të historisë së tyre bashkëkohore dhe duke theksuar veçanërisht dashurinë për gjuhën, flamurin, atdheun dhe shqiptarinë. Gjatë periudhës së agresionit dhjetëvjeçar serb, faqet e saj u hapën gjithnjë e më shumë për tekste me përmbajtje patriotike dhe atdhetare, ndërsa tematika e saj u përshtat me kushtet e qëndresës dhe luftës së popullit shqiptar kundër pushtimit serb.

**Revista
“Dituria
Islame” e
tejkaloj rolin e
saj tradicional
fetar duke u
shndërruar në
një tribunë të
afirmimit
kombëtar dhe
të dashurisë
për atdheun.
Në faqet e saj
u kristalizua
një vizion i
mbështetur
mbi tri shtylla
themelore:
fenë, popullin
dhe atdheun.**

“FEJA, POPULLI DHE ATDHEU”: TRINOMI IDENTITAR DHE IDEJA E NËNKUPTUAR E BASHKIMIT KOMBËTAR

Pavarësisht se roli i saj primar, si një medium që botohej nga institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, ishte fetar, megjithatë “Dituria Islame”, mori mbi vete edhe rolin e një medie që në qendër të saj e vendosi edhe afirmimin dhe fuqizimin e kombit dhe dashurinë për vatanin, gjithnjë duke pasur parasysh se kombi dhe atdheu duhet të ruhen e të zhvillohen kudo dhe në të gjitha institucionet, sidomos kur ata, pra kombi dhe atdheu, janë në rrezik. Prandaj, boshti i shumë teksteve të “Diturisë Islame” në këtë periudhë mund të përmbledhet në moton: feja, populli dhe atdheu, si dhe ideja e nënkuptuar e bashkimit kombëtar si një aspiratë në zhvillim.

Feja në “Diturinë Islame” nuk shpjegohet vetëm si përcjellje e traditës fetare nga librat dhe nga interpretimet e ulemasë, por edhe si promovim i vlerave fetare që përshtaten me kohën dhe me rrethanat në të cilat jetojnë myslimanët. Revista synon që mësimet fetare të jenë të zbatueshme në jetën e përditshme dhe të lidhen me realitetin shoqëror bashkëkohor.

Populli, në faqet e “Diturisë Islame”, është, - në radhë të parë, - populli shqiptar. Kjo shihet në temat që trajtojnë politikën në Kosovë, dhunën dhe padrejtësitë ndaj shqiptarëve, si dhe sfidat e tyre në rajon. Megjithatë, zëri që përcjell revista është kryesisht qytetar, pra ajo synon të jetë zëri i qytetarit dhe i besimtarit në përgjithësi dhe i shqiptarëve në veçanti, kurse fokusi mbi problemet e shqiptarëve lidhet për shkak të përvojave dhe vështirësive që ata kanë kaluar dhe po kalonin.

Atdheu, në përmbajtjen e “Diturisë Islame”, kuptohet si një kornizë për promovimin e parimeve qytetare, ku liria dhe të drejtat janë pjesë themelore e një shoqërie demokratike. Në këtë kuptim, atdheu lidhet ngushtë me Kosovën, ndërsa kauza përfshin shqiptarët në përgjithësi. Sepse “Dituria Islame”, jo vetëm në periudhën e marrë në shqyrtim, por që nga numri i parë e deri më sot, ka funksionuar si një medium mbarëshqiptar, i dedikuar shqiptarëve myslimanë në të gjitha trojet ku jetojnë. Edhe pse pjesa më e madhe e përmbajtjes lidhet me Kosovën, gjë që është e kuptueshme, në faqet e saj janë botuar shkrime edhe për shqiptarët e Shqipërisë, sidomos në fillim të viteve ’90 kur feja filloi të rikthehej në jetën publike, si dhe për shqiptarët e Maqedonisë, ku shpesh u shkelën të drejtat e tyre, deri në situata që çuan edhe në luftë (2001). Në këtë periudhë, “Dituria Islame” shfaqet edhe si dëshmitare e zhvillimeve të kohës, duke pasqyruar realitetin

politik, shoqëror dhe kulturor të shqiptarëve në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, dhe më gjerë në hapësirën ballkanike. Në këtë kuptim, një vend qendror në synimet e saj zë edhe ideja e bashkimit shpirtëror dhe kombëtar të shqiptarëve, si faktor i ruajtjes së vazhdimësisë historike dhe identitetit të tyre, si dhe si një proces historik në zhvillim.

KULTURA DHE TRASHËGIMIA SHQIPTARO-ISLAME SI PËRBËRËSE TË IDENTITETIT


Përveç shkrimeve standarde fetare dhe vështrimeve mbi fenë, moralin dhe edukatën, *“Dituria Islame”* në këtë periudhë filloi të botonte gjithnjë e më shumë edhe shkrime nga kultura dhe trashëgimia jonë shqiptaro-islame, duke synuar të ndriçonte këtë pjesë të rëndësishme të kulturës sonë të përgjithshme, e cila gjatë ish-sistemit komunist ishte anatemuar, anashkaluar dhe injoruar. Kjo qasje nuk lidhej vetëm me nevojën për të rikthyer në vëmendje dimensionin kulturor e historik të trashëgimisë sonë, por edhe me faktin se *“Dituria Islame”*, siç e thamë, e konsideronte veten pjesë të pandashme të një procesi më të gjerë të zgjimit të fuqishëm të vetëdijes shpirtërore, kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve në rrethana të reja shoqërore e politike. Përmes kësaj përmbajtjeje, revista synonte të promovonte vlerat kulturore, ngjarjet historike dhe personalitetet kombëtare, duke kontribuar kështu në fuqizimin e ndjenjës kombëtare dhe në mbështetjen e kauzës së përbashkët për liri, pavarësi dhe emancipim ideologjik e politik.

Në këtë drejtim, në faqet e revistës janë botuar studime të ndryshme që trajtojnë ngjarje dhe personalitete historike, duke filluar nga rikthimi te ngjarjet themelore të historisë shqiptare, si Beteja e Kosovës (1389), Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), e sidomos risjellja në vëmendje e zhvillimeve dhe figurave që kanë lënë gjurmë gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Trajtimi i këtyre figurave historike, i ngjarjeve kyçe të historisë kombëtare, i gjuhës shqipe dhe i idealit të lirisë krijonte jo vetëm dije, por edhe ndjenjë përkatësie dhe përgjegjësie. Në këtë mënyrë, *“Dituria Islame”* arriti të ndërthurë në mënyrë organike aspektin fetar me atë kombëtar, duke u shndërruar në një hapësirë ku dija islame dhe vetëdija historike ushqenin njëra-tjetrën.

Një kontribut të veçantë në këtë drejtim dhanë autorë dhe studiues të shquar, si: Muhamet Pirraku, Mehmet Kajtazi, Ali Podrimja, Kadri Halimi, Pajazit Nushi, Sabile Keçmezi-Basha, Kristaq Prifti, Sabit Uka, Zekerija Cana, Shefqet Pllana, Mehdi Polisi, Drita Statovci, Rexhep Ismajli, Aliriza Selmani, Masar Rizvanolli, Iljaz Rexha, Mehmet Halimi, Rexhep Hoxha, Vehap Shita, Faik Shkodra, Mahmud Hysa, Gazmend Shpuza, Skënder Rizaj, Nexhat Nahi, Isa Bajçinca, Ali Iljazi, Hakif Bajrami, Abdullah Hamiti, Zejnullah Gruda, Behram Hoti, Feti Mehdiu, Milazim Krasniqi, Adem Zejnullahu, Jashar Rexhepagiqi, Abdi Baleta, Nehat Krasniqi, Tahir Z. Berisha, Agim Zogaj, Mehdi Hyseni, Mujdin Ahmeti, Elez Osmani, Qemajl Morina, e shumë e shumë të tjerë, të cilët përmes analizave dhe studimeve të

tyre i dhanë revistës një peshë të veçantë intelektuale, historike dhe kombëtare.

Kontributet e tyre, si: “Liritë e njeriut” (nr. 18, f. 34-35); “Feja dhe kombi te shqiptari” (nr. 19, f. 29-30); “Nuk ka fe pa atdhe!” (nr. 22-23); “Në gjurmët e një veprë të panjohur të Naimit” (nr. 26, f. 34); “Kontributi i shqiptarëve në disiplina shkencore” (nr. 44, f. 26-29); “Roli i femrës në ruajtjen e identitetit kombëtar” (nr. 44, f. 30-32); “Koncepti moral-etik në veprën e Said Najdenit” (nr. 52, f. 21-23); “Një raport i diplomacisë angleze mbi veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare” (nr. 50, f. 46-49); “Elementi fetar islam në letërsinë shqiptare” (nr. 51, f. 10-11); “Arsimi i muslimanëve (shqiptarëve) në Sanxhakun e Nishit” (nr. 51, f. 14-16); “Islamizmi dhe idetë patriotike të tij” (nr. 53, f. 9-11); “Shkaqet e gjenocidit mbi muslimanët” (nr. 54, f. 29-31); “Këngë të bejtexhinjve 1730-1942” (nr. 56, f. 1-16); “Feja na ruajti gjuhën dhe kombin” (nr. 56, f. 35); “Roli i krerëve të komunitetit mysliman në mbrojtjen kombëtare të Shqipërisë etnike (1941-1945)” (nr. 57, f. 14-19); “Qamil Bala – patriot dhe veprimtar i arsimit kombëtar” (nr. 57, f. 28-30); “Konferenca e Parisit dhe problemi i Shqipërisë së Jugut” (nr. 57, f. 24-27); “Medresetë – vatra të edukimit fetar e kombëtar” (Nr. 61, f. 8-10); “Shqiptarët ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit” (nr. 62, f. 4-5); “Gjuha në shërbesë fetare islame” (nr. 62, f. 23-24); “Kthimi i shqiptarëve me dhunë në fenë ortodokse 1912-1913” (nr. 63, f. 23-29); “Hafiz Ibrahim Dalliu – jeta dhe vepra” (nr. 66, f. 18-19); “Shehidët nuk vdesin” (nr. 66, f. 32); “Ringjallja e fesë në Shqipëri” (nr. 67-68, f. 4-5); “Krimet dhe kriminelët në peshoren e ndërgjegjes njerëzore” (nr. 67-68, f. 20-23); Intervistë me Patër Zef Pëllumbin (nr. 67-68, f. 21-23); “Qëndresa osmano-shqiptare në Sanxhakun e Nishit 1876-



1878” (nr. 69, f. 38–42); “Në 50-vjetorin e LPTSH-së” (nr. 73, f. 32–34); “Dromca tragjike nga historia jonë kombëtare 1878–1995” (nr. 74, f. 14–18); “Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë” (nr. 75, f. 38–42); “Kush kë po e terrorizon?!” (nr. 83, f. 4–7); “Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950–1956” (nr. 87, f. 29–33); “Medreseja “Alaudin” në shërbim të çështjes fetare dhe kombëtare” (nr. 88, f. 4–9); “Prononcimi i BI të Kosovës për identitetin institucional” (nr. 99, f. 3); “Shqiptarët – popull i vogël por trim” (nr. 99, f. 24–26); “Studentët paqësorë shqiptarë përballë terrorit serb” (nr. 96, f. 18–20); “Roli i fesë në integrimin e kombit” (nr. 100, f. 54–56); “Hafiz Ali Kraja dhe realcionet fe-komb” (nr. 88, f. 92–93); “Roli i fesë dhe i kombit në themelimin e shtetit të pavarur kombëtar” (nr. 88, f. 66–67); “Nazim Gafurri - Shëmbëlltyrë e ndritshme e historisë kombëtare” (nr. 19, f. 18–22); “Hoxha Hasan Tahsini” (nr. 19, f. 12–14); “Hafiz Ali Korça” (nr. 20, f. 24–27); “Sami Frashëri dhe Kamus i-‘Alami” (nr. 43, f. 20–23); “Skënderbeu në Kamus i-‘Alamin e Sami Frashërit” (nr. 12, f. 23–24) etj., - përfshinin një spektër të gjerë temash që lidhen me historinë kombëtare shqiptare, figurat dhe personalitetet e saj, trashëgiminë kulturore e shpirtërore, gjuhën shqipe, flamurin, atdheun, lirinë dhe vetëdijen historike.

Karakterit historiko-kulturor i revistës “Dituria Islame”, sikurse u tha, shpërfaqet gjithashtu edhe në trajtimin e temave që lidhen me vatrat e shqiptarisë në vende të ndryshme të botës, duke kontribuar në bashkimin e copëzave të mozaikut shqiptar në hapësira të ndryshme gjeografike. Në këtë kuadër, shkrimet e botuara përbëjnë dëshmi të qarta të një pune të kujdesshme dhe me vlera të theksuara shkencore, historike dhe kombëtare: “Një fole e shuar e kulturës shqiptare në Egjipt” (nr. 15–16); “Të dhëna arkivore mbi shqiptarët në Arkivin Kombëtar të Egjiptit” (nr. 18, f. 47); “Me shqiptarët e Turqisë” (nr. 19, f. 39); “Nga shkalla e kulturës dhe e civilizimit të një populli” (nr. 26, f. 20–23); “Shqiptarët dhe trashëgimia evropiane” (nr. 44, f. 19–20); “Shqiptarët në Libi” (nr. 70, f. 29–30) etj..

Në periudhën 1997–1999, ndërkaq, një vend të veçantë në revistë zë mbështetja për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si dhe shkrimet motivuese për rrugën drejt lirisë së Kosovës, e cila trajtohej si e drejtë themelore e individit dhe e shoqërisë, si dhe si e drejtë për vetëvendosje dhe si shprehje e aspiratave historike të popullit shqiptar në Kosovë, ku ndër titujt më përfaqësues përfshihen: “Krizë kosovare dhe roli i Bashkësisë Islame”; “Nuk ka fe pa atdhe”; “Shqiptarët- viktimitë e pansllavizmit në kohën e krizës lindore”; “Mbi relacionet midis kombit dhe fesë “UÇK-ja faktor vendimtar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës” (nr. 102–103, f. 22–24); “Drenica kurban i lirisë së Kosovës” (nr. 99, f. 4–5); Kosova (shqiptarët) në prag të fitores” (nr. 99, f. 6–7); “Masakra e Drenicës vazhdimësi e terrorit serb” (nr. 99, f. 7–9); “Kosova pas Drenicës” (nr. 99, f. 15–16); “Dëshmorët nuk vdesin” (nr. 102–103 f. 3–4); “Ardhmëria është e popullit që sakrifikon” (nr. 101, f. 67–69); “Vetëm të bashkuar do t’i realizojmë qëllimet tona” (nr. 104, f. 20); “Çështja e Kosovës në shtypin amerikan” etj..

Shkrimet e tilla jo vetëm që ndriçuan mendjet e lexuesve myslimanë, por patën një rol të rëndësishëm edhe në motivimin dhe fuqizimin kombëtar të tyre.

“DITURIA ISLAME” SI ARKIV I KUJTESËS HISTORIKE DHE QËNDRESËS KOMBËTARE

Kur jemi këtu, duhet të theksojmë edhe faktin se, në fillim të viteve ‘90, kur shtypi shqiptar në Kosovë përballej me vështirësi të shumta nga regjimi serb, “Dituria Islame” për një kohë të caktuar mori edhe një rol tjetër, duke u shndërrua në një nga mediumet e rralla që pasqyronte ngjarjet dhe dhunën e ushtruar nga forcat policore dhe ushtarake serbe ndaj popullsisë shqiptare. Përmes këtyre shkrimeve, revista informonte opinionin publik për represionin, torturat, vrasjet, dëbimet dhe shkeljet e tjera të të drejtave themelore të njeriut në Kosovë. Në këtë mënyrë, “Dituria Islame” jo vetëm që mori rolin e një organi informues, por u shndërrua edhe në një arkiv të rëndësishëm dokumentar, duke ruajtur fakte dhe dëshmi historike mbi agresionin serb në Kosovë.

Për këtë arsye, “Dituria Islame” mbetet një burim i çmuar i kujtesës fetare, historike, kulturore dhe kombëtare, ku pasqyrohen sfidat, qëndresa dhe aspiratat e shqiptarëve në një nga periudhat më të rëndësishme të historisë së tyre moderne. Si e tillë, historia e Kosovës gjatë kësaj periudhe vështirë se mund të trajtohet në mënyrë të plotë pa iu referuar faqeve të “Diturisë Islame”.

PËRFUNDIMI

Gjatë gjithë veprimtarisë së saj që nga themelimi e deri sot, revista “Dituria Islame”, sikurse edhe vetë botuesi i saj, Bashkësia Islame e Kosovës, nuk është identifikuar me asnjë sistem, regjim apo ideologji që bie ndesh me parimet fetare, morale dhe me aspiratat historike, kulturore e kombëtare të shqiptarëve. Qëndrimi i saj është mbështetur në vlerat universale të fesë islame, dijes dhe etikës, duke ruajtur një pavarësi të qartë intelektuale dhe morale ndaj zhvillimeve politike e ideologjike të kohës.

Në rrugëtimin e saj, “Dituria Islame” ka mbetur besnike ndaj misionit të saj themelor: të jetë një burim i dijes së dobishme, një hapësirë e mendimit të matur dhe një urë lidhëse ndërmjet traditës islame dhe realitetit bashkëkohor.

Kontributi i “Diturisë Islame” nuk matet vetëm në vite botimi, as në numra, por në ndikimin e saj në formësimin e vetëdijes fetare dhe kulturore të lexuesit.

Në këtë përvjetor të 40-të të saj, revistës “Dituria Islame” i dëshirojmë jetë të gjatë dhe vijimësi të suksesshme në përmbushjen e misionit të saj fisnik si tribunë e dijes, mendimit dhe vetëdijes fetare, kulturore dhe kombëtare shqiptare.

Në mënyrë të veçantë, asaj i mbetet të vazhdojë, siç ka vepruar deri më sot, të kontribuojë në mënyrë të suksesshme në kultivimin dhe forcimin e mësimave fetare islame, si dhe në afirmimin dhe konsolidimin e bashkimit kombëtar, duke siguruar kështu vazhdimësinë e identitetit unik dhe të dallueshëm të shqiptarëve.

Dimensioni letrar dhe kulturor i “Diturisë Islame”

Dr. Hysen Matoshi

Strukturimi dhe funksionalizimi institucional i jetës islame në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare, të mbetura nën Jugosllavinë Federale, ishte një proces historik, kombëtar e shoqëror, i rrugëtimit gjysmëshekullor deri në pavarësimin e plotë të Bashkësisë Islame të Kosovës. Kjo arritje nuk është një akt dhe as produkt i një vendimi të vetëm. Përkundrazi, është rrjedhojë e zhvillimeve të pandërprera drejt qëllimit të lirisë si kusht për një organizim të pavarur të jetës fetare. Krahas arritjeve në sfera të tjera të organizimit, formimit të strukturave, funksionalizimit të jetës fetare, nëpërmjet formimit të rrjetit të përgjithshëm të përkujdesjes për jetën fetare e sociale të besimtarëve, që nga këshilli i xhamisë e deri te Kuvendi i Bashkësisë Islame, që nga Medreseja e deri te Fakulteti i Studimeve Islame, një vend me rëndësi e ka

luajtur edhe shtypi islam, përkatësisht veprimtaria botuese e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Jeta islame në Kosovë pati vështirësitë e saja, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kur u zhbë krejtësisht struktura disavjeçare e Komunitetit Mysliman Shqiptar, pasi ishte funksionalizuar në një bazë organizative deri diku etnike shqiptare. Për një veprimtari botuese dhe për periodikun islam as që mund të bëhej fjalë në një periudhë kur edhe qenia fizike e shqiptarëve ishte e rrezikuar. Megjithatë, pasi kishin filluar të dilnin organe të periodikut islam në gjuhën shqipe, sikundër ishin “Buletini”, “Edukata Islame” dhe “Takvimi”, më 1986, nisi jetën e saj revista “Dituria Islame”, e konceptuar si mujore me karakter fetar, shkencor e kulturor. Është e kuptueshme që kjo revistë, si një dinamizim i

Jeta islame në Kosovë pati vështirësitë e saja, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kur u zhbë krejtësisht struktura disavjeçare e Komunitetit Mysliman Shqiptar, pasi ishte funksionalizuar në një bazë organizative deri diku etnike shqiptare.



fuqishëm i periodikut islam në gjuhën shqipe, do të përmbante edhe aspekte të rëndësishme informative lidhur me jetën fetare islame në Kosovë dhe më gjerë.

Misionin dhe fizionominë kësaj reviste, në masë të madhe, ia kishin përcaktuar koha dhe kërkesat e saja. Që atëherë e deri sot ajo është bërë një zë i fuqishëm shoqëror, kombëtar, intelektual dhe i vendosur përballë vështirësive të etapës më dinamike në historinë e Kosovës, pa e lënë anash karakterin e saj primar si revistë islame. Njëri ndër drejtuesit e kësaj reviste dhe kontribuuesit më të shquar të publicistikës islame në Kosovë, profesor Qemajl Morina, në tridhjetëvjetorin e daljes së saj, konsideronte se “numrat e “Diturisë Islame” janë një thesar shumë i çmuar fetar e kombëtar për Bashkësinë Fetare Islame, myslimanët dhe kombin shqiptar në tërësi”. Pra, rëndësia e saj është mbarëkombëtare dhe veçmas në një periudhë të ndalimit të shtypit dhe të mediave në gjuhën shqipe.

Marrë parasysh faktin se në kjo revistë për katër dekada ka qenë një tribunë e rëndësishme edhe e mendimit shkencor, kulturor, por edhe hapësirë për prurje të dimensionit artistik letrar, në këtë vështrim do të ndalemi tek aspektet letrare e kulturore që, kur më shumë e kur më pak, kanë gjetur vend në numrat e saj. Do thënë se një numër i madh shkrimesh i trajtojnë aspektet kombëtare të kulturës dhe të kaluarës së shqiptarëve. Kështu në bibliografinë shumëplanëshe të “Diturisë Islame” ne gjejmë shkrime që kanë të bëjnë me historinë tonë kombëtare, me gjuhësinë, me letërsinë, me kulturën tradicionale etj., por edhe me relacione të kulturës sonë me kultura të tjera në kontakt. Redaksitë e ndryshme gjatë daljes së “Diturisë Islame” u kanë bërë vend në faqet e saj shkrimeve letrare, me një përqendrim të kuptueshëm në letërsinë shqipe. Kështu, gjatë kësaj periudhe, në numrat e saj i kanë publikuar kontributet e tyre emra të shquar të letrave shqipe, qofshin ata të sferës kulturore-artistike, qofshin të sferës shkencore-studimore.

“Dituria Islame” ka qenë një hapësirë e rëndësishme për prezantimin e krijimtarisë origjinale letrare të autorëve tanë, kryesisht të njohur, sikundër janë: Rexhep Hoxha, Bedri Hysa, Ali Podrimja, Sabile Keçmezi – Basha, Mirko Gashi, Vehbi Skënderi, Zeqir Gërvalla, Behram Hoti, Iljaz Prokshi etj.. Gjithashtu një varg autorësh, të pranishëm me temën e lëvruar islame, i kanë botuar shkrimet e tyre letrare në faqet e kësaj reviste, si bie fjala: Ali Vezaj, Mexhid Yveysi, Njazi

Përtej misionit të saj fetar, “Dituria Islame” u shndërrua në një tribunë të rëndësishme të mendimit shkencor, kulturor dhe letrar shqiptar. Në faqet e saj gjetën hapësirë studime, ese, krijime letrare dhe trajtesa mbi historinë, gjuhën, letërsinë dhe kulturën kombëtare, duke mbledhur autorë të shquar nga fusha e artit dhe e shkencës.

Sulça, Hysen Shabani, Ilmi Rexhepi, Eset Qerimi, Ejup Ramadani etj.. Dimensionin letrar i kësaj reviste është plotësuar edhe me botimin e pjesëve të krijimtarisë letrare të autorëve tanë të traditës, të cilët, në të kaluarën, ishin pak të pranishëm në jetën tonë kulturore, ose fare të harruar e rrjedhimisht të panjohur për lexuesin e gjerë shqiptar. Bie fjala, janë botuar shkrime letrare të autorëve të periudhave të ndryshme të letërsisë shqipe, sikundër janë: Nezim Frakulla, Muhamet Kyqyku, Hoxha Tasini, Hafiz Ali Ulqinaku, Hysejn Nexhati, Xheladin Vesel Guta, Hafiz Ibrahim Dalli, Hafiz Ali Korça, Ferit Vokopola, Shevqet Dajiu, Ramazan Dema, Haki Taha etj.. Prezantimi i një numri kaq të madh autorësh, por edhe i periudhave letrare në faqet e kësaj reviste na bën të qartë se karakteri i saj, veç të tjerash, ishte edhe letrar dhe kulturor kundruar në një kontest më të gjerë. Është interesant se redaksitë e “Diturisë Islame” jo domosdo botonin në faqet e saj vetëm temën islame, ngase në mesin e shkrimeve letrare do të gjejmë një llojllojshmëri temash e motivesh. Kjo sidomos në periudhën e ndalimit të shtypit dhe të periodikut shqip në Kosovë si pasojë e masave kufizuese të cilat i zbatoi pushteti serb gjatë viteve 90 të shekullit të kaluar. Pra, kur u mbyllën të gjitha rrugët e komunikimit të vlerave letrare me opinionin e gjerë kulturor, ishte revista në fjalë që ofroi hapësirën e saj për prezantimin e tyre.

Krahas botimit të shkrimeve letrare, në faqet e “Diturisë Islame” kanë gjetur vend edhe kontributet shkencore dhe kritiko-letrare të studiuesve tanë, që kryesisht kanë

të bëjnë me letërsinë shqipe, pa lënë anash edhe faktin se gjejmë, në raste më të rralla, edhe shkrime që e trajtojnë kontekstin më të gjerë kulturor e letrar të autorëve shqiptarë, sikurse edhe ndonjë shkrim për autorë të huaj veçmas nga orienti. Kështu, të një rëndësie të madhe historiko-letrare, por edhe kritiko-letrare, janë kontributet studimore të një vargu autorësh të dalluar në shkencën tonë mbi letërsinë. Mund të thuhet se, krahas prurjeve në fushat e kërkimeve historiografike e gjuhësore, studimet letrare e arsyetojnë karakterin shkencor të “Diturisë Islame”. Ndër emrat e dijetarëve tanë të letërsisë që publikojnë rezultatet e tyre në këtë revistë, pa pretenduar ndonjë hierarki të tyre, do të veçonim: Mahmud Hysën, Muhamet Pirrakun, Nehat Krasniqin, Ibrahim Hasnajn, Adem Zejnullahun, Faik Shkodrën, Qazim Qazimin, Ismail

Ahmedin, Abdullah Hamitin, Elez Ismailin, Qemajl Morinën, Sadik Mehmetin, Festim Rizanajn, Besnik Jahën, Refik Gërbeshin, Fetije Gashin etj..


Marrë parasysh se është fjala për një sintezë të periudhës dyzetvjeçare të këtij krahu shkrimesh, ne nuk do të ndalemi te vlerësimi i kontributeve të veçanta të këtyre autorëve për arsye të kuptueshme. Do të ofrohen vetëm disa të dhëna orientuese lidhur me këtë korpus të çmuar shkrimesh, në të cilat hidhet dritë e re dhe pa paragjykime mbi rëndësinë e një pjesë të letërsisë së anashkaluar shqipe. Porë në një prizëm sintetizues kjo letërsi, e trajtuar nga autorët e përmendur, do të mund të përfshihej në disa tërësi tematike.


Së pari është alamiadoja shqiptare. Në disa raste shkrimet për këtë letërsi dhe vetë veprat e saja janë botuar në kuadër të rubrikës “Nga letërsia e anatemuar shqipe”. Në fakt, ky formulim, në masë të madhe, i përgjigjet realitetit, ngaqë alamiadoja shqiptare ishte paragjykuar në studimet tona, si një letërsi e pavlerë, si strukturë e huaj në kulturën shqiptare etj., dhe, pa asnjë dyshim, “*Dituria Islame*” ishte hapësira që shënoi kthesën lidhur me trajtimin më të drejtë dhe më të saktë të alamiadistëve tanë. Studiuesi i mirënjohur i letërsisë së vjetër shqipe, prof. dr. Mahmud Hysa, i ka kushtuar vëmendje të veçantë hedhjes dritë shkencore mbi vlerat e këtij qarku letrar e kulturor shqiptar (i njohur deri atëherë në mendimin tonë shkencor letrar pothuajse vetëm me togfjalëshin “Letërsi bejtexhinjve”), ndërsa “*Dituria Islame*” për Profesor Hysën ka qenë një tribunë e lansimit të disa

ideve novatore e të sakta shkencore, e përdorimit të një terminologjie përkatëse të shkencës së letërsisë, që e identifikon si njërin ndër fenomenet tona shekullore historiko-letrare, por edhe e shqyrtimeve mbi vepra të panjohura të alamiados shqiptare. Nezim Frakulla dhe Muhamet Kyçyku – Çami janë bërë objekt i shqyrtimeve të tij, ndërsa nga autorët të tjerë të mëvonshëm të letërsisë shqipe trajtohen edhe Naim Frashëri dhe Hafiz Ali Korça. Prof. dr. Muhamet Pirraku ka qenë ndër hulumtuesit e pasionuar të trashëgimisë alamiadiste e islame në letërsinë shqipe. Ai ka bërë përpjekje të mëdha që ta kthejë vëmendjen te kjo pjesë e lënë anash e trashëgimisë sonë kulturore e diturore. Pa asnjë dyshim, është ndër autorët më të përfaqësuar në këtë revistë me shkrime të natyrave të ndryshme, si bie fjala, në ato historiografike, publicistike, kulturologjike e në këtë kontekst është bërë i njohur edhe me shqyrtime letrare. Vlen të përmenden studimet për Hafiz Ali Ulqinakun, Hafiz Ymerin, Xheladin Vesel Gutën etj.. Dr. Nehat Krasniqi është autor i një sinteze studimore lidhur me mevludet në gjuhën shqipe të shkruara me alfabet arab. Po ashtu, duke trajtuar alamiadistë shqiptarë, ai ka sjellë një shqyrtim interesant të veprës “*Ilahi shqip*” të Hysejn Nexhatiut, gjithashtu duke e botuar të transkriptuar në alfabetin e sotëm, në numrin vijues të “*Diturisë Islame*”, me çka ka bërë një punë interes për studimin dhe prezantimin e një veprë që përmban vlera historiko-letrare e gjuhësore.

Një dimension me interes për shqyrtime letrare, që kanë gjetur vend në faqet e “*Diturisë Islame*”, e përbën relacioni ndërmjet folklorit tonë letrar dhe veprës së alamiadistëve shqiptarë, sikurse edhe lidhur me përmbajtjet islame të trashëgimisë sonë popullore. Prof. dr. Faik Shkodra vjen shkrimin në dy vazhdimësi të titulluar “*Lidhjet e poezisë së bejtexhinjve kosovarë me letërsinë popullore*”, në të cilin trajton elementet e përbashkëta të alamiadistëve tanë me letërsinë popullore, me theks të veçantë në veprat letrare të Dervish Hasanit nga Krusha e Vogël, Mulla Beqirit nga Drenica, Mulla Dervishit nga Peja, Tahir Efendi Boshnjakut, Dervish Salihut nga Lubizhda e Hasit të Gurit, Haxhi Ymer Lutfi Paçarritit, Hilmi Maliqit (Sheh Malës), Shaip Zurnaxhiut, Tahir Efendi Popovës etj..

Prof. dr. Adem Zejnullahu është studiuesi, i cili, qoftë në faqet e “*Diturisë Islame*”, qoftë edhe në shkrime të botuara në revista të tjera e në vëllime studimore, ka dëshmuar katërçipërisht praninë e elementeve islame në folklorin letrar shqiptar. Gjithashtu, ky studiues u ka kushtuar vëmendje edhe autorëve të letërsisë sonë me përbërës islamë, duke qëmtuar vlerat estetike e ideore të tyre. Shkurtazi po përmendim vetëm disa prej tyre, siç janë studimet: “*Prozë popullore me shtresime islame*”; “*Drama e muhaxhirëve në këngët popullore*”; “*Toleranca fetare e shqiptarëve në krijimet popullore*”; “*Komponenti fetar e kombëtar në poezinë Mulla Xheladin Vesel Gutës*”;





studimin e gjatë kushtuar Ibrahim Dalliut të titulluar “Flakadan për fe e atdhe” etj.. Adem Zejnullahu është ndër studiuesit e rrallë, që punën e tij të gjertanishme shkencore, në drejtim të studimit të vlerave islame të kulturës shqiptare, e ka kurorëzuar madje edhe me disa vëllime të botuara. Dy nga autorët më të anatemuar të letërsisë shqipe kanë qenë Hafiz Ali Korça dhe Hafiz Ibrahim Dalli, të cilët, ndonëse qysh për të gjallë të tyre, kishin bërë jetë aktive letrare, në periudhën e komunizmit u ekskomunikuan nga historitë e letërsisë, nga antologjitë letrare dhe përgjithësisht nga jeta letrare, kulturore e shoqërore për gati gjysmë shekulli. Së pari, Ismail Ahmedi më 1990 sjell në “Diturinë Islame” një shkrim përmbledhës për Hafiz Ali Korçën, ndërsa shkrimi i Ibrahim Hasnajt për Dalliun botohet më 1992, për t’u pasuar nga një shkrim i tij i gjatë në shtatë vazhdimë në këtë revistë më 1995.

Pa pasur pretendimin që t’i sjellë të gjitha shkrimet për letërsinë në këtë kumtesë, po përmend vetëm emrat e disa prej autorëve dhe kontributet e tyre. Kështu dr. Qazim Qazimi është autor i shkrimit “Thelbi i Kuranit vepër e anashkaluar e Naim Frashërit”, “Veprat letrare të Muhamed Çamit dhe poetët e Lindjes” dhe “Jusufo e Zelihaja – histori e poetizuar”; dr. Abdullah Hamiti është autor i këtyre kontributeve: “Pasqyrë e krijimtarisë letrare me alfabet arab në Kosovë”, “Sami Frashëri për poezinë arabe, persiane e turke”; mr. Elez Ismaili me shkrimin “Elementi

fetar islam në letërsinë shqiptare”, dr. Sadik Mehmeti me kontributin “Bejtexhiu opojar Mehmet efendi Salihu” (1898-1985) etj..

Në një varg shkrimesh të “Diturisë Islame”, që kanë për objekt studimi a shqyrtimi letërsinë, autorët iu kushtojnë vëmendje relacioneve të letërsisë e të kulturës shqiptare me atë botërore, ose edhe vetëm disa autorëve të shquar të përmasës botërore. Bie në sy sidomos një shkrim i përgatitur nga Abedin Kojqiqi me titullin “Kush ishte Umer Khajjami sipas F. Nolit dhe H. Ali Korçës?”, pastaj me interes është edhe trajtesa e Qemajl Morinës me titullin, “Poeti i Islamit në faqet e revistës “Err-rrisale” të Kajros (kushtuar Mehmet Akif Ersojt)”, ajo e Selim Sylejmanit, “Pushkini dhe lindja arabe (disa fjalë rreth ciklit “Imitime të Kuranit)”, pastaj shkrimi “Nga poezia e lashtë persiane, përgatitur Sutki Malohoxha” etj., që përgjithësisht janë dëshmi e interesimeve përtëjkombëtare të studiuesve tanë.

Një prezantim i këtillë, me synimin e një sinteze jubilarë, nuk ofron mundësi më të mëdha dhe më shteruese sa i përket paraqitjes së pjesës dërrmuese të kontributeve artistike letrare, shkencore letrare, kritiko-letrare dhe kulturore përgjithësisht që gjetën hapësirën e duhur në faqet e “Diturisë Islame”. U mjaftuan këtë herë me kthimin e vëmendjes kah ky dimension i rëndësishëm i kulturës sonë fetare e kombëtare me shpresën që, në të ardhmen, kjo materie të trajtohet në një format të përgjithshëm studimor.

Krahas prezantimit të krijimtarisë autoriale letrare shqipe dhe të përbotshme, mendimi shkencor letrar, shqyrtimi kritik i veprave të letërsisë sonë popullore dhe të asaj autoriale, nxjerrja e disa autorëve e veprave të letërsisë shqipe nga terri i ekskomunikimit, heqja e paragjykimëve të rënda për to si kinse një trup i huaj në letërsinë e në kulturën tonë, trajtimi i relacioneve ndërkulturore e ndërletrare të shqiptarëve me të tjerët, e bëjnë “Diturinë Islame” revistë me interes edhe për studimet letrare. Ajo u bë pararendëse e mendimit të lirë, e të vërtetës shkencore, e cila me vështirësi, edhe sot e asaj dite, e gjen rrugën në disa qarqe të dijes shqiptare. “Dituria Islame” është revistë e rëndësishme në disa plane, është e tillë për faktin se e trajton tërësinë e jetës sonë shpirtërore e diturore, artistike e mendimore, është e tillë për faktin se trajton tema me interes të veçantë fetar dhe të përgjithshëm shoqëror, është e tillë për faktin se foli në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur. Ishte dhe uroj të mbetet një thesar i mendimit islam, artistik, kulturor e shkencor ndër shqiptarët. Një shenjë e jona e çmuar në rrugëtimin historik, kulturor e letrar, një dëshmi e trashëgimisë, një dritare e rëndësishme e së sotmes dhe, të shpresojmë, edhe një udhërrëfyese e rrugëtimit të mëtejshëm të shqiptarëve.

Katër dekada në shërbim të dritës dhe dijes

Elez Osmani

Për ta shkruar një shkrim dinjitoz për jubileun e revistës “Dituria Islame”, natyrisht se duhet të kemi në ndërgjegje respektin për historinë e saj, vlerësimin për kontributin intelektual dhe përpjekjet e pareshtura ndër vite për daljen e saj.

Kjo revistë po ecën drejt dhjetëvjetëshit të pestë të daljes dhe botimit të saj, që do të thotë drejt një gjysmë shekulli, duke kaluar nëpër baticë e zbatice, nëpër valët e turbullta e më pak të pastra e të kthjellëta të vërshimeve rrëmbyese nëpër të cilat ka kaluar populli ynë ndër vite, nga regjimi i kaluar e, në veçanti, segmenti fetar, para ardhjes së demokracisë dhe bërjes së Kosovës shtet. “Ajo, përgjatë rrugëtimit të saj mbi katër dekadash, barti me vete gjendjen e rrethanave dhe përthyerjet sociale, historike, fetare, arsimore e ideologjike të shqiptarëve. Ajo ishte dhe mbeti revista më e madhe dhe më e përhapur islame brenda audiencës shqiptare, me reputacion dhe ndikimin më të madh edhe sot. Revista “Dituria Islame” zë një pozitë të spikatur brenda shtypit islam, përkundër botimit të revistave të tjera brenda hapësirës shqiptare”, theksonte Myftiu i Kosovës me rastin e botimit të numrit të 400-të.


Kjo revistë ka një peshë të madhe specifike në fushën e mendimit islam dhe kulturës shqiptare, sepse për katër dekada, deri tash, në faqet e saj janë publikuar çështjet fetare, por edhe ngjarjet më të rëndësishme që u zhvilluan në Kosovë, e sidomos gjatë viteve të nëntëdhjeta. Kjo revistë është më shumë se thjesht një botim periodik. Kjo ka bërë një

histori të veten interesante. Është evidente se prej vitit 1986, kur doli numri i parë, e deri më 1990, mezi u botuan disa numra – 15 numra. Gjatë atyre viteve revista ka punuar në rrethana shumë të vështira, objektive dhe subjektive. Daljen e saj e mbanin vetëm entuziazmi dhe vullneti, apo siç thotë populli: ecte ngadalë, ngreh e mos këput.

Por në vitin 1990, me ardhjen e frymës së re në BIK dhe kur në krye të revistës erdhi mr. Qemajl Morina si kryeredaktor, ishte një mbarësi dhe një përpjekje për një ngritje cilësore dhe profesionale të saj. Ai, pa u hamendur, me përgjegjësi dhe kompetencë profesionale filloi punën. Formuam redaksinë dhe kështu, së bashku me anëtarët e tjerë të redaksisë, revistës i dha formë dhe përmbajtje të duhur. Në atë kohë, me insistimin këmbëngulës të anëtarit të Kryesisë, prof. Naim Tërnavë, iu pata bashkangjitur edhe unë si gazetar-redaktor i rregullt në redaksi, d.m.th., isha i vetmi punëtor i rregullt i punësuar në “Diturinë Islame”.

Qëllimi dhe synimi i kryeredaktorit dhe i redaksisë ishte që revista të standardizohej. Me angazhimin e redaksisë, revista u ringjall dhe u tejkalua me sukses boshllëku i viteve të mëparshme. Redaksia u angazhua në nxjerrjen e numrave tematikë. Ky orientim dhe kjo iniciativë, kjo frymë e re, u tregua e suksesshme. Që nga ai numër, “Dituria Islame” nuk u mjaftua me trajtimin sipërfaqësor të temave apo me përkthime. Ajo mori përsipër një mision fisnik dhe kompleks, të cilin e pasqyron më së miri edhe vetë nëntitulli

Revista “Dituria Islame” zë një pozitë të spikatur brenda shtypit islam, përkundër botimit të revistave të tjera brenda hapësirës shqiptare”, theksonte Myftiu i Kosovës me rastin e botimit të numrit të 400-të.



i saj: “Fetare, Shkencore dhe Kulturore”, një triadë e fuqishme vlerash.

Fetare: sepse revista ka ruajtur me xheloz pastërtinë e mesazhit islam, duke promovuar paqen, tolerancën dhe argumentin e bazuar në Kuran dhe Sunet, larg ekstremizmave.

Shkencore: sepse përmes penave të profesorëve, hulumtuesve dhe dijetarëve më në zë, “Dituria Islame” ka sjellë studime të mirëfillta akademike, duke sfiduar kohën dhe duke pasuruar bibliotekën shqiptare me tema të rëndësishme sociale, filozofike, juridike e fetare, që lexuesve të atëhershëm u kishin munguar.

Kulturore: ajo ka dëshmuar se feja dhe kultura kombëtare nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, por bashkëjetojnë në harmoni, duke lartësuar figurat e ndritura të historisë sonë dhe trashëgiminë tonë kulturore.

Kështu, formimi fetar dhe ai intelektual dhe kombëtar kanë ecur në linja paralele dhe ishte synimi ynë redaksional. “Dituria Islame” ishte zë i fuqishëm dhe i patrembur në mbrojtje të përcaktimit tonë kombëtar për liri, andaj ka krijuar një gjeneratë që i ka sintetizuar në një unitet atdhedashurinë dhe përkushtimin ndaj fesë si dy komponentë që s’bëjnë dot pa njëri-tjetrin”, vlerëson dr. Hysen Matoshi.

Ne kishim editorialin, rubrikat fetare, portretin, intervistën dhe informimin. “Dituria Islame” krijoi fizionominë e saj dhe u bë interesante për publikun në vend dhe më gjerë. Ajo shtoi tirazhin e botimit dhe depërtoi te lexuesi në gjithë hapësirën shqiptare.

Një ditë, më 1998, redaksinë e vizitoi një delegacion zyrtar amerikan, i prirë nga Daglas Dejvison dhe drejtori i Qendrës

Informative të ShBA-së në Prishtinë, Richard Hakebi. Duke biseduar me ta, i informova për vështirësitë e revistës dhe dhunën serbe mbi ne. Vetëm pak muaj më parë, policia serbe në Gjakovë na kishte ndaluar mua dhe Ejup Krasniqin gjatë ekspozimit të saj nëpër këshillat e BI-së. Ai na dha fjalë inkurajuese, duke shtuar se çdo numër të revistës e marrin. Ndërkaq, përkthyesja e tyre, profesoresha e nderuar dr. Zhulieta Mushkolaj, shtoi se jo vetëm që e marrin, por edhe e përkthejnë, dhe Zyra Amerikane në Kosovë është në rrjedhë të zhvillimit të ngjarjeve.

Revista dita-ditës tërhiqte bashkëpunëtorë të shumtë, por edhe fryma në redaksi ishte shumë pozitive. Nuk ngurronim të konsultoheshim me ata që kishin dije dhe përvojë. Fjala vjen, përveç redaksisë, disa artikuj i dërgonim për redakturë dhe shikim të përmbajtjes akaidologjike të këtij lëmi haxhi Sherif Ahmetit. Ky, pa ngurrim, i shikonte, i përpunonte dhe i vlerësonte. Më kujtohet kur na pati thënë: “Më marrin kohë, por më gëzon fakti se ‘Dituria’ ka bashkëpunëtorë të shumtë.”

Në faqet e saj u botuan punimet dhe studimet e fetarëve, shkrimtarëve, poetëve, prozatorëve etj., përmes të cilëve lexuesit i jepej rasti të njiheshin sa më mirë dhe sa më për së afërmi me natyrën dhe “shpirtin” e revistës.

Ne kishim përcaktimin tonë programor, me ç’rast ushtronim ndikim të dukshëm pozitiv në rrjedhat e zhvillimit të kohës dhe në formimin e drejtë fetar e kulturor. Roli i saj në ngritjen dhe rritjen e penave të reja ishte një dimension tjetër që dha rezultate.

Festimi i jubileut të revistës “Dituria Islame” nuk është thjesht shënimi i një nisme botuese; është kremtimi i një rrugëtimi të gjatë e të palodhshëm të mendimit të shëndoshë intelektual, shpirtëror dhe kulturor në hapësirën gjithë-shqiptare. Për vite me radhë, kjo revistë ka qenë dhe mbetet një dritare e hapur drejt së vërtetës, një urë lidhëse mes tradicionales dhe modernes dhe një udhërrëfyes për breza të tërë lexuesish.

Ky jubile, për mua, është rasti ideal për të shprehur mirënjohjen më të thellë për të gjithë kryeredaktorët, anëtarët e redaksisë, punëtorët teknikë dhe, mbi të gjitha, për autorët që derdhën mundin e mendjes së tyre në faqet e kësaj reviste. Pa sakrificën dhe vizionin e tyre, ky stacion jubilar nuk do të ishte kaq i lavdishëm si një udhërrëfyes për breza të tërë lexuesish.

Sot, në epokën e digjitalizimit dhe të informacionit të shpejtë, “Dituria Islame” vazhdon të mbetet një autoritet i besueshëm dhe një shtëpi e ngrohtë për çdo kureshtar të dijes.

I urojmë revistës “Dituria Islame” edhe shumë vite të tjera të suksesshme, duke mbetur gjithmonë ajo që ka qenë: një pishtar që ndriçon mendjet dhe ngroh zemrat e besimtarëve dhe intelektualëve shqiptarë!

“Dituria Islame” – frymëzim për imamët dhe dritë për xhematin

(KATËR DEKADA DRITË E DITURI)

Isa Tërshani

Revista “Dituria Islame” për katër dekada me radhë ka qenë zë i dijes, edukimit dhe vetëdijes fetare dhe kombëtare. Me përmbajtjen e saj të pasur, ajo ka frymëzuar imamët në misionin e tyre dhe ka shërbyer si dritë udhëzuese për xhematin, duke kultivuar vlera, kulturë dhe dituri islame në shoqërinë tonë.

Që nga botimi i saj i parë, kjo revistë u bë një dritare e hapur e dijes për imamët, studentët, intelektualët dhe xhematin në përgjithësi. Nëpërmjet artikujve shkencorë, temave edukative dhe trajtimit të çështjeve fetare dhe shoqërore, revista kontribuoi në ngritjen profesionale të imamëve dhe në forcimin e vetëdijes islame te besimtarët. Ajo ishte jo vetëm një burim informacioni, por edhe një shkollë mendimi dhe orientimi në kohë sfidash dhe ndryshimesh të mëdha shoqërore.

Për shumë imamë, “Dituria Islame” ishte një ndihmëtare e afërt në përgatitjen e hytbeve, ligjëratave dhe aktiviteteve edukative. Temat dhe trajtimet e saj ofronin ide, argumente dhe këshilla të vlefshme, duke ndihmuar që mesazhi islam të përcillej me urtësi, qartësi dhe afërsi ndaj nevojave të xhematit. Ndërsa për lexuesit dhe besimtarët e zakonshëm, revista ishte një burim frymëzimi shpirtëror dhe edukimi moral. Katër dekada dritë e dituri janë dekada

sakrifice, pune dhe përkushtimi në shërbim të fesë dhe besimtarëve.

Prandaj, kur flasim për historinë e edukimit islam në gjuhën shqipe, nuk mund të mos përmendet roli dhe kontributi i madh i revistës “Dituria Islame”. Ajo mbetet një ndër dëshmitë më të rëndësishme të përkushtimit ndaj dijes, fesë dhe shërbimit ndaj myslimanëve të këtij vendi e më gjerë.

DISA VLERA DHE PËRFITIME QË REVISTA “DITURIA ISLAME” UA KA OFRUAR IMAMËVE

Revista “Dituria Islame”, ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin intelektual dhe profesional të imamëve, duke u bërë për shumë prej tyre një burim i vazhdueshëm dijes, orientimi dhe frymëzimi në misionin e tyre fetar. Përmes artikujve shkencorë, trajtimeve dhe analizave të ndryshme fetare, revista ka ndihmuar imamët të ndërtojnë një vizion më të qartë dhe më të qëndrueshëm në misionin e tyre.

Një nga ndihmesat më të mëdha të revistës ka qenë ofrimi i njohurive të thella mbi Kuranin, hadithin, fikhun, akaidin, ahlakun dhe disiplinat e tjera islame. Këto materiale i kanë ndihmuar imamët të pasurojnë dijen e tyre dhe të jenë më të përgatitur në ligjërata, hytbe dhe aktivitete edukative me xhematin. Duke qenë se imami është prijës shpirtëror

“Dituria Islame” ishte jo vetëm një burim informacioni, por edhe një shkollë mendimi dhe orientimi në kohë sfidash dhe ndryshimesh të mëdha shoqërore.

dhe edukator i xhematit, revista ka shërbyer si një mbështetje e rëndësishme në ngritjen profesionale të tij.

Gjithashtu, “Dituria Islame” ka ndihmuar imamët në zhvillimin e një vizioni të urtë dhe të balancuar në thirrjen islame. Përmes trajtimit të temave bashkëkohore dhe sfidave me të cilat përballet shoqëria, revista ka orientuar imamët që mesazhin islam ta përcjellin me maturi, mençuri dhe gjuhë të kuptueshme. Ajo ka nxitur qasje të urta në komunikim, larg ekstremizmave dhe qëndrimeve të ashpra, duke e vendosur në qendër mëshirën, tolerancën dhe edukimin.

Një kontribut i veçantë i revistës ka qenë trajtimi i metodologjisë së dëvetit-thirrjes dhe komunikimit me besimtarët. Imamët kanë gjetur në faqet e saj udhëzime se si të afrohen më shumë me njerëzit, si t’i kuptojnë nevojat shpirtërore të xhematit dhe si t’i trajtojnë problemet shoqërore me urtësi islame. Kjo ka ndihmuar që shumë imamë të krijojnë lidhje më të forta dhe më të afërta me xhematin e tyre.

Revista ka shërbyer gjithashtu si platformë për shkëmbimin e përvojave dhe mendimeve ndërmjet imamëve dhe studiuesve islamë. Përmes publikimit të artikujve dhe analizave nga autorë të ndryshëm, ajo ka krijuar një hapësirë të vlefshme për reflektim, diskutim dhe zhvillim të mendimit islam në gjuhën shqipe. Kjo ka ndikuar në zgjerimin e horizonteve intelektuale të imamëve dhe në forcimin e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj misionit të tyre.

Në kohë sfidash morale, kulturore dhe ideologjike, revista “Dituria Islame” ka qenë një udhërrëfyes i rëndësishëm për imamët. Ajo i ka ndihmuar ata të kuptojnë më mirë realitetin bashkëkohor dhe të ofrojnë përgjigje të argumentuara për çështjet që i shqetësojnë besimtarët. Në këtë mënyrë, imamët janë bërë më të përgatitur dhe më të fuqizuar për ta udhëhequr xhematin në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit fetar e moral, sidomos në kohë sfidash dhe ndryshimesh të shumta shoqërore.

Prandaj, lirisht mund të thuhet se revista “Dituria Islame” nuk ka qenë vetëm një botim informues i një reviste fetare, por edhe një shkollë mendimi dhe orientimi për imamët. Ajo ka kontribuar në formimin e tyre shpirtëror, intelektual dhe profesional, duke u bërë një dritë udhëzuese në rrugën e dëvetit dhe shërbimit ndaj xhematit.

PASURI E DIJEVE FETARE DHE NË PËRGATITJEN E HYTBEVE DHE LIGJËRATAVE

Revista “Dituria Islame” ka qenë një ndihmë e çmuar për imamët në pasurimin e dijeve fetare dhe përgatitjen e hytbeve dhe ligjëratave. Përmes trajtimit të temave fetare, morale dhe shoqërore, ajo i ka ndihmuar imamët të jenë më pranë nevojave të xhematit dhe ta përcjellin mesazhin islam me urtësi dhe butësi.



Për mua personalisht, si imam, kjo revistë ka qenë një burim i vazhdueshëm frymëzimi dhe udhërrëfimi në shërbimin fetar. Nga artikujt e saj kam përfituar tema, këshilla dhe materiale të dobishme për hytbe dhe ligjërata, të lidhura ngushtë me jetën dhe sfidat e besimtarëve. Shpesh ndodhte që nga një numër i vetëm i revistës të përzgjedhja tema dhe materiale të mjaftueshme për disa javë hytbe dhe ligjërata. Artikujt e saj trajtonin tema të ndryshme fetare, morale, edukative dhe shoqërore, të cilat ishin shumë të afërta me nevojat e xhematit. Aty gjeja këshilla të vyera, argumente bindëse, citate domethënëse dhe analiza të thelluara, të cilat më ndihmonin të përgatitesha më mirë dhe ta përcillja mesazhin islam me më shumë qartësi dhe urtësi te besimtarët.

Revista më ndihmonte jo vetëm në zgjedhjen e temave, por edhe në mënyrën e trajtimit të tyre. Përmes shkrimeve të dijetarëve dhe autorëve të ndryshëm, mësoja metoda më të urta dhe më të afërta komunikimi me xhematin. Kjo ndikonte që hytbet dhe ligjëratat të ishin më të pasura në përmbajtje, më të lidhura me realitetin dhe më të dobishme për dëguesit. Në shumë raste, temat që lexoja në këtë revistë bëheshin shkak për reflektim më të thellë edhe tek unë personalisht. Ato më motivonin për hulumtim të mëtejshëm, dhe për përkushtim më të madh në misionin e imamllëkut. Mund të them me bindje se revista ka ndikuar dukshëm në formimin tim intelektual dhe në pasurimin e përvojës sime mbi tri dekada në dëvet.

UDHËZIM NË METODOLOGJINË E DAVETIT

Revista ka ndihmuar imamët në zhvillimin e mënyrave më të urta dhe më efektive në thirrjen islame. Përmes trajtimit të metodave të komunikimit, edukimit dhe afrimit me njerëzit,

ajo i ka orientuar imamët drejt një qasjeje të matur, të butë dhe të balancuar në komunikim dhe thirrje. Një nga detyrat dhe rolet më të rëndësishme të imamëve ka qenë edukimi i besimtarëve. Ata kanë shërbyer si mësues të brezave, duke përcjellë dije fetare dhe morale te fëmijët, të rinjtë dhe te të moshuarit. Po ashtu, imamët kanë luajtur rol të rëndësishëm si këshillues në familje dhe në shoqëri. Ata kanë ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve, forcimin e marrëdhënieve familjare dhe ruajtjen e harmonisë në bashkësi.

FORCIM DHE RUAJTJE E IDENTITETIT FETAR DHE KOMBËTAR

Përmes shkrimeve edukative dhe reflektuese, revista ka ndikuar në rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë tek imamët ndaj misionit të tyre. Ajo ua ka rikujtuar vazhdimisht rëndësinë e sineritetit, moralit dhe përkushtimit në shërbim të fesë dhe kombit. Në periudha të ndryshme historike, “Dituria Islame” ka qenë një ndër faktorët në ruajtjen e identitetit tonë fetar dhe kombëtar. Përmes trajtimit të temave historike, kulturore dhe fetare, ajo ka ndihmuar në ruajtjen e traditës dhe trashëgimisë sonë shpirtërore.

Revista ka promovuar vazhdimisht frymën e mesatares, tolerancës dhe unitetit islam. Ajo i ka orientuar imamët drejt ruajtjes së harmonisë në xhemat dhe largimit nga përçarjet, ekstremizmat dhe interpretimet e gabuara të fesë.

Andaj edhe imamët kanë qenë mbrojtës të traditës, gjuhës dhe kulturës sonë, duke e edukuar popullin me vlerat islame dhe kombëtare. Nëpërmjet hytbeve, ligjëratave dhe mësimeve, ata kanë ndikuar që brezat të mos largohen nga rrënjët e tyre të identitetit shpirtëror dhe nacional.

PËRGATITJE PËR SFIDAT E KOHËS

“Dituria Islame” ka trajtuar tema që lidhen edhe me sfidat moderne, si ndikimi i teknologjisë, problemet sociale, edukimi i rinisë dhe ruajtja e identitetit islam. Kjo i ka ndihmuar imamët të kuptojnë më mirë realitetin bashkëkohor dhe të japin përgjigje adekuate për pyetjet e kohës. Ata i kanë ndihmuar besimtarët të ruajnë vlerat në një botë me shumë ndikime dhe devijime. Imamët kanë qenë zë i drejtësisë, moralit dhe përgjegjësisë qytetare. Në kohë krizash apo vështirësish, kanë ofruar mbështetje morale dhe shpirtërore për njerëzit. Përmes angazhimit të tyre, shumë familje dhe individë kanë gjetur rrugën e qetësisë, harmonisë dhe shpresës.


RUAJTJE E UNITETIT DHE FRYMËS ISLAME

Revista ka promovuar vazhdimisht frymën e mesatares, tolerancës dhe unitetit islam. Ajo i ka orientuar imamët drejt ruajtjes së harmonisë në xhemat dhe largimit nga përçarjet, ekstremizmat dhe interpretimet e gabuara të fesë. Gjithashtu, i ka motivuar imamët që jetën e tyre ta vënë në shërbim të fesë dhe besimtarëve. Kanë sakrifikuar kohë, mund dhe përkushtim për edukimin dhe udhëzimin e gjeneratave të reja që t’i udhëzojnë drejt vlerave islame. Imamët kanë qenë pranë njerëzve në gëzime, pikëllime dhe vështirësi, dhe çdoherë duke iu ofruar mbështetje shpirtërore, këshilla dhe lutje.

Nga e gjithë kjo, lirisht mund të themi se, revista “Dituria Islame” ka qenë për imamët më shumë sesa një botim periodik, ajo ka qenë një shkollë dijes, një udhërrëfyes profesional dhe një burim frymëzimi në rrugën e thirrjes-davetit. Përmes kontributit të saj të vazhdueshëm, ajo i ka ndihmuar imamët të jenë më të përgatitur dhe më të afërt me nevojat e xhematit dhe të shoqërisë.

KONTRIBUT NË EDUKIMIN FETAR TË XHEMATIT

“Dituria Islame” ka dhënë një kontribut të rëndësishëm edhe në edukimin fetar të xhematit. Që nga fillimi i botimit, ajo ka shërbyer si një burim i hapur i dijes islame, duke



trajtuar tema mbi besimin, adhurimin, moralin dhe jetën e përditshme të myslimanit. Në kohën kur literatura islame në gjuhën shqipe ishte e paktë, revista luajti rol të veçantë në përhapjen e dijes dhe ngritjen e vetëdijes fetare.

Përmes shkrimeve të imamëve, dijetarëve dhe studiuesve të ndryshëm që lidhen me besimin në Allahun xh.sh., rëndësinë e namazit, agjërit, zekatit dhe haxhit, si dhe çështje të moralit islam, edukimit familjar dhe përgjegjësisë shoqërore, revista ka ofruar njohuri të qarta dhe të argumentuara, duke e ndihmuar xhematin ta kuptojë fenë më drejtë dhe më thellë.

Vlera e saj qëndronte edhe në gjuhën e thjeshtë dhe të kuptueshme, duke iu afruar jo vetëm studiuesve, por edhe besimtarëve të zakonshëm. Njëkohësisht, ajo ka ndihmuar në korrigjimin e keqkuptimeve dhe praktikave të gabuara, duke i orientuar besimtarët drejt mësimave autentike islame.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i edukimit fetar ka qenë trajtimi i sfidave bashkëkohore me të cilat përballet myslimani. Revista ka trajtuar tema që lidhen me edukimin e rinisë, ndikimin e teknologjisë, ruajtjen e moralit, raporteve familjare dhe sfidat kulturore të kohës moderne. Përmes këtyre shkrimeve, ajo ka ndihmuar besimtarët ta ruajnë identitetin dhe vlerat islame në një botë që ndryshon vazhdimisht.

Përveç aspektit individual, revista ka ndikuar edhe në forcimin e vetëdijes kolektive të xhematit. Shumë lexues, përmes shkrimeve të saj, janë motivuar të lexojnë dhe të mësojnë më shumë për fenë që të jenë më aktivë në jetën fetare dhe shoqërore.

Që nga viti 1993 e deri në ditët e sotme, revista *"Dituria Islame"* ka qenë vazhdimisht pjesë e angazhimit tim në shërbim të xhematit dhe përhapjes së dijes islame. Sa herë që dilte numri i ri i revistës, në ditën e xhuma, në përfundim të hytbes, e shfrytëzoja rastin që ta njoftoja xhematin për temat dhe përmbajtjen e saj. I prezantoja shkurtimisht artikujt, temat edukative, trajtimet fetare dhe çështjet aktuale që revista sillte për lexuesit. Ky njoftim gjithmonë zgjonte interesim të xhemati, sepse besimtarët e shihnin revistën si një burim të vlefshëm dijeshe dhe udhëzimi. Shumë prej tyre e prisnin me dëshirë daljen e numrit të ri, për të lexuar tema që lidhen me fenë, moralin, edukimin familjar, historinë islame dhe sfidat e jetës bashkëkohore. Falë këtij interesimi të vazhdueshëm, zakonisht shpërndaheshin dhe shiteshin nga 30 deri në 50 ekzemplarë të çdo numri, gjë që dëshmon

Vlera e saj qëndronte edhe në gjuhën e thjeshtë dhe të kuptueshme, duke iu afruar jo vetëm studiuesve, por edhe besimtarëve të zakonshëm.

qartë lidhjen dhe etjen e xhematit për dije islame.

Kjo përvojë më ka bindur edhe më shumë për rëndësinë dhe ndikimin që ka pasur revista *"Dituria Islame"* në edukimin fetar të besimtarëve. Ajo nuk ishte vetëm një revistë që lexohej rastësisht, por një mjet edukimi dhe vetëdijesimi që hynte në familjet e besimtarëve dhe bëhej pjesë e jetës së tyre shpirtërore. Përmes saj, shumë lexues fitonin njohuri të reja, forconin bindjet fetare dhe gjenin përgjigje për çështje të ndryshme të jetës së përditshme. Interesimi i vazhdueshëm i xhematit për këtë revistë tregon se fjala e shkruar ka pasur dhe vazhdon të ketë ndikim të madh në përhapjen e dijes dhe kulturës islame. Në një kohë kur burimet e shkruara në gjuhën shqipe nuk ishin të shumta, *"Dituria Islame"* ishte një dritare e çmuar e dijes, e cila i lidhi imamët me xhematin dhe dijen me jetën praktike të besimtarëve.

Megjithatë, në kohën e sotme vërehet se numri i lexuesve të revistës *"Dituria Islame"* ka rënë në krahasim me vitet e mëhershme. Një ndër arsyt kryesore të kësaj rënieje është zhvillimi i madh i mediave elektronike dhe shtimi i platformave online, ku informacioni dhe materialet fetare janë bërë më të çastshme dhe më të shpejta për lexuesin modern.

Shumë njerëz sot orientohen drejt leximit përmes telefonit, internetit dhe rrjeteve sociale, gjë që ka ndikuar dukshëm në uljen e interesimit për revistat e shtypura. Megjithatë, pavarësisht këtij ndryshimi të kohës dhe mënyrës së informimit, revista *"Dituria Islame"* vazhdon ta ruajë vlerën dhe rëndësinë e saj të veçantë. Ajo mbetet një burim serioz dhe i besueshëm i dijes islame, me përmbajtje të përgatitura me kujdes dhe përgjegjësi fetare dhe shkencore. Për shumë lexues, sidomos për imamët, studiuesit dhe dashamirët e librit, ajo vazhdon të jetë një referencë e rëndësishme edukimi dhe frymëzimi shpirtëror.

PËRFUNDIMI

Lirisht mund të themi se revista *"Dituria Islame"* ka qenë dhe mbetet një burim i rëndësishëm edukimi dhe frymëzimi shpirtëror për imamin dhe xhematin, duke kontribuar në forcimin e dijes fetare dhe ruajtjen e vlerave islame në shoqërinë tonë.

Lusim Allahun e Madhëruar t'i bekojë të gjithë ata që shërbejnë në rrugën e fesë dhe ta mbajë xhematin tonë të lidhur gjithmonë me dijen, moralin dhe vlerat e Islamit.

“Dituria Islame” te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut

Prof. dr. Ziber Lata

N umri *dyzet* në mësimet islame dhe në historinë e myslimanëve çdoherë ka qenë sinonim i pjekurisë dhe i urtësisë. Shumë ngjarje përgjatë historisë islame janë të lidhura me këtë numër, mjafton të sjellim ndërmend se Muhamedi a.s. në këtë moshë u përzgjedh për pejgamber.

Një jetëgjatësi të këtillë ka pasur fatin ta ketë edhe revista “*Dituria Islame*”, e cila në këtë vit mbush plot *dyzet* vjet nga themelimi i saj. Deri sot kjo revistë ka qenë një dritare serioze për lexuesin mysliman shqiptar, por nga ky vit, krahas seriozitetit, merr karakterin e një burimi kredibil dhe të një leksikoni të historisë myslimane shqiptare për *dyzet* vitet e kaluara, sepse ajo ngërthen në vetvete historinë, sfidat, sukseset dhe gjithçka që lidhet me popullin mysliman shqiptar përafërsisht për një gjysmë shekulli.

Revista “*Dituria Islame*” sot mund të zë edhe vendin e urtarit të teologjisë shqiptare, sepse rrugën që teologët dhe hoxhallarët e rinj duhet ta kalojnë për të mbërritur te pjekuria, kjo revistë e sjell ajkën e kësaj eksperience të shoshitur mirë dhe të kulluar nëpër sitat e botës komplekse myslimane të dyzetyjeçarit të kaluar.

Ajo nuk është thjesht një revistë që lexuesve shqiptarë u plasojnë vetëm informacione apo mësimet fetare, por lirisht mund të trajtohet edhe një manual i rëndësishëm i historisë dyzetyjeçare të shqiptarëve myslimanë. Aty janë pasqyruar të gjitha lëvizjet shoqërore dhe kombëtare, madje edhe kur periodikët e tjerë kishin aktivitet të kufizuar, të censuruar dhe nguronin të paraqisnin momente kritike, madje edhe politike, revista “*Dituria Islame*” çdoherë ka qenë dritarja që asnjëherë nuk ka nguruar dhe as nuk e ka mbyllur dritaren e

informacionit për mbarë popullin e vuajtur shqiptar, pavarësisht kërcënimeve dhe rreziqeve që bartnin këto aktivitete.

“*Dituria Islame*” nuk ka qenë revistë që u shërbente vetëm myslimanëve të Kosovës, por ajo, në formë shumë profesionale, duke i ndjekur hap pas hapi dhe me shumë dashamirësi, ka pasqyruar edhe barrierat e shqiptarëve të Shqipërisë, veçanërisht sfidat e viteve të nëntëdhjeta pas rënies së komunizmit dhe daljes së tyre në pluralizëm. Gjatë kësaj periudhe është monitoruar ringjallja e aktivitetit fetar islam, rihapja e xhamive, rimëkëmbja e hoxhallarëve të mbetur gjallë, shtuar kësaj ndihmën që myslimanëve shqiptarë u vinte nga mbarë bota islame, veçanërisht nga shqiptarët myslimanë të Kosovës, të Maqedonisë së Veriut dhe të viseve të tjera të banuara me shqiptarë.

Gjithashtu, revista “*Dituria Islame*” ka qenë një zë i fuqishëm edhe për myslimanët e Maqedonisë, veçanërisht në kohët kur ata ballafaqoheshin me krizën e vitit 2001 dhe me çdo sfidë tjetër që përjetuan përgjatë këtij dyzetyjeçari.

Në vitet e tetëdhjeta, kur literatura islame në gjuhën shqipe numërohej nëpër gishta, lexuesit myslimanë shqiptarë mezi pritnin numrat e revistës “*Dituria Islame*” për të shuar sadopak etjen për dijet fetare që u kishin shkaktuar ideologjitë politike shekullare-ateiste. Ishte pikërisht periudha kur në skenë dolën përkthimet e para të Kuranit fisnik në gjuhën shqipe, ku me shumë kërshtëri shfletoheshin faqet e kësaj reviste për të lexuar një ajet kuranor të thurur dhe të qëndisur me germa shqipe, për të lexuar një koment të Kuranit, për të mësuar ndonjë fjalë profetike

“*Dituria Islame*” ka qenë një zë i fuqishëm edhe për myslimanët e Maqedonisë, veçanërisht në kohët kur ata ballafaqoheshin me krizën e vitit 2001 dhe me çdo sfidë tjetër që përjetuan përgjatë këtij dyzetyjeçari.

të Muhamedit a.s. dhe për të mësuar fenë islame nga dijetarë eminentë të botës islame dhe të vendit.

“Dituria Islame”, bashkë me revistën “Hëna e Re”, ishin dy tutorë të zëshëm që qëndronin krah për krah myslimanëve shqiptarë, për t’i pajisur ata me dije të nevojshme fetare dhe kulturore, dhe për t’i informuar për gjithçka që ndodhte rreth tyre.

Lexuesit shqiptarë në Maqedoni me padurim pritnin numrat e këtyre revistave për t’u informuar edhe për botimet e tjera në gjuhën shqipe, të cilat dalëngadalë kishin filluar të shtoheshin në gjuhën shqipe. Ishte pikërisht ajo kohë kur, sa herë që shihnim një libër të botuar në gjuhën shqipe, na dukej sikur Islami në këto troje po fillonte sërish të frymonte si dikur më parë dhe sikur çështja shqiptare bashkë me atë islame po merrnin një hov të madh. Megjithatë, krejt këtë sihariq na e jepnin faqet e revistës “Dituria Islame”.


Nuk e di se si do ruhej trangu teologjik islam mes shqiptarëve pa këto dritare të rëndësishme të komunikimit. Pavarësisht se pjesa më e madhe e hoxhallarëve shqiptarë në Maqedoni ishin shkolluar dhe edukuar në Prishtinë, gjegjësisht në Medresenë “Alaudin”, atyre u duhej një linjë e vazhdueshme e komunikimit, e cila do t’i përditësonte me zhvillimet më të reja të botës myslimane shqiptare, dhe sigurisht do t’u jepte kuraje që të mos ndjeheshin të huaj dhe të vetmuar në hapat e radhës që i pritnin.

Revistat “Edukata Islame”, “Dituria Islame” dhe “Hëna e Re”, plotësuan dhe vazhdojnë të plotësojnë një vakum që assesi nuk e plotëson literatura e përkthyer nga gjuhë të tjera.

Këto revista ishin vazhdimësi të revistave islame shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX, siç ishin “Zani i Naltë”, “Kultura Islame” dhe të tjera. Megjithëse ato nuk kanë pasur lidhje organike me njëra-tjetrën, ato kanë ndjekur të njëjtën politikë botuese: revista të institucioneve zyrtare të myslimanëve shqiptarë në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni. Njësoj siç Medreseja e Naltë e Tiranës i frymëzoi shqiptarët e Kosovës të hapin Medresenë “Alaudin”, dhe ajo “Alaudin i frymëzoi shqiptarët e Maqedonisë të hapin Medresenë “Isa Beu” në Shkup, po ashtu, edhe revista “Zani i Naltë” dhe “Kultura Islame” i frymëzoi shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë që në mungesë të tyre të themelonin revistat e tyre “Edukata Islame”, “Dituria Islame” dhe “Hëna e Re”.

Sa i përket dijes fetare, revista “Ditura Islame”, bashkë me simotrat e veta, ka ushqyer lexuesin shqiptar me dije burimore të saktë. Çdo tematikë që botohej dhe botohet në “Diturinë Islame” buron nga gurra autoktone islame, e cila mbështetet në Kuranin fisnik, në traditën profetike të Muhamedit a.s., të shokëve të tij dhe të dijetarëve eminentë myslimanë përgjatë historisë.

Në faqet e këtij periodiku kemi pasur fatin të lexojmë edhe shkrimet dhe opinionet e dijetarëve më të zëshëm të botës islame, dhe atë të dijetarëve bashkëkohorë dhe të atyre klasikë, të cilët janë përkthyer kryesisht nga gjuha arabe prej përkthyesve shqiptarë profesionistë. Pra, kjo tregon se revista



“Dituria Islame” ka dhënë dhe jep një kontribut të çmuar edhe në fushën e traduktologjisë (përkthimologjisë).

Gjithashtu, tematikat juridike dhe besimore të trajtuara në këtë revistë kanë mbajtur vijën tradicionale të myslimanëve shqiptarë, gjegjësisht të shkollës juridike hanefite dhe të drejtimit akaidologjik maturidit, sepse ato kanë qenë edhe drejtimit zyrtar të institucioneve fetare në trevat shqiptare për më shumë se pesë shekuj.

Këtë revistë e themeloi Bashkësia Islame e Kosovës, prandaj kryeredaktorë ishin intelektualët, dijetarët dhe patriotët e pajisur me dije të bollshme fetare dhe të kalitur mirë në institucionin e vetëm fetar-islam. Prandaj edhe përgjegjësia më e madhe juridike dhe morale për publikimin në revistë fillimisht bie mbi kryeredaktorin, pastaj mbi anëtarët e redaksisë dhe mbi vetë autorët. Sa më shumë që kishte trazira politike, aq më e madhe ishte edhe përgjegjësia, veçanërisht në vitet e para të revistës ku Jugosllavia ishte një regjim në rënie e sipër dhe tepër i brishtë.

Po ashtu, në vitet kur në viset shqiptare filluan të shfaqeshin mendime të ndryshme për çështjet fetare, revista “Dituria Islame” ishte një gardian i fuqishëm i drejtimit vital tradicional, madje edhe sot vazhdon të jetë një promotor i fuqishëm i orientimit tradicional që ndjek Bashkësia Islame e Kosovës dhe më gjerë. Pra, “Dituria Islame” çdoherë ka qenë një zgjedhje e duhur dhe zgjidhje konstruktive në botën e pakontrolluar dhe shpeshherë konfuze të mendimeve të ndryshme që hidhen në arenën e lexuesve shqiptarë.

Sot revistën “Dituria Islame” e gjen te çdo familje myslimane shqiptare e Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Malit të Zi dhe gjetkë, madje shumë familje i ruajnë numrat e saj me shumë nostalgji dhe fanatizëm, duke iu kthyer atyre si referenca të fundit dhe të pakontestueshme. Kjo dhe revistat simotra kanë qenë kible e dijeve fetare për myslimanët shqiptarë anembanë trojeve të tyre.

Roli i revistës “Dituria Islame” në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar në Luginën e Preshevës

Sulejman Fejzullahu

HYRJE

Revista “Dituria Islame”, organi informativ Qendror i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, mbush katërdhjetë vjet jetëgjatësi në vitin 2026. Ky reflektim nuk synon të bëjë një histori të jashtme të revistës, e cila tashmë është trajtuar në konferenca shkencore dhe botime të Bashkësisë Islame. Synimi ynë është që të reflektojmë mbi rolin që ka pasur kjo revistë në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar të shqiptarët myslimanë të Luginës së Preshevës, përkatësisht në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes.

Që në fillim, duhet bërë një vërejtje e ndershme. Literatura shkencore me ndikimin konkret të revistës “Dituria Islame” në këtë trevë është tejet e paktë. Studimi i organizuar i jetës fetare në Luginë ka qenë në vetvete i kufizuar, ashtu si për pjesën më të madhe të

çështjeve që e prekin këtë trevë. Prandaj në vijim do të mbështetemi në burime të tërthorta: në artikuj të vetë revistës që trajtojnë Luginën, në historinë institucionale të Këshillave të Bashkësisë Islame atje, dhe në botimet e Bashkësisë Islame të Kosovës që janë realizuar për ose në bashkëpunim me besimtarët e këtij rajoni.

KONTEKSTI I SHKURTËR I REVISTËS

Revista “Dituria Islame” doli për herë të parë në qershor të vitit 1986, në kushtet e një Jugosllavie ku Islami publik dhe gjuha shqipe ishin njëkohësisht në shënjestër. Themelimi i një reviste fetare në gjuhën shqipe nuk ishte një akt që kapërcente vetëm dimensionin fetar, por ishte gjithashtu akt i mbrojtjes së

Lugina e Preshevës ka qenë historikisht pjesë e indit shqiptar. Vetë Presheva ka qenë kaza e Vilajetit të Kosovës deri më 1912.



identitetit kombëtar. Sulejman ef. Rexhepi do ta përmbledhë më vonë rolin e revistës me një fjali që e mban peshën e vet: “Revista përforcoi identitetin fetar dhe kombëtar të popullatës.” Ky binom, fe dhe komb, është çelësi për ta kuptuar pse kjo revistë do të kishte një vlerë të veçantë jo vetëm në Kosovë, por veçanërisht edhe në trojet shqiptare jashtë saj.

LUGINA E PRESHEVËS NË HESHTJEN E STUDIMEVE SHKENCORE

Lugina e Preshevës ka qenë historikisht pjesë e indit shqiptar. Vetë Presheva ka qenë kaza e Vilajetit të Kosovës deri më 1912. Pas luftërave ballkanike dhe sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kjo trevë mbeti administrativisht nën Serbi, e ndarë nga Kosova me një kufi që, edhe pse formalisht administrativ, në praktikë veprroi si kufi etno-kulturor. Shqiptarët myslimanë të Luginës u gjendën në një gjendje të vështirë, pa institucione të mirëfillta arsimore në gjuhën shqipe, pa botime fetare në gjuhën amtare, pa një infrastrukturë akademike që do të dokumentonte jetën e tyre fetare.

Kjo situatë ka pasur edhe një pasojë akademike që na prek edhe sot kur shkruajmë për këtë temë. Mungesa e burimeve të shkruara mbi historinë fetare të Luginës nuk është rastësi. Është rezultat i drejtpërdrejtë i kushteve politike dhe institucionale në të cilat ka jetuar kjo trevë. Vetë artikulli shumë i dobishëm “Nga historia e fesë islame në Preshevë”, i botuar në zeriislam.com, vëren se për shumë xhami dhe institucione fetare të

Organi që boton “Diturinë Islame”, përkatësisht Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, është edhe organi që administrativisht mbulon pjesën më të madhe të jetës fetare të Luginës. Prandaj, revista nuk ka qenë një botim “i jashtëm” për Luginën, por zëri i vetë bashkësisë së tyre islame.

Luginës “nuk kemi të dhëna që e vërtetojnë ndërtimin e atëhershëm të tyre”. Kur historianët nuk mund të dokumentojnë as datat e ndërtimit të xhamive, mund të paramendohet se sa e vështirë është të dokumentohet diçka aq abstrakte sa qarkullimi i një reviste.

Megjithatë, disa fakte dhe burime na lejojnë të rindërtojmë me një siguri të arsyeshme rolin që “Dituria Islame” ka luajtur në këtë rajon.

ROLI I REVISTËS “DITURIA ISLAME” NË LUGINË

Lidhja e parë dhe më e qartë është institucionale. Në Luginë veprojnë Këshilli i Bashkësisë Islame i Bujanocit dhe ai i Presheves, të cilët, edhe pse gjeografikisht ndodhen brenda kufijve të Serbisë, janë pjesë e Bashkësisë Islame të Kosovës “sipas një marrëveshjeje mbi marrëdhëniet e veçanta të kësaj myftinie me Prishtinën”. Pra, organi që boton “Diturinë Islame”, përkatësisht Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, është edhe organi që administrativisht mbulon pjesën më të madhe të jetës fetare të Luginës. Prandaj, revista nuk ka qenë një botim “i jashtëm” për Luginën, por zëri i vetë bashkësisë së tyre islame.

Kjo lidhje institucionale shtrihet edhe tek arsimimi i kuadrove. Hoxhallarët, imamët dhe mualimët që shërbejnë në xhamitë e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, në të shumtën e rasteve janë formuar në Medresenë “Alauddin” të Prishtinës dhe në Fakultetin e Studimeve Islame të Prishtinës, ku studentët kanë ardhur tradicionalisht nga të gjitha trojet shqiptare, përfshirë Luginën. Këta të

diplomuar, kur janë kthyer në vendlindjet e tyre, përveç dijes së tyre, ata kanë sjellë me vete edhe revistën që lexohej e komentohej në mjediset e tyre studentore, pra në medrese e fakultet. Revista “Dituria Islame” ka qenë pjesë e pandashme e viteve të tyre studentore. Ata e kanë sjellë me vete në xhamitë e fshatrave të Bujanocit, Karadakut, e të Anamoravës. Revista kalonte nga dora në dorë mes familjarëve dhe të afërmeve të studentëve, duke u bërë pjesë e jetës fetare e kombëtare të atyre fshatrave.

Vlen të theksohet edhe një botim konkret që dëshmon angazhimin e drejtpërdrejtë të shtëpisë botuese “Dituria Islame” me hapësirën e Kosovës Lindore, e cila kulturalisht është pjesë e të njëjtës hapësirë me Luginën. Bëhet fjalë për



Një detyrë që do t'i takonte brezit të ri të redaktorëve dhe shkrimtarëve të “Diturisë Islame”, në katërdhjetëvjetorin e saj, do të ishte pikërisht kjo: të mbledhë në mënyrë sistematike dëshmitë e besimtarëve, hoxhallarëve dhe mualimëve të Luginës mbi mënyrën se si revista ka hyrë në jetën e tyre.



monografinë e Demir Behlulit, Arabeska origjinale në xhami të Kosovës Lindore (1984–1994), botuar nga “Dituria Islame” në Gjiilan më 1995. Ky është vetëm një shembull i mënyrës se si emri i revistës është shtrirë në një projekt më të madh të dokumentimit dhe ruajtjes së trashëgimisë islame në hapësirat ku flitet shqip dhe ku jeta fetare ka qenë nën presion.

Më drejtpërdrejt, vetë revista ka botuar materiale për Luginën. Në numrat 216–217, Sabri Bajgora dhe Ramadan Shkodra, i kushtuan një studim Këshillit të Bashkësisë Islame në Preshevë. Botime të tilla, sado të pakta në numër, kanë pasur një vlerë simbolike që e tejkalon përmbajtjen e tyre informuese, duke i thënë besimtarit të Luginës se ai nuk është i harruar, se zëri i tij dëgjohej edhe matanë kufirit administrativ, dhe se ai bën pjesë në një trup të vetëm me popullin e tij.

Pra, roli i revistës në Luginë mund të përmblihet në tri dimensione të ndërlidhura. Së pari, ajo ka qenë mjet i ruajtjes së gjuhës shqipe, e veçanërisht gjuhës fetare shqipe në një trevë ku shkollimi formal ka qenë shpesh në gjuhë tjetër dhe ku terminologjia fetare në shqip nuk kishte burim tjetër sistematik. Së dyti, ajo ka shërbyer si një urë midis besimtarëve

të Luginës së Preshevës dhe atyre të Kosovës. Së treti, dhe ndoshta më e rëndësishmja, leximi i një reviste fetare shqipe në një trevë nën presion asimilues ka qenë në vetvete një akt i dyfishtë: akt besimi dhe akt përkatësie kombëtare. Të dy këto akte, në kushtet e Luginës së Preshevës, nuk mund të ndaheshin.

PËRFUNDIMI

Reflektimi mbi rolin e revistës “Dituria Islame” në Luginën e Preshevës na lë me një ndjenjë të dyfishtë. Nga njëra anë, ajo që mund të dokumentohet, përkatësisht lidhjet institucionale, formimi i kuadrove, dhe botimet specifike, dëshmon se revista ka pasur një rol thelbësor dhe të padiskutueshëm në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Nga ana tjetër, mungesa e studimeve të mirëfillta shkencore mbi këtë temë na lë me ndjesinë se shumë histori, shumë dëshmi individuale, shumë rru-

gëtime të numrave të revistës nga dora në dorë, mbeten ende pa u shkruar.

Ndoshta një detyrë që do t'i takonte brezit të ri të redaktorëve dhe shkrimtarëve të “Diturisë Islame”, në katërdhjetëvjetorin e saj, do të ishte pikërisht kjo: të mbledhë në mënyrë sistematike dëshmitë e besimtarëve, hoxhallarëve dhe mualimëve të Luginës mbi mënyrën se si revista ka hyrë në jetën e tyre. Sepse derisa kjo histori nuk shkruhet, mungesa e burimeve do të vazhdojë të jetë jo një rastësi, por një heshtje që na bënë të varfër të gjithëve.

Reflektimi ynë mbyllet me bindjen se “Dituria Islame”, për Luginën e Preshevës, ka qenë diçka më shumë se një revistë. Ka qenë një lidhje. Dhe lidhje të tilla, në historinë e popullit tonë, kanë qenë gjithmonë të rralla dhe gjithmonë të çmuara.

Bibliografia

- Bajgora, Sabri, dhe R. Shkodra. “KBI në Preshevë.” Dituria Islame, nr. 216–217 (2008).
- “Bashkësia Islame e Kosovës” Wikipedia, qasur më 25 maj 2026. https://sq.wikipedia.org/wiki/Bashk%C3%ABsia_Islame_e_Kosov%C3%ABs.
- Behluli, Demir. Arabeska origjinale në xhami të Kosovës Lindore (1984–1994), Gjiilan: Dituria Islame, 1995.
- “Lugina e Preshevës” Wikipedia, qasur më 25 maj 2026. https://sq.wikipedia.org/wiki/Lugina_e_Preshev%C3%ABs.
- “Mbahet konferenca shkencore kushtuar revistës Dituria Islame”, Bashkësia Islame e Kosovës, 18 nëntor 2016, <https://bislame.net/dituria30vjet/>.
- “Nga historia e fesë islame në Preshevë – I”, Zëri Islam, qasur më 25 maj 2026. <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=2237>.
- “Nga historia e fesë islame në Preshevë – II”, Zëri Islam, qasur më 25 maj 2026. <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=2238>.

Revista “Dituria Islame” dhe rrugëtimi përndritës në mërgatë

Bashkim Aliu

Revista “Dituria Islame” shquhet për rolin e saj jo vetëm në trojet etnike shqiptare, por edhe në mërgatë, si pjesë e pandashme e trupit të kombit që u detyrua të marrë rrugën e kurbetit dhe të theksojë praninë e tij në qendrat më të mëdha të Perëndimit.

HYRJE

Rrugëtimi katër dekadësh i revistës “Dituria Islame” nuk do të ishte i plotë pa u përfshirë edhe ajo pjesë e mendimit islam dhe jo vetëm që kjo revistë e ka zhvilluar në Perëndim, përmes zërit, përvojës dhe veprimtarisë së mërgatës shqiptare myslimane. Revista “Dituria Islame” shquhet për rolin e saj jo vetëm në trojet etnike shqiptare, por edhe në mërgatë, si pjesë e pandashme e trupit të kombit që u detyrua të marrë rrugën e kurbetit dhe të theksojë praninë e tij në qendrat më të mëdha të Perëndimit. Kjo revistë, përmes fjalës së shkruar, ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit fetar, kombëtar dhe integrujes të shqiptarëve myslimanë në mërgatë. Emri i saj nuk është parë vetëm si titull i një reviste, por edhe si një urë lidhëse ndërmjet vendlindjes dhe mërgatës që ka jetuar dhe vepruar jashtë atdheut.

Duke qenë organ i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, ajo ka qenë dhe vazhdon të jetë një burim i pasur me shkrime mbi besimin, parimet e Islamit, moralin, historinë islame, edukimin, jetën familjare, hallallin dhe haramin, mendimin islam, çështjet juridike islame etj., duke kontribuar qartë dhe në mënyrë efektive që mërgata shqiptare myslimane të mbetet e lidhur me vlerat islame, tradicionale dhe kombëtare. Autorësia e këtyre shkrimeve, e përbërë nga studiues dhe njohës të shquar me kredibilitet ndërkombëtar, rajonal dhe vendor, i ka dhënë revistës një peshë të veçantë në diskursin intelektual shqiptar.

NË SHËRBIM TË GJUHËS SHQIPE

Diskursi i artikuluar në faqet e kësaj reviste shtrihet në dimensionet fetare, kulturore, edukative dhe kombëtare, ndikimi i të cilëve ka qenë i dukshëm jo vetëm në kultivimin e vetëdijes fetare, por edhe në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, kulturës dhe traditave kombëtare shqiptare ndër brezat e rinj të mërgatës shqiptare në vende të ndryshme të Evropës dhe më gjerë. Këta breza, të rritur në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore në Evropë dhe më gjerë, janë përballur dhe vazhdojnë të përballen me sfida të shumta, ndër të cilat më e theksuara mbetet ajo e asimilimit dhe e zbehjes së identitetit fetar dhe gjuhësor. Në dritën e këtij realiteti, është më se e qartë se “Dituria Islame” nuk ka vetëm funksion informues, por është shndërruar në një instrument të rëndësishëm të kultivimit të identitetit në rrethanat e jetesës në ambientet e ndryshme kulturore dhe sfiduese të mërgatës.

Revista “Dituria Islame” ka qenë shumë efektive dhe mjaft efektive në kultivimin e gjuhës shqipe në mërgatë, pasi korpusi i pasur i shkrimeve cilësore, që kanë trajtuar tema teologjike, historike, etike, shoqërore etj., si dhe gjuha standarde e përdorur në këto shkrime, kanë shërbyer si burim mësimi dhe edukimi për grupmosha të ndryshme të shqiptarëve myslimanë në mërgatë. Njëkohësisht, përmes leximit të shkrimeve të kësaj reviste, ata kanë ruajtur dhe kultivuar edhe gjuhën amtare shqipe. Qoftë në ambientin familjar, ashtu edhe në institucionet

edukative të qendrave islame shqiptare në mërgatë, brezat e rinj janë rritur me gjuhën shqipe përmes teksteve dhe përmbajtjeve të “Diturisë Islame”. Kjo ka ndikuar që ata të forcojnë lidhjen me gjuhën, kulturën dhe traditat e vendlindjes, duke e bërë gjuhën një urë të gjallë lidhëse ndërmjet brezave dhe hapësirave gjeografike.

“DITURIA ISLAME” DHE KOHEZIONI INTRA-KOMUNITAR

Fjala e shkruar shqipe në faqet e “Diturisë Islame” ka pasur një ndikim të dukshëm dhe ka vepruar fuqishëm edhe në drejtim të kohezionit intra-komunitar, si dhe në forcimin e unitetit dhe solidaritetit mes shqiptarëve në mërgatë, të cilët kanë ardhur nga treva të ndryshme. Pikërisht përmes shkrimeve që trajtojnë tolerancën fetare dhe bashkëjetesën ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare brenda etnisë shqiptare, “Dituria Islame” ka kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e vetëdijes kolektive dhe unitetit ndër shqiptarë, si parakusht për ecjen e përbashkët drejt realizimit të synimeve tona kombëtare në çdo periudhë historike.

E gjithë kjo është reflektuar qartë në themelimin e qendrave islame shqiptare të përbashkëta në mërgatë, pa dallime krahinore, rajonale apo lokale, si dhe më pas në aksionet e suksesshme dhe masive të grumbullimit të ndihmave për raste të ndryshme në vendlindje, veçanërisht në mbështetjen e luftërave të drejta të shqiptarëve. Në këtë kuadër, një element i rëndësishëm që e forcon rolin e “Diturisë Islame” në kohezionin intra-komunitar ka qenë edhe promovimi i unitetit dhe bashkëpunimit mes xhamive shqiptare dhe organizatave të tjera shqiptare në mërgatë, si dhe promovimi i aktiviteteve të mërgatës shqiptare.

BURIM I DIJES, EDUKIMIT DHE PROMOVIMIT TË TEOLOGJËVE ISLAMË SHQIPTARË

“Dituria Islame” ka qenë dhe mbetet një dritare e rëndësishme për teologët islamë në Perëndim, pasi përmes faqeve të saj, gjatë gjithë kësaj kohe, ata kanë pasur qasje në tema dhe autorë të shquar, të cilët janë emra të respektuar të mendimit bashkëkohor islam. Rubrikat e saj kanë qenë dhe mbeten një platformë e rëndësishme për artikullimin dhe zhvillimin e mendimit bashkëkohor islam ndër shqiptarët në përgjithësi, dhe veçanërisht ndër shqiptarët në mërgatë. Revista ka trajtuar tema aktuale nga fusha të ndryshme që i kanë prekur myslimanët në Perëndim, duke u shndërruar kështu në një referencë të besueshme për zhvillimin e mendimit bashkëkohor islam të teologëve shqiptarë.

Faqet e kësaj reviste kanë qenë të pasura me tema që kanë përfshirë debatet e zhvilluara në nivele të ndryshme akademike, si dialogu ndërfeetar dhe brenda-fetar, globalizmi, moderniteti dhe ndikimi i tij në jetën e myslimanëve në përgjithësi dhe në Perëndim në veçanti, marrëdhëniet e

Evropës me Islamin, e ardhmja e myslimanëve në Evropë, si dhe e ka evidentuar kontributin e myslimanëve në shkencë, kulturë dhe civilizim, duke e vendosur këtë trashëgimi në një kontekst të gjerë historik dhe bashkëkohor.

Në të njëjtën kohë, në raport me teologët islamë, por jo vetëm, “Dituria Islame” ka shërbyer si një medium i hapur për publikimin e pikëpamjeve, qëndrimeve dhe analizave të tyre për çështje fetare dhe të natyrave të tjera, duke kontribuar kështu në edukimin dhe vetëdijësimin e mërgatës. Përmes temave të publikuara, mërgata ka pasur mundësi të njihet me intelektualët islamë shqiptarë dhe kontributin e tyre në formësimin e mendimit bashkëkohor islam të shqiptarët.

Teologët islamë shqiptarë kanë ofruar për mërgatën analiza mbi çështje dhe problematika që lidhen me rininë, edukimin, familjen, tradicionalizmin dhe modernizmin, integrimin dhe asimilimin, pjesëmarrjen dhe izolimin, si dhe sfidat e shoqërisë moderne.

Me këtë rast, duhet theksuar se “Dituria Islame” ka qenë e hapur edhe për studiues, intelektualë dhe akademikë shqiptarë jashtë proveniencës teologjike, të cilët, përmes faqeve të saj, kanë kontribuar në edukimin, ngritjen, vetëdijësimin dhe avancimin e mërgatës shqiptare në fusha të ndryshme, me çka “Dituria Islame” është bërë një platformë gjithëpërfshirëse dhe multidisiplinare.

METODOLOGJIA E REVISTËS, GARANCI E SUKSESIT DHE PRANUESHMËRISË

Rrugëtimi i fjalës së shkruar, në veçanti i asaj teologjike islame dhe i analizave religjioze, përbën një sfidë më vete në Perëndim, ku liria e mendimit, të drejtat e njeriut, kohezioni shoqëror, toleranca fetare dhe multikulturalizmi, përbëjnë



themelin e mendësisë moderne dhe të kosmopolitizmit. Nisur nga kjo, shkrimet që gjejnë hapësirë në këtë kontekst, ku është e vendosur edhe mërgata shqiptare myslimane, duhet të jenë të ravijëzuara qartë nga këto parime, gjë që “Dituria Islame” ka arritur ta realizojë me sukses.

Kjo për faktin se shkrimet e publikuara në këtë revistë kanë artikulluar qartë dhe pa ekuivoke ndjekjen e një metodologjie të mesme (mesatare) në të kuptuarit e teksteve fetare dhe të misionit religjioz në shoqëritë moderne, multikulturore, multireligjioze, multietnike dhe të globalizuara. Autorët, përmes shkrimeve të tyre, kanë qenë të zëshëm në promovimin e mendimit reformues, në distancimin nga diskurset dhe narrativat e skajshme, si dhe nga mendësia izoluese dhe prirjet paragjyquese ndaj tjetrit.

Mërgata në përgjithësi, dhe teologët islamë shqiptarë në mërgatë në veçanti, përmes fjalës së shkruar në faqet e “Diturisë Islame”, janë orientuar drejt një kuptimi proaktiv të thirrjes islame, në funksion të bashkëveprimit dhe bashkëpunimit me faktorët relevantë fetarë dhe shoqërorë në hapësirën perëndimore, ku ata jetojnë dhe veprojnë.

Ndërtimi i një qëndrimi tolerant dhe bashkëjetues me tjetrin dhe të ndryshmin, si parim i rrugës së mesme në të kuptuarit e Islamit në përgjithësi, dhe i veprimtarisë islame në kontekst multireligjioz dhe sekular në veçanti, ka qenë një ndër shtyllat kryesore të pranisë dhe ndikimit të suksesshëm të temave të trajtuara në “Diturinë Islame” dhe të pikëpamjeve të autorëve të saj në hapësirën perëndimore në përgjithësi dhe në mërgatën shqiptare myslimane në veçanti.

“DITURIA ISLAME” DHE KONCEPTI I INTEGRIMIT

“Dituria Islame” përfaqëson një medium kredibil dhe me peshë në mërgatën shqiptare dhe në Perëndim në përgjithësi, me theks të veçantë në ndjekjen e një metodologjie mesatare dhe objektive në konceptimin e nocionit “integrim”. Shkrimet dhe autorët kanë mbështetur një koncept afirmativ të integritit, duke e dalluar atë qartë nga asimilimi dhe izolimi, çka ka sjellë kontribut jo vetëm për komunitetin mysliman shqiptar, por edhe për vetë shoqëritë evropiane.

Pa dyshim, parë nga ky aspekt, revista përbën një faktor të rëndësishëm për shoqërinë në tërësi, dhe jo vetëm për komunitetin mysliman shqiptar. Qëndrimet e skajshme dhe jo objektive në formësimin e qasjes ndaj integritit paraqesin barriera për pranueshmërinë e tyre nga mërgata shqiptare myslimane dhe nga komunitetet myslimane në Perëndim në përgjithësi, pasi pengojnë zhvillimin e tyre në përputhje me nevojat e kohës dhe aspiratat e gjeneratave të reja në shoqëritë bashkëkohore dhe në një botë të globalizuar.

Duke iu referuar shembujve nga koha e të Dërguarit të Allahut dhe pranisë së myslimanëve në shoqëri me shumicë jomyslimane gjatë hixhretit (mërgimit) në Abisini, si dhe shembujve të tjerë nga historia islame, autorët kanë arritur ta formësojnë në mënyrë të suksesshme konceptin e integritit

në përputhje me mësimet islame, sipas metodologjisë së mesme. Kjo ka shërbyer si mbështetje e fuqishme për praninë e myslimanëve në Perëndim dhe për rolin e tyre aktiv në shoqëritë perëndimore, ku mërgata shqiptare ka një kontribut të veçantë.

Duke promovuar autorë si: Jusuf el Karadavi, Muhamed Muteveli Sharavi, Muhamed Gazali, Ali Sabuni, Ismail Raxhi Faruku, Muhamed Asadi, Murad Hofmanni, Tarik Ramadani, Vehbi Ismaili, Ibrahim Dalliu, Hafëz Ali Korça, si dhe teologë shqiptarë myslimanë që veprojnë në Perëndim, “Dituria Islame” ka trasuar një rrugë të qëndrueshme në avancimin e metodologjisë mesatare dhe reformuese, e cila synon të sigurojë një vend të merituar për myslimanët në shoqëritë perëndimore.

Në përgjithësi, nga leximi i rubrikave, studimeve, analizave dhe qasjeve të publikuara në faqet e revistës “Dituria Islame” gjatë rrugëtimit të saj katër dekadësh me lexuesin shqiptar, mund të konkludohet se ajo përfaqëson një ndër projektet më të suksesshme intelektuale dhe kulturore të shqiptarëve myslimanë, si në vendlindje ashtu edhe në mërgatë. Ajo ka arritur të ndërtojë ura komunikimi, të ruajë identitetin dhe të promovojë vlera që i rezistojnë kohës dhe sfidave të globalizimit.

Kjo, sepse “Dituria Islame” e ka ndërtuar politikën e saj redaktuese mbi parimet e unitetit përkundër përçarjes, bashkëpunimit përkundër izolimit, si dhe rrugës së mesme përkundër qëndrimeve të skajshme. Pikërisht për këtë arsye, rrugëtimi i saj mbetet një model i suksesshëm i ndërthurjes së fesë, kulturës dhe identitetit në një botë gjithnjë e më komplekse.

Thënë përmbledhtas, revista “Dituria Islame” ka pasur dhe vazhdon të ketë një ndikim të dukshëm në jetën fetare, kulturore dhe kombëtare të mërgatës shqiptare myslimane. Ajo mbetet një burim i rëndësishëm i dijes dhe një mjet i fuqishëm për ruajtjen e identitetit shqiptar dhe islam, si dhe për promovimin e integritit si një përcaktim natyror dhe strategjik i shqiptarëve myslimanë në mërgatë. Përmes misionit të saj edukativ dhe kulturor, revista ka ndihmuar që shqiptarët jashtë atdheut të mos humbin lidhjen me fenë, gjuhën dhe traditat e tyre.

- Bashkësia Islame e Kosovës, “Dituria Islame”, numra të ndryshëm.
- Castells, Manuel, The Power of Identity, Blackwell, 1997.
- Tariq Ramadan, Western Muslims and the Future of Islam, Oxford University Press, 2004.
- J. Cesari, When Islam and Democracy Meet: Muslims in Europe and in the United States, Palgrave Macmillan, 2004.
- Yusuf al-Qaradawi, Fi Fiqh al Aqalliyyat al Muslima, Dar al Shuruq, Kajro, 2001.
- Bassam Tibi, Islam in Europe: Religion and Politics, Routledge, 2010.
- Esposito, John L., Islam: The Straight Path, Oxford University Press, 1998.
- Cesari, Jocelyne, When Islam and Democracy Meet, Palgrave Macmillan, 2004.
- Mandaville, Peter, Global Political Islam, Routledge, 2007.
- Kamali, Mohammad Hashim, The Middle Path of Moderation in Islam, Oxford, 2015.

Kontributi i revistës “Dituria Islame” në avancimin e rolit të gruas myslimane shqiptare

Dr. Violeta Smajlaj

Që nga themelimi i saj në vitin 1986, revista “Dituria Islame” ka qenë një prej forumeve më të rëndësishme të mendimit islam shqiptar. Në periudha të ndryshme historike – vitet e represionit serb, lufta e Kosovës, periudha e rindërtimit dhe sfidat e modernitetit – revista ka luajtur rol të rëndësishëm në formësimin e vetëdijes fetare, kulturore dhe kombëtare të lexuesve shqiptarë. Brenda këtij misioni, një vend të veçantë zë trajtimi i gruas dhe promovimi gradual i rolit të saj në familje, arsim, jetën publike dhe diskursin intelektual islam.

Ky evolucion nuk ka qenë i menjëhershëm. Ai është zhvilluar gradualisht, në harmoni me zgjerimin dhe pjekurinë e trajtesave të tjera tematike të revistës, duke kaluar nga paraqitja

e gruas si subjekt edukimi dhe përkujdesjeje morale, në afirmimin e saj si bartëse e identitetit fetar e kombëtar, e më pas si intelektuale, studiuese, analiste dhe pjesëmarrëse aktive në debatin publik. Në këtë proces, “Dituria Islame” nuk ka qenë vetëm pasqyrë e ndryshimeve shoqërore, por edhe faktor aktiv në prodhimin dhe orientimin e tyre.

KONSTITUIMI I HAPËSIRËS PËR ZËRIN E GRUAS (1986-1992)

Kontributi i parë i rëndësishëm i revistës lidhet me krijimin e hapësirës publike për pjesëmarrjen e grave në diskursin islam shqiptar. Që në filltet e botimit, në faqet e revistës paraqiten emrat e parë të autoreve dhe

Veçanërisht gjatë viteve të luftës dhe në periudhën pas saj, revista evidentoi vuajtjet, sakrificat dhe kontributin e grave shqiptare, duke i vendosur ato në qendër të narratives së qëndresës, mbijetesës dhe kujtesës kolektive kombëtare.



Pas luftës
vërehet një
ndryshim i
rëndësishëm
cilësor. Nëse
deri atëherë
gruaja
trajtohej
kryesisht si
temë studimi,
tashmë ajo
fillon të
shfaqet
gjithnjë e më
shumë si
autore,
studiuuese,
gazetare dhe
opinioniste.

përkthyesve femra, si Besa Shehu (nr.2,1986); Shpresa Prekadini (nr.19, 1990); Naime Hoxha (nr.25 etj.); Flaka Surroi, Lumturie Ndroqi dhe të tjera. Këto kontribute, ndonëse modeste në përmbajtje dhe numër, shënojnë fillimin e një procesi që do të zhvillohej gradualisht gjatë dekadave pasuese.

Kjo periudhë karakterizohet nga dy procese paralele. Së pari, revista prezanton modele të grave myslimane nga historia islame, si "Fatimja r.a., vajza e Profetit Muhamed a.s.", duke ofruar referenca identitare dhe morale për lexueset shqiptare. Së dyti, ajo hap diskutimin mbi pozitën e gruas në Islam përmes artikujve si "Edukata e gruas myslimane"; "Pozita e femrës në Islam dhe në Krishterizëm"; "Femrat në Evropë kërkojnë barabarësi me femrat myslimane" dhe më vonë seria "Pozita e gruas në fenë islame".

Në këtë fazë, diskursi i revistës orienton njëkohësisht dy objektiva kryesore: korrigjimin e stereotipave ideologjike të trashëguara nga periudha komuniste lidhur me fenë dhe rolin e saj në jetën shoqërore, si dhe afirmimin e dinjitetit dhe statusit të gruas sipas kornizës normative islame.

NDËRLIDHJA E ROLIT FETAR ME IDENTITETIN KOMBËTAR (1992-1999)

Një dimension i veçantë i kontributit të revistës është ndërthurja e çështjes së gruas me ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar.

Artikuj si: "Roli i femrës në ruajtjen e identitetit kombëtar" (Sabile Keçmezi-Basha, 1992), studimet mbi "Sami Frashëri për rolin dhe pozitën e gruas në familje e në shoqëri" (nr.72, 1995), si dhe shkrime të shumta mbi figurat kombëtare shqiptare, dëshmojnë përpjekjen e revistës për ta paraqitur gruan jo vetëm si bartëse të vlerave fetare, por edhe si ruajtëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar.

Në këtë mënyrë, "Dituria Islame" afirmoi një qasje në të cilën identiteti fetar dhe ai kombëtar paraqiten si dimensione të ndërthurura dhe reciprokisht plotësuese. Brenda kësaj kornize, gruaja myslimane paraqitet si pikë takimi e të dy dimensioneve dhe faktor i rëndësishëm në ruajtjen e tyre.

Veçanërisht gjatë viteve të luftës dhe në periudhën pas saj, revista evidentoi vuajtjet, sakrificat dhe kontributin e grave shqiptare, duke i vendosur ato në qendër të narratives së qëndresës, mbijetesës dhe kujtesës kolektive kombëtare.

NGA OBJEKTI I DISKUTIMIT TE SUBJEKTI I DISKURSIT (2000-2010)

Pas luftës vërehet një ndryshim i rëndësishëm cilësor. Nëse deri atëherë gruaja trajtohej kryesisht si temë studimi, tashmë ajo fillon të shfaqet gjithnjë e më shumë si autore, studiuuese, gazetare dhe opinioniste. Artikujt për dhunën, dëshmitë e luftës, kujtimet dhe reflektimet mbi sakrificën kombëtare dëshmojnë se revista e afirmonte gruan jo vetëm si shtyllë të familjes, por edhe si bartëse të kujtesës historike, dëshmitare të ngjarjeve dhe pjesëmarrëse në formësimin e fatit kolektiv të kombit.

Në këtë periudhë paraqiten emra si Emine Vezaj, Momoza Sinani, Suela Dibra, Xhevrie Dërguti-Vila, Arta Tahiri, Hatixhe Ahmeti, Besa Ismaili, Esma Morina dhe shumë autore të tjera, që trajtojnë tema nga edukimi, familja, jurisprudenca islame, sociologjia, kultura, historia dhe aktualiteti.

Autorësia femërore fillon të zërë vend në faqe të rregullta

të revistës, duke trajtuar plagët sociale të pasluftës. Në këtë kontekst të tranzicionit dhe riartikulimit të vlerave shoqërore, kontributi i Ardita Kajtazit mbi tematikën "Edukata fetare: duhet të jetë lëndë mësimore (fakultative apo obligative) edhe në shkollat tona" (nr.153, 2003), merr një peshë të re. Ky shkrim nuk duhet parë thjesht si





një kërkesë, por si pjesë e përpjekjeve për t'i institucionalizuar vlerat në hapësirën publike.

Revista nuk kufizohet më vetëm në mbrojtjen teorike të të drejtave të gruas, por i ofron asaj hapësirë reale për pjesëmarrje dhe përfaqësim.

INSTITUCIONALIZIMI I DISKURISË MBI GRUAN DHE KRIJIMI I ELITËS AUTORIALE (2010-2020)

Një etapë tjetër e evolucionit shfaqet me institucionalizimin e debatit mbi gruan dhe me rritjen e ndjeshme të cilësisë akademike të trajtesave. Në këtë periudhë trajtohen tema si: të drejtat ekonomike dhe pronësore të gruas, trashëgimia, arsimimi, mbulesa islame, dhuna në familje, shëndeti i gruas, martesë, divorci dhe pjesëmarrja në jetën publike.

Njëkohësisht, revista shndërrohet në një platformë ku afirmohet një elitë e re intelektuale femërore brenda diskursit islam shqiptar. Në faqet e saj paraqiten gjithnjë e më shumë autore me grada akademike dhe profil shkencor, si: dr. Hatixhe Ahmedi, dr. Samije Menisi, dr. Violeta Smajlaj, dr. Ilmije Kuqi, dr. Valmire Batatina-Krasniqi, dr. Florentina Tërmkolli, msc. Njomza Sadriu, mr. Ibadete Kosumi-Bryma, mr. Muzaqete Kosumi, mr. PhD (C) Melihate Zeqiri dhe të tjera.

Ky zhvillim është i rëndësishëm jo vetëm për historinë e revistës, por edhe për historinë e mendimit islam shqiptar. Ai dëshmon kalimin nga një prani simbolike e gruas në krijimin e një elite autoriale femërore që merr pjesë aktive në debatet teologjike, juridike, sociale dhe kulturore.

GRUAJA MYSLIMANE PËRBALLË MODERNITETIN DHE SFIDAVE GLOBALE (PAS 2020)

Në numrat më të fundit vërehet një zgjerim i konsiderueshëm tematik. Revista nuk merret më vetëm me çështje tradicionale të familjes dhe edukimit, por edhe me sfidat bashkëkohore që prekin gruan myslimane në nivel lokal dhe global. Artikujt e Nada Dosit, Isra Hysenit, Arlinda Amitit, Vildana Gogës, Edlira Durmishajt, Mimoza Sinanit, Azemine Kukajt dhe autoreve të tjera trajtojnë tema si identiteti i grave myslimane në shoqëritë evropiane, islamofobia dhe paragjykimet ndaj grave me shami, diskriminimi në tregun e punës, feminizmi bashkëkohor, debatet mbi teoritë gjinore dhe familjen, si dhe pjesëmarrja e grave në jetën publike, institucionale e akademike. Këto trajtesa dëshmojnë se revista e ka zgjeruar horizontin e saj nga temat klasike të jurisprudencës islame drejt analizës së proceseve komplekse shoqërore, kulturore dhe politike që ndikojnë në jetën e gruas myslimane në shekullin XXI.

Në dy dekadat e fundit, prania e gruas në revistë pëson një evolucion të plotë epistemologjik. Gruaja nuk është më as objekt trajtimi dhe as thjesht një zë reagues; ajo kthehet në një subjekt akademik që dikton agjendën kërkimore të revistës.

PËRFUNDIMI

Analiza e zhvillimit kronologjik të revistës “Dituria Islame” tregon se kontributi i saj në evolucionin e rolit të gruas shqiptare myslimane ka qenë shumëdimensional. Revista fillimisht krijoi hapësirë për prezantimin e modeleve islame të gruas dhe mbrojtjen e dinjitetit të saj, më pas e lidhi figurën e gruas me ruajtjen e identitetit kombëtar, ndërsa në fazat e mëvonshme mundësoi shndërrimin e saj në pjesëmarrëse aktive të jetës intelektuale dhe publike.

Nga një prani sporadike e autoreve femra në fillim të viteve 1990, “Dituria Islame” ka arritur të ndërtojë një platformë ku gratë kontribuojnë në teologji, histori, arsim, sociologji, jurisprudencë, kulturë, media dhe analiza të çështjeve bashkëkohore.

Më shumë se një pasqyrë e ndryshimeve shoqërore, revista ka qenë një faktor aktiv në nxitjen dhe orientimin e tyre, duke kontribuar në formësimin e një profili të ri të gruas shqiptare myslimane: të arsimuar, të vetëdijshme për identitetin e saj fetar dhe kombëtar, pjesëmarrëse në jetën publike dhe kontribuuese në prodhimin e dijes. Në këtë mënyrë, ajo ka ndihmuar evolucionin e rolit të gruas në përputhje me vlerat islame, identitetin kombëtar dhe kërkesat e kohës moderne. Në këtë mënyrë, revista ka kontribuar në rikonfigurimin gradual të rolit të gruas shqiptare myslimane brenda një diskursi që ndërthur dimensionin fetar, kulturor dhe shoqëror në kontekstin e ndryshimeve bashkëkohore.

Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, e mbajtur me rastin e festës së Kurban Bajramit

Kurban Bajrami – Festa e sakrificës, mëshirës dhe solidaritetit – thirrje për unitet dhe përgjegjësi

Të nderuar besimtarë, vëllezër dhe motra,

Sot jemi mbledhur në këtë vend të bekuar, në një nga ditët më madhështore dhe më të bekuara të kalendarit islam – në ditën e Kurban Bajramit, festës së sakrificës, devotshmërisë, mëshirës dhe solidaritetit njerëzor. Kjo festë e madhe nuk përfaqëson vetëm një manifestim ritual të besimit, por është një shkollë e lartë shpirtërore dhe morale, e cila e edukon besimtarin me bindje ndaj Zotit, përgjegjësi ndaj shoqërisë dhe dashuri ndaj njeriut.

Ibrahimi a.s., mbetet simboli më i lartë i besimit të palëkundur, i sakrificës dhe i nënshtrimit të singjertë ndaj vullnetit Hyjnor, si në thirrjen për vizitë Qabesë, ashtu edhe në prerjen e kurbanit. Pikërisht mbi këtë frymë është ngritur edhe mesazhi i kësaj feste të madhe, e cila na kujton se pa sakrificë nuk ka ngritje shpirtërore, pa përkushtim nuk ka afërsi me Zotin xh.sh., dhe pa solidaritet, nuk mund të ketë shoqëri të shëndoshë.

Zoti i Madhëruar thotë: “Dhe për hir të Allahut, vizita e Shtëpisë (Qabesë) është obligim për ata që kanë mundësi ta përballojnë rrugën.” (Ali Imran, 97).

Dhe ajeti tjetër lidhje me kurbanin: “Me të vërtetë, Ne të kemi dhënë ty begati të shumta. Andaj, falu vetëm për Zotin tënd dhe prej kurban!” (El Kevther, 1-2).

Sot, në këtë mëngjes të bukur të kësaj dite madhështore, miliona besimtarë nga të gjitha anët e botës janë mbledhur në tokën e bekuar të Mekës, duke iu përgjigjur thirrjes së përjetshme të Ibrahimit a.s., për të dëshmuar unitetin, barazinë dhe devotshmërinë e shoqërisë islame. Në mesin e



tyre gjenden edhe haxhilerët tanë nga Kosova, të cilët edhe sot pranë Qabesë luten për paqe, falje, mëshirë dhe mirëqenie për popullin tonë dhe për mbarë njerëzimin.

Prandaj, në këtë ditë të madhe, le t'i pastrojmë zemrat tona nga urrejtja, përçarja dhe egoizmi, le t'i forcojmë lidhjet familjare e shoqërore, le t'i ndihmojmë nevojtarët dhe le të bëhemi njerëz të paqes, të dijes dhe të përgjegjësisë.

Pikërisht për këtë arsye, Islami e lidhi këtë festë madhështore me solidaritetin social dhe me kujdesin për tjetrin, që asnjë familje të mos mbetet pa gëzim, pa ushqim dhe pa ndjenjë e përkatësisë njerëzore. Në këto ditë të bekuara feste, ne duhet t'i forcojmë lidhjet farefisnore, ta vizitojmë njëri-tjetrin, t'i pajtojmë zemrat e mërzitura, t'i ndihmojmë të varfrit, jetimët dhe nevojtarët, sepse madhështia e besimit shfaqet më së shumti në madhësinë e humanizmit.

Prandaj, le të jetë kjo festë një moment reflektimi, pastrimi shpirtëror dhe ringritje morale për të gjithë ne. Le të

sakrifikojmë urrejtjen për dashurinë, përçarjen për unitetin, egoizmin për solidaritetin dhe indiferencën për përgjegjësinë njerëzore. Vetëm atëherë do ta kuptojmë thelbin e vërtetë të Kurban Bajramit dhe do ta jetojmë mesazhin e tij në mënyrën më të denjë.

Të nderuar besimtarë, vëllezër dhe motra,

Është obligim moral, kombëtar dhe institucional që të krijohen kushte për jetë dinjitoze, arsim cilësor, punësim të ndershëm dhe perspektivë të sigurt për të rinjtë tanë, sepse rinia është pasuria më e madhe e një kombi. Një popull që humb rininë e tij, humb energjinë krijuese, zhvillimin, vitalitetin dhe shpresën për të ardhmen. Prandaj, ruajtja e rinisë sonë, fuqizimi i saj dhe kthimi i besimit tek e ardhmja duhet të jenë mision i përbashkët i çdo institucioni dhe i çdo qytetari të përgjegjshëm.

Po aq e rëndësishme është edhe ruajtja e identitetit tonë kombëtar dhe fetar, ruajtja e gjuhës shqipe, e traditave dhe kulturës sonë të lashtë. Sepse ato përfaqësojnë amanetin historik dhe shpirtëror që na është lënë nga brezat që sakrifikuan për liri, dinjitet dhe shtet. Një komb që harron rrënjët e veta, rrezikon të humbë orientimin e tij në histori. Ndërsa një komb që e ruan kujtesën, kulturën dhe vlerat e tij, mbetet i fortë edhe përballë sfidave më të mëdha.

Për t'i ndërtuar këto ideale të larta, vendi ynë ka nevojë që përveç stabilitetit ekonomik dhe politik, të ketë edhe institucione funksionale dhe përgjegjësi shtetërore. Fatkeqësisht, interesat e ngushta grupore dhe përplasjet e pafundme politike të partive tona, kanë lodhur qytetarët tanë dhe kanë krijuar pasiguri për të ardhmen. Mbajtja e zgjedhjeve të njëpasnjëshme, mungesa e unitetit institucional dhe polarizimi politik nuk i shërbejnë Kosovës, por e dobësojnë besimin qytetar dhe e zbehin shpresën e brezit të ri.

Nuk mund të ketë interes më të madh se interesi i atdheut. Nuk mund të ketë ambicie personale apo partiake mbi fatin e Kosovës. Prandaj, faktori politik duhet të vetëdijësohet se stabiliteti i shtetit, mirëqenia e qytetarëve dhe e ardhmja e rinisë, janë përgjegjësi historike që kërkojnë maturi, urtësi dhe vizion kombëtar.

Po ashtu, duhet të jemi të vetëdijshëm se jostabiliteti politik ka lodhur popullin tonë dhe ka shqetësuar edhe aleatët dhe miqtë tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë qëndruar pranë nesh në momentet më të vështira të historisë sonë. Përgjegjësia jonë ndaj tyre nuk është vetëm mirënjohja, por edhe ndërtimi i një shteti serioz, demokratik dhe funksional, që ecën përpara me mençuri dhe unitet.

Të nderuar besimtarë,

Ka rastisur që pikërisht në këtë ditë të madhe të Kurban Bajramit të fillojë edhe fushata politike për zgjedhjet e parakohshme që do të mbahen më 7 qershor 2026. Kjo na

obligon edhe më shumë që, në frymën e kësaj feste të paqes, sakrificës dhe mirëkuptimit, të tregojmë pjekuri qytetare, kulturë demokratike dhe përgjegjësi kombëtare.

Ne, si qytetarë të këtij vendi dhe si popull me traditë të lashtë të urtësisë, mikpritjes dhe respektit, duhet të dëshmojmë edhe kësaj radhe edukatë, qytetërim dhe kulturë të lartë politike, në mënyrë që kjo periudhë zgjedhore të kalojë në qetësi, dinjitet dhe respekt të ndërsjellë. Fushatat kalojnë, zgjedhjet përfundojnë, por shteti, populli dhe interesat kombëtare mbeten mbi çdo dallim politik apo partiak.

Prandaj, ju bëj thirrje të gjithëve që të merrni pjesë në zgjedhje me vetëdije të plotë qytetare, të votoni lirshëm, me përgjegjësi dhe sipas bindjes suaj, për ata që mendoni se e meritojnë besimin dhe që kanë vizion, urtësi dhe kapacitet për t'i çuar përpara proceset e rëndësishme të Kosovës.

Në këtë fushatë parazgjedhore, le të mos ketë vend për gjuhën e urrejtjes, fyerjet, linçimet, akuzat e pabazuara dhe njollosjen e njëri-tjetrit me të pavërteta vetëm për hir të një vote. Një fushatë e ndërtuar mbi përçarje dhe shpifje nuk i shërben Kosovës dhe as të ardhmes së saj.

Le të mbizotërojë urtësia, dinjiteti dhe kultura demokratike e dialogut. Të kemi respekt për mendimet ndryshe, sepse pikërisht përmes kundër mendimeve të shprehura me qytetari ndërtohet një shoqëri më e drejtë, më e pjekur dhe më e mirë për të gjithë.

Kosova ka nevojë për debat të bazuar në ide dhe argumente, e jo në urrejtje e përçarje; për vizion dhe përgjegjësi, e jo për baltosje e sulme personale; për afrim dhe mirëkuptim mes njerëzve, e jo për ndarje që dëmtojnë shoqërinë tonë.

Mbesim me shpresë që pas këtyre zgjedhjeve faktori politik të reflektojë me maturi dhe përgjegjësi shtetërore, që institucionet e vendit të formohen sa më shpejt dhe të krijohet stabiliteti i nevojshëm politik e institucional, për të punuar bashkërisht për të ardhmen e Kosovës, për mirëqenien e qytetarëve dhe për perspektivën e brezave të rinj.

Kosova ka nevojë për unitet në çështjet madhore, për institucione funksionale dhe për një frymë bashkëpunimi që e vendos interesin e atdheut mbi çdo interes tjetër. Vetëm të bashkuar mund t'i përballojmë sfidat dhe të ndërtojmë një të ardhme më të sigurt, më të drejtë dhe më dinjitoze për të gjithë qytetarët tanë.

Zoti i ruajt familjet tona, fëmijët tanë dhe shoqërinë tonë nga çdo e keqe, devijim dhe përçarje!

Zoti e ruajt popullin tonë, Kosovën tonë, dhe na udhëzoftë drejt paqes, urtësisë dhe bashkimit!

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 27.05.2026

Pamje nga hixhreti i shokëve të Pejgamberit a.s. drejt Medinës së ndritur

Idris Ahmed

Hixhreti i sahabëve nga Meka në Medinë përfaqëson një nga shembujt më të lartë të besimit, guximit dhe sakrificës në historinë islame. Duke lënë pas familjet, shtëpitë dhe pasuritë e tyre, ata iu bindën urdhrit të Allahut me përkushtim të plotë, duke e vënë fenë mbi çdo interes tokësor.

Lexuesi, duke e shfletuar historinë e kaluar Islame, ndesh disa pamje nga historitë e hixhretit të sahabëve drejt Medinës, ndërkohë që ata largoheshin nga vendi më i nderuar mbi sipërfaqen e Tokës, nga Meka e bekuar. Ata po i linin pas familjet, shtëpitë dhe pasuritë e tyre; pamje këto të trimërisë, guximit dhe sakrificës, të cilat u regjistruan për sahabët gjatë ngjarjeve të hixhretit. Këto pamje shfaqin vlerat e besimit, durimit, bindjes dhe nënshtrimit të plotë ndaj urdhrit të Allahut të Lartësuar, si dhe fljimin e vetes, pasurisë, jetës dhe familjes në rrugën e lartësimit të besimit në monoteizmin e Allahut dhe konsolidimin e shtyllave të tij të pastra nga ndotjet dhe njollat e politeizmit.

Këtë hixhret e ka lavdëruar Kurani fisnik me një shprehje të lartë dhe përmbledhëse: “Ata që janë dëbuar nga vatrat e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: “Zoti ynë është Allahu.” (El Haxh, 40).

Dhe e ka zbuluar qëllimin e sinqertë të muhaxhirëve fisnikë, duke thënë: “Një pjesë e plaçkës i takon edhe muhaxhirëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e sinqertë.” (El Hashër, 8). Kështu, muhaxhirët u cilësuan si të sinqertë, sepse ata e vërtetuan fjalën me vepër.

Muhamed el Gazali e përshkroi këtë pamje madhështore të kësaj etape historike, duke thënë: “Hixhreti nuk është transferimi i një nëpunësi nga një qytet i afërt në një qytet të

largët, as udhëtimi i një kërkuesi të jetesës nga një tokë e thatë në një tokë pjellore... Ai është detyrimi i një njeriu, i cili është i sigurt në vendin e tij dhe me rrënjë të thella aty, që të heqë dorë nga interesat e tij, ta sakrifikojë pasurinë e tij dhe ta shpëtojë vetëm veten e tij, duke ndier – teksa po braktis pozitën e tij – se sa ai është i pambrojtur dhe i plaçkitur, se mund të vdesë në fillim të rrugës ose në fund të saj, dhe se po ecën drejt një të ardhmeje të paqartë, pa e ditur se çfarë trazirash dhe hidhërimesh do të sjellë ajo rrugë. Sikur kjo të ishte aventura e një individi të vetëm me veten e tij, do të thuhej: është një aventurier i pamatur. Po si mund të thuhet kjo, kur ai niset nëpër gjatësinë dhe gjerësinë e vendit, duke marrë me vete edhe familjen dhe fëmijët e tij?! Dhe si është e mundur që ai, megjithatë, të jetë i qetë në ndërgjegje dhe me fytyrë të ndritur?! Ky është besimi, i cili peshon sa malet dhe nuk lëkundet. Besimi te kush? Tek Allahu, të Cilit i përket gjithçka që ka në qiej dhe në Tokë; Atij i takon falënderimi në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe Ai është i Urti, i Gjithëdijshtmi.”

KUR U DHA LEJA PËR HIXHRET

Sahabët i ankoheshin të Dërguarit a.s., për vuajtjet dhe mundimet që u shkaktonin politeistët. Ai i forconte, i nxiste për durim dhe u premtonte lehtësim dhe rrugëdalje nga kjo gjendje e vështirë. Kur jeta në Mekë u bë e ngushtë për ta, kërkuar leje nga Pejgamberi a.s., duke shpresuar që t’u hapej rruga për hixhret. Pastaj erdhi leja nga Allahu i Lartësuar për të Dërguarin e Tij dhe për besimtarët,



duke i urdhëruar për hixhret, ashtu siç e tregojnë edhe tekstet kuranore të përmendura më parë. Është vërtetuar në hadithet e sakta se përzgjedhja e Medinës së ndritur si vend i hixhretit për të Dërguarin a.s. ishte bërë përmes Shpalljes nga Allahu i Lartësuar për Pejgamberin e Tij. Ndër këto dëshmi është hadithi i Pejgamberit a.s., i cili thotë: “Pashë në ëndërr sikur po emigroja nga Meka drejt një toke me palma hurmash; mendimi im i parë ishte se ajo ishte Jemama ose Hexhri, por doli se ishte Medina, Jethribi.” (Sahihu i Buhariut).

Në një hadith tjetër thuhet: “Unë e pashë vendin e hixhretit tuaj: një vend me palma hurmash, mes dy shtrirjeve shkëmbore.” (Sahihu i Buhariut).

Duket se leja për hixhret u dha menjëherë pas Besëlidhjes së Parë të Akabes. Dëshmi për këtë është hixhreti i disa sahabëve drejt Medinës së ndritur, si Musab bin Umejri, Ebu Seleme dhe bashkëshortja e tij, si dhe të tjerë.

El Bera bin Azibi r.a., ka thënë: “Të parët që erdhën te ne nga shokët e Pejgamberit a.s. ishin Musab bin Umejri dhe Ibni Umme Mektumi; ata filluan të na mësonin Kuranin. Pastaj erdhën Amar bin Jasiri, Bilal bin Rebahu dhe Sad bin ebi Vekasi. Më pas erdhi Omer bin Hattabi me një grup prej njëzet vetash. Në fund erdhi Pejgamberi a.s. dhe nuk kam parë që banorët e Medinës të gëzoheshin për diçka më shumë sesa për ardhjen e tij, aq sa edhe vajzat e reja dhe fëmijët thoshin: ‘Ky është i Dërguari i Allahut a.s. që ka ardhur!’” (Sahihu i Buhariut).

Në këtë artikull, do të shqyrtojmë shembuj nga pamjet e hixhretit të sahabëve r.a..

SEMBUJ NGA PAMJET E HIXHRETIT TË SAHABËVE

• I pari që bëri hixhret në Medine

Ibnul Kajjimi ka thënë: “I pari që doli drejt Medinës ishte Ebu Seleme bin Abdul-Esedi dhe bashkëshortja e tij Ummu Seleme. Mirëpo, ajo u ndalua (nga familja e saj) dhe u pengua

t’i bashkohej atij për një vit të tërë, duke u ndarë edhe nga djali i saj. Pastaj, pas një viti, ajo u nis me djalin e saj drejt Medinës, e shoqëruar nga Uthman bin ebi Talha.

Ai kishte dalë me bashkëshorten e tij, Ummu Seleme, dhe me djalin e tyre, Seleme. Ai po ecte duke udhëhequr devenë ku ishin hipur ata të dy, kur e panë burrat e fisit Benu Mugire bin Abdullah bin Omer bin Mahzum, të cilët ishin fisi i bashkëshortes së tij dhe vajzës së axhës, Ummu Selemes, ata iu afruan dhe i thanë: “Veten tënde mund ta mbrosh nga ne, por ç’mendon për këtë gruan tënde? Si të të lejojmë ta marrësh me vete nëpër qytete?” Atëherë ia morën frerin e devesë nga dora dhe e rrëmbyen atë prej tij. Me të parë këtë, u zemëruan Benu Abdul-Esedi – fisi i Ebu Selemes – dhe thanë: “Pasha Allahun, nuk do ta lëmë djalin tonë tek ajo, pasi ju e shpëputët atë nga shoku ynë!” – dhe filluan ta tërhiqnin Selemen mes tyre, sa që ia nxorën krahun (prej vendi) dhe e morën me vete Benu Abdul-Esedi. Sa i përket Ummu Selemes, atë e mbyllën Benu Mugire tek ata, duke e ndarë kështu nga bashkëshorti dhe nga djali i saj. Megjithatë, Ebu Selemeja u nis për hir të Allahut si muhaxhir, pa u kthyer pas për familjen, as për fëmijën, as për pasurinë, derisa arriti në Kuba, ku qëndroi derisa erdhi bashkëshortja e tij pas një viti.

Ummu Seleme thoshte: “Pasha Allahun, nuk di ndonjë familje në Islam që të jetë goditur ashtu siç u godit familja e Ebu Selemes dhe, nuk kam parë kurrë ndonjë shoqëruar më fisnik sesa Uthman bin Talha.”

• Hixhreti i Musabit, i Ibni Umme Mektumit, i Bilalit, i Sadit dhe i Amarit

Myslimanët filluan të pasojnë njëri-tjetrin me shpejtësi në hixhret. Kështu emigroi Musab bin Umejri dhe Abdullah bin Umme Mektumi, të cilët ua mësonin Kuranin ensarëve; gjithashtu emigroi Bilal bin Rebahu dhe Sad bin ebi Vakasi r.a.. Buhariu në “Sahihun” e tij transmeton, me zinxhirin e tij të transmetimit nga El Bera bin Azibi, i cili ka thënë: “Të parët që erdhën te ne – (në transmetimin e Hakimit në librin

“El Ikil” shtohet: prej muhaxhirëve) - ishin Musab bin Umejri dhe Ibni Ummi Mektumi.”

- **Benu Xhahsh el Esedi**

Pastaj emigroi fisi i Benu Xhahshit: Abdullah bin Xhahsh bin Rijab el Esedi, prejardhja e të cilit përfundon tek Esed bin Huzejme, aleat i Benu Umejje bin Abdu Shemsit. Ai u nis së bashku me familjen e tij dhe me të ishte edhe i vëllai i tij, Ebu Ahmed Abd bin Xhahshi. Ebu Ahmed ishte njeri i verbër, por ai sillej nëpër Mekë, në pjesët e sipërme dhe të poshtme të saj, pa pasur nevojë për udhërrëfyes. Ai ishte poet dhe ishte i martuar me Farian, vajzën e Ebu Sufjan bin Harbit. Me ata dy ishte edhe Muhamed bin Abdullah bin Xhahshi. Shtëpia e tyre dhe shtëpia e Ebu Seleme bin Abdul-Esedit ishin pranë Mubeshshir bin Abdul-Mundhirit, në Kuba, te Benu Amër bin Avfi.

Po ashtu emigruan edhe gratë e tyre: Zejneb binti Xhahshi, Hamne binti Xhahshi – bashkëshortja e Musab bin Umejrit – dhe Ummu Habib binti Xhahshi – bashkëshortja e Abdurrahman bin Avfit. Për shkak të këtij hixhreti, shtëpitë e fisit Banu Xhahshit mbetën të mbyllura.

Pranë shtëpisë së Benu Xhahshit kaluan Utbe bin Rebia, Abbas bin Abdul-Muttalibi dhe Ebu Xhehl bin Hishami, derisa po ngjiteshin drejt pjesës së sipërme të Mekës. Utbeja e shikoi atë shtëpi, dyert e së cilës përplaseshin nga era, e shkretë dhe pa banorë. Kur e pa në atë gjendje, mori frymë thellë dhe recitoi: “Çdo shtëpi, sado gjatë që të mbetet e sigurt, një ditë do ta arrijnë fatkeqësia dhe shkatërrimi.”

Pastaj tha: “Kjo shtëpi mbeti bosh nga banorët e saj.” Atëherë Ebu Xhehli i tha Abasit: “Kjo është vepër e nipit tënd; ai e përçau bashkësinë tonë, e shpërndau çështjen tonë dhe e këputi lidhjen mes nesh...”

Në këto fjalë të Ebu Xhehlit shfaqen plotësisht tiparet e tiranëve: ata bëjnë krime, por barrën ua hedhin të tjerëve; i shtypin të dobët, e kur këta refuzojnë të nënshtrohen, atëherë refuzimin e tyre e paraqesin si shkak të problemeve dhe burim trazirash.

- **Hixhreti i Omer bin Hattabit dhe Ajjashit në një grup myslimanësh**

Pastaj emigroi El Faruku, Omeri bin Hattabi r.a.. Në karvanin e Omerit ishin rreth njëzet kalorës, ndër ta: Zejd bin Hattabi, Ajjash bin ebi Rebia, si dhe Amri dhe Abdullahu – dy djemtë e Suraka bin Mutemir el Adeviut, dhe të tjerë.

Omer bin Hattabi kishte lënë takim me Ajjash bin ebi Rebian dhe Hisham bin as bin Vailin në një vend të caktuar

Ngjarja e Ajjash bin Ebi Rebias pasqyron ashpërsinë e sprovave me të cilat u përballën myslimanët e parë pas hixhretit. I mashtruar nga të afërmit e tij me pretekstin e kujdesit për nënën, ai u kthye drejt Mekës, ku u kap, u lidh dhe u poshtërua publikisht.

ku do të gdhiheshin, e pastaj do të emigronin drejt Medinës. Omeri dhe Ajjashi u bashkuan, ndërsa Hishami mbeti i penguar (u ndalua).

Kur arritën në Medine dhe u vendosën në Kuba, erdhi Ebu Xhehli dhe vëllai i tij Harithi tek Ajjashi – të tre kishin të njëjtën nënë – dhe i thanë: “Nëna jote është zotuar se nuk do ta prekë kokën e saj me krehër as nuk do të strehohet nga dielli derisa të të shohë ty.” Atij iu dhimbs shumë nëna e tij.

Omeri i tha: “O Ajjash, këta njerëz duan të të sprovonjë në fenë tënde, prandaj ruaju prej tyre! Pasha Allahun, sikur nënën tënde ta shqetësonin morrat, ajo do t’i krihte flokët; dhe sikur ta rëndonte vapa e Mekës, ajo do të kërkonte hije.” Mirëpo Ajjashi nuk pranoi gjë tjetër, veçse të nisej me ta, që ta përmbushte betimin e nënës së tij.

Atëherë Omeri i tha: “Nëse tashmë ke vendosur të shkosh, atëherë merre këtë devenë time, sepse ajo është kafshë fisnike dhe e bindur; qëndro mbi kurizin e saj dhe nëse vëren ndonjë mashtrim prej këtyre njerëzve, ik me të dhe shpëto.” Kështu, ai u nis bashkë me ta mbi atë deve.

Kur arritën në një pjesë të rrugës, Ebu Xhehli i tha: “O biri i vëllait tim! Pasha Allahun, kjo deveja ime është lodhur shumë. A nuk do të ma jepje pak këtë devenë tënde?”

Ai u përgjigj: “Po, sigurisht.”

Atëherë ai e uli devenë e tij dhe edhe ata të dy i ulën devetë e tyre, që Ebu Xhehli të hipte mbi të. Por sapo u gjendën të gjithë në tokë, ata u hodhën mbi Ajjashin, e mposhtën dhe e lidhën fort. Pastaj e futën në Mekë ditën për diell, të lidhur këmbë e duar, dhe thanë: “O banorë të Mekës! Kështu veproni me mendjelehtët tuaj, ashtu siç vepruam ne me këtë mendjelehtëtin tonë!”

Omer bin Hattabi ka thënë: “Ne thoshim: Allahu nuk do t’ia pranojë atij që është sprovuar dhe është kthyer nga feja asnjë vepër të detyrueshme, as vullnetare dhe as pendim; njerëzve që e njohën Allahun, pastaj u kthyen në mosbesim për shkak të një sprove që i goditi...” Por kur i Dërguari i Allahut a.s., arriti në Medine, Allahu i Lartësuar shpalli për ta – dhe lidhur me fjalët tona dhe fjalët që ata thoshin për veten e tyre: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet.” (Ez Zumer, 53). Atëherë Omeri tha: “Këtë e shkrova me dorën time në një fletë dhe ia dërgova Hisham ibnul Asit.”

Hishami tregoi: “Kur më erdhi fleta, fillova ta lexoja në Dhu Tuva; e lexoja duke u ngjitur e duke zbritur nëpër luginë, por

nuk po e kuptoja, derisa thashë: O Allah, ma bëj të mundshme ta kuptoj!”

Ai tha: “Atëherë Allahu i Madhëruar më hodhi në zemër se ky ajet ishte shpallur pikërisht për ne, për atë që ne thoshim për veten tonë dhe atë që thuhej për ne.”

Hishami vazhdoi: “U ktheva te deveja ime, hipa mbi të dhe u bashkova me të Dërguarin e Allahut a.s..”

• Hixhreti i Suhejb bin Sinan er Rumiut

Kur Suhejb r.a. deshi të emigronte, jobesimtarët e kurejshitëve i thanë: “Ti erdhe te ne i varfër dhe i pa vlerë, pastaj t’u shtua pasuria dhe arrite këtu ku je. Tani dëshiron të largohesh me veten dhe pasurinë tënde?! Pasha Allahun, kjo nuk do të ndodhë!” Ai u tha: “Çfarë mendoni, nëse jua lë juve pasurinë time, a do të ma lini të lirë rrugën?” Ata i thanë: “Po.” Ai tha: “Atëherë, unë po jua lë juve të gjithë pasurinë time.” Kur ky lajm i arriti të Dërguarit të Allahut a.s., ai tha: “Fitoi Suhejb, fitoi Suhejb!”

MËSIMET DHE KËSHILLA NGA HIXHRETI I SAHABËVE

Tregimet mbi hixhretin e sahabëve të nderuar nuk kalojnë pranë nesh thjesht si një rrëfim historik i rëndomtë, por ato janë burim i pashtershëm mesimesh dhe këshillash. Dhe, siç theksojnë dijetarët bashkëkohorë të sires (biografisë pejgamberike), si dr. El Buti dhe dr. Es Salabi, këto ngjarje paraqesin një kuptim të plotë të fesë dhe një program të tërë jetese. Ndër mesimet më të rëndësishme janë:

• Hixhreti, para së gjithash, është adhurim dhe përgjigje ndaj urdhrit hyjnor

Hixhreti nuk ishte thjesht një plan njerëzor për t’i shpëtuar padrejtësisë, por në thelbin e tij ishte bindje dhe nënshtrim ndaj urdhrit të Allahut. Ai ishte një “akt adhurimi” që kërkonte dëgjim dhe nënshtrim; kjo shpjegon se si sahabët arritën t’i braktisnin gjërat më të dashura që posedonin, sepse ata po zbatonin një urdhër hyjnor dhe jo thjesht një zgjedhje të kësaj bote.

• Sakrifika e plotë – çmimi i ndërtimit të kombeve

Hixhreti na mësoi se ndërtimi i së vërtetës dhe themelimi i shteteve kanë çmim të lartë. Këtë çmim sahabët e paguan me kënaqësinë më të madhe:

Suhejb er Rumi e dha të gjithë “pasurinë” e tij;

Ebu Seleme dhe Ummu Seleme e sakrifkuan “familjen” dhe e përjetuan hidhërimin e ndarjes;

Familja Benu Xhahsh e sakrifkuan “atdheun”, derisa shtëpia e tyre u bë “shtëpia e parë që u mbyll për hir të Allahut”. Ky është një mesazh i qartë se fuqizimi dhe fitorja nuk dhurohen falas, por arrihen me sakrificë.

• Besnikëria ndaj besimit i thyen të gjitha lidhjet

Në skenën e hixhretit, u shkrinë të gjitha besnikëritë (ndaj fisit, tokës, pasurisë dhe farefisnisë) dhe i përfshi u lidhja e besimit. Këshilla e Omer bin Hattabit për Ajjash bin ebi Rebian dhe paralajmërimi i tij ndaj sprovës me të ëmën, është



një mësim elokuent se besnikëria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij qëndron mbi çdo besnikëri tjetër, dhe se “ndërtimi i umetit” ka përparësi ndaj lidhjeve tradicionale.

Planifikimi njerëzor së bashku me mbështetjen hyjnore

Hixhreti nuk ishte kaotik, por ishte shembull i planifikimit strategjik. Këtë e shohim në marrëveshjen për t’u takuar ndërmjet Omerit, Ajjashit dhe Hishamit; në shpërnguljen e sahabëve në formë grupesh (karvani i Omerit); në përzgjedhjen e kohëve të përshtatshme dhe në ndjekjen e rrugëve të ndryshme. Ata i shfrytëzuan të gjitha shkaqet dhe mjetet që i kishin në dispozicion si njerëz, duke pasur njëkohësisht bindje të plotë në mbështetjen tek Allahu si besimtarë.

• Prova në fe dhe gjerësia e mëshirës së Allahut

Historia e Ajjash bin ebi Rabias dhe Hisham bin el Asit na tregon se rruga nuk është e lehtë dhe se “prova në fe” është lloji më i rëndë i sprovës. Mirëpo, ajo na tregon gjithashtu një mësim edhe më të madh mbi gjerësinë e mëshirës së Allahut, kur u shpall ajeti: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gynahe...” (Ez Zumer, 53), duke e hapur kështu derën e shpresës dhe të pendimit për atë që gaboi. Kjo e mishëron mëshirën e Islamit, madje edhe ndaj atij që është treguar i dobët në mes të rrugës.

• Fitimi i vërtetë i tregtisë

Pejgamberi a.s., e përmbledhi historinë e hixhretit të Suhejb Rumiut me një fjali të pavdekshme: “Fitoi Suhejb!” Kjo është peshorja pejgamberike: që njeriu ta shpëtojë fenë e tij, ky është “fitimi” i vërtetë; dhe që ta humbasë tërë këtë botë për ta fituar botën tjetër, ky është triumfi i qartë.

Përktheu nga gjuha arabe: Miftar Ajdini

Burimi: <https://islamonline.net/>

صور من هجرة الصحابة رضوان الله عليهم إلى المدينة المنورة

Objektivat hyjnore (2)

Dr. Zenel Hajdini

Ruajtja e jetës si objektiv hyjnor paraqet një manifestim të mëshirës dhe urtësisë hyjnore, duke vendosur kufij të qartë ndaj cenimit të saj dhe duke ngritur një kulturë përgjegjësie kolektive për mbrojtjen e saj.

RUAJTJA E JETËS

Ruajtja e jetës përbën një nga shtyllat më madhore të objektivave të Sheriatit, sepse vetë jeta është themeli mbi të cilin ndërtohet çdo përgjegjësi fetare, morale dhe shoqërore. Pa ekzistencën e saj, as feja nuk mund të zbatohet, as drejtësia të vendoset, as morali të marrë kuptim konkret. Për këtë arsye, jeta njerëzore në Islam trajtohet si amanet hyjnor dhe si dhuratë e shenjtë nga Allahu, e cila nuk i përket plotësisht njeriut, por i është besuar atij për ta ruajtur dhe për ta zhvilluar në përputhje me udhëzimin hyjnor.

Në hierarkinë e “pesë të domosdoshmeve”, ruajtja e jetës zë një vend qendror, sepse garanton vazhdimësinë e qenies njerëzore

dhe stabilitetin e rendit shoqëror. Çdo dispozitë që mbron jetën, që ndalon cenimin e saj, apo që vendos masa parandaluese ndaj dhunës dhe shkatërrimit, është shprehje e drejtpërdrejtë e këtij objektiv madhor. Në të kundërtën, çdo veprim që rrezikon jetën, apo e zhvlerëson atë, konsiderohet shkelje e një prej themeleve mbi të cilat qëndron ligjënia islame.

Sheriati nuk e kufizon ruajtjen e jetës vetëm në ndalimin e vrasjes, por e shtrin atë në sigurimin e kushteve që mundësojnë jetesë të dinjitetshme: ushqim, siguri, shëndet, drejtësi dhe mbrojtje nga padrejtësia. Kjo qasje dëshmon se Islami nuk e sheh jetën thjesht si ekzistencë biologjike, por si një realitet të



nderuar, që duhet mbrojtur, kultivuar dhe respektuar në çdo fazë të tij.

Kështu, ruajtja e jetës si objektiv hyjnor paraqet një manifestim të mëshirës dhe urtësisë hyjnore, duke vendosur kufij të qartë ndaj cenimit të saj dhe duke ngritur një kulturë përgjegjësie kolektive për mbrojtjen e saj. Ajo është garanci për vazhdimësinë e misionit njerëzor mbi tokë dhe dëshmi e vlerës së lartë që Islami i jep qenies njerëzore.

RUAJTJA E JETËS – KUPTIMI I OBJEKTIVIT HYJNOR

Ruajtja e jetës nënkupton mbrojtjen e ekzistencës fizike dhe dinjitetit të njeriut nga çdo formë cenimi, padrejtësie apo shkatërrimi. Sipas dijetarëve, si: Imam Gazaliu, Shatibiu dhe të tjerë, ruajtja e jetës është një nga pesë objektivat themelore të Sheriatit, krahas ruajtjes së fesë, mendjes, pasurisë dhe nderit.¹

Prandaj, për realizimin e këtij objekti madhor, që është ruajtja e jetës, Sheriati islam ka paraparë një sërë mekanizmesh dhe dispozitash, që synojnë mbrojtjen e ekzistencës fizike dhe dinjitetit njerëzor. Së pari, ai ndalon në mënyrë kategorike vrasjen dhe çdo formë dhune që cenon jetën e njeriut, duke e konsideruar atë një nga shkeljet më të rënda. Së dyti, përmes legjislacionit penal, siç është institucioni i kisasit, synohet jo vetëm ndëshkimi i krimit, por edhe parandalimi i tij dhe garantimi i sigurisë shoqërore.

Gjithashtu, Sheriati njeh parimin e domosdoshmërisë, sipas të cilit në raste emergjente lejohen edhe disa gjëra të ndaluara, në mënyrë që të ruhet jeta e njeriut. Kjo tregon fleksibilitetin dhe humanizmin e tij në situata të jashtëzakonshme. Për më tepër, ai promovon drejtësinë, mëshirën dhe solidaritetin shoqëror si vlera thelbësore, të cilat kontribuojnë në krijimin e një ambienti të sigurt dhe të qëndrueshëm për jetën njerëzore.

Në këtë mënyrë, ruajtja e jetës nuk mbetet vetëm një parim teorik, por shndërrohet në një sistem të plotë normash dhe vlerash, që synojnë mbrojtjen dhe mirëqenien e individit dhe shoqërisë në tërësi.

RUAJTJA E JETËS NË KURANIN FAMËLARTË

Kurani i kushton rëndësi të jashtëzakonshme shenjtërisë së jetës njerëzore. Allahu i Madhëruar thotë: *“Kush vret një njeri pa të drejtë, është sikur të ketë vrarë gjithë njerëzimin; e kush e shpëton një jetë, është sikur ka shpëtuar gjithë njerëzimin.”* (El Maide, 32).

Muxhahidi për këtë ajet ka thënë: “Kush e vret një njeri me qëllim, Allahu për të ka caktuar dënim Xhehenemin, është

“Shkatërrimi i gjithë botës është më i lehtë për Allahun sesa vrasja e një njeriu pa të drejtë.”

(Hadith)

hidhëruar me të, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur ndëshkim të madh. Edhe sikur t'i vriste të gjithë njerëzit nuk do t'i shtohet më tepër ai dënim.”²

Gjithashtu, Kurani ndalon rreptësisht vetëvrasjen: *“Mos e vrisni shpirtin që Allahu e ka bërë të shenjtë, përveçse me të drejtë.”* (El Isra, 33).

Në të njëjtën kohë, Kurani lejon përjashtime në raste domosdoshmërie për të ruajtur jetën, siç është lejimi i ushqimeve të ndaluara kur rrezikohet jeta, duke treguar fleksibilitetin dhe prioritetin absolut të këtij objekti... “Por ata që shtrëngohen nga uria e madhe, mund t'i hanë ato, sa ta shuajnë urinë e jo të kalojnë kufirin...” (En Nahl, 115).

SHEMBUJ NGA JETA E PEJGAMBERIT A.S. DHE SHOKËVE TË TIJ

Praktika e Pejgamberit a.s., përfaqëson zbatimin konkret të ruajtjes së jetës. Shembujt nga jeta e tij tregojnë se shmangia e gjakderdhjes kishte përparësi edhe në situata konflikti. Marrëveshja e Hudejbijes është një ilustrim i qartë i kësaj qasjeje, ku paqja dhe ruajtja e jetës u vendosën mbi interesat afatshkurtra politike. Ky traktat nuk ishte thjesht një marrëveshje politike, por një model i thellë i mençurisë strategjike, diplomacisë dhe realizimit të qëllimeve të Sheriatit, veçanërisht në ruajtjen e jetës dhe stabilitetit shoqëror.³

Ndërsa, nga fjalët e tij a.s., gjejmë: “Kush vret një person të mbrojtur (nën marrëveshje), nuk do ta ndiejë erën e Xhenetit.”⁴; “Shkatërrimi i gjithë botës është më i lehtë për Allahun sesa vrasja e një njeriu pa të drejtë.”⁵

Sahabët, shokët e Pejgamberit a.s., e kuptonin thellë këtë parim. Prandaj, edhe gjejmë që gjatë kohës së kalifatit të Omerit r.a., u pezullua zbatimi i dënimit për vjedhje gjatë vitit të urisë,⁶ për të mos rrezikuar jetën dhe mbijetesën e njerëzve.

Ky veprim tregon se ruajtja e jetës ka përparësi edhe ndaj zbatimit të dispozitave ligjore në formën e tyre të zakonshme, kur rrethanat e bëjnë këtë të domosdoshme.

SFIDAT BASHKËKOHORE NË RUAJTJEN E JETËS

Në kohën bashkëkohore, ruajtja e jetës përballat me sfida të shumta dhe gjithnjë e më komplekse, të cilat e bëjnë këtë objektiv themelor më të vështirë për t'u realizuar në praktikë.

Jeta e njeriut sot rrezikohet nga faktorë të ndryshëm, duke filluar nga rritja e dhunës dhe kriminalitetit, aksidentet e shumta në komunikacion, përdorimi i substancave të

Kurani, Suneti dhe praktika e sahabëve, dëshmojnë qartë se jeta njerëzore është e shenjtë dhe se çdo sistem juridik apo shoqëror që synon drejtësinë duhet ta vendosë mbrojtjen e saj në qendër.

rrezikshme, deri te problemet e shëndetit mendor, që shpesh çojnë në pasoja tragjike.

Po ashtu, konfliktet sociale, papërgjegjshmëria individuale dhe mungesa e sigurisë në shumë aspekte të jetës moderne kontribuojnë në cenimin e vazhdueshëm të jetës njerëzore.

Në këtë realitet, nuk kalon pothuajse asnjë ditë pa u dëgjuar për raste me pasoja fatale, gjë që tregon se ruajtja e jetës nuk është vetëm një parim teorik, por një sfidë e përditshme që kërkon ndër-gjegjësim të lartë, përgjegjësi kolektive dhe angazhim të vazhdueshëm për mbrojtjen e saj.

Nga perspektiva islame, këto sfida kërkojnë një qasje të bazuar në shkencën e Makasid esh Sheria (objektivat hyjnore), ku ruajtja e jetës vendoset mbi interpretimet e ngushta tekstuale dhe ku prioritet i jepet parandalimit të dëmit dhe promovimit të së mirës së përgjithshme.

Prandaj, nga dispozitat islame gjejmë se: ndalohet ndërprerja e jetës apo (eutania), e të cilën po e quajmë si vdekje e mëshirshme, vetëm me një injeksion; ndalohet aborti pa arsye të vlefshme mjekësore; kërkohet trajtimi i

sëmundjeve; si dhe ndalohen vetëvrasjet, varësitë narkotike dhe alkoolike dhe pa përkujdesja ndaj shëndetit.

PËRMBYLLJE

Ruajtja e jetës përbën një nga shtyllat themelore të objektivave hyjnore dhe pasqyron mëshirën, drejtësinë dhe urtësinë e Sheriatit islam. Kurani, Suneti dhe praktika e sahabëve, dëshmojnë qartë se jeta njerëzore është e shenjtë dhe se çdo sistem juridik apo shoqëror që synon drejtësinë duhet ta vendosë mbrojtjen e saj në qendër.

Në kohën bashkëkohore, rikthimi te kuptimi i thellë i këtij objekti është thelbësor për adresimin e sfidave globale dhe për ndërtimin e një diskursi islam që promovon paqen, dinjitetin dhe bashkëjetesën njerëzore.

Përtej mekanizmave ligjorë dhe ndëshkues, ruajtja e jetës kërkon një qasje më të thellë, të bazuar në vetëdijesimin etik dhe human të individit. Kur njeriu ndërton një ndërgjegje të fortë morale dhe e percepton jetën si një vlerë të shenjtë, ai nuk shmang dëmtimin e tjetrit vetëm nga frika e dënimit, por nga bindja e brendshme. Prandaj, edukimi, empatia dhe përgjegjësia shoqërore mbeten mjete thelbësore për mbrojtjen reale dhe të qëndrueshme të jetës në shoqërinë bashkëkohore.

- 1 Esh Shatibiu, Ebu Is'hak, El Muvafekat fi usuli esh Sheriah, (Darul Hadith, Kajro, 2005), vëll. II, f. 268. El Gazaliu, Ebu Hamid Muhamed, El Mustesfa, (Dar el Kutub el Ilmije, 1993) vëll. I, f. 172.
- 2 Et Taberiu, Ebu Xhafer Muhamed bin Xherir, Tefsir et Taberij (Xhamiul Bejan an te'vil ajil Kuran), (Darul Kalem, Damask, 1997) vëll. III, f. 205.
- 3 Shih: Safijurrahman el Mubarekfurri, Err Rrehikul Makhtum, f. 422-440, ngjarjen dhe kushtet më gjerësisht.
- 4 Buhariu, Sahihul Buhari, 6914.
- 5 Et Termidhiu, Sunen et Termidhij, 1395; En Nesaiu, Sunen en Nesaiu, 3987.
- 6 Abdurrezak es Sananij, Ebu Bekër, El Musanef, (El Mexhlis el Ilmij, Hind, 1983), vëll. X, f. 242.



Ateizmi i ri dhe Islami

Muhammad Legenhausen

ÇFARË ËSHTË ATEIZMI I RI?

Ateizmi i ri nuk është thjesht sukses në shitjen e librave, fitimin e mbulimit mediatik dhe tërheqjen e syrit të akademisë.

Ajo që është quajtur “ateizmi i ri” doli në qendër të vëmendjes kulturore në vitin 2006. Në atë vit, në Institutin Salk për Studime Biologjike në Kaliforni (Salk Institute for Biological Studies) u mbajt një konferencë e quajtur “Beyond Belief: Science, Religion, Reason and Survival” (Përtej besimit: shkenca, feja, arsyeja dhe mbijetesa).

Kjo konferencë, e cila tërhoqi një mbulim të konsiderueshëm mediatik, theksoi pikëpamjet e ateistëve të cilët pretendonin se feja nuk përputhet me një pikëpamje shkencore të botës, duke përfshirë Richard

Dawkins, Sam Harris dhe filozofin Daniel Dennett. Ishte gjithashtu në vitin 2006 që u botuan disa libra që sulmonin fenë: Dawkins’ The God Delusion (Mashtrimi i Zotit i Dawkins), Harris’ Letter to a Christian Nation (Letra e Harris për një komb të krishterë) dhe Dennett’s Breaking the Spell (Dennett po thyen magjinë).

Këto u ndoqën vitin e ardhshëm nga Christopher Hitchens, God is Not Great: How Religion Poisons Everything (Zoti nuk është i madh: Si feja helmon gjithçka). Thjesht, botimi i librave nga ateistët kundër fesë nuk është i ri; ajo që është e re janë shifrat e shitjeve për libra të tillë. Ata po shesin miliona kopje. Dawkins është ende i 24-ti në listën e librave më të shitur të librave letrar të New York Times. Asnjë ateist nuk ka qenë kurrë në

Ajo që është e re në ateizmin e ri, megjithatë, nuk është thjesht sukcesi në shitjen e librave, fitimi i mbulimit mediatik dhe tërheqja e syrit të akademisë.



gjendje të fitojë kaq shumë vëmendje. Së bashku me shitjet e librave, ka pasur shumë programe televizive, artikuj revistash dhe rubrika gazetash. Gjithashtu, në listën më të shitur janë përgënjeshtimet ndaj ateistëve, të tilla si *The Reason for God* (Arsyeja për Zotin) i Timothy Keller. Ka pasur gjithashtu konferenca dhe diskutime të shumta akademike për fenomenin e ateizmit të ri.

Ajo që është e re në ateizmin e ri, megjithatë, nuk është thjesht suksesi në shitjen e librave, fitimi i mbulimit mediatik dhe tërheqja e syrit të akademisë. Së pari, ateizmi i ri, në kontrast me pjesën më të madhe të ateizmit modern, është militant; d.m.th., ai mban qëndrimin se besimi në Zot nuk është vetëm një botëkuptim i gabuar, por është shtypës dhe duhet të shkulet nga kulturat njerëzore. Ateizmi modern është kryesisht një fenomen evropian. Ndjenjat anti-fetare që arritën në krye në Revolucionin Francez gjetën shprehje si ateizëm filozofik me Auguste Comten (vd. 1857) dhe Ludwig Feuerbachun (vd. 1872) dhe u bënë militantë në lëvizjen komuniste. Lëvizja drejt militantizmit kapet në mënyrë të habitshme në ndryshimin nga komenti i Volterit (vd. 1778) (i cili ishte një deist dhe jo një ateist), “If God did not exist, it would have been necessary to create Him” (Po të mos ekzistonte Zoti, do të ishte e nevojshme ta krijonte Atë”), fjalët e anarkistit revolucionar Mikhail Bakunin (vd. 1876): “If God did exist, it would be necessary to destroy Him!” (Nëse Zoti do të ekzistonte, do të ishte e nevojshme ta shkatërronte Atë!). Termi “ateizëm militant” u prezantua nga Lenini në një fjalim të vitit 1922. Ateizmi i ri nuk është politikisht majtist, por merr urgjencën e thirrjes së Leninin për t’u ngritur kundër fesë.

ATEIZMI I RI DHE ISLAMI

Kjo na sjell te risia e dytë e madhe e ateizmit të ri: kundërshtimi i tij ndaj Islamit. Ateizmi është një refuzim i të gjitha feve, ose së paku i të gjitha feve teiste, dhe meqenëse Islami zakonisht konsiderohet një fe teiste, ateizmi në parim është kundër tij. Megjithatë, si një fenomen me rrënjët e tij në Evropë, ateizmi e ka përqendruar kundërshtimin e tij ndaj fesë së krishterë. Në të kundërt, ateizmi i ri e thekson Islamin si një formë feje veçanërisht virulente që duhet kundërshtuar. Shpesh, ateistët e rinj pretendojnë se për shkak të ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, ata ndihen të detyruar të marrin një qëndrim të fortë kundër fesë në përgjithësi dhe Islamit në veçanti. Për shkak të kësaj, ateistët që fokusohen kryesisht në Islam, si Ajaan Hirsi Ali, mund të konsiderohen gjithashtu si pjesë e ateizmit të ri, ose të paktën aleat me të.

Shumica e përgjigjeve dhe përgënjeshtimeve ndaj ateizmit të ri janë bërë nga të krishterët, të cilët nuk janë aq të interesuar për të mbrojtur çdo fe, por në radhë të parë krishterimin. Disa mbajnë qëndrimin se ateistët e rinj e kanë gabim vetëm

kur sulmojnë fenë e tyre dhe sulmet ndaj feve të tjera mund të mos jenë të padëshiruara.

FILOZOFIA E ATEISTËVE TË RINJ

Në mënyrë filozofike, ateistët e rinj nuk kanë asgjë të re për të ofruar. Ateistët e rinj priren të mos tregojnë interes për filozofinë, fenë apo teologjinë profesionale dhe synojnë tregun masiv. Argumentet kundër ekzistencës së Zotit janë përgjithësisht versione të shkencës, pikëpamjes se të gjitha problemet e jetës mund të zgjidhen duke iu drejtuar shkencave natyrore dhe argumenti moral kundër fesë, që feja nxjerr në pah më të keqen te njerëzit. Një pjesë e diskursit të ateizmit të ri lind nga debati midis kreacionistëve dhe evolucionistëve dhe shpesh duket se qëndron në nivelin e dy fundamentalizmave konkurrues: besimi në të vërtetën e mirëfilltë të shkrimit të shenjtë nga njëra anë dhe besimi në fuqinë shpëtuese të shkencës nga ana tjetër.

Scientizmi (shkencësia) e ateistëve të rinj shoqërohet me zemërimin e tyre moral ndaj fanatizmit fetar, i cili merret si normativ për besimin fetar dhe thuhet se shkaktohet nga mosbazimi i bindjeve të dikujt vetëm në prova.

POZITIVIZMI DHE ATEISTI I RI

Pozitivistët nuk janë, në mënyrë rigorozë, as ateistë dhe as agnostikë. Ata bëjnë parashikime në bazë të këtyre rregullave. Ata vëzhgojnë se si ndodhin gjërat, e jo pse. Vargu pozitivist i mendimit të ri ateist u hodh poshtë tërësisht në qarqet filozofike, sepse u zbulua se edhe shkencat natyrore mbështeten në supozime që nuk mund të mbështeten me prova shkencore. Shpesh parimi i pozitivizmit kthehej kundër vetvetes: nuk ka asnjë provë shkencore për ta mbështetur parimin se duhet pranuar vetëm ato besime për të cilat ka prova shkencore. Sa i përket zemërimit moral, shumë nga tmerret e të ashtuquajturave konflikte fetare kanë shkaqe sociale dhe politike dhe jo ato fetare, dhe disa nga ofendimet më të këqija të shekullit XX nga njerëz si Stalini dhe Pol Poti u kryen nga ateistë të deklaruar.

PËRGJEGJËSIA E MYSLIMANËVE

Si myslimanë, ne duhet të përpiqemi ta mbrojmë besimin tonë me çiltërsi, paanësi dhe arsyeshmëri. Ateistët e rinj përpiqen të provokojnë zemërimin e atyre që ata sulmojnë, në mënyrë që të vërtetojnë pretendimin e tyre se fetarët janë fanatikë. Allahu na dhëntë urtësinë dhe forcën e karakterit për ta shfaqur fenë që na ka dhënë si udhërrëfyes në dritën e saj më të mirë.

Përktheu: Nexhat Ibrahim

Burimi: Muhammad Legenhausen, *New Atheism and Islam*, në: <https://www.islamicity.org/81813/?referer=ecast>.

Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (8)

VEPRAT “EL BIDAJEH” DHE “EL HIDAJEH” TË MERGINANIT

Hazir D. Selmani


Qyteti Merginan (sot: Margilon, Uzbekistan) i ndodhur në krahinën Fergana është një vendbanim shumë i lashtë. Themelet e para të tij u patën vënë nga Aleksandri i Madh. Më vonë, me arritjen e Islamit në ato troje, ky qytet u kthye në një qendër të madhe diturie. Një numër i madh dijetarësh – sidomos hanefi – u njohën me mbiemrin gjeografik *Merginani*, që tregonte origjinën ose banimin e tyre në këtë qytet. Kështu p.sh., kemi Nidhamudin Merginani, Dhahirudin Merginani, Dijaudin Merginani, Alaudin Merginani, Burhanudin Merginani, etj.. Ky i fundit është autori i “*El Bidajeh*” dhe “*El Hidajes*”, doracakët e fikhut hanefi për të cilët do të diskutohet në vijim.

1. KUSH ËSHTË BURHANUDIN MERGINANI?

Për jetën e tij nuk ka edhe aq shumë të dhëna. Familja e tij ishte me gjenezë nga Ebu Bekri r.a.. Emri i tij i plotë është Ebul Hasen Ali b. ebi Bekër b. Abdilxhelil el Fergani el Rishdani el Merginani. Lekneviu është i vetmi që jep një datë për lindjen e tij, i cili duke u mbështetur në ca dorëshkrime thotë se ai lindi në vitin 511 hixhri (1117 gregorian).¹ Dhehebiu në Sijer-in e tij e përshkruan kështu: “Merginani, alamet dijetari dhe alimi i zonave të Maveranehrit. I njohur si Burhanudin Ebul Hasen Ali bin ebi Bekër bin Abdilxhelil el Merginani el Hanefi. Autor i “*El Hidajes*” dhe “*El Bidajes*” në medhheb (të hanefive). Ndonëse jetoi në këto kohëra, neve

nuk na kanë arritur historitë e tija edhe pse ishte prej fuçive të dijes, Allahu e mëshiroftë!”² Mësuesit e tij ishin të shumtë, saqë ai për vete pati shkruar edhe një libër të veçantë të zhanrit “*El Meshiha*” (shq. Koleksioni i mësuesve), siç ishte zakoni i dijetarëve të hadithit. Kumilaj, duke u mbështetur në burime të ndryshme biografike, liston 32 dijetarë të mëdhenj si mësues më të dalluar të Merginanit. Disa prej tyre janë:³ Shejhu’l-islam Ispixhabi, komentuesi i Muhtesar Tahaviut; Ebu Bekër b. Abdilxhelil Merginani, i ati i Merginanit; kadiu Omer el Zeranderamasi, gjyshi i tij nga e ëma; dijetari i madh Nexhmudin Nesefiu, autori i Akaidu’n Nesefijeh, Kadihani, autori i koleksionit të fetfave Fetava Kadihan, etj..⁴ Më vonë do të njihet si Shejhu’l-islam Burhanudin (shq.: Hoxha i islamit dhe argumenti i dinit) si dhe edhe më tepër si “Autori i Hidajes”. Madje, ai u bë aq i ditur saqë arriti nivelet më të larta shkencore edhe mbi vetë mësuesit e tij dhe dijetarët e tjerë bashkëkohëtar dhe që të gjithë dorëzoheshin para (dijes së) tij, sidomos pas shkrimit të veprave “*El Hidajeh*” dhe “*Kifajetu’l-Muntehi*”.⁵ Burhanudin Merginani krahas fikhut ishte ekspert i niveleve më të larta edhe në shumë shkenca të tjera islame si: Gjuhë, Tefsir, Hadith, etj.. Merginani dhe fikhu i tij zënë majat më të larta të dijetarëve dhe dijeve hanefite. Sipas Ibën Kemal Pashës dhe Kënallëzades, ai numërohet në shkallën e 5-të të fukahave hanefi (as’habu’t-Terxhihi mine’l-mukalidin). Ndërsa, Kefeviu gjykon ndryshe dhe atë e numëron në shkallën e

Burhanudin Ebul Hasen Ali el Merginani (1117–1197) konsiderohet një nga autoritetet më të mëdha të medhhebit hanefi. I njohur gjerësisht si “Autori i Hidajes”, ai fitoi famë të veçantë me veprën monumentale *El-Hidaje*.



4-tërt (as'habu't-Tehrixhi mine'l-mukalidin). Më vonë, Merxhani, Lekneviu dhe Keutheriu atë e numërojnë në shkallën e Kadihanit, pra shkallën e 3-të (muxhtehidët medhhebor)⁶ dhe për këtë gjë plotësisht kanë të drejtë. Merginani, pas një jete plot e përplot me dije, sakrificë dhe shkrime, vdiq në vitin 593 hixhri (1197 gregorian). Trupi i tij u bart deri në Samerkand për t'u varrosur në "Varrezën e Muhamedëve", ku ishin të varrosur veçanërisht rreth 400 dijetarë – kryesisht hanefi – me emrin Muhamed. Mirëpo, përgjegjësit e kësaj varreze nuk lejuan që Merginani të varrosej aty, për shkak se emri i tij nuk ishte Muhamed. Varrimi i tij u bë atypari përkaj kësaj varreze.⁷ Ai, krahas shumë librave, pas vetes la edhe një numër të madh nxënësish dijetarë si: Zernuxhi, pedagogu dhe fakihu madh, autori i veprës "Te'alimu'l-mutealim"; Shemsu'l-eimeh Kerderi, mësuesi i Ebu'l Berakat Nesefiut; Ushrusheniu, etj.. Njashtu në mesin e nxënësve të tij të shquar ishin edhe tre djemtë e tij: Imadudini, i vrarë nga tatarët, i cili ishte edhe i ati i autorit të veprës "Fusulu'l-imadi"; Omeri, që është autori i librit "Xhevahiru'l Fikh" dhe "El Fevaid", si dhe djali i tretë Shejhu'l-islam Muhamed Merginani, i cili pas babait u bë koka e hanefive të atyre trojeve.⁸

2. VEPRAT E MERGINANIT

Merashliu numëron 14 vepra të Merginanit, ndërsa dr. Bekdashi, 12:⁹ 1. Daracaku fikhor Bidajetu'l Mubtedij, i botuar në një vëllim; 2. Koleksioni me fetfatë hanefive të vonshëm me titull El Texhnisu ve'l-meqid, prej të cilit është botuar vetëm pjesa Ibadat-ëve në dy vëllime të mëdhenj; 3. El Zijadat, që llogaritet vepër e humbur edhe pse në El Hidajeh lexuesi orientohet disa herë për t'iu referuar asaj; 4. Sherhu'l Xhami'l Kebir, vepër e humbur; 5. Udetu'n Nasik fi iddeti'l-menasik, libër i humbur me tematikë haxhillëkun. Në El Hidajeh, autori jep informata për këtë vepër në fillim të kapitullit të haxhillëkut;¹⁰ 5. Feraidu'l uthmani, libër i botuar në rreth 50 faqe me tematikë e drejta trashëgimore islame; 7. Kifajetu'l Muntehi, koment shumë i madh dhe i zhdukur që prej shumë shekujsh; 8. Muhtaratu'n Nevazil (shq.: Përzgjedhje të çështjeve specifike të fikhut) libër tepër

i veçantë i botuar në një vëllim të madh, që në vete ngërthen mesele e përgjigje që nuk hasen dot në libra të tjerë; 9. Mu'xhemu'sh shujuh ose El Meshihah (shq.: Koleksioni i hoxhallarëve); 10. El Hidajeh sherhu Bidajeti'l Mubtedij, vepra e tij më madhore dhe njëherësh kryevepra fikhere e hanefive, për të cilën do të diskutohet shkurtimisht në vijim.

3. DORACAKU FIKHOR BIDAJETU'L MUBTEDIJ DHE KOMENTET E TIJ

Merginani fillimisht e shkroi përmbledhjen e tij fikhere Bidajetu'l Mubtedij (shq.: Nisja e fillestarit). Këtu bëri një përmbledhje të shkëlqyer të tekstit të El Xhamiu's Sagir të Shejbanit dhe tekstit të Muhtesar Kuduriut me ca shtesa të nevojshme. Si libër fikhu është i plotë me tërë kapitujt e fikhut, me përjashtim të kapitullit të së drejtës trashëgimore islame. Pastaj fakihu hanefi jemenas El Hamiliju (vd. 769 hixhri) mori tekstin e El Bidajeh dhe e vargëzoi në një poezi arabe me rreth 4500 vargje me titull Durru'l muhtedij nedhm Bidajeti'l Mubtedij. Pastaj më vonë, fakihu i shquar hanefi i Ahsasë në Arabinë Saudie, Ebu Bekër el Mulla el Ahsai (vd. 1270 hixhri/1853 gregorian) mori poezinë e Hamilijut dhe e rivargëzoi atë më shkurt dhe e titulloi Tuhfetu't Tulab. Doracaku El Bidajeh deri më tani ka pasur dy botime dhe më i miri llogaritet ai i dr. Bekdashit në rreth 600 faqe. Si doracak i fikhut hanefi mund të llogaritet prej llojit pak të komentuar dhe kjo për shkak të komentit El Hidajeh, që duket se mbylli derën për komentuesit e tjerë, meqë pas El Hidajeh të Merginanit gati-gati askush nuk pati guxim të shkruante më koment tjetër mbi këtë doracak. Mbi këtë doracak janë shkruar të paktën dy komente të drejtpërdrejta dhe dy të tjerë tërthorazi:

1. Kifajetu'l Muntehi (shq.: Libri i mjaftueshëm i ekspertit) i vetë Merginanit. Nganjëherë drejtlexohet edhe si Kifajetu'l Munteha (shq.: Libri i mjaftueshëm i nivelit të fundit). Koment gjigant 80 vëllimësh i Bidajes, të cilin autori nuk e përfundoi dot nga frika se nuk do të mund të shfrytëzohej nga hulumtuesit, shkak të vëllimit të tij të madh. Ky koment është zhdukur në vitet e pushtimit mongol.¹¹ Në Bibliotekën e Izmirit, dorëshkrimin nr. 166, që është kopje e El Hidajeh gabimisht është regjistruar si El Kifajeh. Në qarqet hanefite përflitet se në Pakistan, konkretisht në Bibliotekën "Kutubhaneh Gauthijeh (Makhдум Melik)" ekziston një pjesë dorëshkrimore e lashtë e El Kifajeh, që daton nga viti 628 hixhri. Merginani në El Hidajeh disa herë i referohet kësaj vepre dhe orienton lexuesin që për detaje tjera t'i kthehen asaj.

2. El Hidajeh fi sherhi Bidajeti'l Mubtedij (shq.: Udhëzimi në shpjegimin e fillimit të fillestarit). Për këtë do të diskutohet pak më vonë.

3. Siraxhu'l Dhalam ve Bedru't Temam sherh Mendhumeti'l Hamilij (shq.: Fanari i natës dhe Hëna e plotë – koment i Poemës së Hamilijut) me autor Hadadin, fakihun hanefi

jemenas (vd. 800 hixhri), i cili komentoi librin poetik të Hamilijut, të përmendur pak më parë.

4. Fet'hu'l Vehab sherhu Tuhfeti't Tulab (shq.: Ndihma e Allahut në komentin e dhuratës së nxënësve) me autor Husejn Meki Hanefiun, i cili komentoi librin poetik të Mulla el Ahsait. Këta dy komentet e fundit nuk janë komente të drejtpërdrejtë të El Bidajeh, por të versioneve poetike të tij.

4. DORACAKU FIKHOR EL HIDAJEH SHERHU BIDAJET'I MUBTEDIJ DHE KOMENTET E TIJ

El Hidajeh sherhu Bidajeti'l Mubtedij është komenti i dytë që Merginani e shkroi për doracakun e tij paraprak Bidajetu'l Mubtedij. Edhe El Hidajeh është libër i plotë fikhu me 57 kapituj, pa përfshirë atë të trashëgimisë (ar.: el Feraid). Si burim citohet me të madhe në literaturën fikhore islame. Llogaritet njëri prej librave doracakë më të komentuar në medhhebin hanefi, krahas Muhtesar Kuduriut dhe Multekasë së Halebiut. Shkrimi i kësaj vepre zgjati rreth 13 vjet dhe tërë këtë periudhë thuhet se Merginani e kaloi agjërueshëm. El Hidajeh ka mijëra dorëshkrime të vjetra nëpër bibliotekat islame. Ndërsa botime ka pasur me dhjetëra sosh dhe më i miri prej tyre tani për tani vlerësohet botimi i dr. Bekdashit. Për herë të parë u botua në vitin 1791 në Angli. Si libër është përkthyer në osmanisht, turqisht, persisht, urdu, anglisht dhe boshnjakisht. Në shqip, pjesën e Ibadat-ëve e ka përkthyer me shpjegime të nevojshme hoxha i njohur mr. Amet Memeti dhe së shpejti pritet edhe të botohet. Vepra El Hidajeh ka qenë pjesë e programit të shumë medreseve tradicionale islame dhe akoma vijon të jetë, sidomos në subkontinentin indian. Në Turqi akoma vijon të mësohet në medresetë e mirëfillta islame si p.sh. në zinxhirin e medreseve të Ismailagës kjo vepër mësohet komplet për 3 vjet, edhe atë në nivelin e specializimit fikhor. El Hidajeh nuk është vepër edhe aq e lehtë për t'u zbërthyer plotësisht pa mos iu referuar komenteve të saj, kjo shkak gjuhës së lartë të autorit si dhe imtësirave fikhore që Merginani ka përfshirë në fjalët dhe fjalitë e përdorura aty. Tregohet se, është pyetur Enver Shah el

Kashmiri (vd. 1352 hixhri/1933 gregorian), muhadithi, fakihu dhe alamet dijetari i shekullit të kaluar, se a jeni në gjendje ju personalisht të shkruani një libër në precizitet dhe studim si Fet'hu'l Kadiri i Ibën Humamit, dhe ai ka thënë se po. E si El Hidajeh? Ai ka thënë: Jo, madje as edhe disa rreshta. Ai gjithashtu ka thënë se, librit El Hidajeh nuk i gjendet dot shoqi në asnjërin medhheb për nga përmbledhja aq domethënëse dhe precize e tekstit medhhebor.¹² Për argumentet, metodologjinë dhe terminologjinë e Merginanit në El Hidajeh ka studime dhe libra të veçantë nga dijetarë të mëdhenj si Zejleiu, Ibën Haxher Askalani, Muhamed Avameh, etj.. Mirëpo ajo që vlen të përmendet këtu kalimthi është fakti që shpreh dr. Bekdashi se, autori në librin në fjalë ka përdorur rreth 1540 hadithe dhe aathare, si dhe në shumë mesele të tjera fikhore mjaftohet vetëm me argumentim logjik,¹³ kuptohet kur argumenti tekstual është lehtë i qasshëm nga dijetarët. Shkak vlerës dhe peshës së madhe kjo vepër vetëm në Hashijen e Ibën Abidinit përmendet e citohet afër 1 mijë herë. Kjo kryevepër e hanefive edhe pse vetë është libër i llojit koment (ar.: el sherh), ajo shikuar nga këndvështrimi i komenteve që janë shkruar mbi të, llogaritet libër doracak (ar. el metën). Pra, në të njëjtën kohë është edhe sherh i një libri paraprak edhe metën i shumë librave të mëvonshëm. Njëherësh edhe njëri ndër doracakët më të komentuar përgjatë historisë së medhhebit hanefi. Studiuesja Bintu Rahman shënon 45 komente (ar. El shuruh) dhe mbikomente (ar.: el havashi) të El Hidajes, nga ana tjetër Enciklopedia e Dijanetit të Turqisë shënon se mbi të janë shkruar 60 libra të llojit komente dhe mbikomente, ndërsa dr. Bekdashi liston rreth 100 vepra shuruh dhe havashi të shkruara mbi El Hidajeh.¹⁴ Tërë këto vetëm në arabisht, ndërsa në urdu numri i komenteve të El Hidajes shkon ndoshta deri 40 sosh. Duke marrë parasysh natyrën e zinxhirit të shkrimeve tona "Doracakët më të njohur të fikhut hanefi", këtu do të theksohen vetëm 10 komente të El Hidajeh:

1. El Feva'id me autor Hamidudinin e Verbër (vd. 666 hixhri). Njëherësh ky është komenti i parë i El Hidajeh. Kjo vepër më shumë ngjason me llojin e librave mbikoment (glos-hashijeh) dhe akoma është dorëshkrim. Hamidudin

El Hidajeh e Imam Merginanit konsiderohet një nga veprat më të rëndësishme dhe më me ndikim në historinë e fikhut hanefi. E shkruar përgjatë rreth trembëdhjetë vjetëve, kjo vepër u shndërrua në burim themelor për studiuesit dhe medresetë islame në mbarë botën myslimane.

Dariri është njëri prej mësuesve më të mëdhenj të Ebu'l Berakat Nese'fiut.¹⁵ Ai po me këtë stil dhe po me këtë titull ka edhe ca libra tjerë si: një koment të Kuduriut, një koment të El Fikh el Nafië të Semerkandit dhe një koment të Usulit të Bezdeviut.

2. Nihajetu'l Kifajeh fi dirajeti'l Hidajeh me autor Omer Taxhushieriatin (vd. 709 hixhri). Ky është komenti i dytë më i vjetër i El Hidajes. Së fundmi është botuar në 13 vëllime së bashku me Hashijen (mbikomentin) e Ibën Kemal Pashës mbi Hidajen.

3. El Nihajeh fi sherhi'l Hidajeh me autor Husamudin el Signaki (vd. 711 hixhri). Me tekstin e kësaj veprë në Universitetin Umm el Kurra të Mekës janë mbrojtur 25 punime masteri. Lekneviu e cilëson si njëri ndër komentarët më të zgjeruar të Hidajes, ndërsa para tij Ibën Abidini e cilëson si komenti i parë (më i zgjeruar dhe) më i plotë i Hidajes. Në vitin 2023, shtëpia botuese DKI e botoi në 11 vëllime me gjithsej 6840 faqe,

4. El Gajeh fi sherhi'l Hidajeh me autor Shemsudin el Serruxhi (vd. 710 hixhri). Autori në fjalë fillimisht i përkiste medhhebit hanbeli, pastaj u kthye në hanefi. Kjo gjë i jep vlerë edhe më të veçantë kësaj veprë shkak fikhut dypalësh të autorit. Libri konsiderohet enciklopedi fikhore-hadithore dhe thesar i argumentimit të hanefive. Autori vdiq para sa të përfundonte komentin në fjalë, ku komento i rreth 35% të El Hidajes. Komenti i tij është botuar në 14 vëllime të mëdhenj.

5. Mi'raxhu'd Dirajeh fi sherhi'l Hidajeh me autor Kivamudin el Kâkij el Huxhendi (vd. 749 hixhri). Kjo vepër është botuar në 8 vëllime të mëdhenj me rreth 7600 faqe.

6. Gajetu'l Bejan ve Nadiratu'z Zeman fi Aahiri'l-evan me autor Kivamudin Emir Katib el Itkani (vd. 758 hixhri), kryedijetari hanefi i Egjiptit të asaj kohe. Ky koment është arkë e argumentimit të hanefive dhe përgjigjeve shkencore ndaj kundër-argumenteve të medhhebeve të tjera. Veçori tjetër e këtij komenti janë citimet nga shumë vepra medhhebove hanefite tanimë të humbura si Muhtesar i Kerhit, Muxherrad i Lu'luiut, El Munteka i Hakim Shehidit, etj.. Në shumë burime cilësohet si koment shumë i gjatë dhe tejet i bukur e i veçantë. Së fundmi është botuar komplet në 17 vëllime.

7. El Kifajeh me autor Xhelaludin el Kurlani el Harizmi ose El Huvarizmi (vd. 767 hixhri). Ky është nxënësi i El Signakiut të sipërpërmendur. Në vitin 2019 është botuar në DKI në 8 vëllime me gjithsej 4300 faqe.

8. El Inajeh me autor fakihun dhe muhadithin hanefi Ekmeludin el Baberti (vd. 786 hixhri). Ky koment është prej më të atuaritetshmëve dhe është botuar në 6 vëllime me rreth 3800 faqe.

9. El Binajeh (nganjëherë drejtlexohet edhe si El Benajeh) me autor fakihun dhe muhadithin e madh hanefi Bedrudin el Ajni (vdiq 855 hixhri). Edhe kjo vepër prej më të

atuoritetshmëve në fikhun hanefi. Shkrimi i saj zgjati 33 vjet. Në botimin e DKI-së ka 13 vëllime me afër 6000 faqe.

10. Fet'hu'l Kadir li'l axhizi'l Fekir, me autor Ibën el Humam (vdiq 861 hixhri), që është njëri prej dijetarëve hanefi më të ditur dhe më të autoritetshëm, saqë thuhet se ai pati arritur derexhenë e ixhtihadit më të lartë në fikh. Njëherësh komenti i tij llogaritet kryevepra e tërë komenteve fikhore të El Hidajeh. Fatkeqësisht autori vdiq para se ta përfundonte atë tërësisht. Edhe kjo vepër është botuar nga DKI-ja në 8 vëllime në mbi 3000 faqe.

Për t'u habitur është fakti se sa dije e madhe dalka nga fshehtësitë e El Hidajes, ngase vetëm 10 komentet e sipërpërmendur bëhen 99 vëllime librash fikhu! (vijon inshallah)

- 1 Abdulhaj Leknevi, Mukadimetu'l Hidajeh (Karaçi: Idaratu'l-Kuran, 1996, botimi I, botuar bashkërisht me shënimet e tij anësore mbi El Hidajeh), f. 11.
- 2 Dhehebi, Sijeru Ealami'n Nubela (Bejrut: Muesesetu'r Risaleh, 1985, botimi III), vëll. 21, f. 232, bio. nr. 118.
- 3 Hafidhurrahman el Kumilaj, Ma jenbegi bihi'l inajeh li men jutaliu'l Hidajeh (Daka: Mektebetu Shejhi'l-islam, 2010, botimi I), f. 71; El Fejruzabadi, El Mirkatu'l Vefijeh fi Tabekati'l hanefijeh (Aman: Daru'l-Fet'h, 2024, botimi I), vëll. 1, f. 582, bio. nr. 1008.
- 4 Ibën el Hinai, Tabekatu'l Hanefijeh (Kerkuk: Mektebetu Emin, 2021, botimi I), f. 427, bio. nr. 155; Hazir Selmani, Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (2), (publikuar për herë të parë në Revista Dituria Islame, viti 2023, nr. 396, f. 37; Said Bekdash në hyrjen studimore të botimit të El Hidajeh (Medine: Daru's Siraxh, 2019, botimi I), vëll. 1, f. 23.
- 5 Mulla Ali Lexuesi, El Ethmaru'l xhenijeh fi esmai'l hanefijeh (Bagdad: Divanu'l-vekf'i-sunij, 2009, botimi I), vëll. 2, f. 522, bio. nr. 414; El Mirkatu'l Vefijeh, vëll. I, f. 582; Ibën Dukmak, Nedhmu'l Xhuman fi tabekati es'habi imamine'n Nu'man (Bejrut: Daru Ibën Hazëm, 2024, botimi I), vëll. 4, f. 162, bio. nr. 777.
- 6 Për derexhenë medhhebove të Merginanit shiko: Ibën Kemal Pasha, Tabekatu'l fukaha. (Kuvajt: Revista shkencore Mexheletu'sh Sheriah ve'd dirasati'l islamijeh, 2016, nr. 106), f. 479; Tabekatu'l Hanefijeh, f. 427; El Kefevi, Ketaibu Ea'lami'l-ehjar min Fukahai Medhhebi'n Nu'mani'l Muhtar (Stamboll: Mektebetu'l-irshad, 2017, botimi I), vëll. 3, f. 16; Shihabudin Merxhani, Nadhuratu'l Hak. (Aman: Daru'l-fet'h, 2012), f. 211; Zahid Keutheri, Husnu't Tekadi. (Aman: Daru'l fet'h, 2017, botimi I), f. 236; Leknevi, El Fevidu'l Behijeh fi teraxhimi'l hanefijeh (Bejrut: Daru'l-Erkam, 1998, botimi I), f. 230, bio. nr. 278.
- 7 Abdulkadër Kurashi, El Xhevahiru'l Mudijeh fi tabekati'l hanefijeh. (Hajderabad: Mexhlisu Dairati'l Meaarif, 1914), vëll. 1, f. 4 dhe vëll. 1, f. 383.
- 8 Ma jenbegi bihi'l inajeh li men jutaliu'l Hidajeh, f. 44.
- 9 Jusuf el Mer'ashli, Mesadiru'd Dirasati'l islamijeh el fikhu'l hanefiju furuan ve usulen (Bejrut: DKI, 2020, botimi I), vëll. 1, f. 320-323; Said Bekdash në hyrjen studimore të botimit të El Hidajeh, f. 24-32.
- 10 Hazir Selmani, Vështrim i shkurtër i librave të veçantë të haxhit në medhhebin hanefi, (publikuar për herë të parë në revistën Dituria Islame, viti 2024, nr. 403, f. 23).
- 11 Kasim Kutlubuga, Taxhu't Teraxhim (Damask: Daru'l Kalem, 1992, botimi I), f. 207; El Ethmaru'l-xhenijeh fi esmai'l hanefijeh, vëll. 2, f. 523.
- 12 Selma bint Muxhiburrahman, El Hadi ila rijadi'l-fikhi ve'l fukaha (Timergara: Mektebetu'l-imam Muhamed bin Hasen Shejbani), f. 262.
- 13 Said Bekdash në hyrjen studimore të botimit të El Hidajeh, vëll.1, f. 84
- 14 El Hadi ila rijadi'l-fikhi ve'l fukaha, f. 267; Said Bekdash në hyrjen studimore të botimit të El Hidajeh, vëll. 1, f. 103; Grup autorësh, TDV Islam Ansiklopedisi, (Stamboll: Türkiye Diyanet Vakfı, 1998), vol. 17, f. 472.
- 15 Shiko: El Fevidu'l Behijeh fi teraxhimi'l hanefijeh, f. 211; Hazir Selmani, Ebu'l Berakat Nese'fiu - jeta dhe vepra, (Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame, punim diplome bachelor i pabotuar, 2014), f. 23.

Identiteti islam i Bashkimit Evropian

Enis Reçica

Kontinenti evropian është i banuar kryesisht nga popullsi me përkatësi fetare të krishterë katolike, nga banorët e së cilës u formua edhe Bashkimi Evropian. Shpesh diskutohet për rolin e fesë së krishterë në formimin e kësaj strukture evropiane, duke theksuar se identiteti evropian anon nga kultura e krishterë. Kjo lidhet me faktin se të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë popullsi kryesisht të krishterë. Për shembull, Aurel Plasari, e përkufizon identitetin evropian si të lidhur thellësisht dhe rrënjësisht me krishterimin latin (Grup autorësh, Identiteti Evropian i Kosovës, Simpozium ndërkombëtar, 2007). Madje, në vitin 2004, kur u propozua krijimi i një Kushtetute Evropiane, Vatikani kritikoi faktin që aty nuk u përmendën “rrënjët e krishtera të Evropës”. Kjo çështje ishte në kundërshtim me synimet evropiane, pasi me lindjen e konceptit të të drejtave të njeriut dhe me përpjekjet për tolerancë fetare, Bashkimi Evropian ndau qartë shtetin nga kisha. Megjithatë, me rritjen e popullsisë së feve të tjera, veçanërisht asaj islame në Evropë, shumë autorë shprehën të shqetësuar se “identiteti i krishterë i Evropës është nën kërcënim” (Kinsman Jeremy, With Paris attacks, Europe’s identity crisis deepens, 2015).

Arsyeja e frikës së disa evropianëve nga myslimanët është e shumanshme. Fillimisht, kur u krijua Bashkimi Evropian, shtetet anëtare kishin popullsi kryesisht të krishterë. Me kalimin e kohës dhe për shkak të shtimit të lëvizjeve të popullsisë (sidomos pas Luftës së Dytë Botërore), ndryshimet demografike kanë sjellë rritje të numrit të qytetarëve të BE-së me përkatësi fetare myslimane. Evropianët janë mësuar historikisht të

identifikohen me kishën si objekt fetar dominues, dhe prania e objekteve të tjera fetare u duket shpesh si e huaj. Për këtë arsye, disa shtete evropiane e kanë të vështirë ta pranojnë identifikimin me një religjion tjetër përveç krishterimit. Sidomos, Islamin e shohin si një kulturë që lidhet me Lindjen dhe shpesh mendojnë se kjo fe nuk mund të përshtatet me rrethanat politike, ekonomike dhe sociale të BE-së. Kjo ndjenjë ushqen frikën ndaj myslimanëve, pasi ata identifikohen më shumë me religjionin e tyre sesa me identitetet shtetërore. Për më tepër, bazat e jetesës së tyre shpesh i mbështesin në Kuran dhe në thëniet profetike, gjë që për disa evropianë krijon ndjesinë e një distance kulturore e sociale, pasi veprimtaria e evropianëve bazohet në traktatet dhe rregulloret njerëzore të Bashkimit Evropian. Prandaj edhe autori Ferid Muriqi, thotë se “myslimanët e Evropës veten e identifikojnë shumë më tepër nëpërmjet përkatësisë fetare, sesa nëpërmjet asaj nacionale, dhe kjo shumë më tepër e më shpesh sesa cilido grup tjetër etnik, nacional apo fetar në Evropë” (Ferid Muhiq, Identiteti Islam i Evropës, 2013). Kjo nuk do të thotë se myslimanët e Evropës janë kundërshtues ose përjashtues të normave njerëzore të institucioneve evropiane. Ata i respektojnë ato, teksa jetojnë brenda kësaj bashkësie.

Në anën tjetër, ka shumë autorë që nuk e pranojnë idenë se Bashkimi Evropian është ndërtuar mbi vlerat katolike. Megjithatë, është e qartë se Kishës Katolike i është dhënë një status i veçantë si në Traktatin e Lisbonës, ashtu edhe në Kushtetutën Evropiane (që nuk u miratua), duke e dalluar nga objektet ose bashkësitë fetare të tjera. Për këtë arsye, Evropa shpesh e konsideron fenë katolike si të veten.

Në vitin 2004, kur u propozua krijimi i një Kushtetute Evropiane, Vatikani kritikoi faktin që aty nuk u përmendën “rrënjët e krishtera të Evropës”. Kjo çështje ishte në kundërshtim me synimet evropiane, pasi me lindjen e konceptit të të drejtave të njeriut dhe me përpjekjet për tolerancë fetare, Bashkimi Evropian ndau qartë shtetin nga kisha.

Nga Andaluzia myslimane në Spanjë, e deri te Ballkani nën Perandorinë Osmane, Islami ka lënë gjurmë të thella në kulturën, shkencën dhe jetën shoqërore evropiane. Përmes kontributeve në fusha si matematika, mjekësia dhe astronomia, si dhe përmes bashkëjetesës me traditat lokale, ai është bërë pjesë e mozaikut historik të kontinentit.

Në të vërtetë, të gjitha fetë monoteiste, judaizmi, krishterimi dhe islami, nuk janë fe evropiane, pasi origjina e tyre gjendet jashtë kufijve të kontinentit evropian, në Lindjen e Mesme. Megjithatë krishterimi është përvetësuar dhe bërë pjesë thelbësore e identitetit evropian, myslimanët kanë qenë pjesë e Evropës për më shumë se 1300 vjet (Ferid Muriq, 2013). Si rezultat, Islami gjithashtu ka ndikuar në formësimin e identitetit evropian. Edhe Samuel Huntington vë në dukje se fetë kryesore janë krijuar jashtë Evropës, por megjithatë, ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndërtimin e identitetit kulturor dhe historik të kontinentit. Kështu ai thotë se “fetë e mëdha të botës janë që të gjitha prodhim i qytetërimeve joperëndimore dhe në shumicën e rasteve si kohë janë përpara qytetërimit Perëndimor” (Samuel Huntington, Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror, 2009). Meqenëse fetë janë shumë më të hershme se qytetërimet dhe vetë shtetet-kombe, kjo tregon qartë se ato luajnë një rol të madh në formësimin e identitetit të çdo kombi.

Rrjedhimisht, religjionet zënë një vend të rëndësishëm edhe në veprimtarinë dhe strukturën e Bashkimit Evropian.


Islami, si religjion, e si komunitet, erdhi në kontinentin evropian në vitin 711, vit, ky që konsiderohet fillimi i pranisë myslimane në Iberi (Spanjë dhe Portugali) me hyrjen e myslimanëve në Al Andalus. Si rezultat, ky religjion ka pasur një ndikim të rëndësishëm në kulturën e këtij kontinenti. Ardhja e myslimanëve nga Gadishulli Arabik në Evropë ndodhi kryesisht për shkak të profesionit të tyre si tregtarë. Lëvizjet tregtare nëpër botë i çuan arabët edhe në kontinentin evropian. “Myslimanët arritën në Evropë përmes Spanjës (711 e.r./94 h.) dhe Sicilisë (831 e.r./215 h.), ndërsa më vonë edhe përmes Ballkanit (shek. XI e këtëj)” (Rejhan Neziri, Islami dhe Myslimanët në Perëndim). Gjithashtu, qeverisja e myslimanëve në një shtet evropian, siç ishte Andaluzia, për

afro 800 vjet, luajti një rol të madh në përhapjen e kulturës dhe identitetit islam jo vetëm në Spanjë, por edhe më gjerë. Në atë kohë, myslimanët ishin të njohur për profesionin e tyre si tregtarë, dhe përmes kësaj veprimtarie, ata udhëtonin dhe vendoseshin në vende të ndryshme.

Me qeverisjen e Andaluzisë në Spanjë, myslimanëve u është ofruar një stabilitet dhe siguri e madhe për të zhvilluar tregtinë me vendet e tjera evropiane. Në këtë mënyrë, ata patën mundësinë ta përhapin identitetin e tyre ndër popujt evropianë. Qytete si Kordoba dhe Granada u bënë qendra të dijes ku u përkthyen dhe u ruajtën veprat e Aristotelit dhe Platonit, ndërsa mendimtarë si Ibën Rushdi dhe Ibën Sinai ndikuan drejtpërdrejt në formimin e mendimit evropian. Pa këtë urë kulturore, shumë nga themelet e Rilindjes Evropiane do të kishin qenë më të brishta.

Spanja përbën rastin e parë ku një shtet evropian është udhëhequr nga myslimanët për rreth 800 vjet, deri në momentin kur “feja islame në mbretërinë spanjolle u abrogua me dekretin e Ferdinandit dhe Izabelës në vitin 1502/908 H” (Arnold, W. Thomas, Përhapja e Islamit në mesin e të krishterëve të Spanjës, 17.08.2009). Pas kësaj, përhapja e Islamit vijoi në Ballkan. Në aspektin politik dhe historik, prania myslimane në Evropë ka marrë forma të ndryshme. Perandoria Osmane, për shembull, përmes figurave si Sulejmani i Madhërishtë, ndikoi në hartën politike të Evropës Juglindore për shekuj me radhë. Në këtë hapësirë, përfshirë Ballkanin, Islami u bë pjesë e identitetit kulturor të popujve vendas, duke krijuar një ndërthurje unike midis traditave lokale dhe besimit fetar. Diçka e tillë ndodhi

Përqindja e myslimanëve në çdo shtet evropian



Sot, rreth 25 milionë myslimanë jetojnë në vendet e Bashkimit Evropian, duke përbërë afërsisht 5% të popullsisë së përgjithshme. Të pranishëm në të gjitha sferat e jetës publike, ata kontribuojnë në ekonomi, kulturë, sport dhe politikë, duke u bërë pjesë integrale e shoqërive evropiane.

veçanërisht në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Këto raste dëshmojnë se Islami ka depërtuar në kontinentin evropian që prej kohësh dhe ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme në formimin e identitetit të këtij kontinenti, duke përfshirë edhe vetë identitetin e Bashkimit Evropian. Ndikimi nuk ishte vetëm intelektual. Në fushën e shkencës dhe teknologjisë, bota islame solli përparime në matematikë, mjekësi dhe astronomi. Terma si “algjebër” dhe metoda të reja në mjekësi u përhapën në universitetet evropiane përmes kontakteve me botën myslimane.

Kjo që shpjegojmë përfaqëson vetëm një pjesë të historisë, ku dëshmohet roli i fesë islame në formësimin e kulturës dhe identitetit në Evropë. Si rezultat i kësaj trashëgimie islame, deri në ditët e sotme është rritur ndjeshëm prania e myslimanëve në Evropë. Aktualisht, sipas matjeve të fundit, nga agjencitë statistikore, në vendet e Bashkimit Evropian, jetojnë rreth 25 milionë myslimanë, apo afër 5% e popullsisë totale që jetojnë në këto vende. Në Francë jetojnë afër 9% myslimanë (apo afër 6 milionë), në Suedi rreth 8%, në Holandë 7%, në Gjermani 6%, Bullgari

11%, të popullsisë së përgjithshme të këtyre vendeve evropiane, ku të gjitha janë anëtare në Bashkimin Evropian. Përqindje të tilla shfaqen edhe te shtetet anëtare tjera të BE-së. Sot, komunitetet myslimane janë pjesë integrale e shoqërive evropiane, duke kontribuar në ekonomi, kulturë, sport dhe politikë. Qytete si Parisi, Berlioni dhe Londra janë shembuj të një Evrope multikulturore ku Islami është një nga komponentët e rëndësishëm të diversitetit.

Pavarësisht jetesës ose bashkëjetesës midis popullsisë islame dhe asaj evropiane, ekzistojnë disa dallime mes këtyre dy civilizimeve. Myslmanët kanë tendencën që ta identifikojnë veten më shumë përmes religjionit të tyre, duke ndjekur rregullat e jetesës të përcaktuara në librin e tyre të shenjtë, Kuranin dhe në thëniet profetike. Ndryshe nga kjo,



evropianët priren të përshtaten kryesisht me rregullat ligjore të hartuara nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që myslimanët nuk i respektojnë Traktatet e BE-së apo aktet e tjera ligjore.

Dallimet ndërmjet dy identiteteve, atij islam dhe atij evropian, po e bëjnë këtë të fundit të mos e pranojë identitetin islam si pjesë të “familjes” evropiane. Në këtë kontekst, Ferid Muriqi, në librin e tij Identiteti Islam i Evropës (2013), thekson se Evropa ka një të kaluar islame, por identiteti islam po tentohet të harrohet dhe të refuzohet nga Evropa bashkëkohore. Kjo qasje ka sjellë përplasje midis taborëve islamë dhe atyre evropianë, veçanërisht në çështje të ndjeshme si pranimi i Turqisë në Bashkimin Evropian. Sipas grupeve proislame, arsyeja kryesore që Turqia nuk pranohet në BE është fakti se ky vend ka një popullsi me shumicë myslimane, çka shihet si pengesë në harmonizimin me identitetin evropian të perceptuar. Ndoshta pikërisht nga arsyeja e frikës së pranimi të Turqisë, dhe pse jo edhe të vendeve ballkanike, në Bashkimin Evropian, gazetarja italiane Oriana Fallaci ka shkruar se “Evropa po bëhet gjithnjë e më tepër një krahinë e Islamit, një koloni e Islamit” (Enis Sulstarova, Jam Evropë!, 2012). Kjo frikë buron nga fakti se me anëtarësimin e plotë të Turqisë në BE, rreth 85 milionë banorë, të cilët janë kryesisht myslimanë, do të bëheshin pjesë e “familjes” evropiane, ku përkatësia katolike mbetet historikisht dominante. Kjo situatë shihet si një sfidë për identitetin tradicional evropian dhe strukturat e tij kulturore.

Brezi i ekraneve – fëmijët në epokën digjitale

Dr. Flora Hajdarmataj

Përdorimi i pakontrolluar ose i tepruar i pajisjeve digjitale mund të shoqërohet me sfida të ndryshme që lidhen me zhvillimin emocional, social dhe fizik të fëmijëve.

Gjenerata digjitale është një brez i veçantë që rritet i rrethuar nga teknologjia, duke ndryshuar mënyrën se si mëson, mendon dhe ndërvepron me botën. Teksa përdorimi i pajisjeve digjitale sjell mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim dhe kreativitet, ai kërkon gjithashtu udhëheqje, kufij dhe modele të përshtatura arsimore. Për t'i ndihmuar fëmijët të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për jetën moderne, prindërit, edukatorët dhe institucionet duhet të krijojnë mjedise mësimore interaktive, të balancuara dhe kreative. Vetëm përmes kombinimit të teknologjisë me vëmendjen ndaj zhvillimit emocional, social dhe kognitiv të fëmijëve, mund të ndërtojmë një brez fleksibil, inovativ dhe i aftë të përballojë sfidat e shpejta të epokës digjitale.

TË NJIHEMI ME GJENERATËN DIGJITALE

Në shoqërinë bashkëkohore po rritet një gjeneratë e re fëmijësh që, që në moshë shumë të hershme, janë në kontakt të vazhdueshëm me teknologjinë. Pajisjet digjitale, si telefonat inteligjentë, tabletët dhe qasja e përhershme në internet, janë bërë pjesë integrale e përditshmërisë së tyre. Për këtë arsye, kjo gjeneratë shpesh përkufizohet si “gjenerata digjitale” ose “fëmijët e epokës digjitale”. Ndryshe nga brezat e mëparshëm, këta fëmijë mësojnë të ndërveprojnë me ekranet pothuajse paralelisht me zhvillimin e aftësive bazë të komunikimit, si të folurit dhe të lexuarit.

Zhvillimi i teknologjisë u ofron fëmijëve mundësi të shumta për të mësuar, për të komunikuar dhe për t'u argëtuar. Megjithatë, përdorimi i pakontrolluar ose i tepruar i

pajisjeve digjitale mund të shoqërohet me sfida të ndryshme që lidhen me zhvillimin emocional, social dhe fizik të fëmijëve. Për këtë arsye, është thelbësore që prindërit, edukatorët dhe institucionet arsimore ta kuptojnë më mirë këtë gjeneratë dhe të gjejnë mënyra të përshtatshme për ta orientuar drejt një përdorimi të shëndetshëm dhe të balancuar të teknologjisë.

Një moment i rëndësishëm që ndikoi në rritjen e përdorimit të teknologjisë ishte periudha e pandemisë së Covid-19. Gjatë kësaj kohe, kur një pjesë e madhe e popullsisë u detyrua të qëndronte në shtëpi, përdorimi i pajisjeve digjitale u rrit ndjeshëm. Në këtë kontekst, edhe fëmijët u lidhën më shumë me telefonat dhe pajisjet e tjera elektronike. Pavarësisht shkaqeve që e kanë nxitur këtë proces, varësia e fëmijëve nga ekranet e telefonave apo tabletëve është bërë një fenomen që ngre shqetësime të rëndësishme shoqërore dhe pedagogjike. Në literaturën bashkëkohore ky fenomen shpesh përkufizohet si “varësi nga interneti” ose “varësi nga smart-phonet”. Për rrjedhojë, një nga pyetjet kryesore që shtrohet sot është se si mund të menaxhohet dhe të reduktohet përdorimi i tepruar i pajisjeve digjitale te fëmijët.¹

Në të kaluarën, prindërit shpesh përballeshin me vështirësinë për t'i kthyer fëmijët nga lojërat në rrugë ose në lagje, ndërsa sot sfida kryesore është t'i shkëpusin ata nga ekranet. Krahasuar me dekadat e mëparshme, përqindja e fëmijëve që luajnë rregullisht jashtë është ulur ndjeshëm. Shumë fëmijë duket sikur kanë humbur kontaktin me format tradicionale të lojës në oborr apo në lagje. Për shumë prej tyre, dita fillon me përdorimin e telefonit, i cili shërben si burim

Në hapësirat digjitale shpesh krijohet një kulturë e vetëprezantimit, ku individët përpiqen të shfaqin një version të idealizuar të jetës së tyre, duke nxitur kështu nevojën për vëmendje dhe miratim nga të tjerët.



i menjëhershëm informacioni, argëtimi dhe komunikimi.

Madje, në ditët e sotme, edhe kërkimi i informacionit të thjeshtë nuk realizohet gjithmonë përmes motorëve të kërkimit, por gjithnjë e më shpesh përmes aplikacioneve të bazuara në inteligjencën artificiale. Kjo tregon se gjenerata digjitale jo vetëm që përdor teknologjinë në

mënyrë intensive, por edhe zhvillon forma të reja të ndërveprimit me informacionin. Megjithatë, ky realitet ngre disa pyetje thelbësore: si mund t'i largojmë fëmijët nga përdorimi i zgjatur i telefonave? Si mund të nxitet leximi i librave dhe aktivitete të tjera zhvilluese? Dhe si mund të arrihet kjo kur edhe vetë prindërit shpesh janë të përfshirë në përdorimin e vazhdueshëm të pajisjeve digjitale?

Në këtë kuptim, sfida nuk u përket vetëm fëmijëve, por edhe të rriturve. Nëse synohet që fëmijët të lexojnë më shumë, të luajnë jashtë ose të kalojnë më shumë kohë me familjen, është e domosdoshme që edhe prindërit të shërbejnë si modele pozitive. Kjo nënkupton krijimin e alternativave të shëndetshme në një realitet ku teknologjia është e pranishme kudo: interneti është i qasshëm pothuajse në çdo hap, sinjalet Wi-Fi janë të përhapura gjerësisht dhe ekranet janë bërë pjesë e pandashme e jetës së përditshme.

Megjithatë, pavarësisht këtyre transformimeve, përgjegjësia kryesore mbetet te të rriturit - prindërit, mësuesit dhe kujdestarët. Ata duhet të punojnë në mënyrë të vazhdueshme me fëmijët, të ndajnë me ta përvojën jetësore dhe të përpiqen të kuptojnë më mirë realitetin shoqëror dhe teknologjik në të cilin ata po rriten. Vetëm përmes një kuptimi të thellë të ndikimit që teknologjia ka në zhvillimin mendor dhe emocional të fëmijëve mund të krijohen strategji efektive për

t'i udhëhequr drejt një përdorimi të balancuar dhe të përgjegjshëm të saj.

FORMIMI NË EPOKËN DIGJITALE

Transformimi digjital ka krijuar mundësi të shumta për brezin e ri, veçanërisht në fushën e informimit dhe komunikimit. Megjithatë, në të njëjtën kohë ai i ka vendosur të rinjtë përballë një rrjedhe të madhe informacioni, e cila shpesh është e pakontrolluar dhe përhapet me shpejtësi të madhe. Ky realitet i ri informativ po ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si formohen, socializohen dhe edukohen fëmijët dhe të rinjtë.

Që nga vitet 90-ta, me përhapjen graduale të internetit, komunikimi ndërmjet njerëzve u bë më i lehtë dhe më i shpejtë. Interneti krijoi mundësi të reja për shkëmbimin e ideve, për qasjen në informacion dhe për krijimin e lidhjeve me individë nga kultura dhe vende të ndryshme. Me kalimin e kohës, këto zhvillime filluan të transformonin jo vetëm mënyrën e komunikimit, por edhe mënyrën e jetesës së individëve. Pas viteve 2000, me shfaqjen dhe përhapjen e rrjeteve sociale si Facebook, Twitter dhe Instagram, komunikimi digjital mori një dimension edhe më të gjerë. Nëpërmjet një klikimi të vetëm, përdoruesit mund të lidhen me njerëz në pjesë të ndryshme të botës, të ndajnë informacione dhe përvoja, si dhe të ndërveprojnë në kohë reale.

Megjithatë, krahas përfitimeve të shumta që sjell zhvillimi teknologjik, shumë studiues të mediave dhe komunikimit kanë ngritur shqetësime lidhur me ndikimet e mundshme negative të kësaj bote digjitale. Përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale nga fëmijët dhe të rinjtë është shoqëruar, në disa raste, me uljen e interesit për leximin e librave, dobësimin e marrëdhënieve shoqërore dhe rritjen e përqendrimit te vetja. Për më tepër, në hapësirat digjitale shpesh krijohet një kulturë e vetëprezantimit, ku individët përpiqen të shfaqin një version të idealizuar të jetës së tyre, duke nxitur kështu nevojën për vëmendje dhe miratim nga të tjerët.

Por, kritikant ndaj brezit të ri që rritet në epokën digjitale nuk janë një fenomen i ri në historinë e zhvillimit të mediave. Gjatë periudhave të ndryshme historike, çdo mjet i ri komunikimi është shoqëruar me shqetësime të ngjashme nga shoqëria. Radioja, romanet grafike, televizioni dhe madje edhe librat, në periudha të caktuara, janë kritikuar me argumentin se mund të kenë ndikime negative në zhvillimin e fëmijëve. Në këtë kuptim, shqetësimet që shprehen sot për ndikimin e internetit dhe të teknologjisë mund të konsiderohen pjesë e një cikli historik të përsëritur që shoqëron çdo ndryshim të madh mediatic.

Në vend që përdorimi i teknologjisë nga fëmijët të kufizohet në mënyrë të plotë, një qasje më efektive konsiston në orientimin dhe edukimin e tyre për përdorimin e përgjegjshëm të saj. Fëmijët duhet të mësojnë të ndërtojnë një marrëdhënie të shëndetshme dhe kritike me teknologjinë, duke e përdorur atë si një mjet për zhvillim personal dhe arsimor.

Autori i librit “Growing Up Digital (Të rritesh në epokën digjitale)”, Don Tapscott,² i cili ka hyrë në listën e librave më të shitur të New York Times, thekson se shumë nga kritikant ndaj kulturës së brezit të ri dhe mediave që ata përdorin burojnë nga ndjenja e pasigurisë që shoqëron ndryshimin. Sipas tij, mendja njerëzore shpesh ka prirjen të shmangë ndryshimin dhe të frikësohet nga e panjohura, pasi është e vështirë të parashikohet plotësisht ndikimi i risive teknologjike në të ardhmen. Për këtë arsye, kritikant e ashpra ndaj marrëdhënies së brezit të ri me teknologjinë duhet të interpretohen edhe në kontekstin e frikës së shoqërisë ndaj transformimeve të shpejta.

Për ta kuptuar më mirë brezin e ri, është e rëndësishme të analizohen jo vetëm dallimet që ekzistojnë midis gjeneratave, por edhe elementet e përbashkëta që i lidhin ato. Në procesin e zhvillimit të fëmijëve, ashtu si në të kaluarën edhe sot, familja dhe sistemi arsimor mbeten faktorët më të rëndësishëm në formimin e tyre. Për këtë arsye, bëhet e domosdoshme që institucionet arsimore të zhvillojnë modele dhe sisteme mësimore të përshtatura me realitetin e epokës digjitale, në mënyrë që të mund të udhëheqin dhe mbështesin në mënyrë efektive zhvillimin e brezit të ri.

FËMIJËT MULTITASKING

Studimet tregojnë se fëmijët e epokës digjitale, deri në të njëzetat e tyre, ekspozohen rreth 30 mijë orë ndaj rrjedhës së informacionit digjital. Nga kjo kohë, rreth 20 mijë orë kalohen në internet dhe afërsisht 10 mijë orë në lojëra kompjuterike. Kjo kohë e konsiderueshme e kaluar me teknologjinë ngre pyetje të rëndësishme lidhur me ndikimin e saj në aktivitetet e trurit të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe në mënyrën se si ata mendojnë, mësojnë dhe përpunojnë informacionin.³

Sipas psikologut turk Kemal Sayar, kërkimet bashkëkohore në fushën e neuroshkencës tregojnë se zhvillimi i trurit nuk përfundon vetëm gjatë fëmijërisë, por vazhdon të formësohet gjatë gjithë jetës në varësi të kushteve mjedisore dhe përvojave

individuale. Aftësia e trurit për t'u përshtatur dhe për të ndryshuar në bazë të përvojave të reja – fenomen i njohur si plasticiteti i trurit – tregon se mjedisi në të cilin jetojnë individët dhe aktivitetet që ata kryejnë kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e tyre kognitiv. Të rinjtë dhe fëmijët që rriten në epokën digjitale shpesh zhvillojnë mënyra të ndryshme të të menduarit dhe të të mësuarit krahasuar me gjeneratat e mëparshme.⁴ Hulumtimet tregojnë se të rinjtë që luajnë rregullisht lojëra kompjuterike kanë një vëmendje vizuale më të zhvilluar dhe janë në gjendje të perceptojnë disa stimuj në të njëjtën kohë. Gjatë lojës, përdorimi i mausit dhe ndjekja e vazhdueshme e lëvizjeve në ekran ndihmojnë në zhvillimin e koordinimit sy-dorë dhe rrisin shpejtësinë e reagimit.

Gjithashtu, të rinjtë që rriten në një mjedis të mbushur me stimuj vizualë arrijnë të interpretojnë më shpejt ikonat, figurat dhe elementet grafike. Për këtë arsye, ata shpesh e përvetësojnë më lehtë informacionin që paraqitet në formë vizuale sesa atë që paraqitet vetëm në formë teksti. Materialet mësimore të përbëra vetëm nga teksti priren të tërheqin më pak vëmendjen e nxënësve, ndërsa materialet e shoqëruara me elemente vizuale rrisin interesin dhe e bëjnë procesin e të mësuarit më të shpejtë dhe më efektiv. Në të njëjtën kohë, fëmijët e epokës së internetit priren ta përvetësojnë informacionin në mënyra të ndryshme nga gjeneratat e mëparshme. Teksa brezat e mëparshëm preferonin një proces të të mësuarit të strukturuar dhe linear, ku njohuritë përvetësoheshin hap pas hapi, fëmijët e sotëm shpesh preferojnë të eksperimentojnë fillimisht dhe vetëm më pas të kërkojnë udhëzime për pjesët që nuk i kuptojnë. Kjo prirje tregon se teknologjia ka ndikuar në ndryshimin e mënyrës së të mësuarit dhe të përvetësimit të njohurive.

Në epokën digjitale, shumë fëmijë dhe të rinj janë mësuar të kryejnë disa aktivitete njëkohësisht. Për shembull, ata mund të bëjnë detyrat e shtëpisë ndërkohë që komunikojnë me miqtë përmes mesazheve, dëgjojnë muzikë ose shikojnë televizor. Kjo situatë shpesh i habit prindërit, pasi brezat e mëparshëm janë mësuar të përqendrohen vetëm në një aktivitet të vetëm në një moment të caktuar. Për fëmijët e sotëm, të cilët janë rritur mes telefonave inteligjentë, kompjuterëve dhe internetit, një mjedis me shumë stimuj të njëkohshëm është bërë pjesë e zakonshme e përditshmërisë. Megjithatë, studimet shkencore tregojnë se aftësia e njeriut për të kryer shumë detyra njëkohësisht është e kufizuar. Kur një person përpiket të realizojë disa aktivitete në të njëjtën kohë, truri në fakt nuk i përpunon ato paralelisht në mënyrë të plotë, por kalon vazhdimisht nga një detyrë në tjetrën. Ky proces kërkon kohë dhe energji mendore, duke bërë që aktivitetet të zgjasin më shumë dhe të rriten mundësia për gabime.

Për shembull, nëse një nxënës studion ndërkohë që kontrollon shpesh telefonin, ai duhet ta rikthejë përqendrimin çdo herë që ndërpritet. Kjo e ngadalëson procesin e të mësuarit dhe e bën më të vështirë përvetësimin e informacionit. Hulumtimet në fushën e neuroshkencës

tregojnë gjithashtu se multitasking mund të ndikojë negativisht në kujtesë dhe në procesin e të nxënës. Kur një nxënës studion ndërkohë që ka televizorin ndezur ose merr vazhdimisht mesazhe, informacioni i përvetësuar mund të ruhet në zona të trurit që lidhen me përpunim më sipërfaqësor të informacionit, dhe jo në ato që lidhen me kujtesën afatgjatë. Si pasojë, informacioni i mësuar mund të harrohet më lehtë.

GJENERATA E EKRANEVE

Sot të rinjtë mund të përkufizohen më mirë me termin “screenager” (ekran-gen). Ky term është përdorur nga psikoterapisti Dan Bloom për të përshkruar të rinjtë që janë vazhdimisht të lidhur me ekranet. Në këtë pikë duhet të theksojmë gjithashtu se brezi i sotëm përdor shumë më pak letër dhe laps në jetën e përditshme. Në të kaluarën, për të mësuar, njerëzit kthenin faqet e librave, ndërsa sot të rinjtë më shpesh lexojnë dhe mësojnë duke parë ekranin. Ky është një nga dallimet më të mëdha mes brezit tonë dhe brezit të ri. Teknologjia ndikon edhe në mënyrën se si truri vendos se cilit informacion t’i kushtojë më shumë rëndësi gjatë leximit. Finalisti i Çmimit “Pulitzer”, Nicholas Carr e krahason leximin nga libri me zhytjen në det. Zhytësi zbrit në një ambient të qetë, me lëvizje të ngadalta dhe me pak shpërqendrim, duke u përqendruar thellë në atë që sheh. Ndërsa leximi nga ekrani i ngjan vozisë me jet-ski: njeriu lëviz me shpejtësi në sipërfaqe, sheh shumë gjëra përreth, por për shkak të shpejtësisë mund të përqendrohet vetëm për pak çaste në secilën prej tyre.

Në një studim, pjesëmarrësve iu dhanë informacione për katër modele makinash. Gjysma e tyre i lexuan në ekran, ndërsa gjysma në letër. Kur u pyetën se cili model ishte më i mirë, 66% e atyre që kishin lexuar në letër dhanë përgjigjen e saktë, ndërsa vetëm 43% e atyre që kishin lexuar në ekran arritën ta bënë këtë. Studime të tjera tregojnë se njerëzit mësojnë më mirë nga materiali i lexuar në letër kur nuk ka shpërqendrim të tjera përreth. Edhe pse leximi i romaneve në e-reader mund të mos jetë problem, për studim dhe mësim shpesh është më e dobishme përdorimi i materialeve të shtypura. Studimet mbi përvojat fizike të leximit tregojnë se pozicioni i informacionit në faqe ndihmon në kujtesë. Njerëzit që kujtojnë mirë një tekst shpesh kujtojnë edhe ku ndodhej ai në faqe. Pamja fizike e faqes ndihmon memorien vizuale dhe e bën më të lehtë rikujtimin e informacionit.

Informacioni i lexuar në letër mësohet më shpejt dhe mbahet mend më gjatë sesa ai i lexuar në ekran. Pajisjet teknologjike si telefoni apo kompjuteri ofrojnë shumë aktivitete të tjera. Kur lexojmë në këto pajisje, shpesh tundoheni të kontrolloni internetin, emailin ose rrjetet sociale, sepse argëtimi është vetëm një klikim larg. Ndërsa libri është një objekt që kërkon vëmendje të plotë dhe nuk

Teknologjia ndikon edhe në mënyrën se si truri vendos se cilit informacion t’i kushtojë më shumë rëndësi gjatë leximit.

lejon aktivitete të tjera njëkohësisht. Studimet për mësimin nga interneti tregojnë se kjo mënyrë mund të ndikojë negativisht në kujtesë. Në një eksperiment pjesëmarrësve iu dha informacion për ta mbajtur mend. Për disa prej tyre u tha se informacioni do të ruhej dhe do të mund ta shihnin përsëri më vonë, ndërsa për të tjerët u tha se do të fshihej. Në fund të eksperimentit u pa se njerëzit kujtonin më mirë informacionin që mendonin se do të fshihej, ndërsa e harronin më shpesh atë që mendonin se mund ta gjenin përsëri. Ky fenomen quhet shpesh “efekti i Google-it” dhe lidhet me Google. Njerëzit nuk përpiqen të mbajnë mend informacionin sepse e dinë se mund ta gjejnë përsëri në internet. Si çdo aftësi që nuk përdoret, edhe kujtesa dobësohet me kalimin e kohës.

Sipas autorëve të librit “Fëmija Digjital”, Kemal Sayar dhe Sezin Benli, “screenager”-ët

– pra të rinjtë që janë rritur me ekrane dhe teknologji – nuk do t’i lënë pajisjet e tyre teknologjike në të ardhmen e afërt. Për këtë arsye, sipas tyre, qasja më e mençur nuk është ndalimi i teknologjisë, por përdorimi i saj në mënyrë të zgjuar dhe për qëllime edukative.⁵ Teknologjia nuk e ul gjithmonë performancën në të mësuar; përkundrazi, kur përdoret në mënyrë të duhur, ajo mund ta përmirësojë ndjeshëm procesin e të nxënës. Pajisjet digjitale mund të shndërrohen në mjete të dobishme për organizimin e kohës, për planifikimin e detyrave dhe për zhvillimin e aftësive të reja.

EDUKIMI QË DUHET TË PËRSHTATET ME KOHËN

Sistemi arsimor, edhe pse më ngadalë, po përpriqet të përshtatet me kërkesat e kohës. Përmes tabletëve dhe pajisjeve të tjera digjitale, materialet që mësohen në shkollë mund të përforcohen në shtëpi në mënyrë argëtuese dhe interaktive. Programet kompjuterike për mësimin e matematikës, për shembull, mund të identifikojnë kur nxënësi po mërzitet dhe të përcaktojnë kohën optimale të pushimit. Teknologjia ofron mundësi të jashtëzakonshme si për të mësuar gjëra të reja, ashtu edhe për të përforcuar njohuritë e fituara në shkollë.

Pajisjet teknologjike janë të dobishme kur përdoren si mjete plotësuese së bashku me teknikat e duhura të mësimdhënies. Një studim në Shtetet e Bashkuara mbi përdorimin e teknologjisë në arsim ka treguar se nxënësit që punojnë me ndihmën e programeve kompjuterike tregojnë përmirësim të performancës së tyre. Kjo ndodh sepse programet përshtaten me nivelin e njohurive dhe shpejtësinë e të mësuarit të nxënësit dhe informojnë mësuesit për performancën, në mënyrë që ata të ndërhyjnë kur është e nevojshme. Një tjetër gjetje e rëndësishme është se iniciativat që synojnë thjesht t’i pajisin të gjithë nxënësit me kompjuter



nuk kanë sjellë përmirësim të dukshëm në rezultatet e tyre. Kjo tregon se, përtej rritjes së qasjes në teknologji, është më e rëndësishme të zhvillohen modele arsimore të përshtatura me teknologjinë dhe më pas të pajisen nxënësit me mjetet e duhura për t'i realizuar këto modele.

Për fëmijët me mungesë përqendrimi, shpjegimi i disa lëndëve në formë loje mund të jetë një zgjidhje efektive. Një nxënës që normalisht nuk do të hapte librin e mësimit mund të angazhohet kur informacioni prezantohet në formë loje në kompjuter. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e vetëbesimit dhe të aftësisë për përvetësim të njohurive. Siç u përmend më parë, mënyra se si nxënësit mësojnë dhe përvetësojnë informacionin sot ndryshon nga ajo e brezave të kaluar. Prindërit shpesh vërejnë se fëmijët nuk e mësojnë mësimin gjatë orës, mërziten në klasë dhe hasin vështirësi me detyrat e shtëpisë. Nga ana tjetër, çdo vit shumë nxënës arrijnë rezultate të dobëta në provimet për kalimin në shkollë të mesme apo universitet. Megjithatë, nuk është e drejtë të fajësohet vetëm teknologjia ose lojërat kompjuterike për këto rezultate. Shumë edukatorë të përkushtuar punojnë me përpjekje të mëdha, por hendeuku ndërmjet mënyrës së të menduarit të fëmijëve të epokës digjitale dhe metodave tradicionale të mësimdhënies vazhdon të zgjerohet.

Ne, si prindër të fëmijëve të epokës digjitale, kemi përjetuar një jetë më lineare: shumica përfunduan shkollimin, u specializuan në një fushë dhe ndoqën rrugën e karrierës deri në pension. Në epokën digjitale, jeta është më dinamike; informacioni ndryshon me shpejtësi, fushat e punës evoluojnë vazhdimisht dhe ritmi i jetës është më i shpejtë dhe i paparashikueshëm. Për këtë arsye, një nga aftësitë më të rëndësishme që mund t'u ofrojmë fëmijëve është fleksibiliteti dhe aftësia për t'u përshtatur me kushtet e reja.

Në sistemin tradicional të arsimit, mësuesi transmetonte njohuritë dhe rrjedha e informacionit ishte njëdrejtimore. Fëmijët e epokës digjitale nuk preferojnë këtë qasje; ata kërkojnë mjedise mësimore interaktive, ku informacioni

diskutohet, ndahet dhe ku përmes mendimit kritik arrihet te njohuritë e reja. Modeli interaktiv kërkon një sistem arsimor ku mësimdhënia dhe të mësuarit ekzistojnë së bashku, ku nxënësit marrin pjesë aktive, ku krijohen ide të reja dhe ku teknologjia digjitale mbështet procesin e të nxënës. Klasat duhet të jenë vende diskutimi, ku mësuesi mëson dhe mëson së bashku me nxënësit, duke i inkurajuar ata të shprehin mendimet dhe të bashkëpunojnë.

Brezi digjital nuk pëlqen të ulet pasivisht në klasë; ata preferojnë të jenë aktivë, të diskutojnë dhe të lidhen me botën reale. Arsimi duhet të jetë argëtues dhe interesant, duke i përgatitur ata për një botë dinamike. Tony Ryan,⁶ autor i librit “Fëmija i brezit të ri – Udhëzues për rritjen e fëmijëve në epokën e teknologjisë”, e krahason sistemin aktual të arsimit me një katror: edhe pse mësuesit janë të mirë, modeli është i vjetër dhe bazuar në një koncept fabrikash. Sot nevojitet një sistem më i përshtatshëm për kohën moderne, më i rrjedhshëm dhe tridimensional, ku arsimi është një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë jetës, që kërkon zhvillim dhe inovacion të përhershëm.

Sipas Marc Prensky,⁷ ekspert amerikan i teknologjisë, njerëzit ndahen në dy grupe: “Vendasit digjitalë” dhe “Emigrantët digjitalë”. Vendasit digjitalë rriten me teknologjinë – internetin, kompjuterin dhe telefonin celular – dhe e përdorin si gjuhën e tyre të parë. Emigrantët digjitalë e mësojnë teknologjinë më vonë, duke e perceptuar atë si të huaj. Sot, shumica e fëmijëve janë vendas digjitalë, ndërsa shumica e prindërve janë emigrantë digjitalë, gjë që krijon herë pas here diferenca në kuptim dhe menaxhim të marrëdhënieve ndërbrezore. Roli i prindërve mbetet udhëzues, duke i kuptuar dhe mbështetur fëmijët.

Vendasit digjitalë karakterizohen nga vlerësimi i lirisë së zgjedhjes dhe fleksibilitetit, si në arsim ashtu edhe në punë. Ata preferojnë mjedise fleksibël dhe mundësi për zhvillim personal, nuk janë të lidhur me marka ose platforma të caktuara dhe adaptohen shpejt ndaj risive. Për këtë arsye, të kuptuarit e gjeneratës digjitale është thelbësor për komunikim efektiv, mbrojtje nga rreziqet dhe përdorim të shëndetshëm të teknologjisë. Njohja e shprehive, trendeve dhe mënyrës së mendimit të këtij brezi ndihmon në krijimin e urave ndërbrezore dhe ofron mbështetje të qëndrueshme për ta.

1 Sayar, K., & Yalaz, B. (2019). Ağ: Sanal dünyada gerçek kalmak. Kapı Yayınları.

2 Tapscott, D. (2008). Grown up digital: How the net generation is changing your world. McGraw-Hill Education.

3 Sayar, K., & Benli, S. (2020). Dijital çocuk. Kapı Yayınları.

4 Greenfield, S. A. (2014). Mind change: How digital technologies are leaving their mark on our brains. Random House.

5 Sayar, K., & Benli, S. (2020). Dijital çocuk. Kapı Yayınları.

6 Ryan, T. (2017). The next generation: Preparing today's kids for an extraordinary future. Wiley.

7 Prensky, M. (2001). Digital natives, digital immigrants. On the Horizon, 9(5).

Statusi ekonomik i gruas sipas Islamit

Anisa Hoti

Roli i gruas në zhvillimin ekonomik, paraqet një aspekt themelor të konceptit islam mbi balancën shoqërore. Islami e sheh gruan si pjesëmarrëse aktive në jetën ekonomike, duke i garantuar asaj të drejta në pronësi, punë apo trashëgimi.

Islami i ka dhënë dinjitet gjithë njerëzimit mbi tokë, pavarësisht nga dallimet në gjini, racë apo etni. Kjo do të thotë se, dinjiteti që Islami u ka dhënë grave është një pjesë integrale e dinjitetit që u dhurohet të gjithë njerëzve. Ndarja dhe diferencimi i njerëzve në gjini nuk është as meritë dhe as dobësi për asnjërën palë, andaj kur flasim për statusin e gruas në Islam, kjo nuk nënkupton se Islami nuk ka udhëzime, kufizime, përgjegjësi dhe detyrime specifike edhe për burrat. Ajo që e bën një person të vlefshëm dhe të respektueshëm tek Allahu, nuk është gjinia, pasuria, pozita, inteligjenca, fuqia fizike apo bukuria, por vetëm ndërgjegjja dhe devotshmëria.

Ekzistojnë të drejta dhe obligime të ndryshme për secilin njeri. Njeriu është nën detyrime për t'i përmbushur obligimet ndaj Allahut të Madhërishëm, ndaj vetes së tij, ndaj shoqërisë dhe ndaj natyrës fizike dhe mjedisit. Ai duhet t'i përmbush obligimet e caktuara nga Zoti dhe në të njëjtën kohë, atij i janë dhënë disa të drejta. Shoqëria si tërësi, është e obliguar që t'i respektojë të drejtat e secilit individ pa ia cenuar ato askujt.¹

Islami e nxiti gruan që të kontribuojë në shoqëri me detyra nga më të ndryshmet, duke filluar me detyrën më të bukur që i dha Allahu, e që është përkuqdesja ndaj familjes, pastaj duke vazhduar më gjerë në fusha të

ndryshme, të cilat janë në dobi të shoqërisë ku ajo jeton. Gruaja gjithmonë duhet ta gëzojë kënaqësinë e posedimit të të drejtave në shoqëri, por njëkohësisht, duhet ta bartë edhe përgjegjësinë e obligimeve. Nëse e shohim në këtë kontekst, shohim se gruaja është e barabartë me burrin, por sigurisht të drejtat dhe detyrimet e tyre nuk janë të njëjta. Allahu në Kuranin fisnik thotë: "...Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri..." (Ali Imran, 195).

Islami e sheh gruan si pjesëtare të denjë të shoqërisë me përgjegjësitë, të drejtat dhe privilegjet e saj.² Sheriati islam i ka dhënë të drejta gruas në pronësimin e pasurisë. Në kohën e xhahiljetit shumë pak gra kishin pasuri të veten që bënë me të çka të donin. Shumica e grave konsideroheshin mall, dhe nuk kishin të drejtë të posedonin diçka prej mallit. Kështu, kur erdhi Pejgamberi a.s., u dha grave të drejtën e posedimit (hakk et temlik),³ term ky që njihet në kohën bashkëkohore nga ligjet e reja që synojnë barazinë mes burrit e gruas, por që Islami e ka përdorur para pesëmbëdhjetë shekujve.

Burri nuk ka të drejtë ta detyrojë gruan t'i akumulojë të ardhurat e saj në fondin e përbashkët me të bashkëshortit të saj, dhe prej atij fondi të mirëmbahet familja, sepse dihet se mirëmbajtja e familjes nga aspekti i Sheriatit është obligim i burrit. Gruaja i ndihmon burrit në harxhimet familjare nga vullneti i mirë dhe ndërgjegjja e pastër, e jo nga imponimi dhe domosdoshmëria, qoftë pasuri e fituar apo e trashëguar. Asnjë nga dijetarët

Ajo që e bën një person të vlefshëm dhe të respektueshëm tek Allahu, nuk është gjinia, pasuria, pozita, inteligjenca, fuqia fizike apo bukuria, por vetëm ndërgjegjja dhe devotshmëria.



islamë, përveç Ibën Hazmit, nuk e ka obliguar gruan e pasur ta mirëmbajë burrin e saj të varfër.⁴

Që femrës t'i lehtësohet puna në pajtim me shkallën e prioriteteve dhe që të mos ketë vështirësi në zbatimin e tyre, Sheriati i garanton furnizim si asaj ashtu edhe fëmijëve të saj. Në këtë mënyrë e kursen forcën e saj e cila do të duhej të shpenzohej nëse do të duhej t'i siguronte vetë, kështu që bashkëshorti është ai që detyrohet ta furnizojë atë dhe fëmijët.⁵

Vajza në një familje myslimane s'është kurrfarë ngarkese apo barre. Një grua është aq e lartësuar nga Islami, saqë asaj nuk i duhet të paraqesë dhuratat për të tërhequr burra potencialë. Është dhëndri ai që duhet t'i paraqesë detyrimisht nuses një dhuratë martese – mehr. Kjo dhuratë konsiderohet prona e saj dhe as dhëndri dhe as familja e nuses s'kanë asnjë pjesë apo kontroll mbi të.⁶ Allahu në Kuranin fisnik thotë: "Grave jepni dhuratën e kurorëzimit së tyre (nikahut) më të mirë, e në qoftë se ato nga vullneti i vet ju falin diçka nga ajo, atëherë hane atë hallall të mirë." (En Nisa, 4).

Islami dekreton një të drejtë nga e cila gruaja ka qenë e privuar më parë, e që është e drejta për pavarësi pronësie, dhe kjo e drejtë nuk pëson ndryshime qoftë ajo e martuar apo jo.

Fakti që Islami e mori këtë qëndrim pothuajse para katërmëdhjetë shekujsh, shpesh konsiderohet si diçka mahnitëse dhe jashtëzakonshme. Demombynes,⁷ lidhur me këtë shënon se ligji kuranor i ka dhënë gruas një status, që në shumë aspekte, është më përparimtar se ai i vendosur nga ligji modern evropian. Ngjashëm me këtë, Lichtenstadter,⁸ ka vërejtur se qëndrimi kuranor është në mënyrë aq mahnitëse para kohës dhe mjedisit të vet. Ndërsa me vendimin në favor të së drejtës së gruas për pronësi personale ata thonë se Profeti për disa shekuj i parapriu legjislaturës perëndimore.

Kjo doktrinë e pavarësisë ekonomike ka qenë me siguri shumë para kohës dhe mjedisit të vet që të mund të zbatohet, edhe pse ka mundur të pranohet si një pjesë e mësimave fetare.⁹

Në kohën e injorancës, gruas i zhvatej pasuria dhe e drejta pa asnjëfarë kufizimi, madje ajo nuk kishte të drejtë të trashëgohte as nga i shoqi nëse ai vdiste. Ajo trashëgohej tamam siç trashëgoheshin plaçkat.¹⁰

Kur punët dhe detyrat të cilat i kryen në fillim gruaja, fillojnë të konfrontohen me obligimet e saj familjare dhe shoqërore, ajo nuk ka zgjidhje tjetër pos t'i kthehet shkallës së prioriteteve, për të arritur përmes gjërave më pak të rëndësishme deri

tek ato që janë të nevojshme dhe domosdoshme. Në këtë mënyrë kujdesemi për gjërat e domosdoshme, pastaj të rëndësishme (pra, të nevojshme por jo të domosdoshme) dhe në fund te gjërat e mira që janë në interes të shoqërisë.¹¹

Gratë janë gjysma e shoqërisë, dhe si e tillë ato nuk duhet të jenë të ngrira në shoqëri e të mos kenë mundësi të kontribuojnë në të. Pa dyshim që detyra esenciale e gruas është edukimi i fëmijëve, mision fisnik tek i cili është në dorë e ardhmja e vendit. Rëndësia e ndërtimit të familjes mbi baza të dashurisë, rehatisë, edukatës e mëshirës është shumë e madhe, por kjo nuk nënkupton që gruaja nuk mund të angazhohet krahas kësaj edhe në profesionin e saj, kjo varet nga dëshira e saj dhe rrethanat në të cilat gjendet.

- 1 Islam Hasani, *Ekonomia dhe bankimi islam – koncepte themelore*. (Prishtinë: Dituria Islame, 2013), f. 93.
- 2 Jusuf Kardavi, *Mesazhi ynë në epokën e globalizmit*. (Shkup: Furkan ISM, 2005), f. 225.
- 3 Alaa Adel al Ubaid, *Roli i grave në zhvillimin ekonomik nga një perspektivë islame*, Universiteti i Kuvajtit (<https://islamic-economics.net/دور-المرأة-في-التنمية-الاقتصادية-من-من>), data e qasjes: 08.10.2025.
- 4 *Vendimet dhe fetvatë e publikuara nga Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime*, (Prishtinë: Qendra Shqiptare për Integritim, Kulturë dhe Religjion, 2021), f. 204.
- 5 Muhamed Seid Ramadan el Buti, *Femra midis tiranisë së sistemit perëndimor dhe mëshirës së ligjit hyjnor*. Përkthet: Selim Sylejmani. (Shkup: Libraria Ebu Hanife, 2007), f. 73.
- 6 Sherif Abdel Azim, *Gratë në Islam kundrejt grave në traditën judeo-kristiane: Miti & Realiteti*, (Shkodër: n.d, 1996), f. 40-41.
- 7 Maurice Gaudfroy-Demombynes (1862–1957) ishte një shkencëtar dhe orientalist francez i njohur për studimet e tij mbi botën islame.
- 8 Ilse Lichtenstädter (1901–1991) ishte një orientaliste gjermanoamerikane dhe studiuese e gjuhëve dhe kulturës së Lindjes së Mesme.
- 9 Hamude Abdulati, *Struktura familjare në Islam*. (Shkup: Logos-A, 1995), f. 171-172.
- 10 Ebu Hasen en Nedeuij, *Çfarë humbi bota me dobësimin e muslimanëve*. Përkthet: Flori Kola. (Tiranë: Alsar, 2020), f. 104.
- 11 Muhamed Seid Ramadan el Buti, *Femra midis tiranisë së sistemit perëndimor dhe mëshirës së ligjit hyjnor*. f. 71-72.

Mishi dhe shëndeti: nevojë apo teprim?

Agron M. Rexhepi, PhD, MSci, MD

HYRJE

Në shumë familje të rajonit tonë, mishi Ende shihet si qendra e vaktit apo ‘mbreti i ushqimit’ dhe jo rrallë konsiderohet i domosdoshëm pothuajse çdo ditë. Megjithatë, udhëzimet bashkëkohore të ushqyerjes nuk e vendosin mishin si ushqimin që duhet konsumuar përditë. Përkundrazi, ato favorizojnë një model më të balancuar, ku më shumë hapësirë u jepet peshkut, mishit të shpezëve, proteinave bimore, arrave, farave dhe bishtajoreve, ndërsa mishi i kuq kufizohet dhe mishi i përpunuar minimizohet apo largohet fare nga menyuja ditore ^[1-3].

DY VAKTE ME MISH NË JAVË: NJË KËSHILLË PRAKTIKE, JO NJË FORMULË ABSOLUTE

Qëndrimi se për shumicën e njerëzve dy vakte me mish në javë mund të jenë më se të mjaftueshme duhet kuptuar si një këshillë praktike dhe e moderuar, e jo si një formulë e ngurtë për çdo individ. Kjo qasje është e mbrojtshme shkencërisht, sepse shkon në të njëjtin drejtim me rekomandimet ndërkombe-tare që synojnë uljen e konsumit të mishit të kuq dhe shmangien sa më të madhe të mishit të përpunuar. World Cancer Research Fund, rekomandon që, nëse konsumohet mish i kuq, ai të mos kalojë rreth 350–500

Qëndrimi se për shumicën e njerëzve dy vakte me mish në javë mund të jenë më se të mjaftueshme duhet kuptuar si një këshillë praktike dhe e moderuar, e jo si një formulë e ngurtë për çdo individ.



Lidhja e mishit të kuq me kancerin kolorektal nuk shpjegohet vetëm nga yndyrat. Një rol të rëndësishëm mendohet të luajë hekuri hemik, i cili mund të favorizojë formimin endogjen të N-nitroso përbërjet (compounds) në zorrë.

gram mish të gatuar në javë, ndërsa mishi i përpunuar të jetë sa më afër zeros^[3]. Në këtë kuptim, dy racione modeste në javë nuk janë një kufizim i skajshëm, por një mënyrë e thjeshtë për ta shmangur teprimin.

CILIN MISH DUHET TA FAVORIZOJMË?

Nga këndvështrimi shëndetësor, zakonisht më të favorshëm konsiderohen peshku dhe mishi i shpezëve, sidomos kur zgjidhen pjesë më të ligëta (pa masë dhjamore). Peshku, përveç proteinës, mund të sjellë edhe përfitime të tjera ushqyese, veçanërisht të llojet e pasura me yndyra omega-3. American Heart Association rekomandon të zgjidhen më shpesh burime më të shëndetshme të proteinës, përfshirë peshkun, shpezët e ligëta, bishtajoret dhe arrat^[1,2]. Kjo ndihmon edhe në relativizimin e idesë së gabuar se pa mish të përditshëm nuk mund të ketë ushqyerje të mirë.

PSE DUHET KUFIZUAR MISHI I KUQ?

Kufizimi i mishit të kuq lidhet me dy linja kryesore argumentimi. E para ka të bëjë me profilin e tij yndyror: shumë forma të mishit të kuq përmbajnë më shumë yndyra të saturuara, të cilat, kur konsumohen në tepricë, lidhen me efekte të pafavorshme në profilin lipidik dhe me rrezik më të lartë kardiovaskular^[1,2]. E dyta lidhet me kancerin kolorektal. IARC, përmes Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e ka klasifikuar mishin e përpunuar si kancerogjen për njerëzit dhe mishin e kuq si probablisht kancerogjen, sidomos në raport me kancerin kolorektal^[4].

PSE MISHI I PËRPUNUAR ËSHTË EDHE MË PROBLEMATIK?

Mishi i përpunuar përfshin sallamet, suxhukun, proshutën, bacon-in, hot dog-un, dhe produkte të ngjashme. Pikërisht kjo kategori bart evidencën më të fortë për dëmshmëri

afatgjatë. Sipas IARC, çdo 50 gram mish i përpunuar në ditë lidhet me rreth 18% rritje të rrezikut për kancer kolorektal^[4]. Kjo nuk do të thotë se një konsum i vetëm shkakton sëmundje, por se konsumi i shpeshtë dhe i zakonshëm rrit rrezikun në nivel popullate.

ROLI I HEKURIT HEMIK DHE I NITROSO-PËRBËRJEVE

Lidhja e mishit të kuq me kancerin kolorektal nuk shpjegohet vetëm nga yndyrat. Një rol të rëndësishëm mendohet të luajë hekuri hemik, i cili mund të favorizojë formimin endogjen të N-nitroso përbërjet (compounds) në zorrë^[4]. Nitroso-përbërjet janë komponime që mund të krijohen kur nitritet reagojnë me amina dhe substrate të afërta, sidomos në mjedis acid si ai i stomakut. Te mishi i përpunuar kjo është veçanërisht relevante, sepse nitritet përdoren shpesh gjatë përpunimit dhe konservimit^[5]. Këto mekanizma konsiderohen ndër rrugët biologjike që mund të kontribuojnë në dëmtimin e mukozës së kolonit dhe në rritjen e rrezikut kolorektal^[4,5].

SA GRAM MISH ËSHTË I MJAFTUESHËM PËR NJË RACION?

Një racion praktik dhe i arsyeshëm është rreth 80–100 gram mish i gatuar, afërsisht sa madhësia e një pakete letrash. American Heart Association e përkufizon një porcion standard si rreth 3 ounces, pra rreth 85 gram mish i gatuar, shpezë ose peshk^[6]. Nëse mishi konsumohet dy herë në javë, atëherë bëhet fjalë afërsisht për 160–200 gram mish të gatuar në javë, një nivel qartësisht i moderuar për publikun e gjerë.

A ËSHTË MISHI BURIMI I VETËM SERIOZ I PROTEINËS?

Jo, mishi është një burim i mirë proteine, por nuk është i vetmi. Për më tepër, mishi i ligët i shpezëve, sidomos gjoksi i pulës dhe i gjelit, zakonisht ka më shumë proteina për 100 gram sesa shumë copëra më të yndyrshme të mishit të kuq^[1,2]. Po aq e rëndësishme është se nevojat proteinike mund të plotësohen shumë mirë edhe nga vezët, bulmeti, bishtajoret, arrat dhe farat^[1,2]. Prandaj, pyetja e drejtë nuk është vetëm sa proteina ka mishi, por edhe çfarë pakete ushqyese vjen bashkë me të, sa shpesh konsumohet dhe me çfarë zëvendësohet.

MËNYRA E GATIMIT KA PO AQ RËNDËSI SA LLOJI I MISHIT

Nga pikëpamja shëndetësore, preferohen zierja, avullimi, poçimi, pjekja në furrë në temperaturë mesatare dhe gatimi i ngadaltë. Në të kundërt, djegia e mishit, karbonizimi i sipërfaqes dhe gatimi në temperatura shumë të larta favorizojnë formimin e heterocyclic amines (HCAs) dhe polycyclic aromatic hydrocarbons (PAHs), përbërje që janë

Te copat e plota të mishit të viçit, qengjit ose deles, një pjekje medium mund të jetë më pak problematike (por jo pa rrezik) sesa te mishi i grirë, por standardi i sigurisë nuk është ngjyra e mishit, por temperatura e brendshme.

studiuar për lidhjen e tyre me rrezikun kancerogjen ^[7]. Kjo do të thotë se, kur mishi konsumohet, nuk ka rëndësi vetëm sa shpesh hahet, por edhe si përgatitet.

MISHI MEDIUM DHE SIGURIA USHQIMORE

Një pyetje e shpeshtë lidhet me mishin e pjekur mesatar (medium). Këtu duhet bërë dallim midis cilësisë ushqyese dhe sigurisë ushqimore. Te copat e plota të mishit të viçit, qengjit ose deles, një pjekje medium mund të jetë më pak problematike (por jo pa rrezik) sesa te mishi i grirë, por standardi i sigurisë nuk është ngjyra e mishit, por temperatura e brendshme. USDA rekomandon rreth 145°F (62.8°C) për biftëkë (steaks), kotëleta (chops) dhe cope e madhe mishi (roasts), me pushim 3-minutësh; 160°F (71.1°C) për mishin e grirë; dhe 165°F (73.9°C) për shpezët ^[8]. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët, gratë shtatzëna, të moshuarit dhe personat me imunitet të dobësuar ^[9].

NJË PËRFUNDIM I ARSYESHËM PËR SHËNDETIN PUBLIK

Problemi ynë nuk është se hamë mish herë pas here, por se shpesh e kemi bërë mishin

ushqim të përditshëm, madje shpesh në format më pak të favorshme: shumë mish i kuq, shumë mish i përpunuar, porcione të mëdha dhe gatim agresiv. Një model më i mençur ushqimor është që mishi të mos zërë qendrën e përditshme të ushqimit. Për shumicën e njerëzve, dy vakte me mish në javë janë më se të mjaftueshme, sidomos kur zgjidhen më shpesh peshku dhe shpezët, ndërsa mishi i kuq mbahet më rrallë dhe mishi i përpunuar shmanget sa më shumë apo largohet në tërësi nga menyja ditore ^[1-4]. Kjo nuk është demonizim i mishit, por një qasje më e moderuar, më e arsyeshme dhe më e mbështetur në evidencë për shëndetin afatgjatë.

Referencat:

- 1 American Heart Association. Picking Healthy Proteins. 2024. Available at: <https://www.heart.org/en/healthy-living/healthy-eating/eat-smart/nutrition-basics/picking-healthy-proteins>. Accessed 23 April 2026.
- 2 American Heart Association. AHA Diet and Lifestyle Recommendations. Available at: <https://www.heart.org/en/healthy-living/healthy-eating/eat-smart/nutrition-basics/aha-diet-and-lifestyle-recommendations>. Accessed 23 April 2026.
- 3 World Cancer Research Fund. Limit consumption of red and processed meat. Available at: <https://www.wcrf.org/research-policy/evidence-for-our-recommendations/limit-red-processed-meat/>. Accessed 23 April 2026.
- 4 International Agency for Research on Cancer (IARC). Q&A on the carcinogenicity of the consumption of red meat and processed meat. Available at: https://www.iarc.who.int/wp-content/uploads/2018/11/Monographs-QA_Vol114.pdf. Accessed 23 April 2026.
- 5 Joint FAO/WHO Expert Committee on Food Additives (JECFA). Nitrite (and potential endogenous formation of N-nitroso compounds). Available at: <https://www.inchem.org/documents/jecfa/jecmono/v35je13.htm>. Accessed 23 April 2026.
- 6 American Heart Association. How much protein should I eat in a serving? 2024. Available at: <https://www.heart.org/en/healthy-living/healthy-eating/eat-smart/nutrition-basics/how-much-protein-should-i-eat-in-a-serving>. Accessed 23 April 2026.
- 7 National Cancer Institute. Chemicals in Meat Cooked at High Temperatures and Cancer Risk. Available at: <https://www.cancer.gov/about-cancer/causes-prevention/risk/diet/cooked-meats-fact-sheet>. Accessed 23 April 2026.
- 8 U.S. Department of Agriculture, Food Safety and Inspection Service. Safe Minimum Internal Temperature Chart. Available at: <https://www.fsis.usda.gov/food-safety/safe-food-handling-and-preparation/food-safety-basics/safe-temperature-chart>. Accessed 23 April 2026.
- 9 Centers for Disease Control and Prevention. Safer Food Choices for People at Increased Risk. Available at: <https://www.cdc.gov/food-safety/foods/safer-food-choices.html>. Accessed 23 April 2026.



Filozofia islame në periudhën e kalifatit abasid

MA. Liron Krasniqi

Periudha e kalifatit abasid shënon kulmin e zhvillimit intelektual në historinë e qytetërimit islam. Kjo epokë nxori figura madhore si El Kindi, El Farabiu, Ibën Sina, El Gazali dhe Ibën Rushdi, të cilët kontribuan në filozofi, logjikë, metafizikë dhe shkencë.

HYRJE

Periudha e kalifatit abasid konsiderohet si një nga epokat më të rëndësishme në historinë e qytetërimit islam dhe të mendimit filozofik botëror. Me ardhjen në pushtet të abasidëve në vitin 750, bota islame përjetoj zhvillim të madh politik, ekonomik dhe kulturor, që njëkohësisht ishte vazhdimësi e zhvillimit ndërvjeçar me themelet e vendosura në dy kalifatet e mëhershme, Rashidun dhe Umajad. Qendra e shtetit u vendos në Bagdad, i cili u shndërrua në një nga qendrat më të mëdha të dijes në botë. Në këtë periudhë u zhvilluan shkencat, letërsia, mjekësia dhe veçanërisht filozofia islame.

Përmes institucioneve si Bejt el Hikmeh, dijetarët myslimanë përkthyen dhe studiuuan veprat e filozofëve grekë si Aristoteli dhe Platoni, duke krijuar një traditë të re intelektuale që bashkonte arsyen me fenë islame. Kjo periudhë nxori filozofë të mëdhenj, të cilët ndikuan fuqishëm në zhvillimin e mendimit islam dhe të qytetërimit botëror.

ZHVILLIMI I FILOZOFISË ISLAME GJATË UDHËHEQJES SË ABASIDËVE

Periudha e sundimit të dinastisë abaside konceptohet me të drejtë si periudha e mendimit filozofik, pasi bota islame përjetoj një zhvillim të madh politik, ekonomik, kulturor dhe shkencor. Një ndër fushat që

mori hov të veçantë ishte filozofia, e cila u zhvillua në mënyrë të organizuar dhe ndikoi jo vetëm në mendimin islam, por edhe në qytetërimin evropian të mëvonshëm. Abasidët krijuan një ambient të favorshëm për dijen, duke mbështetur dijetarët, përkthimet dhe debatet intelektuale. Kjo periudhë u bë ura lidhëse ndërmjet trashëgimisë greke dhe mendimit islam.

Dinastia abaside erdhi në udhëheqje në vitin 750 dhe e zhvendosi qendrën politike të botës islame në Bagdad.¹ Bagdadi shpejt u shndërrua në një qendër të madhe kulturore dhe shkencore. Kalifët abasidë, sidomos Harun el Rashidi dhe El Ma'muni, treguan interes të madh për shkencën dhe filozofinë. Ata financuan biblioteka, observatorë dhe qendra studimore, duke ftuar dijetarë nga kultura të ndryshme që të kontribuonin në zhvillimin intelektual të shtetit islam.

Një rol të jashtëzakonshëm në zhvillimin e filozofisë pati institucioni Bejt el Hikmeh, e njohur si "Shtëpia e urtësisë".² Ky institucion u bë qendra kryesore e përkthimeve dhe studimeve filozofike. Në të u përkthyen në gjuhën arabe veprat e filozofëve të mëdhenj grekë, si Aristoteli, Platoni dhe Sokrati. Përkthimet u realizuan nga dijetarë sirianë, persianë dhe arabë, të cilët sollën në botën islame trashëgiminë filozofike të Greqisë antike. Këto vepra ndikuan drejtpërdrejt në formimin e mendimit filozofik islam dhe njëkohësisht duke e ndarë logjikën e së mirës



dhe së keqes në konceptin e idesë, dhe duke i qëndruar besnik parimeve islame, me ç'rast nuk hezitonin ta vendosnin kritikën për autorët e lashtë antik.³

Filozofia islame në këtë periudhë njihej me termin “falsafa”, një fjalë ekuivalente me “philosophia”, ose filozofia në gjuhën shqipe. Filozofët myslimanë u përqopën të harmonizonin arsyen me fenë islame. Ata besonin se mendimi racional dhe shpallja hyjnore nuk ishin në kundërshtim, por mund ta plotësonin njëra-tjetrën.⁴ Kjo qasje krijoi debate të shumta ndërmjet filozofëve dhe teologëve islamë, që shpeshherë mendimet e tyre i bashkërendonin në vijën e kuptimit ideologjik dhe idesë së zbritjes kuranore.

Filozofi i parë i madh islam konsiderohet El Kindi. Ai jetoi gjatë periudhës abaside dhe u përqop të ndërtonte një filozofi që përputhej me mësimet islame. El Kindi mbështeti përdorimin e logjikës dhe arsyes në studimin e natyrës dhe fesë. Ai shkroi për matematikën, astronominë dhe metafizikën, duke u bërë një figurë kyçe në zhvillimin e mendimit racional islam. Përmes veprave të tij, filozofia e lashtë greke filloi të integrohej në filozofinë islame, e ndërtuar mbi parimet e logjikës së pranuar nga shkrimet e mëhershme dhe duke përjashtuar ato të cilat nuk përputheshin me logjikën.⁵

Një tjetër mendimtar i rëndësishëm ishte El Farabiu, i cili njihet si “Mësuesi i Dytë” pas Aristotelit. Ai zhvilloi teori politike dhe filozofike mbi shtetin ideal dhe rolin e udhëheqësit të urtë. Sipas El Farabiu, shoqëria ideale duhet të drejtohet nga një njeri i ditur dhe me moral, i cili udhëheq popullin drejt lumturisë dhe drejtësisë. Ai gjithashtu kontribuoi në logjikë dhe klasifikimin e shkencave, duke ushtruar ndikim të madh në filozofët e mëvonshëm islamë dhe evropianë.⁶

Kulmi i filozofisë islame gjatë periudhës abaside arriti me Ibën Sina. Ai ishte filozof, mjek dhe shkencëtar i shquar. Në filozofinë e tij, Ibën Sina trajtoi çështje të rëndësishme si ekzistenca, shpirti dhe intelekti. Ai argumentonte se Allahu është “Qenia e Domosdoshme”, ndërsa çdo gjë tjetër ekziston përmes tij. Veprat e tij, sidomos në metafizikë dhe mjekësi, u përhapën gjerësisht edhe në Evropë dhe u përdorën për shekuj në universitete, me ç'rast ai u njoh në Evropë si Avicena.⁷

Megjithatë, jo të gjithë dijetarët islamë e pranuan filozofinë pa kritika. El Gazali ishte një nga kritikët më të njohur të filozofëve. Në veprën e tij “Tahafut el Falasifa” ai kundërshtoi disa ide filozofike që sipas tij binin ndesh me mësimet islame. El Gazali kritikoi filozofët grek për mbështetjen e tepruar në arsyen dhe logjikën njerëzore. Megjithatë, ai nuk e refuzoi plotësisht filozofinë, por kërkoi që ajo të mos dilte jashtë kufijve të fesë.⁸

Nga ana tjetër, Ibën Rushdi u bë mbrojtësi më i madh i filozofisë islame. Ai argumentoi se feja dhe filozofia nuk janë kundërshtare, pasi të dyja kërkojnë të vërtetën. Ibën Rushdi shkroi komente të shumta mbi Aristotelin dhe ndikoi fuqishëm në filozofinë evropiane mesjetare, sidomos në skolastikë.⁹

NDIKIMI AFATGJATË I FILOZOFISË ABASIDE NË QYTETËRIMIN BOTËROR

Filozofia abaside ndikoi fuqishëm në zhvillimin e racionalizmit dhe metodës logjike. Filozofët myslimanë besonin se arsyeja dhe feja mund të bashkëjetonin dhe ta plotësonin njëra-tjetrën dhe kjo ide ishte pikërisht model i lindjes së shkencës si koncept. Kjo ide krijoi një traditë të mendimit racional, që ndikoi në mënyrën se si studiuesit e mëvonshëm e kuptonin botën. Kjo njohje e botës konceptohet ndryshe edhe me shpikjet moderne, që shumë nga to kanë pikë reference idetë e filozofëve myslimanë. Shembull, El Kindi ishte ndër të parët që përdori filozofinë greke për t'i shpjeguar konceptet islame. Ai argumentonte se e vërteta mund të arrihet përmes arsyes dhe studimit shkencor. Kjo qasje hapi rrugën për zhvillimin e mendimit kritik dhe të analizës logjike.

Një ndikim tjetër i madh i filozofisë abaside ishte zhvillimi i shkencave natyrore. Në periudhën abaside, filozofia nuk ndahej nga shkenca, siç është e pranishme në ditët e sotme.

Periudha abaside shënoi një lulëzim të jashtëzakonshëm shkencor, ku dijetarë si Ibën Sina, El Razi, Ibën el Haythami, El Khwarizmi, Nasir el Din el Tusi dhe Xhabir ibën Hajani dhanë kontribute themelore në mjekësi, optikë, matematikë, astronomi dhe kimi. Punimet e tyre ndikuan fuqishëm në zhvillimin e shkencës moderne dhe në përparimin e qytetërimit botëror.

Filozofët ishin njëkohësisht matematikanë, astronomë, mjekë dhe fizikantë. Ibën Sina, siç u theksua edhe më lartë, ishte një nga filozofët dhe mjekët më të mëdhenj të historisë. Veprat e tij në mjekësi dhe metafizikë u përdorën për shekuj në universitetet evropiane, që njëkohësisht vepra “Kanuni i Mjekësisë” është vepër e pranuar nga shumica e mjekëve edhe sot. Në anën tjetër, përmes filozofisë, u zhvilluan metoda të reja të vëzhgimit dhe analizës shkencore, të cilat më vonë ndikuan në formimin e shkencës moderne. Po ashtu, filozofia abaside ndikoi në zhvillimin e etikës dhe teorive politike. Shembulli i El Farabit mbi çështjen e shtetit ideal dhe të udhëheqjes së drejtë reflektuan edhe në filozofinë politike evropiane. Konceptet e drejtësisë, moralit dhe përgjegjësisë shoqërore të zhvilluara nga filozofët myslimanë vazhduan të kenë rëndësi edhe në epokat e mëvonshme.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i ndikimit afatgjatë të filozofisë abaside ishte roli i saj në zhvillimin e qytetërimit evropian. Përmes Andaluzisë islame (Spanja e sotme) dhe përkthimeve latine, filozofia islame u përhap në Evropë gjatë mesjetës. Universitetet evropiane filluan të studiojnë veprat e filozofëve myslimanë. Komentet e Ibën Rushdit mbi Aristotelin u bënë themel i filozofisë skolastike në Evropë. Filozofë të njohur të krishterë u ndikuan nga mendimi islam dhe përdorën idetë e filozofëve myslimanë në zhvillimin e teorive të tyre.¹⁰

Në këtë mënyrë, filozofia abaside kontribuoi drejtpërdrejt në lindjen e të quajturës Rilindje Evropiane. Ruajtja e dijes antike dhe transmetimi i saj në Evropë krijoi bazat për zhvillimin e humanizmit, racionalizmit dhe shkencës moderne. Shumë historianë e konsiderojnë qytetërimin islam si urën kryesore që lidh botën antike me Evropën moderne. Pa kontributin e filozofëve myslimanë, shumë nga veprat e filozofëve grekë mund të ishin humbur përgjithmonë.

Filozofia abaside ndikoi gjithashtu në zhvillimin e dialogut ndërkulturor. Në Bagdad dhe qytete të tjera islame jetonin dhe punonin së bashku myslimanë, të krishterë, hebrenj dhe persianë. Ky bashkëpunim intelektual krijoi një atmosferë tolerance dhe shkëmbimi kulturor. Përmes debatit dhe

bashkëpunimit, filozofia islame u pasurua dhe u bë më universale.

Ndikimi afatgjatë i filozofisë abaside shihet edhe sot në mënyrën se si kuptohet lidhja ndërmjet fesë dhe arsyes. Filozofët myslimanë treguan se feja nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me shkencën dhe logjikën. Kjo ide vazhdon të ketë rëndësi në debatet bashkëkohore mbi rolin e fesë, etikës dhe shkencës në shoqëri.

SHPIKJET DHE KONTRIBUTET SHKENCORE TË FILOZOFËVE ABASIDË

Ideja e filozofisë islame ishte një kombinim mes fesë dhe mendimit të logjikës si koncept i jetesës në rrethanat kohore. Kreativiteti ishte i ndërlidhur me mendimin, ideja me kohën, tekstualizimi i mendimit si shembull i mundësisë të krijimit në kohën kur është e mundur. Çdo gjë që shohim sot, ishte në fakt një ide e së djeshmes dhe kjo e djeshme ka si referencë filozofinë islame, që idetë e tyre ishin një burim kryesor i shpikjeve moderne. Kjo pasi që siç u theksua, filozofët ishin njëkohësisht edhe matematicient, mjek, gjeografë etj..

Shembulli i saj ishte El Farabiu. Përveç filozofisë politike dhe logjikës, ai dha kontribute në shkencat e tingullit, me ç'rast njihet si themelues i filozofisë politike dhe shkencës së artit, njëjtë sikur Ibën Halduni, i cili njihet si themeluesi i metodologjisë shkencore të historisë, ku kjo pranohet nga shumica, pasi shembujt e kësaj metodologjie dallohen në veprën e tij “El Mukaddime”.¹¹

Nga kontributet shkencore konsiderohet ai i Ibën Sinës si një nga mjekët më të mëdhenj të historisë. Vepra e tij “Kanuni i Mjekësisë” u përdor për shekuj në universitetet evropiane. Ibën Sina përshkroi sëmundje të ndryshme, zhvilloi metoda diagnostikimi dhe theksoi rëndësinë e higijenës dhe eksperimentimit në mjekësi. Ai gjithashtu studioi anatominë, farmacinë dhe psikologjinë. Kjo qasje shkencore e tij, ishte burim kryesor i mjekësisë ndër vite. Në mjekësi dallohet edhe El Razi, i njohur në Perëndim si Rhazes. Ai ishte një nga mjekët më të mëdhenj të botës islame dhe drejtoi spitale të rëndësishme në Bagdad. El Razi dalloj sëmundjet e lisë dhe fruthit dhe



shkroi vepra të rëndësishme mbi mjekësinë klinike. Ai përdori metoda eksperimentale dhe theksoi rëndësinë e vëzhgimit praktik në trajtimin e pacientëve.¹²

Në fushën e optikës dhe fizikës theksojmë Ibën el Haythamin, i cili konsiderohet themelues i metodës shkencore eksperimentale. Ai studioi dritën, pasqyrimin dhe thyerjen e saj, duke shpjeguar mënyrën se si funksionon shikimi njerëzor. Eksperimentet e tij në optikë ndikuan më vonë në zhvillimin e fizikës moderne dhe të kamerës. Një rol të rëndësishëm pati edhe El Khwarizmi, i cili zhvilloi algjebërën dhe konceptin e algoritmit. Fjala “algoritëm” rrjedh nga emri i tij. Ai kontribuoi në matematikë, astronomi dhe gjeografi, ndërsa sistemi numerik arab që u përhap në Evropë ndihmoi në zhvillimin e matematikës moderne dhe krijimin e algjebërës si ligj matematikor. Në astronomi, dijetarët abasidë ndërtuan observatorë dhe zhvilluan instrumente për matjen e yjeve dhe lëvizjeve planetare. Ata përmirësuan astrolabin dhe hartuan tabela astronomike shumë të sakta për kohën. Këto studime ndihmuan në zhvillimin e navigimit dhe të shkencave astronomike. Gjithashtu, Nasir el Din el Tusi dha kontribute të rëndësishme në matematikë dhe astronomi. Ai ndërtoi observatorë astronomikë dhe zhvilloi modele matematikore që më vonë ndikuan në astronominë evropiane, përfshirë edhe teoritë e mëvonshme të lëvizjes planetare.¹³

Një tjetër figurë shumë e rëndësishme e periudhës abaside ishte Xhabir ibën Hajani, i cili konsiderohet si themeluesi i kimisë moderne. Ai jetoi gjatë periudhës së hershme abaside dhe dha kontribute të mëdha në kimi, farmaci dhe laboratorikë. Xhabir ibën Hajani zhvilloi metoda eksperimentale për përzierjen dhe pastrimin e substancave kimike, duke përdorur procese si distilimi, kristalizimi dhe avullimi. Ai shpiku disa pajisje laboratorike që u përdorën më vonë në Evropë dhe kontribuoi në zhvillimin e acideve kimike.¹⁴

KONKLuzion

Periodha e kalifatit abasid përfaqëson një nga epokat më të rëndësishme në historinë e filozofisë dhe qytetërimit islam. Gjatë kësaj kohe, bota islame u shndërrua në një qendër të madhe të dijes, ku filozofia, shkenca dhe kultura u zhvilluan në mënyrë të jashtëzakonshme. Përkrahja e kalifëve abasidë ndaj dijetarëve dhe institucioneve si Bejt el Hikmeh krijoi kushte të favorshme për përhapjen e mendimit racional dhe studimeve filozofike. Filozofët myslimanë të kësaj periudhe, si El Kindi, El Farabiu, Ibën Sina dhe Ibën Rushdi, arritën të ndërthurin filozofinë e lashtë me mendimin islam, duke krijuar një traditë të pasur intelektuale. Ata kontribuan në zhvillimin e logjikës, metafizikës, etikës dhe shkencave natyrore, ndërsa ndikimi i tyre u përhap edhe në Evropën mesjetare. Rëndësia e periudhës abaside nuk qëndron vetëm në ruajtjen e trashëgimisë antike, por edhe në zhvillimin dhe përshtatjen e saj në një kontekst të ri kulturor dhe fetar. Kjo epokë dëshmoi se dialogu ndërmjet fesë, arsyes dhe shkencës mund të prodhojë përparim të madh intelektual. Për këtë arsye, periudha abaside mbetet një ndër themelet kryesore të historisë së mendimit filozofik dhe të qytetërimit botëror.

- 1 Tayeb el Hibri, *The Abbasid Caliphate: A History*, (Cambridge: Cambridge University Press, 2021), f. 12.
- 2 Majid Fakhry, *A History of Islamic Philosophy*, (New York: Columbia University Press, 2004), f. 45.
- 3 Fakhry, *A History of Islamic Philosophy*, f. 56.
- 4 Dimitri Gutas, “Origins in Baghdad,” *The Cambridge History of Medieval Philosophy*, ed. Robert Pasnau dhe Christina van Dyke (Cambridge: Cambridge University Press, 2014), f. 14.
- 5 Seyyed Hossein Nasr, *Islamic Philosophy from Its Origin to the Present: Philosophy in the Land of Prophecy* (Albany: State University of New York Press, 2006), f.52.
- 6 Hossein Nasr, *Islamic Philosophy*, f. 89.
- 7 Hossein Nasr, *Islamic Philosophy*, f. 123.
- 8 Hossein Nasr, *Islamic Philosophy*, f. 154.
- 9 Hossein Nasr, *Islamic Philosophy*, f. 232.
- 10 Hossein Nasr, *Islamic Philosophy*, f. 321.
- 11 T. J. De Boer, *The History of Philosophy in Islam*, trans. Edward R. Jones (Richmond: Curzon Press, 1994), f.43.
- 12 T. J. De Boer, *The History of Philosophy in Islam*, f.59.
- 13 T. J. De Boer, *The History of Philosophy in Islam*, f. 89.
- 14 Hossein Nasr, *Islamic Philosophy*, f. 369.

Mulla Ramë Gërvalla – mësues dhe hoxhë i kohës

Mr. Fatos Gërvalla

“Historia e një populli nuk shkruhet vetëm me ngjarje, por me jetët e atyre burrave që i shërbyen fesë dhe atdheut me sinqeritet. Kujtimi i tyre nuk është thjesht nderim për të kaluarën, por udhërrëfyes për të ardhmen.”

Mulla Ramadan¹ Gërvalla, një figurë e shquar e historisë kombëtare dhe fetare shqiptare, lindi në ramazanin e vitit 1884,² nga prindërit Ahmeti dhe Ajetja, në fshatin Lupç të Poshtëm, në një nga fshatrat e Llapit, i njohur për traditat e tij të forta dhe popullsinë e përkushtuar ndaj besimit dhe atdhetarizmit. Jeta e mulla Ramë Gërvallës ishte e lidhur ngushtë me zhvillimet e mëdha të kohës, duke i shërbyer besimit të thellë në Zotin dhe dashurisë së paepur për

atdheun. Ai u bë një nga figurat më të respektuara të periudhës së tij, jo vetëm si hoxhë dhe mësues, por edhe si ushtar i atdhetarit të kohës Hasan Prishtinës, duke i dhënë popullit shqiptar një shembull të shkëlqyer të atdhetarizmit dhe besimit të pastër.

Mulla Ramë Gërvalla lindi dhe u rrit në një periudhë të rëndë të popullit shqiptar, në mes të luftërave dhe okupimeve. Rritja e tij në fshatin Lupç të Poshtëm, një vend i thyer nga ndryshimet e mëdha, ndikoi në formimin e personalitetit të tij të fortë dhe besimin e tij të thellë në fuqinë e dijes dhe fesë. Në moshën e re të tij, ai vendosi të ndiqte mësimet në shkollën e Medresesë në Shkup, Darul-Mualimin, një nga institucionet më të njohura për arsimimin e kohës në trevat shqiptare. Kjo shkollë e ndihmoi Mulla Ramën të fitonte një edukim përmbajtësor në shkencat fetare dhe në aspektin e kulturës shqiptare, duke e bërë atë një njeri të aftë për të udhëhequr dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë. Gjatë periudhës së tij në Shkup, mulla Ramë Gërvalla pati mundësinë të mësonte jo vetëm për besimin, por edhe për historinë, traditat dhe kulturën e popullit të tij e më gjerë. Kjo e bëri atë një njeri që ishte i përkushtuar për t'i ruajtur dhe për t'i transmetuar këto vlera te brezat që do të pasonin. Pas përfundimit të studimeve, ai u kthye në vendlindjen e tij, ku e vazhdoi jetën si mësues dhe hoxhë.



Në moshën e re të tij, ai vendosi të ndiqte mësimet në shkollën e Medresesë në Shkup, Darul-Mualimin, një nga institucionet më të njohura për arsimimin e kohës në trevat shqiptare.

Posa u kthye nga mësimet, në fshatin Lupç të Poshtëm, mulla Ramë Gërvalla nisi të ofronte mësimet për fëmijët dhe të rinjtë e fshatit dhe të rrethinës në mejtepin e xhamisë. Ai e kuptoi menjëherë rëndësinë e edukimit dhe zhvillimit të brezave të rinj dhe ishte një nga hoxhallarët që u angazhua për hapjen e shkollave shqipe në rajonin e Llapit. Mësimi filloi në xhaminë e fshatit, ku mulla Ramë

Gërvalla jepte mësimë për fëmijët në gjuhë shqipe, duke u dhënë mundësi atyre të njihnin historinë e popullit të tyre, traditat dhe besimin. Pasi filloi mësimin e nxënësve në gjuhën shqipe, ai e vazhdoi përpjekjen për ta zhvilluar arsimin në fshatin Lupç të Poshtëm dhe fshatrat përreth, edhe pse pengesat nga pushtuesi serb për të ishin të mëdha. Ai shumë herë u maltretua në mënyrat më të rënda të mundshme, por ai nuk hoqi dorë nga misioni i tij. Nga nxënësit e tij ishin mulla Idriz Berisha (deri në vitin 1993 ishte imam në Lupç të Poshtëm), h. Ajet Bajgora, h. Kadri Merturi e shumë të tjerë. Mulla Ramë Gërvalla ishte njeri i cili me dijen e tij dhe përkushtimin për atdheun, si dhe me përkrahjen e bashkëfshatarëve, bëri që mejtepin e tij më pas ta shndërroi dhe ta avancoi në një shkollë e cila më vonë do ta marrë formën e plotë të saj. Si hoxhë, ai gjithashtu kishte një ndikim të thellë në shpirtin dhe jetën fetare të besimtarëve. Ai shquhej për mësimet e tij të thella dhe për udhëheqjen shpirtërore që ua ofronte besimtarëve. Njerëzit e shihnin mulla Ramë Gërvallën si një udhëheqës të besueshëm, një njeri që mund të jepte këshilla për çdo çështje të jetës, qoftë ajo fetare apo shoqërore. Modestia dhe përkushtimi i tij për jetën shpirtërore bënë që ai të ishte i dashur dhe i respektuar nga të gjithë. Mulla Ramë Gërvalla jetoi një jetë të thjeshtë, duke u munduar gjithmonë të ndihmonte dhe të udhëhiqte komunitetin në rrugën e fesë dhe të moralit.

Një nga pjesët më të rëndësishme të jetës së mulla Ramë Gërvallës ishte angazhimi i tij në mbrojtjen e atdheut. Ai mori pjesë në luftën për lirinë e Kosovës dhe të Shqipërisë, dhe ishte një nga ushtarët e besuar të Hasan Prishtinës, një nga liderët e shquar të Luftës së Kosovës dhe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Mulla Ramë Gërvalla, i njohur për përkushtimin dhe guximin e tij, mori pjesë në betejat e shumta për mbrojtjen e kufijve të Kosovës. Si ushtar i Hasan Prishtinës, ai kontribuoi në mbrojtjen e tokave shqiptare dhe në luftën kundër ushtrisë serbe që synonte për të shuar popullin shqiptar. Në ato kohëra të vështira, mulla Ramë Gërvalla e kuptoi se lufta për atdheun ishte e domosdoshme për ta ruajtur identitetin kombëtar dhe për të siguruar një të ardhme të lirisë për pasardhësit. Ai ishte gjithashtu një nga ata që besonte se nuk mjaftonte vetëm lufta fizike, por duhej një luftë e pandërprerë dhe e përhershme për ruajtjen e vlerave fetare dhe kombëtare. Si ushtar i Hasan Prishtinës, dhe më vonë edhe i Hoxhë Kadri Prishtinës në Komitetin "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", mulla Ramë Gërvalla luftoi për këto ideale të shenjta dhe dha kontributin e tij në mbrojtjen e Kosovës.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së mulla Ramë Gërvallës ishte angazhimi i tij në krijimin e mundësive

**Momenti më i
rendë për të
ishte kur në
pleqërinë e tij
të shtyrë i
kthehet djali
Nazmiu i
vdekur nga
ushtria jugosl-
lave, ku nga ai
moment atë e
godet edhe një
sëmundje e
rëndë dhe e pa
përbalueshme
deri në vdekje.**

për pajtimin e njerëzve. Ai ishte një nga udhëheqësit e Islahatit, një organ që kishte për qëllim pajtimin e grupeve dhe individëve të ndarë nga konflikte të ndryshme. Në këtë rol, mulla Ramë Gërvalla dha një shembull të shkëlqyer të udhëheqjes shpirtërore dhe të mençurisë, duke bërë gjithçka për të rikthyer harmoni dhe unitet në një periudhë të ndarë nga lufta dhe tensionet. Ai i udhëhoqi njerëzit që të kërkonin zgjidhje përmes paqes dhe pajtimit, duke i frymëzuar ata të gjenin rrugën e dashurisë dhe respektit reciprok. Roli i mulla Ramë Gërvallës në Islahat ishte i rëndësishëm edhe për forcimin e unitetit social dhe për ndihmën e ruajtjes së stabilitetit në një kohë të pasigurt dhe të ndarë.

Mulla Ramë Gërvalla e jetoi jetën e tij në një mënyrë të thjeshtë dhe të përlulur. Ai ishte një njeri që nuk kërkonte lavdërime për veprat e tij, por gjithmonë e konsideronte shërbimin ndaj kombit dhe fesë si një detyrë të natyrshme. Ai shërbeu për besimin dhe për atdheun pa kërkuar asgjë përveç një jete të thjeshtë dhe të devotshme. Jeta e tij ishte një shembull i pastër i përkushtimit ndaj Zotit dhe dashurisë për komb dhe atdhe.

Momenti më i rendë për të ishte kur në pleqërinë e tij të shtyrë i kthehet djali Nazmiu i vdekur nga ushtria jugosllave, ku nga ai moment atë e godet edhe një sëmundje e rëndë dhe e pa përbalueshme deri në vdekje.

Mulla Ramë Gërvalla ndërroi jetë në vitin 1954, por trashëgimia e tij vazhdon të jetë e pranishme. Ai la një ndikim të thellë në jetën shpirtërore dhe kombëtare të popullit shqiptar. Trashëgimia e tij është e lidhur me mësimet e besimit, arsimin dhe angazhimin e tij për atdheun. Mulla Ramë Gërvalla është një figurë që do të mbetet gjithmonë në zemrat dhe kujtesën e popullit shqiptar si një njeri që e kaloi jetën në shërbim të Zotit dhe të atdheut. Pas vete ai la edhe trashëgimtarët e tij, djalin Nexhipin dhe vajzën Vahiden, tani edhe këta të shkuar në botën e përtejme. Zoti i mëshiroftë dhe i shpërbleftë në Xhenet!

Mulla Ramë Gërvalla ishte një personalitet që e kaloi jetën e tij duke u përkushtuar për besimin, arsimin dhe atdheun. Ai ishte një hoxhë dhe mësues i përkushtuar, një atdhetar që dha gjithçka për të mbrojtur kufijtë dhe identitetin kombëtar, dhe një njeri që ishte gjithmonë i gatshëm të ndihmonte ata që kërkonin këshilla për të jetuar një jetë të drejtë. Ai mbetet një shembull i shkëlqyer i besimtarit të devotshëm dhe atdhetarit të paepur që do të mbetet gjithmonë i nderuar në historinë e kombit shqiptar.

1 Në vijim mulla Ramë Gërvalla.

2 Bazuar në tregimet e të moshuarve dhe nipit të tij, Rilind Gërvallës.

Muhaxhirët – ruajtësit e identitetit kombëtar përmes fesë islame

Refik Gërbeshi

Fqinjët sllavë dhe grekë, të cilët synonin pushtimin e tokave shqiptare dhe i konsideronin ato si “mbetje osmane”, ushtruan dhunë, kryen masakra dhe gjenocid, duke i detyruar banorët autoktonë shqiptarë të merrnin rrugën e hixhretit dhe të shpërnguleshin, duke lënë pas gjithçka që zotëronin.

HYRJE

Shqiptarët kanë qenë historikisht një popull me traditë të theksuar fetare, ndërsa përkatësia e tyre religjioze ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimi, në varësi të rrethanave historike dhe politike. Pas periudhave të besimeve pararendëse dhe përhapjes së krishterimit gjatë sundimit romak e bizantin, Islami filloi të përhapej në trojet shqiptare gjatë Mesjetës, duke marrë përmasa më të gjera gjatë periudhës osmane. Me kalimin e kohës, ai u shndërrua në një komponent të rëndësishëm të identitetit kulturor dhe shpirtëror të një pjese të madhe të popullsisë shqiptare, duke ndikuar në formimin e vetëdijes kolektive, të institucioneve fetare dhe të jetës shoqërore.

Pas dobësimit dhe tërheqjes së Perandorisë Osmane nga Ballkani, trojet shqiptare u ekspozuan ndaj proceseve të reja politike dhe

territoriale. Në këtë kontekst, politika ekspansioniste e shteteve fqinje, veçanërisht e Serbisë dhe Greqisë, u shoqërua me konflikte, dhunë dhe shpërngulje të popullsisë shqiptare nga disa rajone etnike. Një nga pasojat më të rënda të këtyre zhvillimeve ishte dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit gjatë viteve 1877–1878, të njohur në histori si muhaxhirët e Nishit. Pavarësisht humbjeve njerëzore dhe materiale, këto komunitete arritën të ruajnë elemente të rëndësishme të identitetit të tyre fetar, kulturor dhe kombëtar, duke i përcjellë ato ndër breza si pjesë të trashëgimisë historike shqiptare.

SHKAQET E MUHAXHIRISË NGA SANXHAKU I NISHIT

Nishi ishte një qytet shqiptar që nga lashtësia. Dëshmitë për këtë janë të pakontestueshme, duke filluar nga burimet historike e deri te vetë emërtimi i këtij



vendbanimi. Në epokën e hekurit, në trevën e Nishit dhe përgjatë rrugës antike Naissus–Lissus (Nish–Lezhë) u ngrit një varg vendbanimesh në kodra dominuese, të cilat dëshmojnë për vazhdimësinë e jetës dhe zhvillimin e hershëm të kësaj hapësire.¹

Lufta Ruso-Osmane dhe pozicionimi i Serbisë dhe Malit të Zi në anën e Rusisë, bënë që në vitin 1877 të zhvilloheshin luftime të ashpra ndërmjet këtyre shteteve dhe Perandorisë Osmane. Megjithatë, pasojat më të rënda i përjetoi populli shqiptar, pasi luftimet u zhvilluan kryesisht në trevat shqiptare të Sanxhakut të Nishit, i cili në atë kohë bënte pjesë në Vilajetin e Kosovës.

Këto luftëra ndikuan ndjeshëm në dobësimin e Perandorisë Osmane, pjesë përbërëse e së cilës ishin edhe shqiptarët, të cilët kontribuonin si në administratën shtetërore, ashtu edhe në ushtrinë perandorake. Para shpërnguljes së muhaxhirëve, shqiptarët gëzonin mbrojtjen e Perandorisë Osmane nga sulmet e bandave serbe, të cilat kishin filluar të ushtronin dhunë dhe terror ndaj popullsisë shqiptare. Kjo dëshmohet edhe nga dokumentet e kohës, të cilat flasin për përgatitjet që bëheshin për t'u dalë në ndihmë banorëve të Nishit. Në një prej tyre thuhet: "Do të arrihet fitore kundër banditëve serbë nëse një serasqer me reputacion në Nish, me 30 ushtarë, i del në ndihmë Valiut të Bosnjës dhe nëse vjen Malik Pashë Prishtina me 10 mijë ushtarë."²

Serbia dhe Mali i Zi, pasi shpallën pavarësinë e tyre shtetërore, u rreshtuan menjëherë në anën e Rusisë me synimin për t'i realizuar aspiratat e tyre ekspansioniste ndaj trojeve etnike shqiptare. Në anën tjetër, shqiptarët nuk gëzonin mbështetjen e asnjërës prej perandorive apo Fuqive të Mëdha, duke mbetur të vetmuar përballë zhvillimeve politike dhe ushtarake të kohës.

Me tërheqjen e ushtrisë osmane nga këto troje, Serbia, nën vështirimin e Fuqive të Mëdha dhe me miratimin ose tolerimin e tyre, ndërmori politika të spastrimit etnik ndaj popullsisë shqiptare. Këto veprime u shoqëruan me dhunë sistematike, dëbime masive dhe shpronësime, duke detyruar mijëra shqiptarë të braktisnin vendbanimet e tyre shekullore.

Në periudhën e dobësimit të Perandorisë Osmane, trojet shqiptare u përballën me rrezikun e copëtimit dhe uzurpimit nga shtetet ballkanike, të cilat tashmë kishin krijuar shtetet e tyre kombëtare dhe kishin hartuar strategji për zgjerim territorial. Në këtë kontekst, Lëvizja Kombëtare Shqiptare u përball jo vetëm me ambiciet e shteteve fqinje, por edhe me presionin politik dhe diplomatik të Fuqive të Mëdha, të cilat, përmes vendimeve të tyre, ndikuan drejtpërdrejt në fatin e trojeve shqiptare.³

Pas humbjes në luftë, ushtria osmane u detyrua të tërhiqej nga këto troje, ndërsa Serbia ndërmori një fushatë të gjerë terrori, masakrash, gjenocidi dhe spastrimi etnik ndaj popullsisë shqiptare. Si pasojë e kësaj politike, popullsia autoktone shqiptare u dëbua me dhunë dhe vendbanimet shqiptare të këtij rajoni u zbrazën pothuajse tërësisht.

Shumica e shqiptarëve u shpërngulën me forcë, duke u drejtuar qoftë kah Lindja, qoftë kah Perëndimi, ndërsa një pjesë e madhe gjetën strehim në Kosovë. Rajoni i Sanxhakut të Nishit, i cili në atë kohë bënte pjesë në Vilajetin e Kosovës, përfshinte vendbanime me shumicë shqiptare si Toplica, Nishi, Prokupla, Kurshumlia dhe Vranja. Këto treva iu nënshtuan një procesi të dhunshëm spastrimi etnik nga Serbia gjatë viteve 1877–1878. Gjatë kësaj periudhe, mijëra shqiptarë u vranë, u masakruan, u burgosën, u shfarosën ose u dëbuan në mënyrë masive nga trojet e tyre stërgjyshore. Sipas të dhënave historike, në këtë rajon u zhdukën plotësisht 57 vendbanime shqiptare dhe u dogjën rreth 6.050 shtëpi, duke lënë pasojat më të rënda demografike, shoqërore dhe kulturore për popullsinë shqiptare.⁴

Përkatësia islame e shqiptarëve ishte një ndër faktorët që ndikoi në mungesën e mbështetjes nga Fuqitë e Mëdha të kohës. Si pasojë, politikat gjenocidiale dhe etnocidiale të shtetit serb shkaktuan shpërngulje masive dhe vrasje të mijëra shqiptarëve. Këto zhvillime u përforcuan pas vendimeve të Kongresit të Berlinit, i cili ia kaloi rajonin e Toplicës administrimit serb.

Popullsia shqiptare e këtyre trevave përjetoi masakra dhe dëbime të dhunshme, duke u detyruar të largohej drejt Vilajetit të Kosovës dhe viseve të tjera osmane. Lufta Ruso-Serbo-

Me tërheqjen e ushtrisë osmane nga këto troje, Serbia, nën vështirimin e Fuqive të Mëdha dhe me miratimin ose tolerimin e tyre, ndërmori politika të spastrimit etnik ndaj popullsisë shqiptare. Këto veprime u shoqëruan me dhunë sistematike, dëbime masive dhe shpronësime, duke detyruar mijëra shqiptarë të braktisnin vendbanimet e tyre shekullore.

Osmane (1877–1878), e zhvilluar kryesisht në Sanxhakun e Nishit, përbën shkakun kryesor të këtij eksodi.

Për shkak të tërheqjes së ushtrisë osmane, forcat serbe pushtuan Nishin, Kurshumlinë, Prokuplën, Vranjën, Leskocin dhe Pirotin. Si rrjedhojë, popullsia shqiptare u dëbua nga trojet e saj dhe u shpërnda kryesisht në Kosovë, Maqedoni dhe në pjesë të tjera të Perandorisë Osmane, duke u shndërruar në muhaxhirë..

Shpërngulja u zhvillua në kushte jashtëzakonisht të rënda, gjatë dimrit të ashpër, duke i detyruar shqiptarët të braktisnin shtëpitë dhe vatrën e tyre në një kohë shumë të shkurtër. Ata nuk patën mundësi të merrnin me vete pasurinë apo sendet e nevojshme, madje në shumë raste u larguan pa u veshur siç duhej, të detyruar të niseshin menjëherë për të shpëtuar jetën e tyre dhe të familjeve të tyre.⁶

Gjenocidi i ushtruar ndaj shqiptarëve të këtyre trojeve është i dokumentuar edhe nga studiues dhe udhëpërshkrues evropianë, të cilët kanë lënë dëshmi për dhunën, masakrat dhe dëbimet masive të popullsisë shqiptare. Megjithatë, në shumë dokumente dhe historiografi zyrtare, veçanërisht në burimet serbe, këto krime janë heshtur, minimizuar ose paraqitur në mënyrë të njëanshme.

Edhe në historiografinë shqiptare, kësaj shpërnguljeje të dhunshme masive dhe pasojave të saj nuk i është kushtuar gjithmonë hapësira e merituar, ndonëse në botime të ndryshme evidentohen qartë aktet e gjenocidit dhe të spastrimit etnik të kryera ndaj popullsisë shqiptare të Sanxhakut të Nishit.

Me kalimin e kohës, edhe një pjesë e studiuesve evropianë kanë filluar t'i trajtojnë këto ngjarje në mënyrë më objektive, duke bërë dallimin ndërmjet pretendimeve politike dhe realitetit historik të dokumentuar. Kjo ka ndihmuar në nxjerrjen në pah të së vërtetës për fatin tragjik të shqiptarëve të dëbuar nga trojet e tyre stërgjyshore dhe për pasojat afatgjata që kjo tragjedi la mbi popullsinë shqiptare.

PERIUDHAT E MUHAXHIRËVE SHQIPTARË

Periodhat e shpërnguljeve të muhaxhirëve nga Sanxhaku i Nishit, por edhe nga troje të tjera shqiptare, kanë qenë të shumta dhe pothuajse në çdo shekull, populli shqiptar është përballur me migrime të detyruara dhe dëbime masive.

Një nga valët më të mëdha të shpërnguljeve ndodhi gjatë dimrit të viteve 1877–1878 dhe verës së vitit 1878. Burime të ndryshme japin të dhëna të ndryshme për numrin e të dëbuarve, duke përmendur shifra nga 30.000 deri në 83.000 banorë, ndërsa disa studiues vlerësojnë se numri i shqiptarëve të shpërngulur arriti deri në rreth 200.000. Pjesa më e madhe e tyre u vendosën në Kosovë, ku u njohën me emrin muhaxhirë.

Shpërngulja e dhunshme i detyroi shqiptarët të merrnin rrugë të ndryshme të ikjes. Një pjesë u drejtua nga Qystendili në Bullgari, ndërsa të tjerët kaluan në këmbë përmes trevës së Gollakut. Duke qenë se dëbimi ndodhi gjatë një dimri tepër të ashpër, shumë prej tyre humbën jetën nga të ftohtit, uria dhe lodhja gjatë rrugës. Shumica e këtyre muhaxhirëve nuk arritën të ktheheshin më kurrë në vatrën e tyre stërgjyshore.

Periodha 1876–1878 konsiderohet si një nga etapat më të rënda të migrimeve të detyruara të shqiptarëve, ku sipas disa vlerësimeve numri i të shpërngulurve arriti në rreth 350.000 persona. Valët e dëbimeve vazhduan edhe gjatë Luftërave Ballkanike dhe në vitet 1912–1915, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe u vranë dhe u masakruan rreth 150.000 shqiptarë, ndërsa shumë të tjerë kërkuar strehim në territoret e Perandorisë Osmane. Një numër i konsiderueshëm i muhaxhirëve nga Sanxhaku i Nishit u vendosën përfundimisht në Kosovë.

Një tjetër periudhë e rëndësishme e shpërnguljeve përfshin vitet 1918–1941, pas largimit të forcave austro-hungareze dhe bullgare nga këto troje. Gjatë kësaj kohe, si pasojë e



politikave shtypëse dhe gjenocidiale të Mbretërisë Jugosllave në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, ekonomike dhe politike, sipas të dhënave të autorëve të ndryshëm, për në Turqi u dëbuan rreth 276.498 shqiptarë.⁷

Periodha e viteve 1945–1970 karakterizohet gjithashtu me vazhdimin e shpërnguljeve të shqiptarëve, të cilat u nxitën përmes formave të ndryshme të presionit dhe dhunës, me qëllim të detyrimit të tyre për t'u larguar nga trojet e tyre. Pas Luftës së Dytë Botërore, shumë shqiptarë vazhduan të emigronin drejt Turqisë, ku pjesa më e madhe e të shpërngulurve vinin nga Kosova, Maqedonia dhe Çamëria.

Në hapësirën e ish-Jugosllavisë, pas masakrës së Tivarit, u shënuan edhe veprime të tjera të rënda dhe represive ndaj popullsisë shqiptare. Ndër to veçohet i ashtuquajtimi “Aksioni i armëve”, i zhvilluar gjatë dimrit të viteve 1955–1956, i cili u shoqërua me kontroll të ashpër, presion dhe arrestime, duke ndikuar në rritjen e pasigurisë dhe intensifikimin e shpërnguljeve të shqiptarëve drejt Turqisë dhe vendeve të tjera.⁸

MUHAXHIRËT I QËNDRUAN BESNIKË ISLAMIT DHE SHQIPTARISË

Elementi islam në këto troje vërehet që nga shekulli VIII, pasi pozita gjeografike e këtyre hapësirave mundësonte lëvizje dhe kontakte të ndryshme kulturore e tregtare, duke lënë gjurmë edhe para periudhës osmane. Në këtë kontekst përmendet viti 1281 dhe figura e Sari Salltëkut, një mendim i mbështetur nga një numër studiuesish, ndër ta Hasan Kaleshi, Baki Dollma, Nexhat Ibrahim, Qemajl Morina dhe Halil İnalçık, etj..

Sipas këtyre studiuesve, kultura dhe prania islame në trojet shqiptare mund të jetë më e hershme sesa është pretenduar nga disa autorë, të cilët mendojnë se Islami është përhapur vetëm pas ardhjes së osmanlinjve. Në këtë mënyrë, një pjesë e historiografisë thekson se procesi i kontakteve me botën islame në hapësirën shqiptare ka qenë gradual dhe i ndërlikuar, duke mos u kufizuar vetëm në periudhën osmane.⁹

Islami në Ballkan është konsideruar nga disa autorë si më i hershëm se ardhja e osmanlinjve, duke u mbështetur në pozitën gjeografike të rajonit dhe në rrjetin e rrugëve tregtare, si rruga “Egnatia”, përmes së cilës zhvilloheshin lëvizje të

Pas largimit të Perandorisë Osmane, trojet shqiptare mbetën të copëtuara, megjithatë gjurmët e identitetit islam dhe shqiptar nuk mundën të zhdukeshin tërësisht. Paraardhësit tanë, të besimit islam, u kujdesën që të linin pas dëshmi të shumta për ekzistencën dhe praninë e tyre në këto troje arbërore.

shumta tregtare dhe kulturore. Gjithashtu, përmenden edhe dervishë dhe misionarë që kalonin ose qëndronin në këto hapësira, duke ndikuar në kontaktet e hershme me botën islame.

Në këtë kuadër, disa burime historike dhe interpretime të caktuara theksojnë se: “Shqiptarët kishin filluar ta praninin fenë islame para se Shqipëria të binte nën sundimin osman.”¹⁰

Feja islame për shqiptarët ka qenë një element identifikues dhe dallues në raport me fqinjët, të cilët, sipas disa interpretimeve, fenë e kishin më shumë të lidhur me autoritetin politik të kohës sesa me bindjen e thellë ndaj mësimave fetare. Pas ndryshimeve historike dhe largimit të sundimit osman, në disa raste janë shënuar edhe shkatërrime apo ndryshime të objekteve fetare, përfshirë xhamitë, si dhe uzurpime të tyre.

Megjithatë, shqiptarët kanë ruajtur vazhdimësinë e besimit të tyre dhe përkushtimin ndaj Islamit. Nuk ka dyshim se feja është një komponent i rëndësishëm në jetën shpirtërore të çdo populli dhe luan rol të rëndësishëm në formimin e vetëdijes shoqërore e kulturore, përfshirë edhe atë të popullit të Kosovës.

Ky ndikim i fesë në jetën shoqërore ka ndryshuar varësisht nga rrethanat historike, duke qenë në disa periudha më i theksuar dhe në disa të tjera më pak i pranishëm në jetën publike dhe shoqërore.¹¹

Pas largimit të Perandorisë Osmane, trojet shqiptare mbetën të copëtuara, megjithatë gjurmët e identitetit islam dhe shqiptar nuk mundën të zhdukeshin tërësisht. Paraardhësit tanë, të besimit islam, u kujdesën që të linin pas dëshmi të shumta për ekzistencën dhe praninë e tyre në këto troje arbërore.

Ndër këto dëshmi përfshihen nishanet në varreza, xhamitë, teqetë, tyrbet, çezmat, urat dhe objekte të tjera të trashëgimisë kulturore e fetare. Këto monumente përbëjnë një vlerë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme për studiuesit e historisë, kulturës dhe trashëgimisë fetare të Kosovës dhe më gjerë.¹²

Muhaxhirët shqiptarë përjetuan gjenocid dhe u detyruan të braktisin vatrat e tyre stërgjyshore, por dashuria dhe kujdesi për identitetin e tyre nuk u zbehën. Ata mbetën atje ku i sollën stuhitë e përndjekjes, por vendlindjen nuk e harruan.

Në shenjë kujtimi dhe lidhjeje me origjinën e tyre, pothuajse çdo familje muhaxhire ruajti si mbiemër ose si emërtim familjar emrin e fshatit të braktisur me dhunë, duke e kthyer atë në një simbol të vazhdimësisë së identitetit dhe kujtesës historike.¹³

HOXHALLARËT – BARTËSIT KRYESORË TË RUAJTJES SË FESË E KOMBIT

Për ekzistencën e Zotit dhe besimin në Një të Vetmin, dëshmojnë melaqet dhe dijetarët. Nga Kurani kuptojmë se, pas melaqeve, për Njëshmërinë e Allahut dëshmojnë edhe dijetarët dhe hoxhallarët, të cilët kontribuojnë në përhapjen e këtij besimi dhe në përcjelljen e tij te gjeneratat e ardhshme.

Allahu i Lartësuar në Kuranin famëlartë thotë: “Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe melaqet e dijetarët dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit.” (Ali Imran, 18).

Allahu i Lartësuar ka dërguar të zgjedhurit e Tij (pejgamberët), të cilët kanë për mision transmetimin e mesazhit hyjnor te njerëzit. Ndërsa dijetarët islamë dhe hoxhallarët, të cilët i mësojnë njerëzit me këto mësimë, konsiderohen trashëgimtarë të pejgamberëve.

Edhe Muhamedi a.s., e ka sqaruar këtë kuptim në një hadith të njohur, ku thotë: “Vërtet, dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi dinarë as dërrhemë, por kanë lënë si trashëgimi dijen. Prandaj kush e merr atë, le ta marrë në përmasën më të madhe.”¹⁴

Hoxhallarët, si trashëgimtarë të pejgamberëve, kanë bartur misionin e dijes dhe udhëzimit, por edhe sfidat e përndjekjes, përbuzjes dhe persekutimit. Megjithatë, ata mbetën figura me ndikim të madh moral, fetar dhe shoqëror, duke luajtur rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit islam dhe kombëtar të shqiptarëve.

Në periudha të caktuara historike, veçanërisht gjatë regjimit komunist, kontributi i tyre u minimizua ose u shtrembërua nga historiografia zyrtare. Shumë prej tyre u përballën me ideologjinë ateiste dhe politikën asimiluese, ndërsa dokumente të ndryshme dëshmojnë dënimet që morën për kundërshtimin e projekteve serbe ndaj shqiptarëve.

Sipas burimeve historike, qindra hoxhallarë nga viset shqiptare lanë gjurmë të rëndësishme në mbrojtjen e çështjes kombëtare gjatë viteve 1941–1945. Ata u dalluan për ruajtjen e besimit, familjes dhe identitetit kombëtar, duke mos u tërhequr nga idealet e lirisë dhe bashkimit.

Shumë familje muhaxhirësh sollën me vete traditë të fortë islame dhe figura të njohura fetare, të cilat luajtën rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit fetar e kombëtar shqiptar. Ndër ta përmendet Rustem efendi Pllana – Bellaçevci, i dëbuar nga Prokupla gjatë viteve 1877–1878. Hoxhallarët muhaxhirë shërbyen si imamë, mësues dhe regjistruar civilë, duke ushtruar ndikim të madh në jetën

shoqërore. Nga radhët e tyre dolën edhe figura të shquara si mulla Abdylqerimi, mulla Ahmet efendi Mardoçi, mulla Adem efendi Simnica dhe mulla Rustem efendi Pllana, të arsimuar në qendra të njohura të dijes islame, përfshirë Stambollin. Nga fshati Bardh i Madh përmendet edhe mulla Adem efendi Xhigoli, si dhe mulla Sali Rrmoku nga Stublla, i cili më vonë veproi edhe në Prishtinë, duke kontribuar në jetën fetare dhe shoqërore të kohës.¹⁷

Këta u pasuan nga hoxhallarët e periudhës së mëvonshme, ndër të cilët përmenden: myderriz Sadri Prestreshi, mulla Emin Statovci, mulla Sherif Ahmeti dhe mulla Adem Tërnavë, si dhe pasardhësit e tyre, të cilët njihen edhe përmes mbiemrave dhe vazhdimësisë familjare.

Këta dijetarë dhe prijës fetarë vazhduan traditën e mësimdhënies islame, duke kontribuar në ruajtjen e identitetit fetar dhe kulturor të komunitetit shqiptar në periudha të ndryshme historike.

- 1 Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtina, Fushë-Kosova dhe Kastrioti, Prishtinë, 2003, cit., f. 67.
- 2 Besir Neziri, Katalogu i dokumenteve osmane në Arkivin Komunal të Prishtinës, cit. 189, data: 9.III.1807.
- 3 Për shkak të interesave të tyre, Fuqitë e Mëdha anonin që ta ruanin Status Quon për Perandorinë dhe hartën politike të Ballkanit që u vendos në kongresin e Berlinit. Shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Grup autorësh, Historia e Popullit Shqiptar II, Shtëpia botuese: “Toena”, viti: 2002, Tiranë, f. 231.
- 4 Katalogu_DEBIMI-I-SHQIPTAREVE-NGA-SANXHAKU-I-NISHIT-1877-78.pdf
- 5 Naim ef. Tërnavë, Ligjërime për fenë e Atdehun II, Prishtinë, 2015, f. 68.
- 6 Sabit Uka, Muhaxhirët shqiptarë të shpërngulur 1877-1878 nga sanxhaku i Nishit, art. i cit në “Dituria Islame”, nr. 46, viti VIII, Prishtinë, f. 22.
- 7 Hakif Bajrami, Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës, (1844-1995), Prishtinë, 1995, f. 20.
- 8 Jusuf Osmani, Shqiptarët në Sanxhakun e Nishit Muhaxhirët, Libri 6, Prishtinë, 2021, f. 33.
- 9 Nexhat Cocaj, Adresa e mbijetesës-kontributi i xhamisë së Krumës në luftën e UCK-së, f. 46.
- 10 Nehat Krasniqi, Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale, Instituti Albanologjik, 2017, Prishtinë, f. 71.
- 11 Qemajl Morina, Feja si faktor për të ardhmen e Kosovës, “Dituria Islame”, nr. 200, Prishtinë, 2007, f. 4.
- 12 Fakulteti i Studimeve Islame Prishtinë, Epitafet në gjuhën osmane, deshifrimi dhe përkthimi i tyre I, Regjioni i Prishtinës, Përgatiti për botim: Agron Islami, Selim Selimi, Hatixhe Ahmeti, Prishtinë, 2017, f. 7.
- 13 Shemsi Mehmeti, Të huaj në tokën e vet, Prishtinë, 1996, f. 9.
- 14 Transmetojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.
- 15 Dr. Muhamed Piraku, “Mulla Idriz Gjilani shëmbëlltërrë kombëtare”, Revista “Dituria Islame”, nr. 49, f. 30.
- 16 Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmeti, Ramadan Shkodra, Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane, (1880-1912) Sipas Dokumenteve të Meshihatit të Iartë Osman, Prishtinë, 2021, f. 68-69.
- 17 Sabit Uka, Disa të dhëna të përgjithshme historike për Shqiptarët e Sanxhakut të Nishit, Prishtinë, 2004, f. 107.

Beogradi – qytet i xhamive dhe minareve

Dr. Azmir Jusufi

Beogradi, si një nga qytetet më të mëdha në Ballkan, ka qenë historikisht një vendtakim i kulturave, feve dhe qytetërimeve të ndryshme. Një periudhë veçanërisht e rëndësishme është koha e sundimit osman, kur qyteti përjetoi zhvillim të madh dhe u bë i njohur për xhamitë e tij të shumta, teqetë dhe traditën e pasur islame. Beogradi ra nën sundimin osman në vitin 1521 gjatë sundimit të Sulltan Sylejmanit, duke hapur rrugën për zgjerimin e mëtejshëm të osmanëve në Evropë. Ky tekst tregon zhvillimin historik të Beogradit në atë periudhë dhe gjurmët e kulturës islame që kanë mbetur edhe sot e kësaj dite.

BEOGRADI NËN OSMANËT

Kur mori pushtetin në vitin 1520, Sulltan Sylejmani, i vendosi vetes qëllimin për ta pushtuar Beogradin, diçka që paraardhësit e tij nuk kishin arritur ta bënin. Një vit më vonë ai ia doli dhe Beogradi më në fund ra më 28 gusht 1521.¹ Përshkrimi i pushtimit të Beogradit në vitin 1521 dhe i përfundimit të administrimit hungarez mbi qytet në vitin 1521 në historiografinë sllave mbështetëj kryesisht në informacione nga kronikat narrative të shekullit XVI dhe të mëvonshme, ndër të cilat bie në sy kronika moraliste e priftit hungarez Georgius Sirmiënsis (1490–1548).²

Pas betejave të gjata dhe të përgjakshme në të cilat ai pësoi humbje të mëdha, por gjatë të cilave u plagos edhe ai vetë, Mehmedi II vendosi të tërhiqej. Beogradi arriti që të rezistonte edhe një herë. Me urdhër të Papës Callisto III, kambanat e mesditës në kisha e festojnë këtë ngjarje edhe sot e kësaj dite.³

Në shekullin XV, kur Kalaja e Beogradit arriti t'i rezistonte sulmeve turke, ky qytet konsiderohej jo vetëm “çelësi i Hungarisë”, por edhe “bastioni i krishterimit”. Dhe kur, në gusht të vitit 1521, Sulltan Sylejmani e theu rezistencën e garnizonit të Beogradit, Evropa ishte e vetëdijshme se turqit kishin thyer portën që i pengonte ata të shtriheshin mbi rajonin e Danubit dhe ajo dridhej nga frika.⁴

QYTETI I XHAMIVE DHE MINAREVE

Sipas udhëpërshkruesit të madh osman Evlija Çelebiut, në Beograd dikur kishte rreth 270 mesxhide dhe xhami. Megjithatë, gjatë pushtimit të parë austro-gjerman (1688–1690), shumë xhami të Beogradit u shkatërruan dhe ato që mbetën të padëmtuara u shndërruan në kisha. Ndërsa Felix Kanitz, udhëpërshkrues, arkeolog, gazetar dhe ilustrues, duke qëndruar në Beograd në vitin 1861, përmend: “Kishte 15 minare në qytet dhe qytezë”. I njëjti shkrimtar konstaton në vitin 1887 “nga 15 xhamitë e Beogradit gjeta

Sipas udhëpërshkruesit të madh osman Evlija Çelebiut, në Beograd dikur kishte rreth 270 mesxhide dhe xhami.

vetëm një xhami, “Xhaminë e Bajraklisë” në rrugën e Jevremovës”. Sipas një plani turk të qytetit dhe qytezës së Beogradit, i cili daton nga viti 1863, figuruan 12 xhami dhe tri teqe, si më poshtë: Xhamia e Hasan Pashës në pjesën e poshtme të qytetit, Xhamia e Sulltan Mehmedit në pjesën e epërme të qytetit, Xhamia e Sulltan Mustafës, Xhamia e Ali Pashës, Xhamia e Bajraklisë, Xhamia Reis-Efendiut, Xhamia e Laz-Oglisë, Xhamia e Jahja Pashës, Xhamia e Deftedarit, Xhamia e Laz-Haxhi Mahmudit, Xhamia e Kizlar Agës, Xhamia Bajram Beut.⁵

Sot, ekziston vetëm një xhami në territorin e Beogradit, Xhamia e Bajraklisë, në rrugën e Jevremovës 11, e cila është ndërtuar rreth vitit 1575. Xhamia fillimisht quhej Çohaxhi xhamia, sipas bamirësit, tregtarit të Çohës, haxhi Alisë. Në fund të shekullit XVIII, ajo është emërtuar Xhamia e Bajraklisë, sipas flamurit që ngrihej mbi të si shenjë për fillimin e njëkohshëm të namazit në të gjitha xhamitë. Pas restaurimit në shekullin XIX, të ndërmarrë nga princat serbë, ajo u bë xhamia kryesore e qytetit. Edhe sot, është i vetmi vend aktiv i adhurimit islam në qytetin e Beogradit.⁶

Xhamia e Tyrbes në Beograd, e njohur si e Habil Efendiut, ndodhej përballë pallatit të vezirit, dhe kështu u vizatua në planin italian dhe të Gumpit, nga fundi i shekullit XVII. Në oborrin e xhamisë, u varros trupi i Kara Mustafa Pashës, pas dështimit katastrofik të fushatës kundër Vjenës dhe ekzekutimit të tij në vitin 1683 me urdhër të Sulltanit – ai u

mbyt me gërshetë mëndafshi, dhe koka e tij u dërgua në Edrene në duart e Sulltanit, dhe u varros në varrezat kryesore.⁷

Në vendin e Kuvendit Kombëtar të sotëm, gjendej Xhamia Batalit (Xhamia e Ejnehan Beut), e cila ishte xhamia qendrore/kryesore në Beograd.⁸ Në aspektin arkitekturor, ishte një ndërtesë monumentale që dallohej për masivitetin dhe madhësinë e saj. Ajo u shkatërrua më 17 maj 1869.⁹

Xhamia e Sulltan Sylejmanit në pjesën e epërme të qytetit, e cila zinte një pozicion dominues në panoramën e Beogradit. Ishte më e madhja dhe më e bukura, projektuesi i saj, sipas Evlija Çelebiut, ishte arkitekti më i madh turk Sinani. Viti i saktë i ndërtimit nuk dihet, por mund të supozohet se ishte nga fundi i shekullit XVI. Ajo u shkatërrua gjatë sundimit austriak në Beograd 1717-39.

Xhamia e Mehmed Pashë Jahjapashiqit (Xhamia e Imaretit) u ndërtua në vitet 1548-49. Ajo u ndërtua nga Mehmed Pashë Jahjapashiqi, Sanxhak Beu i Smederevës. Gjatë pushtimit austriak, xhamia shërbeu si kishë françeskane. Ajo u rindërtua në vitin 1741 dhe u shkatërrua në vitin 1878.

Xhamia e Bajram Beut u ndërtua midis viteve 1557 dhe 1560 në cep të rrugëve të sotme Dositejeva dhe Vëllezërve Jugoviq, në bllokun e Teatrit Kombëtar. Ajo ndodhej si pjesë e ndërtesave publike të ngritura nga Bajram Beu, Sanxhak Beut të Smederevës. Me ndërtimin e Teatrit Kombëtar në vitin 1869, ajo u shndërrua në një impiant gazi për ndriçimin e teatrit.¹⁰



në Beograd në vitin 1862 kishte 2,328 ndërtesa dhe shtëpi, nga të cilat 842 ishin serbe dhe pothuajse dy herë më shumë shtëpi myslimane (1,486).

MONUMENTET E KULTURËS ISLAME NË BEOGRAD


Në Beograd ekzistojnë teqetë, të cilat janë institucione fetare historike të lidhura me rendet e dervishëve. Siç mësojmë nga udhëtimi i famshëm i Evlija Çelebijut, ndërsa qëndronte në Beograd në vitin 1660, kishte deri në shtatëmbëdhjetë teqe në atë qytet.¹¹ Dervishët kishin edhe rrugën e tyre në Beograd të quajtur Rruga e Dervishëve, e cila ndodhej në Dorqol (fjala turke për udhëkryq) dhe në të cilën ndodhej një nga ndërtesat më të vjetra sufiste në Beograd - Teqeja e Mehmed Pashë - Jahjaliut.¹²

Në Beograd, qysh në vitin 1863, mund të shiheshin të paktën katër nga këto dhjetë teqetë, dhe një nga më të rëndësishmet, Teqeja e Haxhi-Shejh Muhamedit, tyrbja e të cilit është ruajtur dhe ndodhet në ish-oborrin e asaj shtëpie. Ajo u takonte dervishëve të rendit Kadiri.¹³

Hamami në Beograd ndodhet në pjesën e poshtme të qytetit, afër portës lindore të Kalemegdanit. Ai u ngrit në shekullin XIX, mbi rrënojat e barut'hanës. Gjatë Luftës së Parë Botërore, hamami shërbeu si një banjë ushtarake, por më vonë u rrënuar dhe u shkatërrua pjesërisht nga një shpërthim në Portën Lindore gjatë një bombardimi anglo-amerikan në vitin 1944. Në vitin 1962, pas themelimit të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të qytetit të Beogradit, filloi rinovimi i hamamit si objekt i pronave monumentale të padiskutueshme.¹⁴

Nga shkrimet e vjetra dhe dokumentet historike nga gjysma e dytë e shekullit XIX, mund të shihet se myslimanët banonin në pjesë të mëdha të Serbisë së sotme. Kështu, në Beograd në vitin 1862 kishte 2,328 ndërtesa dhe shtëpi, nga të cilat 842 ishin serbe dhe pothuajse dy herë më shumë shtëpi myslimane (1,486). Pas trazirave në rrugët e Beogradit në vitin 1862, njerëzit u larguan nga qyteza, e cili ishte kryesisht myslimane, në Kalanë e Beogradit.¹⁵

Në gjysmën e parë të shekullit XIX, pas marrjes së hatisherifit nga Sulltan Mahmudi II, Serbia mori statusin e Principatës, duke u bërë një territor vasal në raport me Perandorinë Osmane. Në të njëjtën kohë, udhëheqësit serbë punuan për të transformuar autonominë e brendshme që kishte nën dokumentet osmane, në një shtet të pavarur.



Veprime të ndryshme të organizuara u ndërmorën për të dëbuar myslimanët nga zonat nën administrimin e Principatës së Serbisë, veçanërisht pas fitimit të autonomisë brenda Perandorisë Osmane, kështu që një dëbim masiv i myslimanëve filloi në tetor të vitit 1830 dhe zgjati deri në vitin 1834 - faza e parë, dhe në periudhën 1862-1867 pasoi faza e dytë e dëbimit.¹⁶

- 1 <https://www.011info.com/istorija-beograda/beograd-u-poznom-srednjem-veku-prvi-put-pod-srpskom-vlascu>.
- 2 Adnan Kadrić, "Opis Husrev-bega i njegove uloge u osvajanju Beograda..." Kulturno-historijski tokovi u Bosni 15-19. stoljeća (Zbornik radova), Institut orientali, (Sarajevë, 2022), 131.
- 3 <https://www.011info.com/istorija-beograda/beograd-u-poznom-srednjem-veku-prvi-put-pod-srpskom-vlascu>.
- 4 Radovan Samardžić, Beograd pod Turcima, (Beograd, 1954), 3.
- 5 <https://sandzakpress.net/arhiva/gdje-su-217-dzamiya-u-beogradu/>.
- 6 <https://tutinpress.rs/koliko-je-beograd-nekada-imao-dzamiya-a-koliko-ih-ima-danas/>.
- 7 <https://ndhhd2.jimdofree.com/srbija/beograd-turbe-d%C5%BEamija/>.
- 8 <https://www.rijaset.org/index.php/islam/islamske-teme/258-minber-nas-podseca-batal-dzamiya>.
- 9 <https://ndhhd2.jimdofree.com/srbija/protjerivanje-muslimana-1830-1834-1862-1867/>.
- 10 <https://mesihat.org/2017/07/12/dzamiye-u-beogradu/>.
- 11 <https://bosnjaci.rs/beogradske-tekije-tarikati-sejhovi/>.
- 12 <https://www.europeana.eu/hr/stories/the-tuerbe-tomb-of-sheikh-mustafa-in-belgrade>.
- 13 <https://bosnjaci.rs/beogradske-tekije-tarikati-sejhovi/>.
- 14 <https://ndhhd2.jimdofree.com/srbija/hamami-u-srbiji/>.
- 15 <https://ndhhd2.jimdofree.com/srbija/protjerivanje-muslimana-1830-1834-1862-1867/>.
- 16 I njëjti burim.

Vështrim i shkurtër mbi inkuizicionin spanjoll

Sumeja Tahiri

Rreth prejardhjes së fjalës “Andaluzi”, jepen shumë mendime, por më i njohuri është ai se...ka kaluar në arabisht nga Vandalusia, që do të thotë “vendi i vandalëve”.

HYRJE

Për t'u futur në një ndër temat më të ndjeshme të historisë së njerëzimit, që në rastin tonë kemi përzgjedhur ta trajtojmë atë të inkuizicionit spanjoll në Andaluzi, është e udhës t'ia nisim nga e para. Si doli në skenë Andaluzia? Nga rrjedh ky emër? Kujt i përkiste ky shtet dhe ku është sot?

Rreth prejardhjes së fjalës “Andaluzi”, jepen shumë mendime, por më i njohuri është ai se...ka kaluar në arabisht nga Vandalusia, që do të thotë “vendi i vandalëve”.¹ Arabët u drejtoheshin me këtë emër Al Andalus zonës së Gadishullit Iberik.² Pra, në Andaluzi, para se të shkelnin në ato toka myslimanët në krye me Tarik ibën Zijadin, në vitin 711, jetonin vizigotët. Ai që dërguar nga emiri Musa ibën Nusajri. Tarik ibën Zijadi depërtoi në Andaluzi duke kapërcyer ngushticën e Gjibraltarit, e që faktikisht, emri i saj rrjedh nga kjo ngjarje historike. Pra, Xhebelu Tarik – Kodra e Tarikut. Ai me ushtrinë e tij të

përbërë nga afro 12 mijë ushtarë, zhvilloi luftë kundër vizigotëve me në krye mbretin e tyre, Rodrikun, luftë e cila rezultoi me fitoren e myslimanëve duke ua hapur në këtë mënyrë rrugën për në Andaluzi. Në këtë formë, Andaluzia ra në dorë të myslimanëve për disa shekuj me radhë. Pastaj, sundimi iu kaloi inkuizitorëve për të cilët do të diskutojmë gjatë temës. Sidoqoftë, pasi sundimi u kaloi myslimanëve në vitin 711, vlen të theksohet se një numër i madh prej të krishterëve dhe hebrenjve që jetonin aty, u konvertuan në Islam me vullnet të plotë. Mbase kjo ka ndodhur falë përshtypjeve pozitive ndaj Islamit që u formuan përmes tolerancës fetare të treguar nga individët e kësaj bashkësie, unitetit midis tyre, apo thjesht sepse Islami ofroi një mënyrë jetese më të pastër, të sigurt dhe të shëndetshme për njerëzit, që deri atëherë jetonin nën kulmin e një sistemi të korruptuar e në shkatërrim e sipër.



MYSLIMANËT, HEBRENJTË DHE TË KRISHTERËT NË ANDALUZI


Bashkësitë më të njohura jomyslimane në Andaluzi ishin hebrejtë dhe të krishterët. Këta, qheshin ehlu dhimmeh (njerëz të librit), e si të tillë, u njihej e drejta të praktikonin fenë e tyre dhe t'i ruanin objektet e tyre fetare. Po ashtu, edhe në aspektin profesional, gëzonin liri, madje ishin të angazhuar në sfera të ndryshme, në pozita të larta e prestigjioze. Të tri grupet bashkëjetonin në paqe e harmoni, bashkëpunonin dhe sollën në botë vepra të ndryshme të pasura, si në filozofi, shkencë, art, matematikë, letërsi, teologji etj.. Përballë kemi fjalën e analistit dhe gazetarit të njohur britanik, Gerald Butt, ku ndër të tjera thekson kontributin në pasurinë intelektuale që dha ky vend, madje ai në citatin e tij përmend vetëm shifrën e një pjese të diturisë-libra që posedonte Grënada si rezultat i punës dhe angazhimit të popullatës nën sundimin islam: “Kur të krishterët pushtuan Grënadën, ata i dogjën të gjithë 80,000 librat që gjendeshin në bibliotekën e pallatit-për të bërë që të shuhej kujtesa e sundimit islam.”³ Pra, shkurtimisht, ndërveprimi mes grupeve fetare ishte i dukshëm dhe frytdhënës, e në këtë formë sigurisht se Andaluzia do lulëzonte. Ehlu-dhimmeh ndërkaq, detyroheshin të paguanin xhizjen, taksë kjo e cila paguhej në vend se të shërbenin ushtarakisht, por ishte shumë simbolike. Për më tepër, taksa ishte në përputhje të kategorisë profesionale, ndërsa gratë, fëmijët, murgjit, të paafitit, të sëmurët, lypsarët dhe skllëvërit ishin të liruar.⁴

KORDOVA

Kordova ishte prej qyteteve më të veçanta të Andaluzisë, e pasuruar me dije, art, estetikë, arkitekturë brilante dhe e pashembullt, u krahasua me Bagdadin që njihej si qendër e dijes. Historianët vlerësojnë se në vitin 1000, qyteti ka pasur 300 deri në 500 mijë banorë.⁵ Qyteti kishte rreth 200 mijë shtëpi, biblioteka të shumta, tregje, rreth 600 xhami e medrese, kisha e sinagoga, 800 hamame, 50 spitale dhe punishte.⁶ Xhamia e Kordovës me 856 shtylla është vepra më e rëndësishme e arkitekturës fetare andaluziane. Ndërtimi i saj filloi në vitin 786 me porosi të Abdurrahmanit I, me shtesat që iu bënë eventualisht u zmadhua derisa arriti në përmasat e sotme mbresëlënëse.⁷ Kjo ndërtesë madhështore është ruajtur, porse kur u morr Kordova në vitin 1236 nga të krishterët, u kthye në katedrale. Edhe sot ekziston kjo ndërtesë duke dëshmuar për arkitekturën tejet të bukur andaluziane. Kordova ra nga sundimi i myslimanëve në vitin 1236.

INKUIZICIONI

Deri tani vështruam shumë cekët mbi gjendjen e Andaluzisë gjatë sundimit mysliman. Mirëpo, ashtu si çdo mbretëri gjatë historisë, edhe ajo e myslimanëve pati batica e zbatica. Në fillim, sunduesit zgjidheshin prej guvernatorëve, kalifëve apo edhe vetë banorëve të Andaluzisë, duke iu dorëzuar posti atij që ishte më meritori. Por, me kalimin e



kohës, afro dyzet vjet më vonë, pozita e udhëheqësit i trashëgohej familjes së sunduesit. Kjo, natyrisht se ishte me pa të drejtë dhe nuk përkonte me sunetin. Pra, pavarësisht nëse pasardhësi kishte aftësi udhëheqëje apo jo, atij i takonte sundimi. Dhe natyrisht se, në këtë formë, sundimi ka prirje të dobësohet. Pos kësaj, ajo që çoi në dobësimin e myslimanëve, ndër të tjera, ishte edhe fakti se pasuria u zgjerua konsiderueshëm dhe thuhet se asaj nuk i shihej fundi në Andaluzi, e kjo i tundoi rëndë myslimanët. Këto tundime, pastaj mosmarrëveshjet për pushtet, e drejtuan bashkësinë islame në përçarje e madje edhe lufta civile. Këto ndikuan thellë në dobësimin e pushtetit të tyre, ndërsa nga ana tjetër, të krishterët trinitarianë e shfrytëzuan këtë pikë të dobët të myslimanëve që të ndërmerrnin hapa gradual e konsistentë për t'i sulmuar myslimanët, ndonëse kjo nuk ndodhi menjëherë dhe vrullshëm, por, siç përmendëm, në mënyrë konsistente derisa u hap zyrtarisht inkuizicioni. Edhe pse inkuizicioni s'ishte instaluar ende, të krishterët me urdhra nga i pari i tyre, Papa, bënë përndjekjen e myslimanëve dhe hebrejve, dhe ndërmorën hapa derisa arritën të forcoheshin vet dhe të dobësohej tjetri. Kisha, si institucion normativ e me autoritet juridiksional në atëbotë, shpallte dekrete mbi popullin. Po, cilat ishin disa nga këto dekrete të lëshuara nga kisha që ndikuan drejtpërdrejt në dobësimin e bashkësive tjera fetare? Në vitin 1216, Këshilli Lateran lëshoi një dekret, që një veshje e dalluar dhe një shenjë duhej të mbaheshin nga të gjithë hebrejtë dhe myslimanët. Kjo lloj veshjeje u bë e njohur si “san-benito”. Kjo masë nuk ishte vetëm përçmuese, por edhe e rrezikshme, sepse secili që mbante veshje të tillë ekspozohej ndaj ofendimeve dhe keqtrajtimeve, sidomos kur

udhëtonin rrugëve tejet të pasigurta. Aplikimi i një mase të tillë çoi në vrasje të shumta nëpër rrugë.⁸ Në vitin 1248, Papa Inocenti i IV, urdhëroi mbretin e Aragonës që “Morot (myslimanët) të mos kishin asnjë trajtim tjetër përveçse si skllevër”. Në vitin 1250 ishte lëshuar një dekret, që askush nuk mund të blinte apo shiste nga një mysliman, përveç nëse ai posedonte një leje të posaçme për një veprim të tillë.⁹ Kishte dhe shumë ngjarje të tjera që shënuan skllavërimin e bashkësive të tjera fetare, dhe ngritjen në pushtet të krishterëve trinitarianë. Autorizimi i inkuizicionit u bë në vitin 1478, ndërsa në vitin 1483, u emërua Inkuizitori Gjeneral dhe u bë institucionalizimi i tij (i inkuizicionit). Inkuizicioni ishte sistem që dënonte heretikët, pra, ata që pagëzoheshin prej myslimanëve apo hebrenjve me dhunë dhe pastaj shfaqnin ndonjë “tradhti” ndaj krishterimit, qoftë kjo duke vepruar apo mosvepruar diçka që jepte përshtypjen se personi në fakt është ende në fenë e tij para pagëzimit. Fjala vije, heretik konsiderohej një person që nuk pinte verë apo hante mishin e derrit, duke lënë përshtypjen se është mysliman apo hebre, sepse që të dyja e ndalonin konsumimin e tyre. Apo nëse dikush lahej të premten dhe vishej mirë, duke lënë përshtypjen se ishte mysliman dhe myslimani pastrohet të premteve sipas sunetit. Pos këtyre, dënohej edhe blasfemia apo çdo lloj kundërshtimi që bëhej ndaj kishës. Inkuizicioni dënonte përmes torturës, burgimit a djegies. Dënimi pra aplikohet të dikush që nuk pranonte të pagëzohej, e që në këtë rast vritej, apo tek ai që u pagëzonte por nuk sillej si i krishterë. Nga dënimi nuk përjashtohej as fëmija. Pos këtyre, heretikëve u konfiskohej edhe pasuria, andaj fjala vije, po të dënohej me burg ndonjëri, pasi të dilte nga burgu dilte i varfër pasi nuk e posedonte më pasurinë e vet. Kësisoj, sistemi pati mundësinë e pasurimit të shpejtë. Për t’i ikur konfiskimit të pasurisë, ishte mundësia e vetme ajo që personi ta denonconte veten si të fajshëm dhe të pendohej. Përndryshe, nëse denoncohej nga dikush tjetër, pësonte konfiskimi dhe dënimi. Në këtë mënyrë, shumë persona e denoncuan veten dhe të tjerët që të ruheshin nga njëri-tjetri në rast se denoncoheshin. Një përjashtim rregullë ku mund të shpëtonte një heretik nga konfiskimi i pasurisë dhe nga burgimi ishte nëse denonconte veten dhe të tjerët vullnetarisht në “fazën e mëshirimit”, periudha e 30-të deri në të 40-tën ditë të mëshirës së dhënë nga inkuizicioni. Pasuria e konfiskuar shkonte për kurorën. Ferdinandi dhe Isabella e ndanin atë pasuri në tri grupe: njërin për luftë kundër myslimanëve, një për inkuizicionin dhe një për çështje fetare, ndonëse nuk ishte praktikuar formalisht. Kur kthehemi te dënimet që aplikoheshin te heretikët, në fakt, nuk ishin të vetmit ata që pësonin edhe pse ishte “faji” i tyre personal, por, nën udhëzimet e Torquemadas të lëshuar në Seville, në nëntor të vitit 1484, edhe pasardhësit, edhe të dënuarit vuanin për krimin e tij apo të saj: Fëmijët ose nipërit e të dënuarve nuk mund të mbanin poste zyrtare publike, si: gjyqtarë, kryebashkiakë, policë, juristë...¹⁰

FUNDI I INKUIZICIONIT

Inkuizicioni vazhdoi me shekuj, por kur përfundoi zyrtarisht? Gjatë këtyre shekujve, duke u bërë spastrimi i “heretikëve” vërehet se kishte, ndër të tjera, rënie të madhe ekonomike e financiare në Spanjë. Pas parasysh se, lulëzimi i vendit u bë nga një punë e vazhdueshme e fuqizuar dhe e begatuar nga bashkëveprimi mes fiseve, pavarësisht fesë, tani duke ndodhur e kundërta, pra, vrasje e torturë e armiqësi ndaj tjetrit, është e logjikshme që ai lulëzim s’do të zgjaste shumë. Kështu, inkuizitorët me punën e tyre në fillim natyrisht u pasuruan, por me kohën, bujqësia, tregtia e fusha të tjera, filluan të zbehen, pasi me to merreshin shumë nga myslimanët e hebrenjtë, e pastaj fuqia punëtore ra me rënien e këtyre dy bashkësive. Natyrisht, edhe pasurimi i inkuizitorëve, edhe spastrimi fetar, edhe rënia ekonomike, asnjëra as tjetra nuk ndodhën brenda javësh e as vitesh, por shekujsh. Në shek. XIX u mbyll zyrtarisht procesi i inkuizicionit, por edhe para kësaj ai qe zbehur, kjo pasi shumë nga populli ishin mbytur, shumë persona kishin emigruar, nuk kishte mbetur shumë viktima, andaj edhe presioni ishte zbehur. Mirëpo edhe nuk vërehej më se kush ishte vërtet i krishterë e kush pretendonte sa për t’i ikur dënimit, andaj me kohën ky sistem filloi të binte. Ndërsa viteve të fundit veçse ishte zbehur veprimtaria e inkuizicionit, ai, u anulua dhe u mbyll zyrtarisht më 15 korrik 1834, ku ishte bërë një dekret formal me të cilin përfundimisht inkuizicioni ishte shtypur. Nga kjo datë inkuizicioni pushoi së ekzistuari në Spanjë.¹¹ Sot, në Spanjë jetojnë shumë myslimanë në paqe dhe gëzojnë të drejtat e tyre. Spanja ka një bukuri të veçantë dhe kulturë të pasur, e cila ende ka gjurmë të së kaluarës së saj andaluziane. Ky punim, ndër të tjera, pati qëllim të theksojë faktin se, të gjithë njerëzit, pa dallim feje e nacionaliteti mund të jetojnë nën një çati për sa kohë e respektojnë dhe e ruajnë njëri-tjetrin. Vetëm në këtë mënyrë jeta do lulëzojë dhe vazhdojë të sjellë art e bukuri në përvojën e njerëzve.

1 Ibrahim Kalin, “Unë, tjetri dhe përtej”, përkthyer nga Rubin Hoxha (Shkup: LOGOS-A, 2017), f. 147.

2 <https://www.britannica.com/place/Al-Andalus>, 17.12.2025.

3 Gerald Butt, “E kaluara islame e Spanjës”, revista “Dituria Islame” 234, janar 2010, f. 24.

4 Ahmad Thomson, “Islami në Andaluzi”, përktheu: Ejup Ramadani (Prishtinë: Dituria Islame, 2022), f. 48.

5 Ibrahim Kalin, “Unë, tjetri dhe përtej”, përkthyer nga Rubin Hoxha (Shkup: LOGOS-A, 2017), f. 152.

6 Po aty, 152.

7 Ibid, 154.

8 Ahmad Thomson, “Islami në Andaluzi”, përktheu: Ejup Ramadani (Prishtinë: Dituria Islame, 2022), f. 172.

9 Ibid, 173.

10 Ahmad Thomson, “Islami në Andaluzi”, përktheu: Ejup Ramadani (Prishtinë: Dituria Islame, 2022), f. 185, e ky i bazuar në: H. Kamen, “The Spanish Inquisition”, f. 120.

11 Ibid, 363.

Në Kosovë u prit dhe u festua festa e Kurban Bajramit

Ashu si në mbarë botën myslimane, edhe në Kosovë, më 27 maj 2026, u prit dhe u festua festa e Kurban Bajramit, një festë e cila vjen pas kryerjes së ritualeve të haxhit, dhe që në vete simbolizon sakrificën, humanizmin dhe solidaritetin ndërmjet njerëzve.

Manifestimi qendror i faljes së namazit të Kurban Bajramit i mbajtur në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, filloi me faljen e namazit të sabahut, të cilit i priu kryetari i Këshillit të BI-së së Prishtinës, Hetem ef. Sopjani, për të vazhduar më pas me ligjëratën kushtuar festës, të cilën e mbajti kryeimami i Këshillit të BI-së së Skenderajt, Arbnor ef. Sinani. Ligjëratat u karakterizuan me mesazhet për paqe, solidaritet, harmoni dhe dashuri ndërmjet besimtarëve.

Pas faljes së namazit të Kurban Bajramit, të cilit i priu Mustafë ef. Dallku, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mbajti edhe hytben e Bajramit, në të cilën adresoi mesazhet për unitet, bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet vete, larg gjuhës së urrejtjes dhe përçarjes.

“Sot, në këtë mëngjes të bukur të kësaj dite madhështore, miliona besimtarë nga të gjitha anët e botës janë mbledhur në tokën e bekuar të Mekës, duke iu përgjigjur thirrjes së përrjetshme të Ibrahimit a.s., për të dëshmuar unitetin, barazinë dhe devotshmërinë e shoqërisë islame. Në mesin e tyre gjenden edhe haxhilerët tanë nga Kosova, të cilët edhe sot pranë Qabesë luten për paqe, falje, mëshirë dhe mirëqenie për popullin tonë dhe për mbarë njerëzimin. Prandaj, në këtë ditë të madhe, le të pastrojmë zemrat tona nga urrejtja, përçarja dhe egoizmi, le të forcojmë lidhjet familjare e

shoqërore, le t'i ndihmojmë nevojtarët dhe le të bëhemi njerëz të paqes, të dijes dhe të përgjegjësishë”, tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Myftiu Tërnavë, në mesazhin e tij, duke marrë parasysh zgjedhjet e njëpasnjëshme, u bëri thirrje subjekteve politike që të unifikohen për të mirën e vendit dhe të krijojnë kushte më të mira për të rinjtë.

“Një komb që harron rrënjët e veta, rrezikon të humbë orientimin e tij në histori. Ndërsa një komb që e ruan kujtesën, kulturën dhe vlerat e tij, mbetet i fortë edhe përballë sfidave më të mëdha. Për të ndërtuar këto ideale të larta, vendi ynë ka nevojë, përveç stabilitetit ekonomik dhe politik, edhe për institucione funksionale dhe përgjegjësi shtetërore. Fatkeqësisht, interesat e ngushta grupore dhe përplasjet e pafundme politike të partive tona kanë lodhur qytetarët tanë dhe kanë krijuar pasiguri për të ardhmen. Mbajtja e zgjedhjeve të njëpasnjëshme, mungesa e unitetit institucional dhe polarizimi politik nuk i shërbejnë Kosovës, por e dobësojnë besimin qytetar dhe e zbehin shpresën e brezit të ri.”

PRITJA TRADICIONALE PËR URIME ME RASTIN E FESTËS SË KURBAN BAJRAMIT

Me rastin e festës së Kurban Bajramit, në selinë qendrore të Bashkësisë Islame të Kosovës, u organizua pritja tradicionale e mysafirëve. Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, pritë kërër institucionesh, përfaqësues politikë, diplomatë dhe mysafirë të shumtë, të cilët përcollën urimet e tyre me rastin e kësaj feste, duke vlerësuar njëkohësisht rolin dhe kontributin e vazhdueshëm të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Kam nderin që në festën e Kurban Bajrami të jem këtu në Bashkësinë Islame të Kosovës. Me këtë rast urova Myftiun Naim Tërnavë, por edhe bashkëpunëtorët e tij për festën e Kurban Bajramit.

Me këtë rast, më lejoni që të shpreh urimet e mia edhe për gjithë besimtarët myslimanë, por po ashtu edhe për shqiptarët kudo që janë, brenda Kosovës, por edhe jashtë saj.

Festa e Kurban Bajramit është festë e shenjtë e besimit islam dhe kjo na kujton vlerat e sakrificës, solidaritetit, mirësisë, respektit e përkushtimit për vendin, vlera këto të cilat duhet t'i mbajmë lart e më lart dhe rreth së cilave duhet të jemi të



bashkuar edhe si institucione, edhe si qytetarë, por edhe si shoqëri.

Unë sot po ashtu falënderova Bashkësinë Islame të Kosovës, falënderova Myftiun Tërnavë, për rolin pozitiv që kanë pasur në vazhdimësi në shoqërinë tonë, për ndikimin pozitiv, për luftimin e dukurive negative me të cilat përballlet shoqëria jonë, por, gjithashtu edhe për ndihmën e qytetarëve në nevojë. Pra, është pikërisht Bashkësia Islame e Kosovës, përmes Shoqatës “Bereqeti”, përmes bashkëpunëtorëve dhe partnerëve që kanë ndihmuar mijëra familje gjatë gjithë kësaj periudhe kohore. Faleminderit Myfti!

Myftiu dhe sot edhe një mesazh dhe më njoftoi që ka pasur një ligjëratë, në të cilën ka kërkuar që gjuha e urrejtjes, sulmet, gjuha linçuese të ndalohet, sepse ajo nuk ka vend në shoqërinë tonë. Prandaj, e falënderova edhe për këtë aspekt. Më lejoni që t’ju uroj edhe një herë të gjithëve, edhe juve media për festën e Kurban Bajramit, uroj më të mirat për qytetarët dhe për secilën familje.

Faleminderit!



Znj. Albulena Haxhiu,
Udhëheqëse e Presidentes së Kosovës

Vizitën e parë për festën e Kurban Bajramit, si për çdo vjet, edhe sivjet vijmë te Bashkësia Islame e Kosovës për t’ia uruar Myftiut Naim Tërnavë dhe bashkëpunëtorëve të tij këtë festë të sakrificës, e cila na e përkujton dhe vazhdimisht na mëson që edhe sakrificë është festë, sepse ne i gëzojmë të mirat dhe frytet e atyre të cilët kanë sakrifikuar para nesh dhe na kanë mundësuar që ne të kemi liri e prosperitet.

Para se gjithash dëshmorët dhe martirët e kombit, ku ne asnjëherë nuk e harrojmë që aty janë edhe 37 imamë – hoxhallarë nga lufta çlirimtare, bartëse e së cilës ishte UÇK-ja, e deri tek ajo që bëjmë sot si institucione të shtetit, si Bashkësi



Islame, si shoqatë “Bereqeti” që qytetarëve të Republikës t’ju dalim në ndihmë për çdo nevojë që kanë.

Meqenëse Kurban Bajrami është festë, e cila na obligon të ndihmojmë njëri-tjetrin, të përkujdesemi për njëri-tjetrin, të tregojmë solidaritet, bujari, dashamirësi për të mirën e përgjithshme, duke mos e lënë asnjërin mbrapa.

Edhe një herë urime Kurban Bajrami, me fat e për hair siç themi ne në mënyrë popullore, të gjithë qytetarëve.

z. Albin Kurti,
Kryeministër i Kosovës

Urime festa e Kurban Bajramit gjithë besimtarëve myslimanë kudo që janë në Kosovë dhe në vendet e trojeve tona.

Jam këtu për të shprehur mirënjohjen, por edhe urime tona Myftiut Naim Tërnavë, gjithë Bashkësisë Islame, ashtu që të dëshmojmë edhe njëherë si gjithmonë respektin e ndërsjellë, bashkëjetesën ndërfaqetare, gëzimin ndërvëllazëror, bashkëndarjen e dhimbjes dhe gëzimit, në këtë rast bashkëndarjen e ndjenjave të festës, sikur është Kurban Bajrami.

Çdo festë është një lartësim i shpirtit drejt Krijuesit të gjithëpushtetshëm. Çdo festë është një vetëdije e njeriut për të nënshtruar përpara dashurinë, e cila buron nga qielli dhe sigurisht se të gjitha këto përcillen me sakrificë, me falje, me pajtim dhe me bashkëndarje të përgjegjësisë për të ardhmen që kemi.



Është një moment i mirë që së bashku me Myftiun, por edhe me të gjithë të tjerët, në këtë festë të lutemi për vendin tonë, për politikën tonë që të qetësohet dhe të marrë përgjegjësitë dhe të mos vazhdojë në përplasje se kush ka për të pasur pushtet, po ku do ta çojmë të ardhmen e fëmijëve tanë dhe të jetës sonë.

Faleminderit, e paqja mbretëroftë mbi të gjithë ne!

Dom Lush Gjergji,
Ispeshkvi i Ispeshkvisë së Kosovës

Më lejoni që edhe në emër të bashkëpunëtorëve, t’iu uroj festën e Kurban Bajramit të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës që festojnë këtë festë, uroj për sa më shumë begati, uroj për shëndet dhe të gjitha të mirat për secilën familje që feston sot në Kosovë. Mbi të gjitha uroj për më shumë solidaritet ndërnjerëzor, i cili është i domosdoshëm në këtë kohë në të cilën po kalon Kosova.



Dua edhe sot ta falënderoj Kryemiftun dhe gjithë bashkëpunëtorët e tij dhe gjithë Bashkësinë Islame për punën që e bëjnë, për punën që e bëjnë në dy rrafshë, në rrafshin e parë, duke ndihmuar ata që kanë më së shumti nevojë, jo vetëm në këtë Kurban Bajrami, por edhe për çdo situatë tjetër, duke u siguruar që ata t'i kenë sofrat plot, duke u siguruar që ata të mund të festojnë edhe këtë festë me begati në sofrat e tyre, dhe në të njëjtën kohë i falënderoj për bashkëpunimin që kemi pasur për ta ngritur edhe më shumë subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, për ta forcuar atë edhe më shumë dhe për t'u siguruar që sa më shumë shtete anekënd botës ta mbështesin Republikën tonë.

Ky është edhe një kontribut atdhetar, të cilin Bashkësia Islame e Kosovës vazhdon ta japë, e për të cilin jemi jashtëzakonisht shumë mirënjohës.

Urime edhe një herë Kurban Bajramit gjithë qytetarëve që e festojnë, edhe juve, mediave, natyrisht që sot jeni në punë.

Znj. Vjosa Osmani,
Ish-presidente e Kosovës

Si zakonisht, në festa të tilla vijmë për ta urren Bashkësinë Islame, Myftiun, mikun tim, Naim Tërnavë. Për festën e Kurban Bajramit shfrytëzoj rastin që gjithë besimtarëve të besimit islam t'ju uroj këtë festë të solidaritetit, sakrificës, një ditë e veçantë që njerëzit i bashkon, njerëzit shkojnë të urojnë te njëri-tjetri, kështu ka qenë, kështu do të jetë dhe kështu duhet të jetë edhe në të ardhmen.

Është kënaqësi që isha këto dhe gjithë familjeve në Kosovë ju uroj shëndet, begati dhe mirëqenie.

Faleminderit shumë!

z. Bedri Hamza,
Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës



Sot, me bashkëpunëtorët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në emër të anëtarësisë sonë urrem Myftiun Tërnavë, bashkëpunëtorët e tij dhe gjithë komunitetin mysliman për festën e Kurban Bajramit, një festë që na mëson shumë, na mëson për sakrificën si vlerë sublime tonën dhe obligim ndaj Krijuesit dhe ndaj njëri-tjetrit, për solidaritetin ndaj të tjerëve, sidomos për ata që janë në hall e në nevojë, për mirësinë ndaj miqve, familjarëve dhe shoqërisë sonë.

Në këtë festë, më lejoni të uroj gjithë popullin tonë, besimtarët myslimanë për këtë festë të Kurban Bajramit dhe qofshin këto vlera gjithmonë vlera të sjelljes sonë njerëzore secilën ditë, e jo vetëm në këtë festë.

Urime dhe faleminderit!



z. Lumir Abdixhiku,
Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës

Faleminderit Myftiut Tërnavë për pritjen sot për Bajram. Kjo është një festë e madhe e besimtarëve myslimanë në Kosovë, mirëpo është festë që dhe besimtarët e tjerë e respektojnë dhe e duan.

Ajo që kisha mund t'ju thosha sot është që Kosova dhe populli shqiptar janë me fat për harmoninë fetare që e kemi, por edhe për mesazhin që e përcjell Bashkësia Islame e Kosovës në vazhdimësi për një shtet të së drejtës, për një shtet që kujdeset për qytetarët e vet.

Në emër të Aleancës, i kam ofruar këto fjalë edhe sot për Myftiun Tërnavë dhe gjithë Bashkësinë Islame të Kosovës. Faleminderit!

z. Ardian Gjini,
Kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës



Bajram Zeqiri

Reportazh nga organizimi i haxhit 2026 nga Bashkësia Islame e Kosovës

Nga Kosova drejt Mekës - një udhëtim i përjetuar me shumë përkushtim



Nën kujdesin dhe organizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës, edhe këtë vit, me shumë përkushtim dhe kujdes të veçantë, nisi dhe përfundoi me sukses organizimi i haxhit për 1576 haxhilerë nga Kosova, të cilët këtë vit morën rrugën drejt vendeve të shenjta për ta kryer kushtin e pestë të Islamit, haxhin.

Përgatitjet për këtë udhëtim kishin filluar qysh herët, ndërkaq, më 15 prill 2026, për të dëshmuar gatishmërinë dhe angazhimin e lartë të Bashkësisë Islame të Kosovës për një organizim sa më të mirëfilltë të haxhit, në ambientet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, u mbajt një takim ndërmjet udhëheqësve të Haxhit të Kryesisë së BIK-ut dhe udhëheqësve të haxhilerëve nga Këshillat lokalë të BIK-ut. Gjatë këtij takimi u kërkuar nga udhëheqësit që të rrisin edhe më tej përkushtimin e tyre në shërbim të haxhilerëve, si dhe të jenë të gatshëm që t'u përgjigjen me përgjegjësi të plotë të gjitha kërkesave që mund t'i kenë haxhilerët gjatë këtij udhëtimi të rëndësishëm shpirtëror të tyre. Gjatë këtij takimi u theksua edhe njëherë rëndësia e koordinimit sa më të mirë ndërmjet Kryesisë dhe Këshillave lokalë për të siguruar një organizim sa më të suksesshëm dhe një përvojë sa më të dinjitetshme për haxhilerët tanë në vendet e shenjta.

Pas këtij takimi, në të gjitha Këshillat e BI-së së Kosovës, u organizuan trajnime dhe ligjërata me haxhilerët me udhëzimet e duhura për kryerjen e haxhit, ndërkaq në fund

të këtyre trajnimeve, mbahej edhe dua e haxhit, me lutjet për haxh dhe ibadete të pranuar.

Më 15 maj 2026, grupi i parë i haxhilerëve nga Prishtina, nga Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" u nis drejt aeroportit të Xhides. 231 haxhilerët e parë u përcollën nga familjarë të shumtë, teksa haxhilerët u shprehën të lumtur që po u jepej mundësia ta vizitonin Qabenë dhe ta kryenin një nga obligimet më madhore të fesë islame. Për t'i përcjellë haxhilerët, në aeroport ishte i pranishëm edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili u uroi rrugë të mbarë, shëndet dhe haxh të pranuar, duke kërkuar që në lutjet e tyre t'i kujtojnë familjet dhe vendin.

Pas grupit të parë, më 16, 17 dhe 18 maj 2026, udhëtuan edhe gjashtë grupe të tjera, për ta përmbledhur kështu numrin prej 1576 haxhilerëve. Haxhilerët në aeroportin e Xhides priteshin nga udhëheqësit e Drejtorisë së Haxhit të BIK-ut, të cilët në mënyrë të organizuar, i akomodonin në autobusët dhe menjëherë niseshin drejt Mekës.

Gjatë gjithë rrugës për në Mekë, haxhilerët tanë këndonin telbijen "Lebejk Allahume lebejk" për të dëshmuar kështu përgjigjen për urdhrin e Zotit për kryerje të haxhit. Pasi që arrinin në Mekë, të udhëhequr nga udhëheqësit lokalë, haxhilerët niseshin drejt Qabesë për kryerjen e umres së haxhit. Natyrisht se emocionet e takimit të parë me Qabenë për gjithë haxhilerët ishin të pa përshkruara, ndjenja e tyre e parë përballë Qabesë i mahniste dhe sikur zhvendoseshin nga kjo botë në një botë imagjinare, që kurrë më parë se kishin menduar. Të tjerë, saji ndërmjet Safasë dhe Mervasë, uji zemzem, falja pas Mekami Ibrahimit dhe të tjera obligime, shoqëroheshin gjithnjë nga udhëheqësit me këshilla dhe me histori të treguara. Asnjëherë nuk mungonte edhe këshilla për të bërë dua, duke ua kujtuar që në duatë e tyre të mos mungojë as vendi ynë Kosova.

Pas përfundimit të umres së haxhit, haxhilerët tanë kishin mundësi që çdo ditë, në xhaminë e hotelit ku qëndronin të ndiqnin ligjërata tematike kushtuar vlerës dhe rëndësisë së haxhit, si dhe rreth përgatitjeve që duhen t'i bëjnë për qëndrimin në ditën më madhështore të vitit, në Ditën e Arafatit.



Gjatë kësaj periudhe, haxhilerët tanë shijonin momentet e pa harruara pranë Qabesë së bekuar, duke shfrytëzuar kështu çdo moment që të falen pranë saj dhe për të bërë ndonjë umre apo tavaf më shumë.

Në mbrëmjen e 25 majit 2026, haxhilerët tanë, të organizuar në grupe-grupe, u nisën drejt rrafshnaltës së Arafatit, ku do ta kalonin ditën e nëntë të dhulhixhes aty. “Haxhi është Arafat” – ka thënë Pejgamberi a.s., prandaj, bashkë me miliona haxhilerë nga e mbarë bota, edhe haxhilerët tanë, më 26 maj 2026, në Natën e Kurban Bajramit, në Ditën e Arafatit, u gjendën tok të bashkuar për ta kryer kështu njërin nga kushtet themelore të haxhit. Gjatë qëndrimit në Arafat, haxhilerët tanë falën namazin e drekës dhe të ikindisë të bashkuar, të cilëve iu priu kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, teksa ligjëratën kushtuar vlerës së kësaj dite dhe haxhit në përgjithësi, e mbajti anëtar i Kryesisë së BI-së, Agim ef. Hyseni, e më pas duanë e haxhit e bëri imami Remzi ef. Haziri. Më pas u lexua Kuran dhe u kënduan

telbije, teksa haxhilerët vazhduan gjithë ditën e tyre duke bërë dua dhe duke madhëruar Zotin në forma të ndryshme.

Pas perëndimit të diellit, haxhilerët lanë kodrën e Arafatit, për t'u nisur më pas drejt Muzdelifes, aty ku do ta kalonin një pjesë të natës. Qëndrimi aty u karakterizua me faljen e namazit të akshamit dhe të jacisë, edhe këto të bashkuar, e më pas edhe me mbledhjen e guralecëve, të cilët do t'i gjuanin më pas në Xhemerate, për ta gjuajtur kështu simbolikisht djallin e mallkuar.

Pas kryerjes së këtyre ritualeve dhe kalimit të një pjese të natës në Muzdelife, haxhilerët u nisën drejt Minas, e më pas edhe drejt Xhemerateve, ku gjuajtën shtatë guralecët e parë. Pas kësaj ata u kthyen në hotel, duke uruar njëri-tjetrin për pranim të haxhit dhe për festën e Kurban Bajramit. Në mbrëmje, haxhilerët kryen edhe tavafin e haxhit, ndërsa edhe dy ditë të tjera më pas, gjuajtën guralecët në Xhemerate, ndërsa krejt në fund edhe kryen tavafin e lamtumirës apo tavafin e përshëndetjes së Qabesë.





Gjatë qëndrimit në Meke, me ftesë të Princit të Kurorës e kryeministrit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Lartësisë së tij, Muhamed bin Selman, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në pritjen festive të Bajramit në Pallatin Mbretëror në Mina, në Mekën e bekuar. Kjo është një nga pritjet tradicionale të organizuara nga Mbretëria e Arabisë Saudite me rastin e festës së Bajramit, në të cilën marrin pjesë zyrtarë të lartë shtetërorë, liderë fetarë dhe personalitete e mysafirë nga vende të ndryshme të botës.

Po ashtu, një ngjarje që e karakterizoi dhe e veçoi organizimin e haxhit 2026 nga Bashkësia Islame e Kosovës ishte edhe ndarja e çmimit si një ndër shtatë krerët më të mirë ndërlidhës në organizimit e haxhit 2026, sipas Ministrisë së Haxhit dhe Umres së Mbretërisë së Arabisë Saudite. Ky çmim iu nda kreut të misionit të haxhit të Kosovës, kryeimamit Vedat ef. Sahiti, i cili njëherësh u shpallë si një nga shtatë krerët më të mirë ndërlidhës në organizimin e Haxhit. Çmimi prestigjioz ndërkombëtar u nda në një konkurrencë të përfaqësuesve nga më shumë se 100 vende të botës. Bashkësia Islame e Kosovës shprehu krenarinë e saj për këtë njohje të rëndësishme, e cila konfirmon jo vetëm kontributin individual të kryeimamit Sahiti në krye të drejtorisë së Haxhit, por edhe seriozitetin sistematik, profesionalizmin dhe përkushtimin e të gjithë ekipit. Gjithashtu, Bashkësia Islame e Kosovës, e sheh këtë çmim si njohje, vlerësim dhe konfirmim të standardeve të larta organizative që Drejtoria e Haxhit dhe Umres ka kultivuar me sukses për vite me radhë në fushën e organizimit të haxhit dhe umres, si dhe reputacionin që gëzon midis institucioneve dhe autoriteteve saudite dhe partnerëve ndërkombëtarë. Çmimin e dorëzoi ministri i Haxhit dhe Umres, z. Taufik Rabiah, bashkë me dy zëvendësit e tij, ndërsa ndarja e tij u bë në ceremoninë përmbyllëse të Haxhit 2026 në selinë e Ministrisë së Haxhit dhe Umres në Mekë, ku edhe u dorëzua planprogrami orientues i haxhit të vitit të ardhshëm 2027.

Pas kryerjes së haxhit dhe përfundimit të qëndrimit në Meke, haxhilerët tanë u nisën drejt Medinës së Pejgamberit a.s.. Aty, përveç vizitës së Xhamisë së Pejgamberit a.s., haxhilerët patën mundësi që ta vizitojnë Kopshtin e Xhenetit (Reuda esh Sherifeh), që është një zonë e caktuar në pjesën e parme të Xhamisë së Pejgamberit a.s. dhe që shtrihet midis shtëpisë dhe minberit të Pejgamberit a.s.. Për këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë: "Pjesa midis shtëpisë sime dhe minberit tim është një kopsht prej kopshteve të Xhenetit." Më pas haxhilerët kanë kaluar pranë varrit të Pejgamberit a.s., Ebu Bekrit r.a. dhe Omerit r.a., ku kanë dërguar selamet dhe përshëndetjet e tyre për ta, për të vazhduar më pas edhe me vizitën dhe përshëndetjen e mijëra sahabëve të varrosur në Bekia. Përveç kësaj, të organizuar në grupe, haxhilerët tanë vizituan disa nga vendet historike të Medinës. Ata fillimisht vizituan kodrën e Uhudit dhe varrezat e shehidëve të Uhudit. Më pas, ata vizituan Xhaminë e Dy Kibleve, aty ku Pejgamberi a.s. në fillim të shpalljes ishte falur i kthyer nga Mesxhidi Aksaja, derisa i erdhi shpallja për t'u kthyer nga Qabeja e bekuar, ndërsa vizita më pas vazhdoi në Xhaminë Kuba, për të cilën Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ai që pastrohet në shtëpinë e tij, merr rrugën dhe niset për në Xhaminë Kuba dhe i fal dy rekate aty, i llogaritet sikur të ketë bërë umrë."

Edhe ditëve të qëndrimit në Medinë u erdhi fundi, kështu që më 5 qershor 2026, grupi i parë i haxhilerëve arriti shëndosh e mirë në Kosovë, teksa më pas, më 6, 7 dhe 8 qershor, arritën edhe gjatë grupet e tjera me haxhilerët nga Kosova. Në pritje të tyre, plot mall dhe emocione, kishin dalë familjarë të shumtë, të cilët u uruan mirëseardhje dhe haxh e ibadete të pranura.

Lusim Zotin e Madhëruar që haxhilerëve tanë t'ua ketë pranuar haxhin, duatë dhe gjitha ibadetet që i kanë përfunduar gjatë qëndrimit në vendet e shenjta, në Mekë dhe Medinë! Amin!

Bajram Zeqiri

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DIPLOMATIN Z. JAMES HAGAN

Më 8 maj 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim diplomatit, z. James Hagan, i cili është edhe zëvendësambasador i Irlandës në Hungari, që mbulon edhe Kosovën.

Gjatë këtij takimi, u bisedua për dialogun ndërfetar në Kosovë, bashkëjetesën dhe tolerancën ndërmjet komuniteteve fetare, si dhe për situatën e përgjithshme fetare në vend. Po ashtu, u diskutua edhe për sfidat dhe problemet me të cilat përballen komunitetet fetare, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe ruajtjes së harmonisë ndërfetare.

Myftiu Tërnavë e njohu diplomatit irlandez për rolin dhe angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës në promovimin e vlerave të paqes, mirëkuptimit dhe tolerancës në shoqërinë kosovare.



NËNSHKRUHET MEMORANDUMI PËR RIKONSTRUKTIMIN E XHAMISË SË IBRIT

Më 2 maj 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me kryeimamin Vedat ef. Sahiti, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për hartimin dhe zbatimin e projektit të rikonstruktimit të Xhamisë së Ibrit me kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurti dhe ministrin e Kulturës dhe Turizmit, znj. Saranda Bogujevci.

Me këtë memorandum, Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet ringritjen e këtij monumenti me rëndësi historike dhe kulturore. Po ashtu, gjatë këtij takimi është nënshkruar edhe një memorandum tjetër bashkëpunimi me Qeverinë e Kosovës, i cili synon forcimin e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore islame.

Myftiu Tërnavë theksoi se pikërisht në ditën kur përkujtohet 27-vjetori i djegies së kësaj xhamie, jam tejet i lumtur që në këtë ditë edhe po nënshkruhet memorandum për rikonstruktimin e saj. Këto angazhime janë pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në



vend, pas dëmeve të shkaktuara gjatë luftës së viteve 1998–1999.

Kujtojmë se Xhamia e Ibrit është ndërtuar në vitin 1777, ndërsa është djegur më 2 maj 1999.

MYFTIU TËRNAVA UROI KRYETARIN E RI TË KMSHZ-SË

Më 6 maj 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i ka dërguar një telegram urimi kryetarit të ri të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, Feim ef. Abazit.

Myftiu Tërnavë uroi për kryetarin Abazi shëndet, mbarësi dhe suksese në krye të kësaj detyre dhe të këtij misioni kaq të rëndësishëm për besimtarët dhe kombin tonë që jeton dhe vepron në shtetin mik të Zvicrës.

Ai ofroi gatishmërinë dhe përkushtimin personal dhe institucional që të vazhdojë bashkëpunimi institucional ashtu siç ka qenë deri më tani, në të mirë të fesë sonë të pastër islame dhe gjithë besimtarëve në trojet tona dhe kudo në diasporë.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË TAKIMIN E KOORDINATORËVE TË “BEREQETIT”

Më 12 maj 2026, Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” mbajti një takim me koordinatorët e saj, të cilin e udhëhoqi drejtori Xheladin ef. Fazliu. Në këtë takim, përveç për aktivitetet dhe organizimet e radhës të shoqatës, u diskutua edhe për organizimin sa më të mirë të shpërndarjes së mishit të kurbanit.

Në këtë takim mori pjesë edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili falënderoi të gjithë koordinatorët për punën dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm në shërbim të familjeve në nevojë. Ai po ashtu shprehu mirënjohje për të gjithë donatorët që kontribuojnë në veprimtarinë humanitare të shoqatës. Myftiu Tërnavë kërkoi nga koordinatorët që të vazhdojnë me përkushtim punën edhe në të ardhmen, duke



qenë sa më afër familjeve nevojtare dhe duke forcuar aktivitetet humanitare në shërbim të qytetarëve.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS

Më 13 maj 2026, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e radhës, të udhëhequr nga kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Gjatë kësaj mbledhje u diskutua për raportet e aktiviteteve të zhvilluara gjatë muajit Ramazan në Kosovë dhe në diasporë. Po ashtu pjesë e diskutimit ishte edhe njohja e anëtarëve të Kryesisë me parapërgatitjet rreth organizimit të haxhit dhe therjes së kurbanit për këtë vit.

Po ashtu, gjatë mbledhjes u diskutuan edhe lëndë të ndryshme, që i përkasin kësaj Kryesie.



U MBAJT CEREMONIA E ABSOLVENTIADËS PËR STUDENTËT FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME

E

Më 21 maj 2026, nën emocione dhe në një atmosferë solemne, në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, u mbajt ceremonia e absolventiadës për 25 studentë, që përfunduan me sukses studimet e tyre.

Ceremonia mbledhi rreth vetes profesorë, familjarë, përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe mysafirë të shumtë, të cilët ndanë së bashku gëzimin e këtij momenti të rëndësishëm për gjeneratën e re të diplomuar.

Dekani i Fakultetit, prof. dr. Islam Hasani, në fjalën e tij drejtuar absolventëve, tha se diploma që ata marrin sot përfaqëson shumë më tepër sesa përfundimin e studimeve. Ai theksoi se Fakulteti i Studimeve Islame nuk synon vetëm përgatitjen profesionale të studentëve, por edhe formimin e tyre si kontribuues aktivë në shoqëri dhe komunitet.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili këtë ditë e cilësoi si moment krenarie për të gjithë. Myftiu shprehu mirënjohje edhe për profesorët dhe kontributin e tyre ndër vite, ndërsa kujtoi me respekt ish-myftiun e Kosovës, dr. Rexhep ef. Bojën, të cilin e cilësoi ndër



njerëzit më meritore për ngritjen dhe zhvillimin e këtij institucioni.

Emocionet nuk munguan as në fjalimin e kryetares së Unionit të Studentëve, Amira Osmanit, e cila tha se kjo është një nga ato ditë ku njeriu mbetet mes buzëqeshjes dhe mallëngjimit. Ceremonia u pasurua me ilahi dhe poezi.

Në fund të ceremonisë, studentët u pajisën me certifikata, duke shënuar kështu përmbylljen e një etape të rëndësishme të jetës së tyre akademike.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYEIMAMIN E TREVËS SË KRAJËS, IRFAN EF. KACA

Më 22 maj 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryeimamin e trevës së Krajës (Mexhllisit të Ostrosit), Irfan ef. Kaca.

Gjatë këtij takimi u diskutua për gjendjen dhe sfidat me të cilat përballen banorët e kësaj treve, si dhe për mundësitë konkrete për të qenë më afër njerëzve tanë në Krajë, duke krijuar ura bashkëpunimi e mbështetjeje për ata që dëshirojnë rikthimin dhe forcimin e lidhjes së tyre me vendlindjen, traditën dhe vlerat tona shpirtërore e kombëtare.

Po ashtu, gjatë këtij takimi u bisedua edhe për braktisjen e kësaj treve, dukuri kjo që po ndikon drejtpërdrejt në zbrazjen e vendbanimeve dhe dobësimin e jetës shoqërore, kulturore e fetare në këtë krahinë me traditë dhe vlera të çmuara kombëtare.



NDIHMohen 76 JETIMË NË PRAG TË FESTËS SË KURBAN BAJRAMIT

Më 25 maj 2026, në prag të festës së Kurban Bajramit, Bashkësia Islame e Kosovës, ka ndihmuar 76 jetimë me nga 100 euro, me qëllim që të shpallë buzëqeshje dhe gëzim në këto ditë feste.

Kjo ndihmë vjen në kuadër të aktiviteteve humanitare dhe solidarizuese që organizohen tradicionalisht gjatë ditëve të festave fetare, e të cilat do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, duke treguar kështu një ndër prioritetet e institucionit për t'i ndihmuar jetimët dhe kategoritë në nevojë.

KRYEIMAMI SAHITI TAKOI KRYEIMAMËT E KËSHILLAVE TË BI-SË

Më 5 maj 2026, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka mbajtur një takim pune me kryeimamët e Këshillave të BI-së në Kosovë, ku u diskutua për avancimin e aktiviteteve edukativo-fetare nëpër xhami.

Në fokus të veçantë ishte mësim-besimi në xhamitë e Kosovës, si dhe organizimi i garave të mësim-besimit gjatë pushimit veror, duke u theksuar rëndësia e një organizimi të drejtë dhe motivues për nxënësit. Kryeimami Sahiti kërkoi nga kryeimamët që të punojnë edhe më tej me imamët dhe mualimet, në mënyrë që të nxisin një garë frymëzuese ndërmjet nxënësve, e cila jo vetëm që promovon dijen, por edhe kultivon etikën, disiplinën dhe dashurinë për mësimet fetare.

Ai theksoi se përmes një qasjeje motivuese, shpërblimeve simbolike dhe vlerësimit të përpjekjes së secilit nxënësi, mund të rritet interesimi dhe pjesëmarrja aktive në mësim-besim.



Në takim u fol edhe për sfidat në terren dhe nevojën për koordinim më të mirë ndërmjet Këshillave lokalë dhe qendrës, me qëllim të ngritjes së nivelit të edukimit fetar. Kryeimami Sahiti, në përfundim, falënderoi kryeimamët për punën e tyre, si dhe i inkurajoi ata për vazhdim të punës me përkushtim.

KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM KOORDINATOREN E TIKA-S, ZNJ. FULYA ASLAN

Më 8 maj 2026, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim koordinatoren e Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) në Kosovë, znj. Fulya Aslan.

Gjatë këtij takimi u bisedua për fillimin e punimeve në restaurimin e Xhamisë së Bajraklisë në Prizren, projekt ky me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore dhe fetare të vendit.

Kryeimami Sahiti falënderoi TIKA-n për mbështetjen dhe kontributin e vazhdueshëm në realizimin e projekteve të rëndësishme për Bashkësinë Islame të Kosovës, duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet dy institucioneve. Ai po ashtu theksoi nevojën e vazhdimin të bashkëpunimit edhe në të ardhmen, në funksion të ruajtjes së trashëgimisë islame dhe realizimit të projekteve me interes për besimtarët dhe shoqërinë në përgjithësi.



NË SARAJEVË U HAP EKSPOZITA “KUJTESA NË FOTOGRAFI” KUSHTUAR XHAMIVE TË SHKATËRRUARA NË BOSNJE DHE KOSOVË



Me rastin e shënimit të Ditës së Xhamive, më 7 maj 2026, në bibliotekën Gazi Husrev-beg në Sarajevë u hap ekspozita tematike “Kujtesa në fotografi: xhamitë e shkatërruara në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë gjatë viteve '90 – sakralocidi i planifikuar”, e organizuar bashkërisht nga Bashkësia Islame në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Bashkësia Islame e Kosovës. Ekspozita dokumenton përmes fotografive dhe dëshmimeve autentike shkatërrimin sistematik të trashëgimisë islame gjatë luftërave në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë.

Zëvendësisul-ulema, dr. Enes Ljevaković, tha se përmes manifestimeve “Ditët e Vakëfit” dhe “Ditët e Xhamive dhe Xhematit” kultivohet kultura e kujtesës dhe përkujtohen objektet fetare të shkatërruara gjatë luftës. Ai rikujtoi se më 7 maj 1993 u rrënu Xhamia Ferhadija në Banja Llukë, ndërsa kjo datë është caktuar si Dita e Xhamive. Sipas tij, mbi 600

xhami u rrënuan në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa një fat i ngjashëm i goditi edhe xhamitë në Kosovë, me synimin për të zhdukur gjurmët e identitetit kulturor dhe fetar të popujve vendas.

Drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese në Kryesinë e BIK-ut, Ramadan Shkodra, përcolli përshëndetjet e Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe theksoi se ekspozita nuk paraqet vetëm histori, por edhe kujtesën e një dhimbjeje që nuk duhet harruar. Ai nënvizoi se fotografitë dëshmojnë përpjekjet për të shkatërruar jo vetëm objektet fetare, por edhe identitetin, besimin dhe kujtesën kolektive. Sipas tij, xhamitë kanë qenë gjithmonë qendra adhurimi, edukimi dhe ruajtjeje të identitetit kulturor e kombëtar.

Drejtori i Drejtorisë për Punë të Jashtme dhe Diasporë pranë Rijasetit të Bashkësisë Islame në Bosnjë dhe Hercegovinë, Muhamed Jusiq, bëri të ditur se ekspozita po

prezantohet për herë të parë para publikut boshnjako-hercegovinas, pasi më parë ishte ekspozuar në disa qytete të Kosovës. Ai njoftoi se planifikohet që ajo të prezantohet edhe në qytete të tjera të Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe në vende të Bashkimit Evropian.

Në aktivitet foli edhe ministri për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët i Bosnjës dhe Hercegovinës, Sevlid Hurtiq, i cili kujtoi shkatërrimin e Ferhadijes dhe të shumë xhamive të tjera gjatë luftës, duke theksuar se shumica e tyre janë

rindërtuar me mbështetjen e Bashkësisë Islame dhe qytetarëve.

Gjatë agresionit serbo-çetnik ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës (1992–1995) u rrënuan 614 xhami dhe qindra objekte të tjera vakëfnore. Ndërkaq, gjatë Luftës Çlirimtare në Kosovë (1998–1999), u shkatërruan ose u dëmtuan 218 xhami, si dhe shumë institucione dhe prona të tjera të trashëgimisë islame.

DREJTORI SIMNICA VIZITOI QENDRËN ISLAME SHQIPTARE “HËRI” NË CYRIH

Më 1 maj 2026, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, vizitoi Qendrën Islame Shqiptare “Hëri” në Cyrih, Zvicër, ku fali namazin e xhumasë dhe mbajti një fjalë rasti para xhemit.

Në fjalën e tij, drejtori Simnica përshëndeti imamin Bilal ef. Tahiri, kryetarin Sami Leka dhe të gjithë xhematin, duke përcjellë përshëndetjet dhe falënderimet në emër të BIK-ut dhe Myftiut Naim ef. Tërnavë. Ai vlerësoi kontributin e mërgatës shqiptare dhe theksoi rëndësinë e xhamive në diasporë si qendra adhurimi, edukimi dhe bashkimi për komunitetin.

Po ashtu, drejtori i njohu të pranishmit me institucionet edukativo-arsimore të BIK-ut dhe me aktivitetet humanitare të Shoqatës “Bereqeti”.

Gjatë qëndrimit në Cyrih, ai vizitoi edhe disa qendra islame shqiptare në qytet dhe rrethinë. Ai fali namazin e ikindisë në xhaminë e Cyrihut me imamin Nebih ef. Rexhepi, namazin e akshamit në xhaminë e Regensdorfit me imamin Ferid ef. Zekiri, si dhe vizitoi xhaminë shqiptare në Seebach të Cyrihut, ku shërben imami Bashkim ef. Aliu.

Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet BIK-ut dhe qendrave islame shqiptare në Zvicër, si dhe në rrugë për të marrë pjesë në manifestimin e organizuar me rastin e 20-vjetorit të themelimit të xhamisë “Dituria” në Gjenevë, Zvicër.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN VALON EF. IDRIZI

Më 8 maj 2026, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka prituri në takim imamin e xhamisë “Medina” në Rheine të Gjermanisë, Valon ef. Idrizin.

Gjatë këtij takimi u bisedua për jetën fetare të bashkatdhetarëve në diasporë, për sfidat dhe aktivitetet që zhvillohen në xhamitë dhe qendrat islame jashtë vendit, si dhe për rëndësinë e ruajtjes së identitetit fetar e kombëtar të mërgimtarët.

Po ashtu, gjatë këtij takimi u diskutua edhe për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet xhamive dhe qendrave islame në diasporë me Bashkësinë Islame të Kosovës, në funksion të forcimit të lidhjeve institucionale dhe koordinimit të aktivitetëve fetare dhe edukative.





KY LIBËR SYNON TË ZGJOJË NË LIDHJE MË TË VETËDËSHME ME TË DËRËGUARIN E ALLAHUT A.S. "JA RESULULLAH, TI JE MË I DASHUR SE VETJA IME!" ËSHTË NË THIRRJE PËR REFLEKTIM, PASIM DHE PËRKUSHTIM, QË E KTHEN BESIMIN NGA NË KONSEPT TEORIK NË NË REALITET TË JETUAR.